

**INSTITUTI I HISTORISË “*ALI HADRI*”-PRISHTINË
INSTITUTI I HISTORISË-TIRANË
INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E
KULTURORE TË SHQIPTARËVE-SHKUP**

**ISA BOLETINI NË LËVIZJEN KOMBËTARE
SHQIPTARE**

(Materiale nga Konferenca Shkencore: “Isa Boletini në
Lëvizjen Kombëtare Shqiptare”, mbajtur në Prishtinë, më 5
qershor 2015)

Prishtinë, 2015

Kryeredaktor:
Prof. assoc. dr. Sabit SYLA

Redaktor shkencor:
Prof. dr. Isa BICAJ

Sekretar i redaksisë:
Dr. sc. Gjon Berisha

Redaksia:
Akademik Beqir META
Prof. dr. Sabile KEÇMEZI-BASHA
Akademik i assoc. Marenglen VERLI
Dr. sc. Skender ASANI

Redaktore gjuhësore:
Ma. sc. Shqipe DODA

Arti grafik:
Dr. sc. Teuta SHALA - PELI

Kjo vepër u financua nga Kuvendi i Republikës së Kosovës
Botohet me rastin e 100-vjetorit të rënies së Isa Boletinit me
bashkëluftëtarë

Konferenca Shkencore

“Isa Boletini në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare”

(5 qershor 2015)

Prishtinë, 2015



Fjala përshëndetëse e kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës Z. Kadri Veseli, në hapje të Konferencës



Nga punimet e Konferencës

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE

Sabit SYLA - Fjala e hapjes

Kadri VESELI - Fjalë përshëndetëse

1. Pajazit NUSHI

Isa Boletini dhe tematizimi enciklopedik i jetës dhe veprimtarisë së tij.....19

2. Sabile KEÇMEZI - BASHA

Trajtimi i figurës së Isa Boletinit në historiografinë shqiptare.....37

3. Proletar HASANI & Bernard ZOTAJ

Dimensioni ushtarak i Isa Boletinit.....47

4. Jusuf OSMANI & Bujar DUGOLLI

Roli i Isa Boletinit në pengimin e hapjes së Konsullatës Ruse në Mitrovicë dhe vrasja e konsullit rus.....73

5. Marenglen VERLI

Isa Boletini në mbrojtje të Shqipërisë së Pavarur (në Vlorë, Londër, Durrës).....87

6. Fatmira MUSAJ

Qëndrimi i Isa Boletinit ndaj politikës së Beogradit dhe elementit serb në Kosovë (1912 - 1916).....103

7. Ledia DUSHKU

Shoqëria “Shqipnia” dhe Isa Boletini.....117

8. Sokol GJËRMENI

Isa Boletini dhe kryengritja e vitit 1911.....127

9. Nebi DERVISHI

Veprimtaria atdhetare e Isa Boletinit në vitet

1912 - 1913.....143

10. Qerim LITA

Kryengritja e Shtatorit më 1913 dhe roli i Isa

Boletinit.....159

11. Halim PURELLKU

Shteti shqiptar dhe roli i Isa Boletinit, më

1913-1915.....177

12. Hakif BAJRAMI

Si u vra Isa Boletini, më 1916?.....193

13. Lush CULAJ

Bashkëpunimi i Patër Ëngjëll Palajt dhe Zef Gjiododës me

Isa Boletinin.....203

14. Fitim RIFATI

Bashkëpunimi i Isa Boletinit me krerët e trevave lindore

gjatë kryengritjeve të viteve 1910 - 1912.....211

15. Gjet NDOJ

Isa Boletini udhëheqës kryengritës, politikan dhe nacionalist

i shquar.....225

16. Dritan EGRO

Kosova dhe Isa Boletini, sipas gazetës zyrtare xhonturke

“Tanin” (1910).....241

17. Frashër DEMAJ

Aktivitetet e Isa Boletinit sipas burimeve britanike
1910 - 1912.....251

18. Xheladin SHALA

Isa Boletini në burimet serbe 1914 - 1916.....263

19. Sylë UKSHINI

Roli i Isa Boletinit në lëvizjen anti - xhonturke, sipas
burimeve arkivore austro - hungareze.....287

20. Isa BICAJ

Isa Boletini në dokumentet dhe shtypin malazez.....299

21. Sevdail DEMIRI

Pasqyrimi i figurës së Isa Boletinit sipas burimeve
dokumentare dhe shtypit bullgar, më 1912.....307

22. Teki KURTI

Vështrim i shtypit shqiptar mbi heroin kombëtar Isa
Boletini.....317

23. Adem ZEJNULLAHU

Isa Boletini në epikën historike, në poezinë e kultivuar dhe
në kujtimet e popullit.....325

24. Asllan MURATI

Sjellja e eshtrave të heroit kombëtar Isa Boletinit nga
Mali i Zi në Mitrovicë.....349

Beqir META

Fjala e mbylljes.....355

PARATHËNIE

Më 5 qershor të vitit 2015, Instituti i Historisë “*Ali Hadri*”-Prishtinë në bashkëpunim me Institutin e Historisë-Tiranë dhe Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve-Shkup, organizuan në Prishtinë Konferencën Shkencore: “*Isa Boletini në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare*”. Mbajtja e kësaj Konference i parapriu aktiviteteve të tjera, ndër të cilat përmendim rivarrimin e eshtrave të Isa Boletinit dhe bashkëlufëtareve të tij në vendlindjen e heroit, në Boletin.

Konferenca i zhvilloi punimet në sallën e Kuvendit të Republikës së Kosovës nën patronazhin e Kuvendit të Kosovës dhe të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Punimet u ndoqën nga shumë studiues, deputetë, ministra, drejtues të organeve pushtetare të nivelit qendror e atij lokal. Në veçanti, Konferencën e nderuan me pjesëmarrjen e tyre kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kadri Veseli, ambasadori i Republikës së Shqipërisë, Qemal Minxhozi, kryetari i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Hivzi Islami etj. Interesim të madh për këtë veprimtari treguan edhe mediat, të cilat ishin dukshëm të pranishme.

Organizimi i kësaj Konference Shkencore dhe publikimi i akteve të saj në 100-vjetorin e rënies së Isa Boletinit, janë fryt i bashkëpunimit të vazhdueshëm të tri instituteve tona të historisë, me qendra në Prishtinë, Tiranë dhe Shkup. E veçanta e kësaj here ishte realizimi i projektit me angazhimin dhe bashkërenditjen shumë të mirë të tri institucioneve tona. Ky bashkëpunim do të shkojë më tej, mbi bazën e platformës shkencore kombëtare, me projekte afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, duke u bërë kështu një shembull pozitiv në veprimtari të përbashkëta integruese në sferat e shkencës, të arsimit dhe kulturës.

Bordi organizativ i konferencës nga të tri institutet, duke vlerësuar cilësinë e kumtesave dhe risitë që sjellin shumë prej tyre, vendosën që rezultatet e saj të publikohen në këtë vëllim të veçantë. Redaksia falënderon për mbështetjen morale dhe financiare, Zyrën e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, që siguroi mjetet e nevojshme si për mbajtjen e konferencës, ashtu edhe botimin e këtij vëllimi.

Redaksia

Dhjetor, 2015

**Prof. assoc. dr. Sabit SYLA - Drejtor i Institutit të Historisë
“Ali Hadri”-Prishtinë**

**FJALA E HAPJES NË KONFERENCËN SHKENCORE:
“ISA BOLETINI NË LËVIZJEN KOMBËTARE
SHQIPTARE”**

***I nderuar Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Z.
Kadri Veseli,
I nderuar Ambasador i Republikës së Shqipërisë në Prishtinë,
Z. Qemal Minxhozi,
Të nderuar akademikë, rektorë të universiteteve e dekanë të
fakulteteve shtetërore e private, përfaqësues të institucioneve
shkencore, arsimore e kulturore, media të shkruara dhe
elektronike, zonja dhe zotërinj,***

Kam kënaqësi dhe nder të veçantë që në emër të Këshillit Organizues, t’ju përshëndes me përgëzimet më të sinqerta për pjesëmarrjen tuaj në Konferencën Shkencore: “Isa Boletini në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare”. Rasti i parë e solemn, që më jep mundësinë të ndodhem para jush për të thënë disa fjalë për hapjen e kësaj Konference, organizuar nga Instituti i Historisë “Ali Hadri”-Prishtinë në bashkëpunim me Institutin e Historisë në Tiranë dhe Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, që ka për qëllim të ndriçojë veprën e Isa Boletinit dhe bashkëlufëtareve të tij me rastin e 99-vjetorit të rënies e rivarrimit të eshtrave të tyre, konferencë kjo e cila po mbahet nën përkujdesjen e Kuvendit të Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, më emocionon e më bënë të nderuar.

Zonja dhe zotërinj,

Në këtë konferencë do të zhvillohet një veprimtari e shumanshme shkencore. Në 2 sesione, do të lexohen 24 kumtesa nga studiues të njohur të hapësirës sonë shqiptare. Kumtesat nga fusha e historisë shkruhen për t'i sjellë të vërtetat e periudhave të ndryshme, për të cilat historianët u referohen fakteve dhe dëshmime historike dhe parapraakisht vlerësojmë se, do të jenë të këtij niveli shkencor. Andaj me të drejtë presim që kjo konferencë si pjesë kontributore reale, do të sjellë edhe debate të frytshme duke u bërë shtytës hulumtimesh e gjurmimesh të reja të potencës së kërkimit shkencor, të cilat, padyshim do të shpijnë përpara studimet në fushën e historiografisë shqiptare e më gjerë.

Mbajtja e kësaj Konference Shkencore si dhe manifestimet tjera të nduarndurta që do të vazhdojnë me rastin e rivarrimit të eshtrave të Isa Boletinit, ka një rëndësi të veçantë në historinë më të re shqiptare si një afirmim i fuqishëm i identitetit politik të Kosovës, për të nderuar e respektuar jo vetëm Isa Boletinin, por një plejadë të tërë luftëtarësh. Është edhe inspirim i mëtejshëm i përpjekjeve tona për plotësimin dhe jetësimin e idealeve të të parëve tanë si dhe një dëshmi e fortë e vitalitetit dhe imunitetit tonë, për gjeneratat e ardhshme se sa e gjatë dhe e vështirë ishte rruga e realizimit të aspiratave tona kombëtare.

Jeta dhe vepra e Isa Boletinit dhe bashkëkohësve të tij, janë të freskëta dhe mbeten frymëzim i përhershëm për të gjithë shqiptarët kudo që gjenden, e që kristalizuan idealet e detyrat që shtronte fillimi i shek. XX, si epokë e madhe për çlirimin e vendit, emancipimin dhe çlirimin tonë kombëtar, detyra këto aktuale edhe për kohën tonë. E themi këtë, pasi rrallëherë ndodhë në histori të lindë e të formohet një plejadë e tërë luftëtarësh të devotshëm për çështjen kombëtare sikurse ngjau në gjysmën e dytë të shek. XIX.

Të nderuar të pranishëm,

Në mbyllje të fjalës time, më lejoni që në emër të Këshillit Organizues dhe në emrin tim personal, të shpreh

falënderime të gjithë atyre që ndihmuan materialisht dhe moralisht për organizimin e kësaj konference. Në fund, duke Ju dëshiruar punë të mbarë e të frytshme dhe qëndrim të këndshëm të gjithë studiuesve mysafirë dhe atyre vendës, në ambientet e tempullit ku u kryen shumë procese historike, i shpall të hapura punimet e Konferencës Shkencore: “Isa Boletini në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare”.

Ju faleminderit!

Prishtinë, më 5 qershor 2015

**Kadri VESELI - Kryetar i Kuvendit të Republikës
së Kosovës**

**FJALA PËRSHËNDETËSE NË KONFERENCËN
SHKENCORE: “ISA BOLETINI NË LËVIZJEN
KOMBËTARE SHQIPTARE”**

I nderuar Ambasador i Republikës së Shqipërisë, Z.

Minxhozi,

I nderuar Ministër i Forcës së Sigurisë i Kosovës, Z. Demolli,

***Të nderuar profesorë, studiues, akademikë, mysafirë të
nderuar, zonja dhe zotërinj,***

Jam i nderuar që sot ndodhem në mesin tuaj, në këtë konferencë shkencore, kushtuar njërës prej figurave më të rëndësishme të historisë sonë Isa Boletinit. Kjo konferencë që po mbahet në prag të rivarrimit të Isa Boletinit, e bënë edhe më madhështore këtë ngjarje.

Të nderuar të pranishëm,

Isa Boletini jetoi dhe veproi në një periudhë dramatike të historisë sonë kombëtare, ishte periudhë e kthesave të mëdha historike. Sundimi shekullor osman po kalonte vitet e fundit të tij dhe shqiptarët po përballeshin me një sfidë radikale: ose do të dilnin nga ky sundim si një komb i formuar dhe me aftësi shtetformuese, ose rrezikonin shpërbërjen kolektive, si etni dhe territor. E gjithë veprimtaria e Isa Boletinit ishte një përballje me këtë sfidë. Ishte një përballje titanike, e cila e çoi atë nga betejat e grykave të Kosovës, në mbrojtjen e pavarësisë kombëtare të shpallur në Vlorë, e prej andej në zyrat diplomatike të Evropës. Isa Boletini ishte një lider popullor që veproi në përputhje me nevojat e kohës. Kjo ishte koha e

çlirimit kombëtar dhe formimit të shtetit kombëtar. Ishte koha e dëshmimit të ekzistencës së tyre dhe të drejtave të tyre. Të gjitha kryengritjet e Isa Boletinit ishin në shërbim të këtij qëllimi të madh.

Zonja dhe zotërinj,

Sot në kushtet e reja sociale dhe politike, figura historike e Isa Boletinit kërkon qasje të reja shkencore dhe akademike. Unë besoj se historiografia jonë, tanimë e pavarur nga diktatet ideologjike dhe politike, është në gjendje të përmbushë këtë nevojë të vetëdijes sonë kombëtare, të kulturës dhe kujtesës sonë historike. Duke besuar se vet kjo konferencë është në funksion të kësaj nevoje, më lejoni t'ju uroj punë të mbarë dhe kreative.

Ju faleminderit!

Prishtinë, më 5 qershor 2015

Akademik Pajazit NUSHI
(Prishtinë)

ISA BOLETINI DHE TEMATIZIMI ENCIKLOPEDIK I JETËS DHE VEPRIMTARISË SË TIJ

Isa Boletini dhe sfondi historik për jetën dhe veprimtarinë e tij

Rezultatet e gjurmimeve historike, etike, antropologjike, psikologjike dhe nga këndvështrime tjera, të jetës pesëdhjetedy vjeçare dhe veprimtarisë tridhjetepesë vjeçare të Isa Boletinit kanë vërtetuar se, kur flitet për Isa Boletinin bëhet fjalë për integritet tiparesh të karakterit, që e shquajnë atë nga të gjithë të tjerët të periudhës kohore ndërmjet Lidhjes Shqiptare të Prizrenit - shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë dhe mbrojtjes së saj dhe të drejtave etnike të shqiptarëve. Pra, fjala është për një periudhë të rëndësishme zhvillimore të shqiptarëve dhe të shtetthemelimit të tyre, ku rol të posaçëm kanë luajtur personalitet e njohura Ismail Qemali, Hasan Prishtina, Isa Boletini, Idriz Seferi, Haxhi Zeka, Bajram Curri e të tjerë. Rezultatet e analizës dhe vlerësimit të aktivitetit të tij tregojnë se Isa Boletinit i atribuohen tiparet parësore historike të luftëtarit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit që nga mosha adoleshente 17 vjeçare deri në ditën e vrasjes më 16 janar 1916, kur kishte arritur të bëj për

veti luftëtarët e Shalës, Mitrovicës, Vushtrisë, Llapit dhe të Gjakovës e më gjerë në frontin e luftës për liri. Gjatë gjithë kësaj periudhe ishte luftëtar, prirës i kryengritjeve kundër pushtuesit osman, më pas atij serb, malazez, rus e austro-hungarez. Pohimi i tij *“Un` jam mirë kur asht` mirë Shqipnia”* është qëndrim aktiv, me të cilin e ka identifikuar dhe e ka bërë të varur personalitetin e mirëqenien e vetë të familjes, të farefisnisë dhe të popullit të tij më të mirën e Shqipërisë, të cilën e ka konsideruar vlerën më të lartë të shqiptarëve të kohës së tij. Këto tipare atdhetare janë të ndërlidhura me sjelljet etike të veçanta të tija dhe të familjes së vetë. Në këtë kuadër mjafton të përmendim sjelljet e tij në Stambollin e viteve 1876-1909, kur për “beun” e sulltan Abdyl Hamitit II “Boletini bjeshkor e malor ishte më i mirë se Stambolli - kryeqytet i Perandorisë Osmane”.

Lidhur me këtë, duhet përmendur se shtëpia e tij konsiderohej shtëpi bamirëse për hallexhinjtë dhe strehimorë e patriotë shqiptarë. Këtij grupi të tipareve etike duhet shtuar edhe angazhimin e tij për zhvillim të arsimit dhe të shkollës shqipe; ky hapi shkollën e parë shqipe në Boletin. Ishte i matur në mendime dhe fjalë dhe modest në kërkesat dhe sjelljet e tij. Modestia e tij u dallua në shumë situata; ai kishte refuzuar postin e ministrit në Qeverinë e Ismail Qemalit, me arsyetim se për këtë vend duhen njerëz të shkolluar. Sjelljet e këtilla ishin të ndërlidhura edhe me disa tipare antropologjike e psikologjike, si: hijeshia e gjatësisë së trupit të tij të veshur me petka malësori të pastra të lidhura me brez pishtoli, ndjenja e lartë e atdhedashurisë, përkatësisht sentimentin e atdhedashurisë me fuqi motivuese të jashtëzakonshme, guximi, trimëria, zemërgjerësia, konsekuenca e lidhjes së fjalës së dhënë me realizim praktik të saj, fjalëmatësia në biseda me burra të Shalës, të Drenicës, të Rrafshit të Dukagjinit, të Malësisë së Gjakovës, shpresa e bindja në fitore, ndjenja e vetëmohimit dhe e sakrificës, etj.

Këto tipare u argumentuan në qëndrimet dhe sjelljet e tij në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të shqiptarëve. Kishte besim të madh në forcën morale të besëlidhjes së shqiptarëve në kohën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe të Lidhjes së Pejës, në themelimin e së cilës mori pjesë drejtpërdrejt. Të gjitha këto tipare u treguan të ndërlidhura dhe të integruara në një personalitet karakteristik me ndikim të madh në organizimin e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare dhe në udhëheqjen e kryengritjeve shqiptare të mëdha kundër pushtuesit osman, në vitet 1910-1912. I këtillë, ngeli në Shalë, në Isniq, në Malësi të Gjakovës, në Vlorë, në Londër, në Podgoricë e kudo që shkoi.

Mbi këtë bazë mbështes gjykimin, sipas të cilit Isa Boletini kishte besim të madh në fuqinë morale të bashkëkohanikëve të shumtë; meqë kjo forcë u tregua e pamjaftueshme për çlirim, shpallje të pavarësisë dhe mbrojtje të etnisë shqiptare, Isa Boletini u tregua i gatshëm të zëvendëson forcën morale me forcë të armatosur për themelimin të shtetit të Shqipërisë në zhvillim dhe mbrojtje të tij. Besojë se kur populli i ka kënduar Ismail Qemalit: ***“Unë jam Ismail Qemali/Historia vjen pas meje...”*** domethënia e këtyre vargjeve shtrihet edhe në veprimtarinë e përbashkët me Isa Boletinin. Do të thosha se Ismail Qemali së bashku me Isa Boletinin kanë ndikuar drejtpërdrejt në ndryshimin e historisë së popujve të Evropës Juglindore në saje të përpjekjeve të pandërprera për çlirim nga pushtuesi otoman, etj. Por, tiparet e përmendura të Isa Boletinit kanë qenë njëkohësisht shkak i smirës së armiqve të Isa Boletinit, sepse i shkaktuan përndjekje, privim nga familja e pasuria, djegie të kullës së tij, shkatërrim të pronës, më në fund mu për këto tipare u vra në pabesi. Isa Buletinit i atribuohet jo vetëm statusi i personalitetit historik, por edhe statusi i personalitetit enciklopedik të historisë

kombëtare të shqiptarëve të viteve të bujshme ushtarake të mbarimit të shekullit XIX dhe fillimit të shekullit njëzet.¹

Isa Boletini në artikujt shkencorë, në botimet monografike, leksikografike dhe në botimet enciklopedike

Për jetën dhe veprimtarinë e Isa Boletinit është shkruar relativisht shumë. Për këtë u shkruan artikuj popullorë, fejtone, trajtesa shkencore, monografi, studime leksikografike dhe zëra enciklopedikë. Kështu, Isa Boletini është jo vetëm subjekt i aktiviteteve ushtarake, politike, historike, etj., por shkrimet e shumta për jetën dhe aktivitetin e tij këtë e kanë bërë edhe objekt studimesh. Mbi këtë bazë të gjerë shkrimesh e trajtimesh shkencore u përpoqëm të hedhim dritë më shumë në çështjen e tejbartjes integrale të tipareve atdhetare, e luftarake, etike, antropologjike dhe psikologjike të shkruara gjerësisht në qindra mijëra faqesh në zërin enciklopedik prej 25-30 rreshtash gjysmëfaqor. Shkrimet për Isa Boletin, përpos atyre të karakterit historik, i kemi ndarë në artikuj shkencorë, studime monografike, leksikografike dhe ato enciklopedike. Kjo ndarje i përgjigjet edhe zhvillimit të nivelit mendor nga përshkrimet e thjeshta të jetës dhe veprimtarisë së tij deri në nivelin më të përgjithësuar dhe më të ngjeshur - nivelin të mendimit enciklopedik.

Nga grupi i artikujve shkencorë konsultuam artikullin e studiuesit Bogomil Hrabak, të Aubrey Herbert, të Robert Elsie dhe të studiuesit Ramiz Abdyli.² U studiua përmbajtja e monografisë për Isa

¹ Oliver Jans Schmit "Kosova - histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike", Koha, Prishtinë, 2012; 2. George Gawruch "The Grescent and the Eagle" - "Gjysmëhënadheshqiponja", I. B. Tausis, New York, 2006, 3, SkënderLuarasi, Tri jetë - Koloneli Tomson, Ismail Qemali, Isa Boletini", Shtëpia Botuese: Migjeni; 2007 dhe 4. Branko Babić "PolitikaCrne Gore u novo oslo bodjenimkrajevima 1912-1914", Pobjeda, Titograd, 1984.

² 1. "Arbanaškiprvak Isa Boletinac i Crna Gora 1010-1922", IstoriskiZapisi 1977

Boletinin e studiuesit Skënder Luarasi³ dhe ajo e studiueses Fatmire Musaj.³ Nga botimet leksikografike u studiua zëri “Isa Boletini”, nga përmbajtja e veprës së Robert Elsie⁴, zëri Isa Boletini nga i njëjti autor⁵. Nga fjalorët enciklopedik u studiua zëri Isa Boletini I botuar në dy fjalorët enciklopedik të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.⁶ Nga grupi i teksteve të mirëfillta enciklopedike u studiuan tekstet për Shqipërinë dhe për Isa Boletinin në këto tipe të enciklopedisë së përgjithshme, “Enciklopedia Britanika”, “Bolšaja Sovjetskaja enciklopedija” dhe “Jugosllavenska Enciklopedija”.⁷ Në gjurmimin e raporteve ndërmjet teksteve të përmendura u shtrua kjo çështje kryesore: si është bërë përshkrimi i përmbajtjes së veprimtarisë politike, ushtarake e historike të Isa Boletinit në zërin enciklopedik? Për të zbrërthyer këtë çështje shqyrtuam trajtimin e Isa Boletinit në botimet leksikografike, në fjalorët enciklopedikë institucional dhe joinstitutional dhe në tipin e enciklopedisë së përgjithshme.

Tekstura e Isa Boletinit në botimet leksikografike

Jeta dhe vepra e Isa Boletinit u përpunuan në fjalorë biografikë, në fjalorë historikë dhe në fjalorë enciklopedikë. Kështu, zëri “Isa Buletini” haset në “Fjalorin Biografik të Historisë

1; 2. Aubrey Herbert: “A Meeting with Isa Boletini”-“Takimi me Isa Boletinin”, 3. Robert Elsie, Text and Documents of Albanian History dhe 4 “Dosja e Portës së Lartë për Isa Boletinin” nga Ramiz Abdyli “Koha Ditore” e datës, 3, 10 e 17 janar 2015.

³ Skënder Luarasi “Isa Boletini”, Tiranë, 1972 dhe 6. monografia “Fatmira Musaj “Isa Boletini 1864-1916”, Tiranë, 1987.

⁴ Robert Elsie, “Fjalori Historik i Kosovës”. Skanderbeg Books, Tiranë, 2011.

⁵ Robert Elsie, “Fjalori Historik i Shqipërisë, Eugen, Tiranë, 2011.

⁶ Akademia e Shkencave e Tiranës, Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Tiranë, 1985 dhe 10.

⁷ “Enciklopedia Britanika”, 4.12. Bolšaja Sovjetskaja Enciklopedija” dhe 4.13 “Jugosllavenska Enciklopedija”.

Shqiptare” (A Biographical Dictionary of Albanian History). Në këtë fjalor është përpunuar shkurt jeta dhe veprimtaria e Isa Boletinit e nxjerrur kryesisht nga Historia Shqiptare. Përmbajtja e këtij zëri mbështetet në rolin e Isa Boletinit në zhvillimin e luftërave të shqiptarëve për çlirim nga sundimi i Perandorisë Otomane. Nga përmbajtja e këtij zëri u shtjellua zëri “Isa Boletini” në tekstin kompjuterik të veçantë.⁸ Zërin “Isa Boletini” e hasim të përpunuar në veprën e studiuesit kanadez Robert Elsie “Historical Dictionary of Kosova” (Fjalor Historik i Kosovës) dhe në veprën e ngjashme e po të njëjtit autor “Historical Dictionary of Albany” (Fjalor Historik i Shqipërisë) përkthyer në shqip, më 2011. Në zërin “Boletini, Isa Bej” të botuar në veprën “Fjalor Historik i Kosovës” lexojmë:

“Boletini, Isa Bej (15.01.1864 - 23.01.1916). Figurë nacionaliste dhe luftëtar gueril. Isa Bej Buletini, i lindur në fshatin Boletin afër Mitrovicës, ishte një nga luftëtarët e mëdhenj të lirisë në Kosovë në fillim të shekullit të kaluar. Pas themelimit të Lidhjes së Prizrenit, mori pjesë si i ri në Betejën e Slivovës kundër forcave osmane, më 22 prill 1881. Në vitin 1902, Boletini u emërua kreu i ‘rojave personale shqiptar’ të sulltan Abdyl Hamidit II (sundoi 1876-1909) në Stamboll, ku edhe kaloi pjesën më të madhe të katër viteve të ardhshme dhe mori titullin ‘bej’. Ai ishte besnik i sulltanit, por në vitin 1908, i dha mbështetjen e vet të parë Turqve të Rinj. Kur Xhavit Pasha dërgoi një ushtri me 7 mijë ushtarë për të nënshtruar Kosovën në nëntor 1908, Boletini me një grusht shokësh i bënë atij qëndresë të fortë. Për të marrë hak gjatë largimit, forcat turke i vunë flakën shtëpisë së tij.

Në vitin 1909, Boletini ishte në krye të luftimeve në Prishtinë, Prizren dhe gjetkë, dhe luajti një rol të rëndësishëm në Kryengritjen e Përgjithshme të pranverës së vitit 1910 në Kosovë, ku për dy ditë bllokoi përparimin e forcave turke në Carralevë, midis Ferizajt dhe

⁸ “Biography w.w.w. fam people, com/cat – isa – bol.”

Prizrenit. Gjatë Luftës së Parë Ballkanike në vitin 1912, ai drejtoi forca guerile të armatosura në Kosovë dhe më vonë edhe në Shqipëri, në mbështetje të Qeverisë së Përkohshme që shpalli pavarësinë e shqiptarëve në Vlorë më 28 nëntor 1912. Trupat e tij më vonë mbrojtën Princ Vilhelm Vidin (Wilhelm zu Wied), deri në largimin e këtij të fundit nga Shqipëria në shtator 1914. Pas kësaj Boletini u internua në Podgoricë ku thuhet se u vra në një shkëmbim zjarri”.⁹

Përmbajtja e zërit “Boletini, Isa Bej” të veprës “Fjalori Historik i Shqipërisë” është shtjelluar ngjashëm me tekstin e të njëjtit zë në veprën e parë. Këtë e dallojmë kur lexojmë:

“Boletini, Isa Bej (15.01.1864 - 23.01.1916). Figurë nacionaliste dhe kryengritës Isa bej Boletini. I lindur në fshatin Boletin pranë Mitrovicës, ishte një nga luftëtarët e mëdhenj të lirisë në Kosovë në fillim të shekullit të kaluar. Pas themelimit të Lidhjes së Prizrenit, djaloshi Boletini, mori pjesë si luftëtar kundër forcave turke, në Betejën e Slivovës, më 22 prill 1881. Më 1902, Boletini u caktua kreu i ‘rojave shqiptare’ të sulltan Abdyl Hamidit II (sundoi më 1876-1909) në Stamboll, ku dhe kaloi pjesën më të madhe të katër vjetëve të ardhshme dhe mori titullin ‘bej’. Ai ishte besnik i sulltanit, mirëpo më 1903 mbështeti xhonturqit. Megjithatë kur Xhavid Pasha në nëntor 1908 dërgoi një ushtri me 7 000 ushtarë drejt Shqipërisë për të nënshtruar Kosovën, Isa Boletini me një tufë burrash i bëri qëndresë të fortë. Në tërheqje e sipër, trupat turke dogjën kullën e familjes së tij në shenjë hakmarrjeje. Më 1909, Boletini udhëhoqi betejat në Prishtinë, Prizren e gjetkë dhe luajti rol të rëndësishëm në Kryengritjen e Përgjithshme në pranverë 1910, kur për dy ditë bllokoi përparimin e forcave turke në Carralevë, midis Ferizajt dhe Prizrenit. Gjatë Luftës I Ballkanike, më 1912, u vu në krye të çetave të armatosura në Kosovë dhe më pas në Shqipëri, në mbështetje të

⁹ Robert Elsie, “Fjalor historik i Kosovës”, Skandebeg Books, Tiranë, 2011, f. 94.

Qeverisë së Përkohshme që shpalli Pavarësinë në Vlorë më 28 nëntor 1912. Në mars 1913, shoqëroi Ismail bej Qemalin në Londër, për të kërkuar mbështetjen britanike për vendin e sapokrijuar. Edwin Jacques tregon anekdotën që ‘sapo hyri në godinën e Ministrisë së Jashtme Britanike për mbrojtjen e çështjes së kombit të tij, polici i sigurisë i kërkoj të hiqte revolen nga brezi dhe ta linte në vendin e posaçëm në sallën e pritjes. Ai u bindë pa fjalë. Pas takimit, ministri i Jashtëm, Sër Eduart Grei (Sir Edward Grey) e shoqëroi Boletinin në hollë, ku ai mori revolverin dhe e ngjeshi në brez. Ministri i Jashtëm komentoj duke buzëqeshur, ‘Gjeneral, gazetatat mund të shkruajnë nesër se Isa Boletini, që as Mahmut Shefqet Pasha s’mundi ta çarmatoste, sapo u çarmatos në Londër’. Boletini iu përgjigje me një buzëqeshje të ngrohtë, ‘Jo, jo, as në Londër’, dhe nxori nga xhepi i pasmë një revole të dytë. (Jacques 1995, 339). Boletini u kthye në Shqipëri, ku trupat e tij mbrojtën Princ Vilhelm Vidin (Wilhelm zu Wied) deri kur ai u largua nga Shqipëria. Më vonë, ai u internua në Podgoricë ku thuhet se u vra në një shkëmbim zjarri. Shtëpia dhe varri i tij ruhen në fshatin Boletin.¹⁰

Për autorin e këtyre veprave, përkatësisht për Robert Elsien, Isa Boletini në Kosovë karakterizohet figurë nacionaliste dhe luftëtar, kurse Isa Boletini për Shqipëri ishte figurë nacionaliste dhe kryengritës. Ai “ishte një nga luftëtarët e mëdhenj të lirisë në Kosovë...” Historia e shqiptarëve na mëson se lufta e tij kishte për qëllim çlirimin e shqiptarëve duke mos bërë dallime në vendin ku ai ka luftuar. Këtë e argumenton, përpos tjerash, edhe udhëtimi i Isa Boletinit në Londër së bashku me Ismail Qemalin. Internimi i tij në Podgoricë nuk ka argumente të qëndrueshme, sepse nuk është informacion i vërtetuar a ka qenë internuar apo jo!

¹⁰ “Fjalori Historik i Shqipërisë” Uegen, Tiranë 2011, f. 126.

Më 2002 u botua në Tiranë “Fjalori Enciklopedik” i hartuar dhe i përgatitur për shtyp nga autori Pasho Baku. Në këtë fjalor për Isa Boletinin është shkruar:

*“Boletini, Isa (1864-1916). Atdhetar dhe prijës popullor. Qysh i ri mori pjesë në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit kundër forcave osmane të pushtimit. Gjatë viteve 1901-1902 ishte në krye të qëndresës së armatosur në Kosovë, kundër ndërhyrjeve në Shqipëri të Serbisë, Malit të Zi, Rusisë dhe të Austro-Hungarisë. Përkrahu revolucionin xhonturk të vitit 1908, por kundërshtoi politikën e xhonturqve ndaj Shqipërisë. Ishte në ballë të forcave kryengritëse (1910-1912) në zonat: Mitrovicë, Drenicë, Podujevë dhe Prishtinë. Më 28 nëntor 1912, si prijës i përfaqësuesve të Kosovës, ishte përkrah Ismail Qemalit. Ka qenë anëtar i delegacionit shqiptar që shkoi më 1913 në Londër për të protestuar kundër vendimit të Fuqive të Mëdha për copëtimin e Shqipërisë. U vra pabesisht në Podgoricë nga shovinistët malazezë”.*¹¹

Zëri “Isa Boletini” u botua edhe në veprën “Enciklopedia Universale e Ilustruar” nga i njëjti autor i veprës së sipërpërmendur, që u botua në Tiranë, nëntë vjet më vonë, përkatësisht më 2011. Në këtë tekst është shkruar:

“Boletini, Isa (1864-1916). Atdhetar dhe prijës popullor për liri. Hero i Popullit. Lindur në fshatin Boletin të Mitrovicës në Kosovë, në një familje fisnike dhe me tradita patriotike. Qysh i ri mori pjesë në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit kundër forcave osmane të pushtimit. Gjatë viteve 1901-1902 ishte në krye të qëndresës së armatosur në Kosovë, kundër ndërhyrjeve në Shqipëri të Serbisë, Malit të Zi, Rusisë dhe të Austro-Hungarisë. Përkrahu revolucionin xhonturk ndaj Shqipërisë. Ishte në ballë të forcave kryengritëse (1910-1912) në zonat: Mitrovicë, Drenicë, Podujevë dhe Prishtinë.

¹¹ “Fjalorenciklopedik”, hartoi dhe përgatiti: Pasho Baku, Shtëpia Botuese Bacchus, Tiranë, 2002, f. 148

Në tetor 1912, u vu ne mbrojtje të trojeve shqiptare kundër serbëve. Më 28 nëntor 1912, si prijës i përfaqësuesve të Kosovës, ishte përkrah Isamil Qemailit dhe patriotëve të tjerë në Vlorë. Ka qenë anëtar i delegacionit shqiptar që shkoi më 1912 në Londër për të protestuar kundër vendimit të Fuqive të Mëdha për copëtimin e Shqipërisë. U vra pabesisht nga forcat shoviniste malazeze në Podgoricë, së bashku me dy djemtë e vetë, Halilin dhe Seidin dhe pesë shokë të tyre”.¹²

Siç është e njohur, vlera e teksteve enciklopedike përcaktohet sipas kriterit të vërtetësisë së argumentuar të shprehur me indin mendor të gjykimeve, konstatimesh e vlerësimesh të sakta dhe me sasi të ngjeshura të informacioneve të shprehura shkurtimisht dhe pa përdorim të figurave stilistike. Me fjalë të tjera, sa më shumë informacione të argumentuara të ketë një njësi enciklopedike dhe sa më e shkurtër të jetë ajo njësi aq më e lartë është vlera enciklopedike e saj. Tekstet e enciklopedisë universale i përkasin nivelit më të lartë enciklopedik. Në këto tekste pritet të flitet për domethënien e luftërave të heronjve për çlirim kombëtar dhe më gjerë. Me fjalë të tjera, Isa Boletini dhe vepra e tij duhet vështruar në raportet e përgjithshme politike e ushtarake të këtij regjioni gjatë kohës së zhvillimit të luftërave të Isa Boletinit. Raportet e këtilla në fjalorë enciklopedikë të autorëve individualë janë përpunuar pjesërisht. Por, nga përgjithësimet e këtilla vuajnë përgjithësisht botimet individuale duke përfshirë edhe fjalorët historikë dhe ata enciklopedikë.

¹² Pasho Baku, “EnciklopediaUniversale e Ilustruar”, Bacchus, Tiranë, 2001, f. 148.

Personaliteti i Isa Boletinit në fjalorë enciklopedikë të botuara nga institucione akademike

Tekstet enciklopedike të institucioneve shkencore kanë vlera njohëse të argumentuara në nivele autoriale, redaksish disiplinash të posaçme, të redaksive qendrore dhe të redaktorit përgjegjës të botimit të institucionit të caktuar. Në pikëpamje teorike dhe pragmatike tekstet e këtilla janë tekste që i nënshtrohen kritereve përmbajtjesore, gjuhësore, grafike, teknike të mprehta objektive, dhe si të këtilla, duhet të kenë vlera shkencore përkatëse.

Siç është e njohur, vetëm më 1985 u botua vepra e parë enciklopedike në gjuhën shqipe “Fjalori Enciklopedik Shqiptar”. Kjo vepër u përgatit nga Qendra e Enciklopedisë Shqiptare të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Kuptohet, mendimi enciklopedik shqiptar ka filluar të zhvillohet më herët; kjo është e lidhur me veprën “Amus - ul alam” të Sami Frashërit, që u botua më 1901. Në këtë vepër bota shqiptare, përkatësisht gjeografia dhe historia e popullit shqiptar, ka zënë vend të veçantë. Në esencë kjo vepër ka hapur rrugën e zhvillimit të mendimit enciklopedik ndër shqiptarët, pavarësisht që u botua në gjuhën osmane. Këtu gjenden të përpunuar shumë zëra enciklopedik nga historia e gjeografia e popullit shqiptar. Kuptohet, zëri “Isa Boletini” nuk ka qenë e mundur të shtjellohet në kohën e botimit të kësaj vepre.

Zëri Isa Boletini është përpunuar për herë të parë nga institucioni përkatës në “Fjalor Enciklopedik Shqiptar”¹³ dhe në “Fjalor Enciklopedik Shqiptar” të botuar njëzetetë vjet më vonë¹⁴.

¹³ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Qendra e Enciklopedisë Shqiptare “Fjalor Enciklopedik Shqiptar” Tiranë, 1985.

¹⁴ 20, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Qendra e Enciklopedisë Shqiptare “Fjalor Enciklopedik Shqiptar”, Tiranë, 2008.

Këto dy vepra i përkasin tipit kombëtar enciklopedik, përkatësisht, siç është theksuar në përmbajtjen e kësaj vepre “FESH nuk është një vepër enciklopedike e tipit universal”¹⁵. Në përmbajtjen e këtij zëri të botuar në botimin e fundit të Fjalorit Enciklopedik Shqiptar zëri Isa Boletini u përpunua në dyzetetete rreshta¹⁶. Në këtë vepër zëri “Isa Boletini” u përpunua më gjerësisht nga ai i botimit më të vjetër në përputhmëni me tiparin dallues të FESH të ri - pasqyrimi i gjerë i personaliteteve e i figurave të historisë kombëtare”¹⁷. Këtu është shkruar:

“Boletini, Isa (1864-1916). Luftëtar e udhëheqës ushtarak popullor, organizator e drejtues i Lëvizjes për Çlirimin Kombëtar. Hero i Popullit. Lindi në fshatin Boletin të Mitrovicës. Në moshën 17-vjeçare mori pjesë si luftëtar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në Betejën e Slivovës (shih) kundër forcave osmane. Përkrahu Haxhi Zekën (shih) dhe atdhetarët e tjerë në themelimin e Lidhjes Shqiptare të Pejës (shih) dhe në qëndresën e saj kundër sunduesve osmanë dhe synimeve grabitqare të Serbisë e të Malit të Zi. Më 1901-1902 u vu në krye të qëndresës popullore në Kosovë kundër ndërhyrjeve të Serbisë, Malit të Zi dhe Austro-Hungarisë në Shqipëri. I. B. përkrahu revolucionin xhonturk të v. 1908, ishte një nga organizatorët e Kuvendit të Ferizajt më 1908, që luajti rol të rëndësishëm në shpalljen e kushtetutës. Iu kundërvu politikës antishqiptare xhonturqve. U dallua si udhëheqës e organizator i kryengritjeve të mëdha popullore ndërosmane të v. 1909-1912 dhe, sipas vlerësimit të shtypit të kohës, ishte “shpirti i këtyre kryengritjeve”. Udhëhoqi luftëtarët në betejat dhe ushtrinë turke në Shtime-Carralevë më 1910, mbështeti kryengritjen kundërosmane v. 1911, udhëhoqi forcat

¹⁵ Po aty, f., XVII.

¹⁶ Akademi e Shkencave e Shqipërisë - Qendra e Enciklopedisë Shqiptare, Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Botim i ri, Vëllimi i tretë: N – Zh dhe një shtesë, Tiranë 2009, f. 2559.

¹⁷ Po aty, f. XVII.

kryengritëse në Drenicë-Mitrovicë dhe Podujevë-Prishtinë më 1912, u vu në krye të çetave të armatosura vullnetare për mbrojtjen e popujve shqiptarë kundër pushtuesve serbë, në ditët e shpalljes së pavarësisë, në krye të përfaqësuesve të Kosovës, u ndodh përkrah Qemalit (shih) në Vlorë dhe mori pjesë aktive në organizimin e forcave të armatosura për mbrojtjen e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës. Më 1913 si anëtar i delegacionit shqiptar së bashku me I. Qemalin shkoi në Londër, ku kundërshtoi me forcë vendimet e Fuqive të Mëdha për copëtimin e Shqipërisë. Më vonë I. B. kaloi përsëri në Kosovë, ku organizoi qëndresën popullore kundër pushtuesve të rinj serbo-malazezë. Duke e kaluar jetën në luftë e përpjekje dhe në urtësinë e tij, fitoi autoritet si udhëheqës popullor. Më 23 janar 1916 u vra pabesisht nga shovinistët malazezë në Podgoricë, së bashku me dy djemtë dhe dy nipat e tij dhe tre luftëtar të tjerë”.

Po në këtë vepër Isa Boletini përmendet edhe në pjesën historike të zërit “Shqipëria”¹⁸. Zëri “Isa Boletini” u botua në veprën “Enciklopedija Jugosllavije” (Enciklopedia e Jugosllavisë) me tekste identike në kroatisht, meqedonisht, serbisht (me shkronja cirilike dhe latinike) dhe sllovenishte si edhe në gjuhën hungareze e shqipe¹⁹. Përmbajtja e të njëjtit zë, siç është e njohur tashmë, u botua edhe në gjuhën shqipe²⁰. Në këtë botim, si edhe në të gjitha botimet e gjuhëve të tjera të kombeve të ish-Jugosllavisë duke përfshirë edhe hungarishten, është shkruar:

“Boletini, Isa, një ndër krerët shqiptar nga Kosova (Boletin, më 15.I.1864-Podgoricë (sot Titograd), më 23.I.1916). Në vitin 1881 mori pjesë në luftën kundër ushtrisë osmane, e cila qe dërguar për ta shtypur Lidhjen e Prizrenit. Rëndësia e luftës së Boletinit për

¹⁸ Po aty, f. 2559.

¹⁹ Enciklopedija Jugosllavije, 2 Bje – Crn, Jugoslavenski Leksikografski Zavod, Zagreb 1982, f. 53-54.

²⁰ Enciklopedia e Jugosllavisë, Botimi në gjuhën shqipe, 2 Bib-Çif, Jugoslavenski Leksikografski Zavod “MiroslavKrljeza”, Zagreb 1987, f.136.

autonominë e shqiptarëve në Perandorinë Osmane, qëndrimi i tij ndaj organeve osmane më 1897-1903, si edhe bashkëpunimi i tij me ta në persekutimin e popullsisë serbe vlerësohet në mënyrë të ndryshme. Pas v. 1903 bie në konflikt me Portën dhe internohet në Stamboll, prej nga kthehet në Kosovë më 1906. Me regjimin e xhonturqve ra në konflikt më 1908 dhe u arratis. Si njëri ndër udhëheqësit më të njohur të kryengritësve shqiptarë në Kosovë (1909-12) bashkëpunoi me përfaqësuesit e mbretërive të Malit të Zi dhe të Serbisë. Qeveria serbe e ndihmoi materialisht dhe me armë, posaçërisht me rastin e sulmit në Shkup më 1912. Pas hyrjes së Kosovës e Metohisë në përbërje të Serbisë dhe të Malit të Zi emigroi në Shqipëri. U vra nga organet ushtarake malazeze në Podgoricë, i dyshuar se ishte në lidhje të fshehtë me austriakët”.

Personaliteti i Isa Boletinit në tipin e enciklopedisë së përgjithshme

Tipi i enciklopedisë së përgjithshme shtjellon zëra personalitetesh, të cilët me veprimtarinë e tyre i kanë kontribuar proceseve zhvillimore me rëndësi të përgjithshme, që kalojnë caqet e kombëtares. Në këtë kuadër, në zërin e përgjithshëm “Historia e Shqiptarëve” personaliteti i Isa Boletinit duhet të theksohet posaçërisht. Këtë e ka bërë “Enciklopedia Britanike”, ku është theksuar: “Xhonturqit ndërkaq, ndonëse për suksesin e tyre më së shumti u detyroheshin shqiptarëve, refuzuan të njihnin të drejtën e shqiptarëve për vetadministrim deri te Kryengritja e 1912-ës e cila kulmoi me okupimin e Shkupit nga malësorët shqiptarë nën udhëheqjen e Isa Boletinit. Që atëherë xhonturqit dorëzohen...”.

Ndërkaq, botimet e tjera të këtij tipi enciklopedish as këtë nuk e përmendin. Siç argumentojnë faktet historike pjesa e historisë së

shqiptarëve nga viti 1881-1916 do të ngelte e mangët pa theksimin e rolit të Isa Boletinit, këtij “burri të Kosovës, që luajti rolin qendror si kryetar i Kryengritjes së Përgjithshme në pranverë të 1910...”, në çlirimin e shqiptarëve, në themelimin e shtetit shqiptar dhe në mbrojtjen e tij. Me këtë, siç është e njohur, ka ndryshuar harta politike e Evropës Jugperëndimore dhe raportet ndërmjet shqiptarëve dhe të tjerëve. Për këtë shkak, personaliteti i Ismail Qemalit, i Hasan Prishtinës dhe i Isa Boletinit mund të përpunohen si zëra të veçantë në tipin e enciklopedisë së përgjithshme.

Isa Boletini në enciklopedi të ish-Jugosllavisë

Përmbajtja e zërit “Isa Boletini” ndryshon nga një botim enciklopedik kombëtar në tjetrin, varësisht nga burimet historike prej nga janë nxjerrur faktet historike dhe nga baza ideologjike e trajtimit të tyre, si edhe të raporteve ndërmjet tyre. Në këtë rrafsh dallimi më i madh në trajtimin enciklopedik të jetës dhe veprimtarisë së Isa Boletinit dallohet në përmbajtjen e këtij zëri në “Fjalorin Enciklopedik Shqiptar” dhe në botimin e të njëjtës përmbajtje në tematika enciklopedike të botuara në gjuhët sllave të Jugut, përkatësisht në serbisht, kroatisht, sllovenisht dhe maqedonisht, si edhe në gjuhët e dy kombësive më të mëdha në ish-Jugosllavi, gjegjësisht në gjuhën shqipe dhe në gjuhën hungareze.

Përmbajtja e zërit “Isa Boletini” në tipin e enciklopedisë në gjuhët e përmendura mbështetet në trajtimin e historisë së shqiptarëve kryesisht nga burimet sllave. Mjafton të përmendim disa qëndrime nga parathënia e “Enciklopedisë së Jugosllavisë”, për të argumentuar themelin mbështetës të trajtimit të historisë së shqiptarëve duke përfshirë edhe personalitetet historike. Ja çfarë ka marrë për pikënisje “Enciklopedia e Jugosllavisë” në trajtimin e historisë së shqiptarëve duke përfshirë edhe jetën dhe veprimtarinë e

Isa Boletini: “Krenohemi për Republikën tonë të Shpirtit, e cila si re e ndritshme mbi errësirën e skllavërimit na solli në vendin e lirë socialist, në të cilin popujt sllavë të jugut sot po ndërtojnë pa pengesa kulturën e qytetërimit të tyre”²¹.

Gjykuar sipas këtij qëndrimi veprimtaria e të ndjerit Isa Boletini është vlerësuar sipas kriterit, a i ka kontribuar republikës shpirtërore të sllavëve të jugut, apo këtë e ka penguar. Meqë republikës shpirtërore të sllavëve të jugut aktiviteti i Isa Boletinit nuk i ka kontribuar, atëherë në përmbajtjen e zërit “Isa Boletini” ndër të tjera thuhet: “... bashkëpunimi i tij me ta (me organet osmane P. N.) në persekutimin e popullsisë serbe vlerësohet në mënyra të ndryshme... Bashkëpunoi me përfaqësuesit e mbretërive të Malit të Zi dhe të Serbisë. Qeveria serbe e ndihmoi materialisht edhe me armë, posaçërisht me rastin e sulmit në Shkup më 1912. U vra nga organet ushtarake malazeze në Podgoricë, i dyshuar se ishte në lidhje të fshehtë me austriakët”²². Për këtë pohim nuk janë emërtuar burimet e literaturës shkencore. Por, e gjithë lënda e “Enciklopedisë së Jugosllavisë” mori përmasa politike të kohës së viteve ’80 në ish-Jugosllavi. Nën ndikimin e ndryshimeve politike të filluara në vitin 1981 ndryshoi përmbajtësish kapitulli për shqiptarët dhe marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave.

Pas katër vjetësh të botimit të tekstit original për shqiptarët dhe marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave u botua teksti i ndryshuar, ku informohen parapaguesit se: “Në librin e parë të botimit latinik “Enciklopedije Jugosllavije” (Enciklopedia e Jugosllavisë) janë botuar artikujt “Albanci” (Shqiptarët, f. 72-85) dhe “Albansko-Jugoslavenski odnosi” (Marrëdhëniet Shqiptaro-Jugosllave, f. 86-98). Meqë Redaksia Qendrore më vonë ka kryer disa ndryshime dhe

²¹ Enciklopedija Jugosllavije, 1 A - Bib, Jugoslavenski Zavod “Miroslav Krleža”, Zagreb 1980, f. VI.

²² Po aty, f. 53-54.

plotësime në këta artikuj, ju sjellim të gjithë parapaguesve të botimit latinik versionet e reja të këtyre artikujve.

Në botimet e tjera të “Enciklopedisë së Jugosllavisë” (të botimit cirilik, në gjuhën maqedone, sllovene, shqipe dhe në gjuhën hungareze) tashmë janë botuar ose do të botohen versionet e reja të këtyre teksteve²³. Ndryshimet e botuara janë relativisht të mëdha. “Historia e Shqiptarëve” e shkruar nga akademik Ali Hadri dhe “Marrëdhëniet kulturore Shqipëri Jugosllavi” e shkruar nga prof. dr. Pajazit Nushi kanë pësuar ndryshime rrënjësore, përkatësisht u largua plotësisht nga versioni i teksteve të ndryshuara zëri “Marrëdhëniet kulturore Shqipëri-Jugosllavi”.

²³“Enciklopedija Jugoslavije”-“Enciklopedia e Jugosllavisë”, Jugoslavenski Leksikografski Zavod “Miroslav Krleža”, Zagreb, 1984, f. 1-14.

Pajazit NUSHI

SUMMARY

THE LIFE AND ACTIVITY OF ISA BOLETINI AS REPRESENTED IN ENCYCLOPEDIC ENTRIES

The results in historical, ethical, anthropological and psychological research pertaining to the figure of Isa Boletini have shown that his personality was a combination of several virtues which made him distinguished from most men of his time – namely pertaining to the period of the Albanian League of Prizren and the period of the declaration of independence for Albania. His famous words “I am well whenever Albania is doing well” represent an active stance of his, with which he identifies himself and his entire family.

Regarding the life and activity of Isa Boletini many articles and research papers have been published. From the lexicographic publications the most famous one is “Isa Boletini”. Encyclopedias published by the Academy of Sciences of Albania have also researched the historical figure of Isa Boletini. A set of most well known encyclopedic entries regarding Isa Boletini include: “Enciklopedia Britanika”, “Bolšaja Sovjetskaja enciklopedija”, “A Biographical Dictionary of Albanian History”, “Historical Dictionary of Of Kosova”, “Historical Dictionary of Albany”, “Jugosllavenska Enciklopedija”.

Prof. dr. Sabile KEÇMEZI - BASHA
(Prishtinë)

TRAJTIMI I FIGURËS SË ISA BOLETINIT NË HISTORIOGRAFINË SHQIPTARE

Para 19 viteve, kur Instituti i Historisë në Kosovë kishte organizuar Simpoziumin për jetën dhe veprën e Isa Boletinit, me atë rast kisha përgatitur kumtesën: “Portreti i nënës së Isa Boletinit”. E punova gjatë dhe me një përkushtim shkencor, por nga ajo që mëtoja, më dolën dhe u hapën shumë vështirësi e dilema. Në shkrime të ndryshme, por kuptohet dhe në kohë të ndryshme, heroit dhe atdhetarit të madh kombëtar Isa Boletinit iu kishin qas dhe trajtuar në mënyra të ndryshme, ose kishte periudha kohore - historike kur mungonin tërësisht ose fare të pakta ishin shkrimet për të. Të tëra këto oscilime që i hetova në shkrime, më imponuan që mos të jem indiferente ndaj një të kaluarë të lavdishme dhe ndaj vlerave të mirëfillta atdhetare të historisë sonë. Nga ana tjetër edhe si sfidë mu duk, që me këtë rast të trajtoj figurën e Isa Boletinit në historiografinë shqiptare. Më se gjysmë shekulli, historia e LKSH-së në ish-Jugosllavi, herë-herë ishte e kualifikuar si veprimtari antishtetërore dhe herë-herë mbante shifrën e fshehtësisë shtetërore

të shkallës më të lartë - si tabu temë. Mbyllja apo seleksionimi që u bëhej disa dokumenteve arkivore dhe censura e hekurt që aplikohej në vendin tonë, kontrolli i plotë i shtypit, medias dhe mungesa e “rrjedhës” së informacionit, propaganda mbi “sukseset” e regjimit, kishin si qëllim të pengonin të vërtetën për historinë dhe historiografinë shqiptare.

Nga kjo del e dhëna se, shteti totalitar i Jugosllavisë, duke politizuar çdo qelizë të jetës shqiptare, nuk la pa prekur as historiografinë. Ky politizim u shfaq në faktin se gjithë zhvillimin e proceseve historike e lidhte vetëm me faktorin serbo - sllav, me rolin e shtetit dhe luftën e tyre për çlirim. Në shkrimet dhe punimet e ndryshme të gjitha ngjarjet dhe figurat shqiptare vlerësoheshin vetëm sipas kultit të historiografisë serbe.¹ Me këtë trajtim të njëanshëm, historia kombëtare shqiptare ishte jo vetëm bardhë e zi, por dimensionet kombëtare të saja tkurrreshin e ngushtoheshin deri në pa besueshmëri. Gjatë tërë kësaj periudhe (1945-1990), nga historia shqiptare u mënjanuan ose fare pak u shkrua për ngjarje e figura të shquara të kombit. Bile-bile, shkohej aq larg, sa këto të fundit ishin trajtuar si forca reaksionare dhe antikombëtare.

Në rrugën e gjatë të lëvizjeve për çlirim, bashkim dhe përparim të kombit, para dhe pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë², një vend meritore e zë figura atdhetare e Isa Boletini, i cili ishte pjesëmarrës i dalluar i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Megjithatë, figura e Isa Boletinit u vlerësua lartë në çdo kohë dhe në çdo periudhë, me oscilime të herë-hershme në shkrimet e ndryshme të kohës, si dhe nga shumë autorë të huaj që janë marrë me problemet e LKSH-së. Duke shfletuar bibliografinë e punimeve që u

¹ Xhemil Frashëri, “Probleme të objektivitetit shkencor në historiografinë e re shqiptare”, Studime historike, nr. 2, Tiranë, 1991, f. 8.

² Adem Murati, *Ramadan Agushi (1919-1991)*, Prishtinë, 2003, f. 5.

shkruan për Isa Boletinin, nuk më ka rastisur që të hasja në ndonjë shkrim për të, që ishte shkruar para LDB. Pas përfundimit të saj, megjithatë fillon një periudhë, ku më tepër thellohen studimet për Rilindjen Kombëtare Shqiptare. Një rëndësi e veçantë Isa Boletinit iu kushtua dhe iu dha, deri diku pas viteve 1945, por në vitet e '70 të shekullit XX, marrinë hov më të shprehur shkrimet për jetën e veprën e Isa Boletinit. Brenda mundësive që kam pasur dhe konsultimit të shumë veprave e shkrimeve që kam bërë në historiografinë shqiptare, më ka rastisur që emri i Isa Boletinit të zë një vend meritore në “Historinë e Shqipërisë” vëllimi i dytë, (botim i Universitetit të Tiranës, 1965; Më vonë, në vëllimin II e III, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 1984). Në këto vëllime u theksua dukshëm roli i Isa Boletinit në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare për liri dhe pavarësi dhe ruajtjen e tërësisë tokësore të vendit në fund të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX. Jepet kontributi i tij në kryengritjet e mëdha 1910-1912. Përmendet në faqet 438 e deri në faqen 490. Në këtë vëllim jepet edhe fotoja e tij bashkë me Ismail Qemalin.

Një prezantim dinjitozë i bëhet figurës së Isa Boletinit edhe në “Fjalorin Enciklopedik Shqiptar” botuar më 1985, f. 107-108. Po ashtu, heroi i Kosovës prezantohet edhe në “Fjalori Enciklopedik Shqiptar” pjesa e parë, Tiranë 2008³, nga studiuesja Fatmira Musaj në faqen 276-277. Isa Boletini në këtë shkrim e shoqëron edhe një fotografi. Prezantimi i Isa Boletinit na paraqitet edhe në ribotimet e tjera të mëvonshme, si “Historinë e Popullit Shqiptar”, ribotuar më 1984. Libri i parë biografik i zgjeruar për figurën e Isa Boletinit është shkruar nga Skender Luarasi, Tiranë, më 1971. Por, një vit më vonë (1972), po i njëjti libër ribotohet edhe në Prishtinë, nga “Rilindja”⁴.

³Fjalori Enciklopedik Shqiptar, *Pjesa e parë*, Tiranë, 2008, f. 276.

⁴ Skender Luarasi, *Isa Boletini*, Tiranë, 1971.

Në këtë libër autori Luarasi kryesisht është mbështetur në kujtimet e bashkëkohanikëve të atdhetarit dhe mendoj se ky libër pati vlerën e vetë se për herë të parë popullarizoi veprën atdhetare të Isa Boletinit. Ndërsa, me argumente shkencore për jetën e veprën e Isa Boletinit, ka shkruar profesoresha e nderuar dr. Fatmira Musaj, në librin “Isa Boletini”⁵, botimi i parë më 1987, nga Instituti i Historisë në Tiranë, dhe më 2004 e riboton librin po me të njëjtin titull. Prof. Musaj, njëherit na ofron të dhënat më të kompletuara që më vonë shumë shkencëtarë i përdorën dhe vazhdojnë t’i përdorin si të dhëna relevante për shkrimet e tyre. Fatmira Musaj, në shkrimet e saja, jo që na lë trashëgim një vepër të çmuar shkencore, por edhe me një guxim të pakrahasueshëm iu qas dhe iu rrekë hulumtimeve për këtë figurë emblematike të kombit shqiptar. Ajo gjurmoi në Arkivin Shtetëror të Shqipërisë me muaj të tërë, vetëm e vetëm që të zbardhë dhe të dëshmojë se patrioti i madh, ishte një atdhetar i padiskutueshëm që ndikoi shumë në rrjedhat e historisë.

Figura e Isa Boletinit, është trajtuar në aspektin shumë dimensional nga historianët dhe të tjerët, si në Kosovë dhe në Shqipëri. Më vitin 1969 botohet punimi i parë nga:

1. Fetah Bahtiri “Rezistenca e shqiptarëve të Selacit ndaj turqve në fillim të shek. XX”, në revistën *Përparimi*, nr. 4. 1969;
2. Shukri Rahimi, “Kryengritjet shqiptare në Kosovë 1909-1912”, *Kosova*, nr. 1. 1972;
3. Pajazit Nushi, “Isa Boletini dhe roli i tij në luftën e popullit shqiptar për çlirim nacional”, *Përparimi*, nr. 3, 1979, Prishtinë;

⁵ Fatmira Musaj, *Isa Boletini*, Tiranë, 1987, 2004.

4. Tahir Abdyli, “Tribuni popullor i bashkëjetesës”, *Kosova*, nr. 15, 1986;
5. Gazmend Shpuza, “Disa mendime rreth pikëpamjeve politike të Isa Boletinit, Koncepti i tij për autonomin e Shqipërisë”, *Buletini shkencor*, Instituti i Lartë Pedagogjik, Shkodër, nr. 1. 1988;
6. Fatmira Musaj, “Isa Boletini në luftë për liri dhe konsolidimin e shtetit të pavarur shqiptar”, Konferenca kombëtare kushtuar 80-vjetorit të Pavarësisë, Tiranë, 1982;
7. Fehmi Pushkolli, *Arti Ushtarak i Isa Boletinit*, Prishtinë, 1996.

Por, pas vitit 1990, kur në Kosovë fillon të jetësohej sistemi shumë partiak (megjithëse i kufizuar), por kjo kohë ishte ende në kapërcyell, kur ndërgjegjia intelektuale haptas dhe më këmbëngulje u vu në mbrojtjen e popullit të vetë dhe filloi të shkruante për të kaluarën e afërt nga një kënd tjetër, kur shkrimet historike, publicistike dhe politike filluan me rebelizëm të mos respektojnë censurën e hekurt serbo-jugosllave dhe të zhvishen nga ideologjizmat e censurat e ndryshme. Pikërisht atëherë, kur të dhënat historike filluan të quhen me emrin e vërtetë e shkencor - fakte historike, veprimtaria e Isa Boletinit filloi të prezantohet, më me guxim dhe në vend më meritore.

Botimet për jetën dhe veprën e Isa Boletinit nuk mungojnë edhe në vitet e më vonshme. Në kushte okupimi, kur vështirë ishte të qëndroje vertikalisht, e ishte edhe më vështirë të organizoje diçka, atëherë kur nuk organizohej asgjë, por me entuziazmin e dashurisë për lirinë, më 1996, Instituti i Historisë në Prishtinë, për nderi të 80-vjetorit të rënies të Isa Boletinit, organizoi sesionin shkencor të titulluar: “Isa Boletini dhe koha e tij”, ku merrnin pjesë shkencëtarë-

historianë të periudhave të ndryshme. Në aspekte gjithëpërfshirëse e të nduarndurshme u trajtua jeta dhe vepra e atdhetarit. Por, për hir të situatës së rëndë që mbretëronte në vend, punimet e këtij sesi u botuan pas dy vitesh nga Instituti i Historisë më 1998, në të cilën u përfshin 17 kumtesa shkencore. Por, me këtë rast do i përmendi vetëm disa nga ato, si:

1. Jusuf Bajraktari, “Relacionet e Isa Boletinit me Bajram Currin”;
2. Fehmi Rexhepi, “Isa Boletini dhe koha e tij”;
3. Emine Bakalli, “Shkrime disonance për Isa Boletinin”;
4. Xheladin Shala, “Veprimtaria kombëtare e Isa Boletinit në vitet 1912-1916”;
5. Isa Bicaj, “Relacione të Malit të Zi me Isa Boletinin”;
6. Limon Rushiti, “Isa Boletini dhe kryengritjet shqiptare të vitit 1913-1915”;
7. Izber Hoti, “Roli i Isa Boletinit në LKSH në Shalë, në Llap dhe Gallap (1908-1912);
8. Ramiz Abdyli, “Isa Boletini në Kryengritjen e Përgjithshme antiosmane të vitit 1912, sipas burimeve Bullgare”;
9. Sabile Keçmezi-Basha, “Portreti i nënës së Isa Boletinit”⁶, etj.

Heroi gjithëkombëtar, përfshihet edhe në punime ku nuk është temë trajtimi ai vetë, por aty ku gërshetohen luftërat për pavarësi me atdhetarët e tjerë po të asaj kohe, si në fejtonet e mr. Sadulla Brestovcit, që i prezantohen publikut të gjerë nëpërmes gazetës së përditshme shqiptare “Rilindja”, me fejtonin e titulluar

⁶ Konferenca shkencore: “Isa Boletini dhe koha e tij”, Prishtinë, 1998.

“Idriz Seferi - Kreshniku i Karadakut”, (në 20 vazhdime), “Rilindja”, janar 1979⁷. Po ashtu, në librin e Shukri Rahimit “Vilajeti i Kosovës më 1878-1912”, Prishtinë, 1968; “Mitrovica dhe rrethina”, Mitrovicë, 1979. Po në të njëjtin vit studiuesi Zekria Cana boton librin “Lëvizja Kombëtare Shqiptare në Kosovë në vitit 1908-1912”, Prishtinë, 1979; Tafil Boletini, “Pranë Isa Boletinit”, Kujtime 1, (1892-1916), Tetovë, 1986, përgatitur nga Marenglen Verli, e shumë e shumë punime të tjera.

Duhet thënë, se për jetën e veprën e Isa Boletinit u shkrua shumë, sidomos me rastin e përvjetorëve të lindjes e të vdekjes së heroit, në shtypin e përditshëm duke e përkujtuar me pietet të thellë. Duke pasur parasysh rezistencën e vazhdueshme dhe sakrificën e kësaj familje, e gatishmërinë për t’iu kundërvënë çdo zaptuesi e robëruesi të huaj në mbrojtje të vatrave familjare e kombëtare, në mbrojtje të nderit familjar e kombëtar, në mbrojtje të popullit e atdheut të vet, familja Boletini u bë e njohur jo vetëm në Kosovë por në mbarë trojet shqiptare e më gjerë. Në bazë të të dhënave që na i ofron autorja Fatmira Musaj dhe të tjerët, vijmë në përfundim se Isa Boletini:

1. Përbënë figurën më emblematike dhe veprën më supreme me përkushtimin e tij ndaj çështjes mbarëkombëtare. Momenti më kulmor i veprës së tij është angazhimi dhe vet sakrifika e tij e vetëdijshme për çështje të mëdha të atdheut.

2. Isa Boletini në bazë të të dhënave që na i ofrojnë autorët, na del se me përkushtimin e vet ngjitet në majat e atdhetarisë dhe qëndron në lartësitë mbarëkombëtare e mbarëpopullore mbi interesat e ngushta lokale, kanunore, materiale e fetare.

⁷ Sadulla Brestovci, “Idriz Seferi - Kreshniku i Karadakut”, (në 20 vazhdime), “Rilindja”, janar, 1979.

3. Në emër të atdheut, të popullit dhe të kombit ngrihet fuqishëm mbi natyrën dhe formën e regjimeve e të qeverisjeve kolonizuese.

4. Pa i marrë parasysh ofiqet e benificionet që i ofrohen nga ana e okupuesve, atdhetari i shquar Isa Boletini sakrifikonte jetën vetëm e vetëm për ta bërë kombin e vet të pavdekshëm dhe vendit të tij t'i sigurojë një shtet të pavarur në suazat e tij të plotnueme.

5. Duke e lexuar dhe studiuar në shkrime të ndryshme, veprën e Isa Boletinit detyrohem ta respektojmë e nderojmë edhe më tepër figurën madhore të vet Isa Boletinit, se me një atdhetar të këtij kalibri lartësohet, fuqizohet, trimërohet, kulturohet dhe krenohet i tërë kombi para historisë dhe para së ardhmes.

Dhe, krejt në fund, duhet shtuar se, hulumtimi e studimi i jetës dhe veprës së Isa Boletinit është i lidhur ngushtë me ndriçimin e historisë së Lëvizjes Kombëtare Shqiptare si në Kosovë po ashtu edhe në Shqipëri, dhe se emri dhe veprimtaria e tij ngrit e lartëson historinë kombëtare, për të cilin, ka për çka të shkruhet dhe çka të thuhet, se me këto shkrime që u përmenden më lart mendoj se megjithatë, ende nuk kanë shteruar të dhënat për jetën dhe veprën e atdhetarit.

Prof. dr. Sabile KEÇMEZI - BASHA

SUMMARY

THE TREATISE OF THE FIGURE OF ISA BOLETINI IN ALBANIAN HISTORIOGRAPHY

As it is known, in the long and bitter, yet glorious, roads of history, our people had many famous characters, organizations, movements and achievements, which bear great values not only for us, but for the entire history of the region and more, with which the Albanian nation is proud of. In the long road of Albanian liberation and unification movements prior and after the declaration of Albania's independence, a place full of merit is dedicated to the patriotic figure of Isa Boletini, who was a renowned participator of the National Albanian Movement.

The figure of Isa Boletini was highly valued at any given time and period, with slight oscillations in some writings of foreign authors who study the issues related to the National Albanian Movement. As the historian and biographer of Isa Boletini, Prof. Dr. Fatmira Musai would say, there is no published article known pertaining to the historiography of pre-liberation period which documents the activity of Isa Boletini in his quest for the national resolution. Going through the works of biography written for Isa Boletini, I did not stumble upon any article that was written before the Second World War.

After the war, there was a period when the studies for the National Albanian Awakening were being intensified. A particular importance was paid to Isa Boletini from 1945 up until the '70s of the 20th century.

**Prof. dr. Proletar HASANI &
Prof. assoc. dr. Bernard ZOTAJ
(Tiranë)**

DIMENSIONI USHTARAK I ISA BOLETINIT

Në historinë e popullit shqiptar, Isa Boletini është padyshim ndër figurat më të spikatura dhe të vlerësuara për shpirtin e flaktë atdhetar, protagonizmin e shquar dhe të veçantë në rrugën e gjatë dhe të mundimshme për formësimin, çlirimin, pavarësinë kombëtare dhe krijimin e shtetit shqiptar. Ai ishte jo vetëm i pranishëm, por edhe protagonist në shumicën e ngjarjeve të mëdha historike të popullit shqiptar, që nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit deri në mesin e Luftës së Parë Botërore. Në këtë këndvështrim mund të thuhet pa lëkundje se I. Boletini ishte një figurë shumëdimensionale, politike, diplomatike dhe emblematike.

Por, njëherësh dhe më së shumti, ai përshfaqti në të gjithë veprimtarinë e tij të gjatë dhe të pasur luftarake edhe një dimension tjetër të veçantë, të njohur, por gjithsesi pak të rrahur dhe analizuar, në të cilën spikatën cilësitë e rralla si një lider, strateg, komandant dhe takticient krijues dhe i suksesshëm, *ndonëse nuk ishte aspak një*

oficer i mirëfilltë i karrierës! Ky dimension përfshin cilësitë e tij prej prijësi dhe lideri ushtarak të lindur e popullor, natyrisht me dukuritë dhe të veçantat e veta. Isa Boletini, siç dihet, nuk kishte studiuar art ushtarak dhe nuk ishte diplomuar në ndonjë shkollë apo akademi ushtarake, si dhe nuk kishte marrë njohuri të kultivuara për historinë, mendimin dhe teoritë ushtarake. Për këtë arsye ai nuk kishte patur mundësi të lexonte klasikët e mendimit ushtarak, *Sun Cu*, *Zhomin*, *Klauzevitc* apo dhjetëra të tjerë.

Megjithatë, me zgjuarsinë dhe intuitën natyrale, ai arriti të bënte pjesë të arsenalit të pasur të njohurive, një numër elementësh të artit të drejtimit dhe komandimit, të artit të luftuarit, të cilat i zbatoi në fushëbetejat, në mënyrë krijuese. Dhe ia doli për mrekulli t'i gërshetonte ato mjaft mirë me mendimin dhe artin luftarak tradicional të popullit shqiptar në kushtet e teatrit luftarak karakteristik dhe të ushtrive jo të rregullta, të përbëra nga luftëtarë vullnetarë, që dinin të përdornin deri në perfeksion taktikën e luftës popullore, të trashëguar nga paraardhësit e tyre. Në to ai kishte pasur shpesh suksese me rrjedhoja historike dhe jehonë evropiane, duke përvijuar kështu një fizionomi dhe dimension të vetin. Për këto arsye tek çdo shqiptar, por jo vetëm, për Isa Boletinin ruhet, përveç imazhit burrëror dhe luftarak, edhe ai i liderit dhe strategut të veçantë popullor, pa veshje dhe spaleta ushtarake, por gjithsesi me një fizionomi të vetën! Dhe ishin pikërisht përmasat që përfaqësonte kjo figurë e madhe, që e shtynë njërin ndër politikanët dhe intelektualët e njohur shqiptarë, Eqrem bej Vlorën ta portretizonte Isa Boletinin si, "... njëra nga figurat më të fuqishme dhe të kompletuara të Shqipërisë së atëhershme"¹.

¹ Eqrem bej Vlora, *Kujtime 1885-1925*, Shtëpia e Librit dhe Komunikimit, Tiranë, 2003, f. 221.

Dhuntitë dhe aftësitë luftarake e drejtuese prej prijësi, komandanti dhe takticieni të talentuar të Isa Boletinit ishin të lindura e natyrale, por ato u përpunuan dhe perfeksionuan me përvojën e fituar me kohë, nga njëra ngjarje në tjetrën dhe nga beteja në betejë. “Pagëzimin” e zjarrit, Isai e mori në moshë të re, si luftëtar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, në betejën e njohur të Slivovës kundër forcave osmane.²Më pas, në vitet 1901-1902, ai vihet në krye të qëndresës popullore të Kosovës kundër ndërhyrjeve të Serbisë, Malit të Zi dhe Austro-Hungarisë në Shqipëri.

Pas kësaj kohe emri i tij si luftëtar, por sidomos si lider i përmasave të mëdha nisi të rritej dhe do të bëhej shumë i njohur, si dhe pjesë e *Zenithit shqiptar*, për zgjuarsinë, aftësitë luftarake dhe ato drejtuese ushtarake, që shpalosi në veprimtarinë luftarake kundër pushtuesve osmanë. Isa Boletini u bë përkrahës i Revolucionit Xhonturk të vitit 1908, ndërkohë që ishte së bashku me prijësit e tjerë të shquar, si: Bajram Curri, Hasan Prishtina, Idriz Seferi dhe Ramadan Zaskoci, ishte një ndër organizatorët e Kuvendit të Ferizajt po të këtij viti, i cili luajti një rol me rëndësi në shpalljen e Kushtetutës dhe fitoren e xhonturqve.

Por, shumë shpejt ai dhe shqiptarët u tërhoqën të zhgënjyer për shkak të politikës antishqiptare që ndoqën *Turqit e Rinj*³. Isa Boletini u shqua veçanërisht si organizator dhe udhëheqës i spikatur në kryengritjet e mëdha popullore kundërosmane të viteve 1909-1912. Sipas vlerësimeve të autoriteteve dhe shtypit të asaj kohe, Isai

²*Fjalori Enciklopedik Shqiptar (FESH)*, Vëll. 1, “Kristalina K-H”, Tiranë, 2008, f. 276.

³*FESH*, Vëll. 2, f. 1435.

ishte vetë “shpirti i këtyre kryengritjeve”.⁴Në këtë kuadër ai udhëhoqi dhe drejtoi me aftësi të veçanta luftarake dhe të suksesshme disa nga betejat në përballjet e armatosuara me forcat e ushtrisë osmano-turke, sidomos në vitin 1910, një ndër më të ashprat ndër to ishte beteja e Shtime-Carravelës. Më tej, Isa Boletini mbështeti fuqishëm Kryengritjen kundërosmane të Malësisë së Madhe, të vitit 1911, si dhe u vu në udhëheqjen e forcave kryengritëse shqiptare në zonën Drenicë-Mitrovicë dhe Podujevë-Prishtinë, në vitin 1912. Gjatë Kryengritjes së madhe të Përgjithshme të vitit 1912, të cilat çuan në shpalljen e pavarësisë dhe krijimin e shtetit të parë të pavarur shqiptar, Isa Boletini ishte në udhëheqjen e çetave vullnetare të armatosura për mbrojtjen e territoreve shqiptare kundër shovinistëve serbë.

Me krijimin e shtetit të pavarur shqiptar, ai gjendet përkrah qeverisë së përkohshme të Vlorës, për organizimin e Forcave të Armatosura Shqiptare. Madje, edhe në kohën kur po kërcënohej ekzistenca e Qeverisë shqiptare të Princit Vilhem Vidit (*Wilhelm von Wied*) nga rebelët e Shqipërisë së Mesme, në vitin 1914, Isai u vu në mbrojtje të saj. Siç ka shkruar Eqrem Vlora lidhur me këtë ngjarje: “Në mbrojtje të qeverisë Vidi, në Durrës mbritën aty nga fillimi i Qershorit 1914, me çetat e para (rreth 400 burra) nën komandën e Isa Boletinit dhe Hysni Currit”⁵.Këtë fakt e përmend në librin e tij edhe prof. Arben Puto⁶.

⁴Skender Luarasi, *Isa Boletini*, “8 Nëntori”, Tiranë, 1971, f. 105.

⁵ E. Vlora, *Kujtime 1875-1925*, libër i cituar, f. 381.

⁶ Arben Puto, *Shqipëria politike 191 -1939*, TOENA, Tiranë, 2009, f. 140.

Për të zbuluar dhe vënë në pah disa ndër vetitë organizative dhe aftësitë prej drejtuesi të përmasave strategjike dhe takticieni krijues me cilësi të veçanta, që përbëjnë dimensionin prej ushtaraku të Isa Boletinit, po ndalemi në disa prej betejave dhe luftimeve që u zhvilluan në kuadrin e Kryengritjeve të mëdha shqiptare të viteve 1910 dhe 1912. Në to Isai ishte një ndër ideatorët, organizatorët dhe drejtuesit kryesor, një mjeshtër dhe ekspert i vërtetë, me cilësi të rralla organizative, si dhe një strateg vizionar në përcaktimin e objektivave të një kryengritjeje me përmasa kombëtare.

Siç shkruam më parë, I. Boletini zotëronte aftësinë e çmuar, të spikatur dhe të veçantë të negocimit, aq e nevojshme për organizimin e kuvendeve, kodi i të cilave ishte besëlidhja (apo aleanca), siç ishte modë të thuhej atëherë. Po ashtu, shkëlqente edhe si një organizator i rrallë, në pikëpamje strategjike, të kryengritjeve kundër pushtuesve osmanë dhe shovinistëve sllavë, ashtu siç ishte dhe një strateg vizionar. Janë të njohura Kuvendi i Ferizajt i vitit 1908, i Verrave të Llukës i vitit 1910, ai i Junikut i majit 1912. Pikërisht nga këto kuvende lindën besëlidhjet që siguruan mbështetjen dhe bashkëpunimin e shumë prijësve dhe të mijëra luftëtarëve dhe i çuan përkrahësit në kryengritjen e vitit 1908, 1910 në Kosovë dhe Shqipëri dhe ajo e njohur si Kryengritje e Përgjithshme e vitit 1912 që, siç dihet, çoi në triumfin e çështjes kombëtare shqiptare, shpalljen e pavarësisë dhe krijimin e shtetit të parë modern shqiptar, më 28 nëntor 1912.

Ndërkaq, besëlidhjet janë baza të fuqishme, të pazëvendësueshme për fitore, në çdo betejë apo luftë, edhe në ato populllore, ku veprojnë të njëjtat ligjësi, si dhe në artin ushtarak të ushtrive të rregullta aktive. Besëlidhjet apo aleancat, të mëdha apo të vogla, janë kurdoherë arsye për të qenë më të fortë, për të qëndruar dhe fituar. Dhe Isai e dinte mirë këtë të vërtetë. Kështu, aty nga fundi

i muajt prill të vitit 1910, Isa Boletini së bashku me Hasan Prishtinën dhe Sulejman Batusha, thirrën Kuvendin e Verrave të Llukës, në të cilin I. Boletini shtroi domosdoshmërinë e mbështetjes dhe shtrirjes së kryengritjes përtej Kosovës. Sipas tij, lufta e shqiptarëve duhej të synonte çlirimin kombëtar dhe shoqëror, gjë e cila kërkonte bashkimin dhe mbështetjen e fuqishme të Kryengritjes⁷. Në këtë mënyrë mori jetë dhe formë organizimi i Kryengritjes së vitit 1910, në Kosovë.

E trembur nga këto përgatitje të shqiptarëve, Qeveria osmane vendosi t'i shtypte ato me forcën e armëve. Për këtë qëllim Ministria e Luftës dhe ajo e Brendshme përgatitën edhe një plan operacioni luftarak, që i u ngarkua për zbatim dhe komandim gjeneral Shefqet Turgutit. Në rrjedhën e këtij operacioni, aty nga fundi i prillit 1910, forcat operacionale osmane ishin përqendruar në Shkup, si dhe në trevat e Prishtinës, Pejës, Gjakovës dhe Gjilanit. Sipas planit operacional të tyre, synohej mësymja mbi forcat kryengritëse në tre drejtime kryesore, nëpërmjet tri kolonave për asgjësimin e forcave shqiptare dhe shtypjen e kryengritjes së tyre. Në kundërpërgjigje të këtij plani, të cilin kishin arritur ta zbulonin dhe konceptonin, drejtuesit kryesorë të Kryengritjes, strategët Isa Boletini dhe Idriz Seferi, së bashku me prijës të tjerë të njohur bënë përqendrimin e afro 30 mijë luftëtarëve kryengritës⁸ të grumbulluar, që ishte përpunuar sipas një ideje strategjike, të ideuar dhe formuluar qysh më parë. Në përputhje me këtë strategji, forcat luftarake shqiptare u ndanë në dy grupe kryesore që, pas një lëvizje të shpejtë dhe në rrugëkalime të shkurtra, duhej të vendoseshin në mbrojtje, secili në një drejtim me rëndësi strategjike, për t'i mbrojtur ato dhe, njëkohësisht, për të penguar e dëmtuar forcat osmane, si dhe për të

⁷*Kryengritjet e vitit 1910 në Kosovë*, Instituti i Historisë-Prishtinë, 2012, f. 13, 101.

⁸Po aty, f. 118.

ndaluar furnizimet e tyre në rrugëkalimet kryesore Shkup-Ferizaj-Prishtinë dhe Shkup-Shtime-Prizren.

Ideja pasohej nga një plan i mirëdetajuar, ku parashikohej çdo veprim, që nga mënyra e lëvizjes së forcave kryengritëse, rrugëkalimet, ndarja në grupime, vendvendosjet e secilit prej tyre, furnizimet me ushqime dhe municione, shfrytëzimin e terrenit, fshehtësinë e lëvizjes, deri tek mbajtja dhe mënyrat e ardhjes së forcave rezervë. Duke kapur nyejt dhe lartësitë kyçe që mbizotëronin dhe kontrollonin arterien më të rëndësishme rrugore, që bashkonte tre qytetet Shkupin me Prishtinën dhe më tej, me Mitrovicën, ashtu si dhe arterien tjetër, jo më pak të rëndësishme, Ferizaj-Shtime-Prizren. Kështu, ushtria osmane do të dëmtohej, rraskapitej, do t'i ndërpriteshin furnizimet dhe, ç'është më e rëndësishmja, nuk do të lejohej që të depërtonte në brendësi të vendit për të shtypur dhe asgjësuar forcat kryengritëse shqiptare.

Në zbatim të këtij plani strategjik, forcat kryengritëse u ndanë dhe u vendosën si më poshtë: *Grupimi i Parë*, që drejtohej nga Isa Boletini, Hasan Hysen Budakova dhe Sulejman Batusha, kishte për detyrë të pengonte depërtimin e forcave ushtarake osmane, që do të mësynin përgjatë rrugës kryesore Ferizaj-Shtime-Prizren. Për këtë qëllim drejtuesit e këtij grupimi kryengritës, përzgjedhën të zinin dhe të mbronin me forcë nyjën me rëndësi strategjike dhe përcaktuese, tashmë me vlera historike për tërë rajonin dhe më gjerë, që ishte rajoni Shtime - Carralevë, me qendër Grykën e Carralevës, për të ndaluar forcat osmane që kishin për qëllim të çanin në drejtimin e rrugës Shtime-Ferizaj-Prizren. Ndërkohë, *Grupimi i Dytë* i forcave kryengritëse, të ardhura nga kazaja e Gjilanit, Kumanovës dhe Preshevës, i drejtuar nga një tjetër prijës po aq i njohur, strategu popullor, Idriz Seferi, shpejtoi të zinte dhe të vinte nën mbrojtje

Grykën tjetër po aq strategjike, atë të Kaçanikut që gjendet po në atë bosht rrugor.

Përfundimisht, përmes lëvizjeve me ide mbrojtëse, pasi të kapeshin me forca të dy grykat, synohej të pengohej dhe ndalej mësymja e forcave ushtarake osmane përballë dhe të ndalej bashkëveprimi i tyre me grupimin tjetër të ushtrisë osmane që mësynte nga drejtime të tjera. Njëherësh, synohej të bllokohej lëvizja e trenave që bënë furnizimin e forcave osmane me ushqime, municione, veshmbathje etj., përgjatë këtij aksi rrugor.

Parë në këtë këndvështrim, plani i mësymjes bazohej në një strategji mjaft të qartë, të saktë, racionale dhe efektive, sepse vendosja e forcave kryengritëse në lartësitë e dy grykave strategjike, që mbisundonin dhe kontrollonin kalimin përgjatë rrugës që përshkonte luginën, ishte një gjetje sa e zgjuar aq dhe e duhur për të zbutur raportin më të vogël në forca dhe mjete luftarake të kryengritësve shqiptarë, në përjasje me forcat ushtarake osmane. Kjo ndodhte sepse, ata ishin pjesë e ushtrisë së rregullt dhe kishin përparësi në armatime, municione, logjistikë, ushqime, mjete transporti etj., por kishin edhe përvojë luftarake të pasur. Dhe të gjitha këto ndodhën në betejën e ashpër të Shtime-Carralevë, që u zhvillua në datat 8 deri më 10 dhe 11 maj, ndërkohë që raporti i forcave fliste në dobi të mësymësve osmanë në treguesin e numrit të forcave, armatimeve dhe mjeteve luftarake. Më 7 maj 1910, përballë 3 000 luftëtarëve shqiptarë⁹, vullnetarë këmbësorë, të armatosur pothuaj tërësisht me armë supi dhe brezi, mësynë 8 000 ushtarë¹⁰

⁹ *Kryengritja e vitit 1910 në Kosovë*, f. 33.

¹⁰ *Fjalori Enciklopedik Shqiptar (FESH)*, Vëll. 1, “*Kristalina K-H*”, Tiranë, 2007, f. 226, jepen shifrat 8 000 shqiptarë dhe 20 000 turq - osmanë. Kurse në librin *Kryengritja e vitit 1910 në Kosovë*, cituar më parë, f. 120, jepen të dhëna për armatimet e forcave ushtarake osmane si më poshtë: “9 topa fushorë, 9 topa malorë, 8 pushkë - mitralozë dhe 1 automatik lufte”.

osmanë, të armatosur me pushkë, mitralozë dhe artileri, e cila godiste me predha vazhdimisht pozicionet e kryengritësve në mbrojtje. Në këtë betejë, raporti në forca ishte më se 2-3:1, kurse në mitralozë dhe artileri tërësisht në favor të forcave të ushtrisë mësymëse osmane.

Zhvillimi i veprimeve luftarake, që nisën më 28 prill 1910, së pari në mësymje kundër forcave mbrojtëse kryengritëse në Grykën e Kaçanikut, të ashpra dhe me përdorimin e armëve të rënda të zjarrit për dy ditë me radhë, dëshmoi qartë realizimin, racionalitetin dhe efektshmërinë që përbënte thelbin e këtij plani. Nga ana tjetër, edhe pse mbrojtësit e Kaçanikut u tërhoqën për shkak të epërsisë së osmanëve në forca dhe armatime, megjithatë lufta vazhonte. Përpara qëndronte një nyje tjetër e vërtetë strategjike, Gryka e Carralevës, që mbrohej nga forcat kryengritëse të drejtuara prej Isa Boletinit. Për këtë arsye forcat osmane, jo vetëm do të dëmtoheshin me të vrarë dhe të plagosur, por vonoheshin shumë në realizimin e qëllimit të tyre për të thyer dhe shuar kryengritjen shqiptare në trevat e Kosovës.

Në ndryshim me strategjinë dhe taktikën e ndjekur nga mbrojtësit e Kaçanikut, në Carralevë Isa Boletini projektoi dhe vuri në zbatim një taktikë tjetër. Ai ndoqi taktikën e mbrojtjes aktive ose kundërsulmuese, që i jepte zhdërvjelltësi dhe manovrueshmëri forcave për të dëmtuar dhe penguar qysh në nisje forcat ushtarake osmane, të cilat lëvizën në disa kolona nga vendpërqendrimet për në vijën e mësymjes ose të nisjes për mësymje. Luftëtarët e grupimit mbrojtës, të komanduar dhe prirë nga vetë Isa Boletini, megjithëse të vendosur në pozicione mbrojtjeje, e nisën luftimin (betejën) me shumë zgjuars, duke i sulmuar kolonat armike qysh gjatë afrimit. Sulmi u dha nga lartësitë dhe krejt në befasi. Kryengritësit, duke qenë njohës të mirë të terrenit, e shfrytëzuan atë mjaft mirë, duke i detyruar forcat osmane të ndaleshin dhe tërhiqeshin me humbje të

ndjeshme në njerëz dhe mjete luftarake. Ashtu si rrodhën ngjarjet, komandanti i operacionit, gjeneral Shefqeti, u detyrua të kërkonte armëpushim, me synim plotësimin e forcave, riorganizimin e tyre, si dhe rishikimin e planit të mësymjes. Mësymja do të rifillonte më 10 maj dhe pas luftimesh shumë të ashpra, të cilat u përhapën në një front tejet të shtrirë e të gjerë, të karakterizuar nga një qëndresë e jashtëzakonshme e vetëmohuese e forcave kryengritëse, në një raport forcash dhe mjeteesh luftarake që ndryshonte çdo orë në favor të mësymësve osmanë, ndërsa municionet po shteronin, kurse forcat rezervë dhe ndihmëse nuk po dukeshin; teksa unaza e rrethimit po ngushtohej, Isa Boletini dhe bashkëprijësi Hasan Hysen Budakova, ndërmoren vendimin për të dalë nga rrethimi. Dalja nga rrethimi u organizua dhe u krye me sukses, duke shfrytëzuar një shteg të ngushtë dhe errësirën e natës së datës 11 maj 1910. Pas daljes nga rrethimi forcat kryengritëse u tërhoqën drejt Drenicës dhe Anamoravës.

Në analizë të betejës mbrojtëse të Carralevës vërehet se, plani dhe drejtimi i forcave kryengritëse ishin konceptuar dhe realizuar me zgjuarsiri dhe mjeshtëri nga drejtuesit e tyre kryesorë. Në mbrojtje u ndërthurën me sukses veprimet mbrojtëse me ato sulmuese, që i dhanë lëvizshmëri, manovrën e duhur dhe efektivitet mbrojtjes, duke kapërcyer skemat shabllone të taktikës së mbrojtjes së palëvizshme, e cila thyhet shpejt dhe detyron tërheqjen, shpesh me humbje të ndjeshme. Kjo dukuri i kishte shtyrë oficerët turq të besonin tek alibia se luftëtarët kryengritës drejtoheshin me siguri nga ushtarakë të shkolluar dhe specialistë të zot që, sipas tyre, nuk mund të ishin shqiptarë¹¹! Ndërsa, konsulli francez në Shkup, në një raport të asaj kohe do të bënte një vlerësim më të singertë, teksa shkruante: “...

¹¹ Gazeta “*Le Progres de Selanique*”, maj, 1910.

kryengritësit luftonin sipas një plani të përcaktuar e të parapërgatitur, sipas një taktike mjaft të përparuar”¹².

Arsyeja që u ndalëm më gjatë tek Kryengritja e vitit 1910 në Kosovë, ka qenë për t’u marrë veçanërisht me betejën e Shtime-Carravelës, si dhe për të veçuar dhe vënë në dukje rolin e Isa Boletinit si strateg, takticien krijues dhe komandant kurajoz e trim. Por, në kuadrin e Kryengritjes së Përgjithshme të vitit 1912, Boletini ishte pjesë në projektimin dhe drejtimin e një vargu luftimesh në trevat e Kosovës. Ndër to ishin veprimet luftarake sulmuese mbi qytetin e Pejës, më 31 maj 1912, me 2 000 luftëtarë¹³. Apo luftimet disa ditore të 1 500 luftëtarëve kryengritës për thyerjen e operacionit mësymës të grupimit ushtarak osman, të përbërë nga 4 000 ushtarakë, të mbështetur nga artileria, kundër fshatit Boletin, më 30 qershor deri 3 korrik po të këtij viti, ku osmanët lanë 100 të vrarë¹⁴.

Për të vijuar me mësymjen e 6 000 forcave kryengritëse të drejtuara nga Isa Boletini kundër forcave osmane që mbanin Mitrovicën, të cilin ai i doli ta merrte me bisedime, më 27 korrikun e vitit 1912¹⁵. Për të ardhur më 13 gusht, po të vitit 1912, kur forcat kryengritëse nën komandën e I. Boletinit, marshuan drejt qytetit të Shkupit, të cilin e çliruan, duke hapur rrugën për forcat kryesore, të përbëra nga afro 6 000 luftëtarë, që hynë në këtë qytet dy ditë më pas¹⁶. Nëse mbështetemi në përshkrimin dhe analizën e këtyre dhe të veprimeve luftarake mbrojtëse apo mësymëse të përmendura më herët, të forcave kryengritëse të udhëhequra dhe të komanduara nga Isa Boletini, me praninë dhe asistencën e prijësve të tjerë të shquar, u vunë re disa veçori dalluese.

¹² *Kryengritja e vitit 1910 në Kosovë*, Prishtinë, 2012, f. 103.

¹³ *Historia e Popullit Shqiptar*, Vëll. II, e cituar, f. 471- 472.

¹⁴ Po aty, f. 480,483,

¹⁵ Po aty, f. 483.

¹⁶ *Historia e Popullit Shqiptar*, Vëll. II, f. 491.

Pothuajse në të gjitha betejat, ku ka marrë pjesë edhe Isa, plani për vendosjen apo rendimin e forcave, përzgjedhja dhe përcaktimi i pozicioneve të mbrojtjes (terrenit) dhe vija e nisjes për sulm, ashtu si dhe taktikat për realizimin e tyre dhe komandimin e forcave, janë marrë në mënyrë të përbashkët ose ndryshe kolegjiale, si në një shtab ushtarak klasik! Kujtoni, me këtë rast, betejën e famshme të Carralevës dhe daljen e forcave kryengritëse nga rrethimi pas tri ditë luftimesh, përcaktimi i taktikës aktive dhe manovruese, ashtu dhe vendimi për daljen nga rrethimi kërcënues më datën 10 në darkë për 11 maj 1910, u morën pas diskutimesh midis I. Boletinit, H. Budakovës etj. E parë në këtë këndvështrim, e njëjta gjë mund të thuhet edhe për thurjen e idesë kryesore dhe të parimit strategjik, sipas të cilit do të realizoheshin qëllimet strategjike të kryengritjes së vitit 1910, në Kosovë. Nëse i referohemi kësaj strategjie të thjeshtë dhe racionale, por edhe mjaft realiste, që merrte për bazë elemente të tillë të rëndësishëm, përcaktues për fatin e luftimeve si terreni, rrugëkalimet strategjike dhe raportin e forcave e të mjeteve luftarake të të dy palëve, u përcaktua si më poshtë. Veprimet e forcave luftarake vullnetare kosovare duhej të përqendroheshin në dy grupe që në fakt, do të vepronin në tre drejtime kryesore.

Grupimi i Parë përfshinte luftëtarët nga trevat e Shalës, Llapit dhe Drenicës, të drejtura nga I. Boletini dhe Hasan Hysen Budakova, zonë Grykën e Cerralevës, që kontrollonte dhe mbyllte drejtimin e vijës Ferizaj-Shtime-Prizren, një rrugëkalim ky tejet i rëndësishëm për atë kohë. Një pjesë e grupimit, ku bënë pjesë forcat kryengritëse të drejtura nga prijësi i njohur Hasan Hysen Budakova, u vendosën në “rajonin malor në perëndim të Ferizajt deri në pjesën jugore të Carralevës”¹⁷. Ndërkohë, *Grupimi i Dytë* i drejtuar nga prijësi dhe strategu tjetër Idriz Seferi, i përbërë nga forca vullnetarësh

¹⁷Jusuf Bajraktari, *Kryengritjet antiosmane të vitit 1910 në Kosovë*, f. 15.

të ardhur prej Gjilanit, Kumanovës dhe Preshevës, mori mbi vete mbrojtjen e drejtimit strategjik të Grykës së Kaçanikut. Që këndeje duhej të pengonte dhe ndalonte mësymjen e ushtrisë turke përgjatë rrugës Shkup-Tetovë dhe drejtimin e saj nga qendra e Vilajetit drejt pjesës së brendshme të Kosovës¹⁸.

Në përfundim të zhvillimit të veprimeve luftarake, që zgjatën shumë ditë, duke u shtrirë në një gjerësi dhe thellësi të madhe, mund të thuhet se, plani strategjik i përpiluar nga I. Boletini, I. Seferi dhe “shtabi” i tyre, ishte rezultativ. Duke nisur nga grumbullimi, armatosja, lëvizja dhe afrimi i forcave vullnetare kryengritëse nëpër rajonet dhe vendqëndrimet, deri tek bërja e shpejtë dhe e fshehtë për në rajonet apo pozicionet e përcaktuara për mbrojtje, ishin të ideuara dhe realizuara mjaft mirë. Edhe përzgjedhja dhe zënia e dy grykave, të Carralevës dhe Kaçanikut, nga luftëtarët kryengritës, si dy rajone me rëndësi strategjike, si dhe shpërndarja e pozicionimi i forcave në pikat më kyçe në tërë hapësirën midis dy grykave, ashtu si dhe qëndresa luftarake shumëditëshe, nën një mësymje me forcat superiore turke, të një ushtrie me përvojë luftarake, të mbështetura nga zjarri i fuqishëm i artilerisë malore dhe fushore, si dhe zjarri i mitralozave, dëshmuar se strategjia e përdorur nga drejtuesit e kryengritjes ishte e ndërtuar me mençuri dhe mjeshtëri luftarake. Nga ana tjetër, si një pjesë e kësaj strategjie, duhet të veçohet organizimi ushtarak i forcave kryengritëse nga liderët e kryengritjes, ku një rol të dorës së parë luante, pa diskutim I. Boletini.

Drejtimi i forcave kryengritëse nga I. Boletini dhe nga disa prijës e drejtues të tjerë, duke gërshetuar harmonishëm veprimet mbrojtëse me ato sulmuese dhe kundërsulmuese shpeshherë ishin të realizuara kaq mjeshtërisht, sa që kjo i shtyu ushtarakët turq, të mos besonin se ishin drejtues shqiptarë. Përkundrazi, ata mendonin se

¹⁸*Historia e Popullit Shqiptar*, Vëll. II, e cituar më parë, f. 430.

luftëtarët kryengritës drejtoheshin nga njerëz të shkolluar dhe specialistë të zot. Madje, ata shkonin deri atje sa të krijonin alibinë se këta nuk mund të ishin shqiptarë¹⁹! Duke u shtyrë nga zhvillimi i këtyre ngjarjeve, historiani i njohur kosovar Zekeria Cana ka përcaktuar qartazi se: “Kryengritja e vitit 1910 ishte organizuar mirë... ajo ishte vepër e Seferëve dhe Boletinëve”²⁰.

Një ndër të veçantat që e dallonte I. Boletinin nga prijësit e tjerë të shquar shqiptarë bashkëkohës me të, përshtatet dukshëm sidomos në sferën e organizimit ushtarak, si dhe të krijimit të zbatimit të skemave taktike gjatë betejave apo luftimeve. Kjo veçanërisht në kuadrin e kryengritjeve shqiptare të viteve 1908, 1910 dhe 1912. Duke shfrytëzuar përvojën e trashëguar, tradicionale, në organizimin e formacioneve luftarake populllore vullnetare, që morën pjesë në veprimtaritë luftarake, si dhe rendimin e tyre për mbrojtje apo sulm, kundër forcave pushtuese turke apo të tjerë. Struktura organizative bazë e forcave luftarake vullnetare shqiptare, edhe në Kosovën e viteve 1908-1912, përgjithësisht ka qenë çeta, natyrisht me përbërje numerike të ndryshme, nga njëra krahinë apo prijës tek tjetri. Çeta ishte një formacion i lehtë, i pajisur me armë supi dhe brezi, gjë që e bënte atë të shpejtë dhe të manovrueshëm, sidomos në luftimet mbrojtëse, posaçërisht në prita. Për këtë arsye çetat, shpeshherë gjatë veprimeve mbrojtëse, kalonin në kundërsulme, sidomos kur terreni i mundësonte dhe favorizonte ato nga lart-poshtë. Si rregull, kur bëhej fjalë për të vepruar në një betejë apo luftim së bashku, çetat organizoheshin me grupçeta apo grupforcash, nën drejtimin ose komandën e një prijësi apo lideri popullor më të njohur të krahinës ose trevës përkatëse.

¹⁹ *Kryengritja e vitit 1910 në Kosovë*, f. 103.

²⁰ Zekeria Cana, *Lëvizja Kombëtare Shqiptare në Kosovë 1908 - 1912*, Prishtinë, 1979, f. 29.

Të tilla kanë qenë formacionet e organizuara dhe të drejtuara edhe nga Isa Boletini në fushëbetejat e kryengritjeve të viteve 1910 apo 1912. Tipike ishte beteja e famshme e Carralevës ku, çetat e ardhura nga krahina e Shalës, Llapit dhe Drenicës, krijuan një grupim ose grupforcë dhe u vendosën në mbrojtje të rajonit strategjik të Shtime-Carralevës, që kontrollonte rrugën Ferizaj-Shtime-Prizren. Pikërisht në organizimin dhe përdorimin e këtyre formacioneve luftarake me efektivitet të dukshëm, ishte mendja dhe dora e Isa Boletinit, por edhe e strategëve dhe prijësve të tjerë shqiptarë përreth, si: Idriz Seferi, Hasan Hysen Budakova etj.

Por, Isa Boletini njihej dhe vlerësohej së tepërmi nga bashkëprijësit, nga shtypi evropian i kohës, madje edhe nga vetë kundërshtarët e përhershëm turq, si njohës dhe përdorues i shkëlqyer i skemave taktike të luftimit, për të cilat çmohej si një takticien i dorës së parë, dhe mjeshtër i vërtetë. Këto aftësi spikatën si në luftimet me karakter mbrojtës, edhe në ato mësymëse. Për këto aftësi, në arsenalin e pasur të taktikave, formave dhe metodave luftarake që përdorën forcat luftarake shqiptare në suazën e luftimeve apo betejave të kryengritjeve popullore të viteve 1908-1909, 1910-1912, krahas prijësve të tjerë të shquar, ndikim të dukshëm pati edhe Isa Boletini, me idetë, gjetjet dhe zgjidhjet e tij racionale dhe rezultative të sferës taktike. Ndër to bien në sy disa veçori dalluese, që u vunë re pothuajse ndër të gjitha veprimet luftarake ku mori pjesë dhe drejtoi I. Boletini. Përmes këtyre metodave shqiptarët, duke u përpjekur të kompensojnë numrin shumë më të pakët të forcave, të armëve, municioneve dhe mjeteve luftarake të kohës, mungesën e ushtrisë së rregullt, luftëtarët vullnetarë popullorë zbatuan një taktikë racionale të zgjuar dhe efektive. Nëpërmjet saj, ata i lodhnin dhe rraskapitnin forcat e ushtrisë turke, duke u përhapur sa herë që kjo ushtri sulmonte me forca më të mëdha se sa ata. Ndërkohë, luftëtarët

shqiptarë shfaqeshin papritur dhe u binin armiqve që nga pritat ku ishin pozicionuar, ndërsa forcat kundërshtare ishin në lëvizje për t'u afruar, pa e ditur se çfarë i priste.

Gjithashtu, duke përdorur elementin e befasisë, luftëtarët shqiptarë sulmonin rojat turke përgjatë nyjave rrugore, grykave apo qafave të maleve por, jo rrallë, edhe garnizonet turke brenda në qytetet e vendit. Po sipas këtij kodi taktik kryengritësit shqiptarë godisnin në fshehtësi karvanët me furnizime të armikut me ushqime, armatime e municione dhe, nëpërmjet sulmeve natën edhe kampet me tenda ushtarake duke asgjësuar ushtarët turq.

Pikërisht lidhur me taktikën e zbatuar nga forcat luftarake shqiptare gjatë luftimeve, disa gazeta evropiane do të shkruanin se, "... shqiptarët përdorën taktikën që e lodhte shumë ushtrinë turke. Ata shpërndahen sa herë që ushtria turke mësyn me forca shumë më të mëdha se ato shqiptare. Pas kësaj ata i bien ushtrisë armike nga pritat, kur ushtria osmane është duke marshuar në rrugët e afrimit për në rajonet ose vijat e mësymjes; ata u suleshin befas asqerëve që bëjnë roje përgjatë nyjeve rrugore, në gryka apo në garnizonet e qyteteve të vendit... sulmojnë natën viset ku janë ngulur tendat ushtarake, vrasin sa më shumë kuaj që bartin topat"²¹. Kështu i përshkruan shkrimtari dhe studiuesi i mirënjohur Skënder Luarasi shkrimet e disa gazetave të Evropës, kushtuar luftës dhe taktikave të përdorura në to nga forcat kryengritëse shqiptare. Aq i vërtetë ishte fakti që kryengritësit shqiptarë shënjonin dhe godisnin oficerët turq, sa që në betejat e Carralevës dhe të Kaçanikut, shkruhej se oficerët plagët i kanë në gjoks e lartë. Kjo tregon se shqiptarët shtien drejt²². Falë këtyre taktikave dhe metodave luftarake, "... gjeneralët me tirq dhe vetëm me diplomën e akademisë së luftës...", si I. Boletini, Idriz

²¹ Skënder Luarasi, *Isa ...*, libër i cituar, f. 110.

²² Tri jetë, "Koloneli Tomson, Ismail Qemali, Isa Boletini", f. 220 - 221.

Seferi, Hysen Hasan Budakova dhe të tjerë, edhe pse komandonin forca disa herë më të pakta në numër, thyen me turp kryekomandantin e ushtrisë turke në Shqipëri, Mahmut Shefqet Pashën i cili, vetëm në betejën e fundit la në sheshbetejë 1 000 ushtarë dhe 90 oficerë të lartë²³.

Isa Boletini ishte një mjeshtër i vërtetë i organizimit dhe drejtimit me zgjuarsia të luftimit në prita dhe terrene të kufizuara e të mbyllura, por edhe i luftimeve të hapura dhe të zgjatura në kohë, të pasuara me ndjekjen e forcave në hapësira të gjera. Gjatë zhvillimit të veprimeve luftarake me forcat që drejtonte, shpeshherë në kushte të pabarabarta në forca, armatime e municione, por i gjendur jo rrallë përpara të papriturave dramatike, në çaste përcaktuese për jetë a vdekje, falë aftësive të tij, me talentin dhe burrërinë që e karakterizonte, u ngrit mbi to dhe gjeti zgjidhjen e duhur për të zhbllokuar situatat e vështira. Por, beteja e njohur e Carralevës, e zhvilluar në kuadrin e Kryengritjes së vitit 1910 në Kosovë dhe që bashkë me betejën tjetër të famshme të Kaçanikut, të cilat përbëjnë thelbin e kësaj kryengritjeje, është një ndër veprimet luftarake që përshfaqin në mënyrën më të plotë e të gjithanshme aftësitë prej takticieni dhe drejtuesi ushtarak që fshihehin tek Isa Boletini.

Me rënien e Kaçanikut, pas një beteje shumë të ashpër, deri në luftim të afërt trup me trup, ku u përdorën thikat, vëmendja e ministrit të Luftës, Mahmut Shefqet Pashës u përqendrua kundër I. Boletinit, i cili drejtonte forcat kryengritëse që mbronin Grykën e Carralevës, sepse ai e dinte mirë që Isa Boletini ishte në të vërtetë, vetë“shpirti i kryengritjes”²⁴. Vetëm me asgjësimin e tij mund të përparonin forcat e ushtrisë turke, prandaj Pashai turk urdhëroi mësymjen kundër grykës strategjike të Carralevës, me të gjitha fuqitë

²³ Gazeta bullgare “Dnevnik”, viti 1910.

²⁴ S. Luarasi, *Isa Boletini*, e cituar, f. 105 - 106.

që komandonte! Me rënien e Kaçanikut, vija që duhej të mbronin forcat kryengritëse të Carralevës, ishte zgjeruar, por duhej mbuluar vetëm me 2 000 luftëtarët e vendosur në mbrojtje. Ndërkohë, ndihma që pritej nga Peja, sipas besëlidhjes në Verrat e Llukës, nuk erdhi, duke i vështirësuar veprimet e mëtejshme dhe, duke i thelluar raportin e forcave, të armatimeve dhe mjeteve luftarake në anën e armiqve. Tashmë, i mbetur vetëm I. Boletini, që e kishte zbuluar planin e komandës së forcave ushtarake turke, me intuitën dhe përvojën e një drejtuesi ushtarak të rrallë, të lindur, kishte kuptuar gjithçka. Ai kuptoi, nga drejtimi i lëvizjes së forcave osmane se, ideja dhe synimi kryesor i turqve ishte sulmi kundër qendrës së pozicioneve të forcave kryengritëse, Grykës së Carralevës, në qendër të të cilave ai gjendej. I shtyrë nga kjo ide Isai, pasi bëri sigurimin e Grykës së Carralevës me forcat e nevojshme, duke lëvizur përmes zjarrit të artillerisë turke, iu drejtua majës së Carralevës.

Si takticien krijues që ishte, në betejën për mbrojtjen e Carralevës, Isa Boletini mendoi dhe vuri në zbatim një “skemë” taktike, e cila i përshtatej më së miri idesë dhe qëllimit të mbrojtjes, raportit të forcave dhe mjeteve luftarake të pafavorshme për forcat kryengritëse, terrenit mbizotërues, njohjes dhe rëndësisë së tij, ashtu si dhe karakterit, trimërisë dhe shpirtit luftarak të kryengritjes. Skema e zgjedhur, në thelb, parashikonte që për mbrojtjen e rajonit strategjik të Carralevës, të përdorej taktika e mbrojtjes së manovruar, në përputhje me rrethanat e krijuara. Sipas kësaj taktike, mbrojtësit kryengritës të drejtuar me aftësi dhe trimëri nga vetë I. Boletini dhe i ndihmuar dhe asistuar nga prijës të tjerë të njohur, e nisën betejën me sulm mbi kolonat e armikut që lëviznin për t’u afruar në bazat e nisjes për mësymje. Këtë taktikë e favorizuan dukshëm pozicionet e zëna në një terren mbizotërues dhe tejet favorizues për luftëtarët kryengritës.

Duke përdorur këtë taktikë, siç ka shkruar një nga studiuesit e figurës së Isa Boletinit, prof. Fatmira Musaj, me shpirtin luftarak dhe qëndresën e fuqishme, kryengritësit shqiptarë, "...edhe mbrojtësit e Carralevës shfrytëzuan terrenin e favorshëm dhe taktikën e luftës popullore, i detyruan forcat turke të tërhiqeshin disa herë me humbje të shumta njerëzore dhe armatime"²⁵. Kjo taktikë e gjetur mirë dhe qëndresa, me drejtimin mjeshëtor të veprimeve luftarake, e detyroi vetë komandantin e operacionit Mahmut Shefqet Pashën të ndërmerre një armëpushim dyditor. Gjatë armëpushimit, komanda turke i përforcoi forcat me trupa të tjera dhe bëri riorganizimin e tyre, me synim nisjen e një mësymje të re, që nisi më 10 majin e vitit 1910. Më tej, siç dihet, pas një qëndrese të ashpër që bënë luftëtarët gjatë datës 10 maj, po atë darkë, për shkak të mungesës së municioneve, rënies së raportit të forcave, zjarrit të artilerisë së rëndë dhe afrimit të errësirës, për të mos rënë në kurthin e rrethimit armik, Isa Boletini urdhëroi daljen nga rrethimi. Dalja nga rrethimi u bë me luftim, duke çarë përmes një terreni të kufizuar dhe duke shfrytëzuar errësirën e natës 10 për 11 maj 1910. Dalja nga rrethimi mund të thuhet se ishte një operacion më vete, i suksesshëm.

Dalja nga unaza e zjarrit të rrethimit u bë sipas idesë që, duke luftuar nga të dy krahët, si dhe duke mundësuar daljen përmes një "shtegu të ngushtë" i cili, më së shumti pas një ore, do të mbyllej nga turqit. Luftëtarët kryengritës mundën të dilnin të gjithë, pa humbje, përmes shtegut të përzgjedhur, pikërisht atëherë kur mësymësit e rraskapitur nga mësymja në terrenin e thyer dhe nga qëndresa e fortë dhe e gjatë e shqiptarëve mendonin se, "...nga ai bllokim nuk do të shpëtonte dot asnjë shqiptarë i gjallë!"²⁶.

²⁵ *Kryengritja e vitit 1910 në Kosovë*, f. 103.

²⁶ *Tri jetë*, "Koloneli Tomson, Ismail Qemali, Isa Boletini", f. 220.

Beteja e Kaçanikut, së bashku me atë të Carralevës, të ndërmarra në kuadrin e Kryengritjes së vitit 1910, në Kosovë, të cilat zgjatën më se tri javë, janë nga më të rreptat, të përgjakshmet dhe më të njohurat në historinë e popullit shqiptar dhe të historisë ushtarake të tij. Ato tronditën më tej pushtetin politiko-ushtarak osmano-turk të atyre viteve, por edhe ia kishin arritur të vononin dhe dëmtonin ndjeshëm forcat e ushtrisë osmano-turke, duke ndikuar në realizimin e disa prej objektivave kryesore të Kryengritjes së vitit 1910 në Kosovë. Natyrisht që, në ato beteja me përmasa dhe rëndësi historike, meritat lidhur me përfundimet e gjithanshme, edhe luftarake, u përkasin gjithnjë pjesëmarrësve në to. Por, në to spikati qartë jo vetëm aftësia organizative, ndërtimi i formacionit të luftimit dhe vendosja e forcave në një mbrojtje të pabarabartë, zotësia drejtuese dhe komanduese, ashtu si dhe guximi e trimëria e pashoqe e drejtuesve të luftimeve. Në Carralevë ra në sy qartë përcaktimi dhe përzgjedhja e duhur e drejtimit të çarjes dhe daljes nga rrethimi me sukses duke shmangur humbjet njerëzore. Gjatë Kryengritjes së Përgjithshme të vitit 1912, edhe Prishtina, si Mitrovica dhe Tregu i Ri, ishte qendër e rëndësishme ushtarake, me prani të madhe të ushtrisë turke, për pasojë për ta marrë atë, u zhvillua një luftë e ashpër, me tërbim të paparë, me gjithë gjerësinë e frontit prej 80 km. Më parë, me anën e korrierëve të shpejtë, i u njoftua Xhemal Prishtinës (Berishës), në kohën e duhur, vendi dhe ora e fillimit të sulmit, kur komandanti i forcave të operacionit, Fadil Pasha, do të godiste ballin e Llapit, vendi ku po qëndronin forcat më të rëndësishme kryengritëse nën drejtimin e Isa Boletinit. Prishtina u mësy nga kryengritësit dhe, pas luftimeve të ashpra, ra në fundin e korrikut të vitit 1912. Qyteti, atë kohë i populluar me 12 000 banorë, priti më se 30 000 luftëtarë kryengritës, që i mbajti për 18 ditë.

Ishte hera e parë që forcat politike dhe luftarake shqiptare vepruan së bashku dhe në bashkërendim me njëra-tjetrën, arsye për të cilën triumfuan mbi ushtrinë pushtuese osmano-turke në Kosovë. Në vijim u vendos, që një pjesë e mirë e kryengritësve, pas një manovre në formë harku nga ana e Lindjes, do t'i jepnin një goditje të fortë Shkupit dhe Kaçanikut prapa krahëve. Këtë detyrë, sa të rëndësishme aq dhe të rrezikshme, e morën përsipër dy burra të njohur dhe të zot, Isa Boletini - heroi i Carralevës dhe Idriz Seferi - heroi i Betejës së Kaçanikut, dy vjet më parë.

Të dy drejtuesit, tashmë legjendarë, së bashku, me anë të një plani të zgjuar dhe të fshehtë, me një lëvizje të shpejtë dhe të beftë, i ranë pas shpine forcave turke në qytetin e Shkupit. Kjo mësymje e gjatë, e vështirë dhe tejet e rrezikshme, por kërcënuese e detyroi komandën turke në Shkup të hiqte dorë nga qëndresa. Për rrjedhojë, forcat shqiptare hynë në Shkup më 13 gusht 1912. Lidhur me këtë betejë fitimtare, njohësja, mikja dhe mbështetësja e shqiptarëve, Edit Duham (Edith Durham) nuk do të vononte të shkruante se, shqiptarët e Kosovës përsëri ngritën krye, si gjithmonë nën udhëheqjen e Isa Boletinit. Isai çoi në fitore luftëtarët, që pasi hynë në Shkup, u sollën në mënyrë shembullore²⁷. Një ndër arsyet më kryesore, që çuan në përmbylljen me sukses të veprimeve luftarake në çlirimin e Pejës, Prishtinës dhe Shkupit, padyshim që ishte bashkëveprimi midis forcave kryengritëse, që ia dolën përballë një mizërie prej 70 000 ushtarakëve turq. Dhe, të mendosh se ata ishin të stërvitur, pajisur dhe armatosur mirë, të komanduar nga oficerë me përvojë dhe akademi ushtarake të njohura. Por, për shkak të ecurisë, zhvillimit të veprimeve luftarake dhe aftësisë e mjeshtërisë së lartë të drejtimit të tyre nga drejtuesit e forcave luftarake kryengritëse, e kishin detyruar

²⁷ Edith Durham, *Njëzet vjet ngatërresa ballkanike*, Tiranë, 2000, f. 67.

komandantin e përgjithshëm të forcave turke në Shkup të shprehej i çuditur: *“Mor, po sa Isa Boletini po dalin këtu në Kosovë?!”*

Për të gjitha cilësitë dhe dukuritë e përmendura më herët, Isa Boletini ka fituar dhjetëra epitete dhe vlerësime të merituar nga shqiptarët dhe të huajt, që i kanë njohur apo lexuar historitë në çdo fushë të veprimtarisë së tij. Midis tyre ai është emërtuar si “titan”, “gjeneral i madh i Kosovës”, “mbrojtësi ushtarak i Shqipërisë” apo “tmerri i Turqisë”, në kryengritjet kundër ushtrisë turke. Kështu, poeti dhe politikani i njohur shqiptar Hil Mosi, duke vlerësuar cilësitë e I. Boletinit do të shkruante: “Luftëtar të rebt’ e trim si ty s’ban nana! Kurse shoqëria shqiptare “Besa - Besën”, e Bostonit, thirri bashkatdhetarët në të ashtuquajturin “Miting i Zëmërimit” të mbajtur më 20 maj 1910, pikërisht atëherë kur ishte ende e freskët jehona e betejës epike të Carralevës. Në rezolutën e lexuar në të shkruhej: “Mitingu i dërgon të fala kryekapedanit Isa Boletini dhe dëfton admirimin për trimëri dhe kalorësin e Ushtrisë Kombëtare Shqiptare”.

Ndërsa gazeta shqiptare “*Dielli*”, që botohej në Amerikë, do të shkruante se, “...kjo kryengritje ka karakter të përgjithshëm se dhe të krishterët luftojnë tok me myslimanët kundër armikut të kombit, ... me mijëra janë bashkuar në ushtrinë e Isa Boletinit... një burrë që ka fuqi dhe forcën e karakterit...”.

Nga ana e tij, Fan S. Noli, në mitingun e Bostonit do të theksonte: “...Isai din të hidhet në mes të topave të një ushtrie turke përmbi 20 000 vetësh, ta mundë dhe, në kohë paqe, të heshtë, është një trim që do të kishte turp ta baraziste veten e tij me gjeneralët e djeshëm e të sotëm të ballkanit... po të rronte Uashingtoni, do të

vinte t'i zinte dorën Isa Boletinit dhe t'a njihte për trim sa veten e tij!". Por, vlerësimet për, janë pafund.

Për shqiptarët e Kosovës, të Shqipërisë dhe kudo tjetër ku ata jetojnë, Isa Boletini përfaqëson figurën madhështore të atdhetarit dhe luftëtarit të rrallë në skenat e luftërave për liri dhe pavarësi të atdheut tonë të përbashkët, siç e ëndërronte ai dhe bashkëluftëtarët e tij. Por, përtej cilësive të veçanta, të rralla, të padiskutueshme, ai ishte padyshim dhe u shqua midis bashkëluftëtarëve si një prijës ushtarak, me cilësi natyrale të lindura, të pakultivuara, i përmasave të mëdha, në organizmin dhe drejtimin e forcave luftarake jo të rregullta shqiptare gjatë veprimeve luftarake të shumta çlirimtare, mbrojtëse apo mësymëse. Në to ai shkëlqeu si një gjeneral i vërtetë popullor, paspaleta! Për të gjitha këto, për rolin e tij të veçantë në çlirimin dhe pavarësinë e trojeve shqiptare, për formësimin dhe bashkimin kombëtar, Isai çmohet dhe nderohet shumë nga shqiptarët, arsye për të cilat ai është bërë pjesë e kahershme e historisë sonë kombëtare. Njëherësh dhe padyshim, ai është bërë pjesë e përhershme e historisë ushtarake shqiptare, për të veçantat e tij, për të cilat duhet të vijnë studimet dhe analizat në auditorët e shkollave dhe akademive, si dhe në veprat e studiuesve tanë ushtarakë, sot dhe në vitet e ardhshme.

Prof. dr. Proletar HASANI &
Prof. assoc. dr. Bernard ZOTAJ

SUMMARY

MILITARY ASPECTS REGARDING ISA BOLETINI'S ACTIVITY

The paper treats the figure of Isa Boletini as a military leader and a warrior who hailed from Kosova and Albania, as an uneducated general who triumphed as a victor above the Ottoman army and the Young Turks, while regenerating the olden bravery of the Albanians. From the referenced material his wisdom in battlefields becomes evident, a wisdom which portrays the necessary military maturity and bravery of a warrior which Isa Boletini possessed. Further on the paper treats the endless war against the Ottomans, his persistence in gaining freedom for Albania and the boundless support he received by the Albanian patriots.

The material referenced treats the hero of Carralevë as a patriotic role model to the brave men who fought in every battle and war in Albanian territories. Isa Boletini wrote history by supporting Ismail Qemali's cause in arms, who fought for his fatherland in the battlefields, as well as in politics and diplomacy. The paper broadly treats the Great Albanian uprising, a development closely related to Isa Boletini as a leader of the time, which made him renowned throughout the Balkans and Europe. Isa Boletini's figure is treated in the context of mobilization of soldiers for the liberation war of

Albania. The documents referenced in the paper portray the life of Isa Boletini in relation to his military activity, fighting all the way to the Bridge of Podgorica for Albania's freedom and independence.

**Prof. dr. Jusuf OSMANI &
Prof. ass. Bujar DUGOLLI
(Prishtinë)**

**ROLI I ISA BOLETINIT NË PENGIMIN E HAPJES SË
KONSULLATËS RUSE NË MITROVICË DHE VRASJA E
KONSULLIT RUS**

Në fillim të shek. XIX qarqet shoviniste pushtetare serbe i shtuan përpjekjet për të vënë në jetë programet serbe të njohura për pushtimin e tokave shqiptare. Më 1885, Milutin Garashanin i biri i Ilja Garashaninit përpiloi programin me titull: “Uputstva za održavanje uticaja u Makedonji i Staroj Srbiji” (Udhëzim për mbajtjen e ndikimit në Maqedoni dhe Serbi të Vjetër), duke sugjeruar hapjen e dy fronteve: atë ushtarak dhe diplomatik të shoqëruar me hapjen e konsullatave për të aplikuar metoda diversive, si dhe nevojën për depërtimin në troje shqiptare me agjentura serbe, ruse etj. Serbia kaloi në veprime konkrete në fushën politike, ideologjike, kulturore, arsimore e ushtarake. Dërgoi në Kosovë dhe në trevat tjera shqiptare priftërinj, mësues e agjentë serbë. Nxiste grindje, përçarje e konflikte midis popullsisë shqiptare dhe asaj serbe. Hidhte

vazhdimisht banda të armatosura që ushtronin terror mbi popullsinë shqiptare, që vrisnin e zhduknin udhëheqës popullorë shqiptarë të cilët ishin bërë pengesë në realizimin e synimeve të saj. Nëpërmjet tyre qeveria serbe kishte si qëllim të shkombëtarizonte popullsinë shqiptare, të forconte në Shqipëri pozitën politike të Serbisë dhe të krijonte në këtë mënyrë rrethana të favorshme për ndërhyrje të hapur¹.

Qeveria serbe, me përkrahjen e Rusisë Cariste, në mënyrë të njëanshme dhe të fshehtë qysh herët kishte filluar të armatosë popullatën serbe në trevat shqiptare. Qëllim ishte destabilizimi i Perandorisë Osmane dhe pushtimi i tokave shqiptare. Këto veprime kishin filluar në dhjetëvjeçarin e fundit të shek. XIX. Mirëpo, duhet theksuar se armë nga Serbia edhe më parë ishin sjellur në Kosovë në forma të ndryshme. Që në vitin 1901, ishte krijuar një aferë e quajtur *Afera e Kollashinit*, ku popullata serbe e kësaj treve është marrë me kontrabandë të armëve të sjella nga Serbia. Kollashini u armatos plotësisht në pranverë të vitit 1901, dhe filloi të armatosë edhe Anadrininë (pakicën serbe) duke filluar nga Runiku i Drenicës e deri në Pejë. Mirëpo, para se të arrijë ngarkesa e parë e armëve me kuaj në Kosovë, nëpër Kollashin, zbulohet nga njerëzit e Isa Boletinit, dhe konfiskohet në fshatin Uglar. Përkitazi me këtë dhe çështje të tjera, Qeveria serbe iu kishte drejtuar diplomacisë ruse që të ndërmjetëson për ndihmë. Qeveria ruse menjëherë iu është përgjigjur dhe ka filluar një aktivitet të madh. Konsulli rus në Shkup, Mashkov është dërguar në Kollashin dhe rrethinë që në vend të njihet me veprimet e turqve dhe të shqiptarëve².

¹ Fatmira Musaj, *Isa Boletini*, Tiranë, 2004, f. 29.

² AS, MID, PPO, 1901, F.I; M. Vojvodic, *Srbija u medjunarodnim odnosima .. f. 336.*

Vazhdimet të armatosjes së popullatës serbe në masë të madhe e kishin ndihmuar konsullatat serbe dhe ato ruse në Ballkan, sidomos Konsullata serbe në Prishtinë. Në këto rrethana para popullit shqiptar, qëndronte detyra e lartë e mbrojtjes së tërësisë të trojeve shqiptare. Shqiptarët e kuptuan rrezikun nga armatosja serbe dhe ndërmorën masa për kontrollimin e kufirit me Serbinë. Posaqërisht kundër armatosjes së popullatës serbe u angazhua Isa Boletni. Në çdo mënyrë ai iu kundërvu veprimtarisë antishqiptare të Qeverisë serbe dhe në çdo rast e demaskoi atë³.

Isa Boletini organizoi patrullimin në kufi me Serbinë dhe arriti që të kapte serbë të armatosur si dhe kafshë të ngarkuara me armë, të cilat i çoi në komandën turke në Mitrovicë. Isa Boletini e bëri këtë së pari, për t'i vënë autoritetet osmane para një prove të gjallë, në mënyrë që ato të mos kishin mundësi ta mohonin edhe më tej futjen e fshehtë të armëve nga ana e Serbisë dhe së dyti, për të demaskuar propagandën serbe, se gjoja armët nuk silleshin nga Serbia, por u shiteshin fshatarëve serbë nga kontrabandistë shqiptarë⁴. Kundër një qëndrimi të tillë indiferent të autoriteteve lokale osmane, Isa Boletini dhe shumë shqiptarë të tjerë i dërguan një telegram proteste Portës së Lartë, ku kërkohej që të merreshin masa të menjëhershme, ndryshe do të merrnin vetë në dorë mbrojtjen e vendit⁵.

³*Mitrovica me rrethinë*, Mitrovicë, 1979, f. 90.

⁴ Haus und hov Stats Archive, Politischen Archive, Wien (HHST A, PA), Raporti nr. 155 i konsullit, në Shkup drejtuar Vjenës, 1 gusht 1901; F. Musaj, Isa Boletini, f. 32.

⁵ Politisches Archiv des Aus Wartingen Amtes (PAAA), Tel. nr. 115, Legata perandorake gjermane në Boegrad, - kontit von Bulov, kancelar i Rajhut, Berlin, 26 korrik 1901; F. Musaj, *Isa Boletini*, f. 32.

Porta e Lartë, jo vetëm që s'mori asnjë masë, por në përgjigjen e saj urdhëronte që shqiptarët të qëndronin të qetë⁶. Pas kësaj Isa Boletini u kujdes vetë për çarmatimin e popullsisë serbe. Ai filloi menjëherë çarmatimin e serbëve në trevën e Mitrovicës. Veprimtaria e shqiptarëve dhe e Isa Boletinit e detyroi Portën e Lartë që më 15 korrik të miratonte veprimet e çarmatosjes së pakicave serbe nga shqiptarët⁷. Në malin e Rogoznës më 10 qershor 1901, në fshatin Rudinë, patrulla prej 30 vetave e formuar nga Isa Boletini hasën në tre serbë të Kollashinit që sillnin armë të ngarkuar në 7 kuaj dhe gjatë përleshjes njëri serb i Kollashinit vritet dhe dy të tjerë zihen robër dhe dërgohen në Mitrovicë. Kjo ngjarje shkaktoi shqetësim të madh te banorët shqiptarë në Jeni Pazar, në Mitrovicë dhe në pakicën e qytetarëve që e konsideronin vetën turq⁸.

Aksioni i shqiptarëve dhe i Isa Boletinit për çarmatosjen e serbëve hidhëroi Serbinë dhe Rusinë dhe nxiti që të protestojnë tek Perandoria Osmane, se po rrezikohet popullata serbe. Në korrik 1901, Qeveria ruse e ajo serbe, nëpërmjet përfaqësuesve të tyre në Stamboll, ushtruan presion mbi Portën e Lartë që të ndërhynte, qoftë edhe me forcë për të ndalur menjëherë çarmatimin, të cilin e quajtën si “masakrim të popullatës serbe”. Gjithashtu Rusia e Serbia, duke parë se Isa Boletini ishte jo vetëm udhëheqësi kryesor i lëvizjes shqiptare, por edhe një luftëtar e udhëheqës i vendosur i luftës për mbrojtjen e trojeve shqiptare nga rreziku i copëtimit prej shovinistëve fqinjë, i kërkuan Qeverisë turke ta largonte nga Mitrovica e Kosova⁹.

⁶Po aty.

⁷HHStA, PA, Teleg. Nr. 16 i administratorit Dobrozanski në Shkup, Vjenës, 16 korrik 1901; F. Musaj, *Isa Boletini*, f. 33.

⁸Ahmet Maloku, *Isa Boletini* - Integristi ..., f. 52.

⁹HHStA PA, Teleg. Nr. 16 i administratorit Dobrozanski - Vjenës, 18.07.1901; F. Musaj, *Isa* ..., f. 34.

Rusia cariste, për të realizuar aspiratat e veta ndikuese e pushtuese në trevat shqiptare si dhe t'iu ndihmojë satelitëve të saj, Serbisë e Malit të Zi, synonte të hapte konsullata të reja në tokat shqiptare. Një konsullatë të tillë donte ta hapte në Mitrovicë. Ajo më parë në Kosovë kishte hapur konsullatën në Prizren. Në dokumentet arkivore ruse shihet se që nga nëntori i vitit 1901 kishin filluar iniciativa për hapjen e konsullatës në Mitrovicë¹⁰. Planifikohej që në fillim të vitit 1902, të hapet zyra e konsullatës në Mitrovicë dhe për këtë është ndarë buxheti¹¹. Mirëpo, qëllimi i vërtetë i Rusisë cariste ishte okupimi i këtyre trojeve nga satelitët e saj, Serbia e Mali i Zi.

Në një dokument tjetër të Këshillit Shtetëror, Departamenti i Legjislacionit, dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme të Rusisë, njoftohet se ishte marr vendimi që nga 12 janar 1902, për hapjen e konsullatës ruse dhe kërkohej sigurimin i mjeteve të nevojshme për konsullin dhe sekretarin e tij, si dhe sugjerohej që konsullata të fillonte punën sa më parë¹². Ajo, përveç konsullatës në Prizren, vendos që të hapë edhe konsullata në Mitrovicë. Më 7 maj 1902, kishte caktuar si konsull Gligorije Shqerbinin, i cili ka pasur përvojë me shqiptarët, përkatësisht ka qenë si ekspert për çështje të Ballkanit, ndërsa përvojat i ka arritur me punën në Stamboll, Cetinë dhe Shkodër¹³.

Kuptohet se Rusia ishte e interesuar për këto vende dhe donte më tepër që të ndikojë në ngjarjet që zhvilloheshin në to. Shqiptarët të informuar për këtë veprim të Rusisë dhe duke i ditur qëllimin e

¹⁰ Rosijski Gosudarsveni Istoriceskij Arhiv (RGIA), Sankt Petesburg, Fond 566, op.4, delo 14483, list 1-3. Dokumentet janë hulumtuar nga ana e autorit në Arkivin Shtetëror Historik të Rusisë në Sankt Petesburg, në nëntor të vitit 2000.

¹¹ Ibid, list 5.

¹² RGIA, Sankt Petesburg, Fond 566, op.4, delo 14483, list 5.

¹³ Pravoslavljje, Novinesrpske patrijaršije, Živorad Janković, Ubistvo konsula Ščerbine, <http://www.pravoslavljje.org.yu/>

Rusisë në këto territore, filluan ta kundërshtojnë hapjen e konsullatës ruse. Kundërshtimi për konsullatën dhe konsullin rus kishte marrë përmasa të gjera ndërsqiptare, kjo raportohet dhe theksohet edhe në shumë shkrime dhe reagime nga autorë të ndryshëm vendorë dhe të huaj. Emërimi i tij ka ngjallur revoltë të madhe në mesin e shqiptarëve. Shqiptarët nga të gjitha anët kërcënoheshin dhe rekomandonin që nuk do ta durojnë në mesin e tyre konsullin rus. Këtë e dëshmon edhe fakti që ministri ushtarak turk, Riza Pasha, e ka lutur Ambasadën ruse në Stamboll që mos të ngutet që konsulli Shqerbini menjëherë të shkojë në Mitrovicë¹⁴.

Sipas një shkrimi serb, thuhet se politika e jashtme serbe është udhëhequr në frymën e pastër rusofile dhe sipas tyre, ka dhënë rezultate të dobishme. Në mënyrë që të mund t'i mbrojë serbët dhe të kontrollojë Austro-Hungarinë, Rusia e ka hapur konsullatën në Mitrovicë në mars të vitit 1902, dhe si konsull e ka caktuar Gregorije Shqerbinin. Kjo hapje e konsullatës ruse ka shkaktuar shqetësime në mesin e shqiptarëve, por edhe pakënaqësi të madhe në Vjenë¹⁵. Ministri i Punëve të Jashtme të Perandorisë Osmane, Teufik, me shkresën nr. 2048, datë 7 shtator 1902, e informon Portën e Lartë se ka marrë një shkresë nga Ambasada ruse për hapjen e konsullatës ruse në Mitrovicë dhe largimin e Isa Boletinit dhe dërgimin e tij si “surgin” në ndonjë vend. Qeveria turke i është përgjigjur se brenda një viti do ta largojë Isa Boletinin.

Ndërhyrja e vazhdueshme e Rusisë në çështjet e brendshme të Perandorisë Osmane dhe përkrahja prej saj e lakmive pushtuese të disa shteteve ballkanike në këtë zonë i shtyri shqiptarët të kundërshtonin çështjen e konsullatës ruse dhe hyrjen e konsullit të Rusisë në Mitrovicë. Mirëpo, në një anë, edhe vetë Porta në njëfarë

¹⁴Zoran Djordjević, *Političko-prosvetna ...*, f. 175.

¹⁵ http://www.rastko.org.yu/rastko-bl/istorija/Čorović/istorija/7_8_1.html

mënyre i ka përkrahur shqiptarët që të mos lejojnë hapjen e konsullatës ruse në Mitrovicë. Si duket, një numër i krerëve shqiptarë kanë qenë të mendimit, nëse hapet konsullata ruse në Mitrovicë, të hapet edhe konsullata austro-hungareze, me qëllim që të paralizohet propaganda ruse në këto treva¹⁶. Në fillim të shtatorit të vitit 1902, shqiptarët të prirë prej Isa Boletinit, shprehen revoltën dhe organizuan më 7 shtator 1902 një protestë në Mitrovicë dhe fshatra rreth saj, kundër vendimit të Portës për lejimin e hapjes së konsullatës ruse në qytetin e tyre dhe kundër ndërhyrjes së Rusisë në trevat shqiptare¹⁷. Kjo protestë e organizuar ndikoi që për një kohë të ndalohet realizimi i vendimit për hapjen e konsullatës ruse.

Në këtë kohë edhe popullsia e Mitrovicës ishte bërë me dije, se kush e strehon konsullin rus, shtëpia do t'i digjet nga luftëtarët shqiptarë. Qyteti jetonte në një atmosferë të tendosur. Drejtuesi i konsullatës mbretërore në Selanik, Terapija, datë 23 shtator 1902, lajmëron se më 20 të këtij muaji i ka ardhur lajmi, se shqiptarët në natën e kaluar i kanë hequr dy copë binarë të hekurudhës Mitrovicë-Shkup, kështu që treni nga Mitrovica nuk ka mundur të niset në mëngjes. Kjo vepër lidhet me pakënaqësinë, e cila ka shpërthyer për shkak të emërimit të konsullit rus në Mitrovicë¹⁸. Porta e Lartë nuk ishte në gjendje të plotësonte kërkesën e Rusisë. Stambolli ishte i bindur tashmë, në qoftë se arrestimi i Aqif Pazarit shkaktoi lëvizjen e Pazarit të Ri, arrestimi apo vrasja e Isa Boletinit do të kishte pasoja të mëdha dhe do t'i nxirrte shumë telashe Perandorisë. Nga ana tjetër, Porta e Lartë mendon ta shfrytëzojë autoritetin e madh të Isait, duke e vënë atë në shërbim të politikës së vetë, mbasi, sikurse theksonte

¹⁶ Vl. Čorović, *Diplomatska prepiska*, 512; Emin Pllana, "Popujt e Kosovës...", Kosova, nr. 3, f. 110.

¹⁷ *Historia e popullit shqiptar* II, Akademia e Shkencave e Shqipërisë - Instituti i Historisë, Tiranë, 2002, f. 307.

¹⁸ AK, dokumente në dorëshkrim të deshifruara, dok. nr. 217.

revista “Kalendari Kombiar”: “deri sa të kishte për vedi Isën, kishte për vedi gjithë ato anë të Kosovës, të cilat me një fjalë të të parit të vetë, ishin gati me i qit djemtë dhe burrat e vet në mal t’uj bjerë gjithçka kishin shpie e tokë, gra e fëmijë, mjaft që ta lyp nevoja me dalë me dekë në luftë kundër armiqve të kombit”¹⁹.

Nën presionin e Rosisë, që kërkonte me këmbëngulje hapjen e konsullatës në Mitrovicë, sulltan Abdyl Hamiti u detyrua të dërgonte te Isa Boletini, Shemsi Pashën, si dhe miqtë të tij si Sylejman agë Begçeqiqin e Haxhi Adem agë Nikshiqin, që t’ia mbushnin mendjen për të shkuar në Stamboll për të biseduar me sulltanin. Ata, në emër të sulltanit i ofruan Isait mjaft pasuri e ofiqe. Por, edhe kjo përpjekje e tyre nuk pati sukses. “Të tjerë janë ata që shkojnë pas kockave - iu përgjigj Isai të dërguarve të Stambollit. Unë nuk jam nëpunës që të kënaqem me tituj e as tregtar për fitime”²⁰.

Presioni i Rosisë ndaj Perandorisë Osmane për burgosjen dhe dëbimin e Isa Boletinit shtohet gjithnjë e më tepër. Përpjekjet e të dërguarve të Portës së Lartë për të bindur Isanë të nisej në Stamboll për të biseduar me Sulltanin, nuk reshtën më se dy muaj. Në fillim të nëntorit 1902, Isai, duke menduar se do të mund të bindte sulltanin që të mos lejonte hapjen e konsullatës ruse në Mitrovicë, vendosi të nisej. Për siguri ai i kërkoi sulltanit që të merrte me vete tre djem të armatosur si dhe të mos lejohej vendosja e konsullit rus në Mitrovicë. Porta i pranoi këto kushte të Isait. Ditën që Isai do të nisej për në Stamboll, u njoftua nga Sylejman aga se do të mbahej për një kohë të gjatë në Selanik. Kjo do të thoshte se Porta mund të kishte përgatitur internimin e tij, prandaj Isai e anuloi nisjen²¹. Kështu, sulltanit iu

¹⁹ Kalendari Kombiar i vjetës 1919, Vepra Pjore, Shkodër, 1918, f. 22; F. Musaj, *Isa...*, f. 43.

²⁰ AQSH, Fondi 74, dosja 4; F. Musaj, *Isa...*, f. 43.

²¹ AQSH, Fondi 74, dosja 4; F. Musaj, *Isa...*, f. 44.

desh përsëri të ndërmerre bisedime të tjera me Isa Boletinin dhe ta siguronte se ndaj tij nuk do të merrej asnjë masë. Për këtë iu premtua se do të dërgohej në Boletin si peng cilido që do të dëshironte Isai, derisa ai të arrinte në Stamboll²².

Kështu, Isa u nisë për në Stamboll në javën e fundit të muajit nëntor të vitit 1902, i përcjellë deri në Mitrovicë nga një masë e madhe e popullit. Nga Mitrovica deri në Shkup e përcollën gjithë paria. Nga Shkupi për në Stamboll u nis më 4 dhjetor i shoqëruar nga Halit Ahmet Suhogërlla, Bislim Selim Radisheva dhe Ahmet Leskovci-kapter xhandarmërie, i cili kishte dhënë dorëheqje që të ndodhej çdo herë pranë Isa Boletinit²³. Isa Boletini, para se të nisej për në Stamboll, kishte marrë besën e shqiptarëve, se nëse hapet konsullata në Mitrovicë, ata do ta pengojnë me forcën e armëve. Në ditën kur u nisë Isa Boletini për në Stamboll, ia la amanet martinën e tij, Tahir Selacit, duke qenë i bindur se nuk do ta korisë, por do ta nderojë²⁴. Isai nuk u zinte besë premtimeve të Sulltanit, prandaj, para se të largohej nga Boletini për në Stamboll, ai u la porosi bashkëluftëtarëve të vet të mos pranonin në asnjë mënyrë internimin e tij. Në rast se sulltani merr një vendim të tillë, ata do t'i përgjigjeshin me kryengritje të armatosur²⁵.

Gjatë qëndrimit trevjeçarë në Stamboll, Isa Boletini përjetoi shumë peripeci. Ai ishte vendosmërisht kundër padrejtësive e sulmeve mbi shqiptarët. Qarqet shqiptare dhe ato zyrtare flisnin me të madhe për shkuarjen e Isa Boletinit në Stamboll. Madje, atë e

²²Ibid.

²³ <http://www.agimi.com/modules.php?name=News&file=article&sid=485>

²⁴ Adem Zejnullahu, "Përpyetje për ndriçimin e figurës së Ibrahim Halit Sukes", Gjurmime albanologjike, Folklor dhe etnologji 32-2002, IAP, Prishtinë, 2004, f. 117.

²⁵ PAAA, Relacion i përfaqësisë gjermane në Beograd, kancelarit von Bulov, Berlin 30 dhjetor 1902; F. Musaj, *Isa ...*, f. 44 - 45.

quanin edhe “Ambasadori i Shqipnisë në Stamboll”. Edhe në Stamboll, Isa Boletini i kishte deklaruar Sulltanit, se nuk pajtohet me hapjen e konsullatës ruse në Mitrovicë, sepse ajo ishte çështje politike. Shqiptarët nuk pajtohen që në zemër të vendit, siç thekson gazeta “Zastava” e Novi Sadit, e datës 20 mars 1903, ku nuk ka asnjë rus, të jetë qendër e sllavizmit.

Porta e Lartë e mbajti Isa Boletinin në Stamboll deri në vitin 1906. Gjatë viteve sa qëndroi në Stamboll, Isai mbajti lidhje të rregullta me popullin e atdheun. Shtëpia ku ai qëndronte, priste e përcillte çdo ditë miq e shokë që vinin nga Kosova dhe e njoftonin për gjithçka që ndodhte atje. Për veprimtarinë e Isait në Stamboll, në kujtimet e Tafil Boletinit përmendet propozimi që autoritetet osmane i bënë Isa Boletinit për të qëndruar përgjithmonë në Stamboll. I premtuan grada dhe ofiqe, por Isai i hodhi poshtë me përgjigjen “Boletini është më i mirë se Stambolli”²⁶. Në ndërkohë në Kosovë ishin mbajtur disa tubime të popullatës shqiptare kundër reformave dhe hapjes së konsullatës ruse në Mitrovicë. Tubime të tilla u mbajtën më Gjakovë më 28 janar 1903, i quajtur Kuvendi i Gjakovës. Një takim i tillë u mbajt edhe në lagjen “Kapishnica” në Pejë më 30 janar 1903, më 1 shkurt 1903 një tubim u mbajt edhe afër Manastirit të Deviqit, pastaj më 4 shkurt u mbajt Kuvendi te Ura e Llukës, Kuvendi i Marinës më 26 mars 1903²⁷, tubimi më 21 mars 1903 në Novosellë të Maxhunajt, pastaj u mbajtën edhe në Llap, në Zojz të Prizrenit etj.

Gjatë kohës sa Isa Boletini ishte në Stamboll, në Mitrovicë erdhi konsulli rus Shqerbini. Ai në Mitrovicë erdhi më 1 shkurt 1903. Mirëpo, popullata vendore ishte e pakënaqur me këtë dhe filloi t’i

²⁶AQSH, Fondi 74, dosja nr. 3 - 4, dok. nr. 1937; Kopje në Arkivin Ndërkomunal të Mitrovicës, fondi i formuar, Isa Boletini.

²⁷Vladimir Čorović, *Diplomatska prepiska*, 613.

shpërfaqë haptas pakënaqësitë dhe sulmin në Mitrovicë më 16 mars 1903. Në këtë sulm u vranë një numër i madh i luftëtarëve shqiptarë, sidomos nga Shala e Bajgorës. Konsulli rus Shqerbini, e kishte kuptuar mirë se ishte i padëshirueshëm në Mitrovicë. Atë ditë ai ishte larguar përkohësisht nga Mitrovica nën vëzhgimin e situatës për t'u kthyer prapë. Nizami shqiptar Ibrahim Halit Popovci nga Suka e Gjilanit, duke konsideruar atë si fajtorin kryesor për këto ngjarje dhe vrasjen e shqiptarëve në trazirat e 16 dhe 17 marsit, më 18 mars 1903 e godet me revole konsullin rus, duke i shkaktuar plagë të rënda, nga të cilat më pas do vdes.

Me ngjarjet e Mitrovicës Lëvizja Kombëtare Shqiptare u zgjerua në të gjitha viset e Vilajetit të Kosovës. Porta, nën tryshninë e Fuqive të Mëdha dhe shteteve ballkanike, ndërmori masa ushtarake kundër shqiptarëve. Në Vilajetin e Kosovës sollën fuqi të mëdha ushtarake, të ardhura edhe prej Azisë së Vogël. Lëvizja antireformiste shqiptare ka qenë e pavarur dhe pa ndikim nga jashtë. Isa Boletini si prijës dhe personalitet me ndikim në këtë kohë i mbeti besnik programit politik, ushtarak dhe kombëtar të Lidhjes së Prizrenit. Ai i dinte shumë mirë ambiciet e Rosisë dhe aleatëve të saj në Ballkan prandaj u vunë në ballë të kundërshtimit edhe të prezencës së diplomatëve rusë dhe serbë në territoret e Kosovës. Edhe kur u internua në Stamboll, luftëtarët e tij i mbeten besnikë në rrugën e tij dhe kundërshtuan prezencën e konsullit rus në Mitrovicë. Në fillim të janarit 1906 u përhap lajmi në të gjitha anët e Kosovës se Isa Boletini do të lirohej nga internimi. Ardhja e tij nga Stambolli në Kosovë, për të gjithë shqiptarët ishte ngjarje e shënuar, sepse Lëvizjes Kombëtare Shqiptare po i kthehej promotori i luftës, i cili, armët për liri kurrë nuk i kishte lëshuar nga dora.

Prof. dr. Jusuf OSMANI &

Prof. ass. Bujar DUGOLLI

SUMMARY

THE ROLE OF ISA BOLETINI IN PREVENTING THE OPENING OF THE RUSSIAN CONSULATE IN MITROVICA AND THE ASSASSINATION OF THE RUSSIAN CONSUL

The liberation Albanian movements during the 19th and 20th century deeply disturbed not only the Ottoman Empire, but the Russian Kingdom as well as the Austro-Hungarian one together with some other western kingdoms, who were in favor of preserving the status quo of the Balkans, and most of them in favor of preserving their dominion in the region. The Great Eastern crisis that began with the uprising in Bosnia in 1875 caused the Russian-Turkish War (1877-1878), which is known as a turning point in the development of liberation movements in the Balkans.

Despite this tremendously difficult situation the disturbed Albanians chose the path of resistance and non-compliance. The formation of the League of Prizren in 1878-1881 aiming to protect the territorial integrity of the country the founding of political and territorial autonomy on a national level, it became evident that the Albanian cause cannot be treated as a case to appease the Russian, Serbian, Montenegrin, Bulgarian and Greek appetites. During this period there were many Albanian personalities that left traces in history with their national activity. When Isa Boletini was 17 years old, he sided with the armed forces of the League to fight for the

freedom and autonomy of Albania. He became popular with his military and political activities as a counter response to the Slavic aspirations in the Balkans, particularly so in the Albanian territory.

The Tsarist Russia attempted to fulfill its aspirations through its satellites, Serbia and Montenegro, by opening consulates and attempting to open them in Albanian territories. The Russian government began opening its consulates in Shkodra, Prizren, Manastir, Shkup, Durrës etc. Russia attempted to open a similar consulate in Mitrovica. The paper will treat some of the circumstances created by these attempts as well as the role of Isa Boletini in these historical events.

Akad. assoc. Marenglen VERLI
(Tiranë)

ISA BOLETINI NË MBROJTJE TË SHQIPËRISË SË
PAVARUR (NË VLORË, LONDËR, DURRËS...)

Shekulli XX evidentoi një brez të ri atdhetarësh dhe prijësish të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Në Kosovë burra të shkolluar si Hasan Prishtina, apo burra të traditës si Bajram Curri e Isa Boletini, do të viheshin në krye të popullit në këtë krahinë, për t'u ngritur gradualisht në rastet e ngjarjeve të mëdha kombëtare, në nivelet e udhëheqësve të gjithë kombit. Isa Boletini kishte spikatur fillimisht në trevën e Mitrovicës, në vitet e para të shek. XX, duke arritur në vitet 1910-1912, të kthehej në një figurë qendrore për Kosovën e më gjerë. Biografia e Isa Boletinit para dhe pas 28 nëntorit të vitit 1912, përkatësisht para dhe pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, është e njohur. Disa monografi dhe shumë artikuj studimorë e kumtesa i janë kushtuar këtij personaliteti të padiskutueshëm të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Emri i tij ndeshet në një mori vëllimesh dokumentare të botuara, ose memoaresh. Të tjera dokumente dalin në dritë dita-ditës e do të vijojnë të dalin. Falë informacionit të vjelë nga gjithë burimet e sipërpërmendura, mund të thuhet pa mëdyshje se I. Boletini, pavarësisht nga akuzat që i janë bërë në momente të ndryshme të jetës, gjithmonë veprroi i udhëhequr nga morali popullor

e human, nga kanuni tradicional dhe nga interesat e kombëtare. Natyrisht ishte një burrë me karakter të fortë, me tipare pozitive të spikatura që vlerësoheshin për kohën, ndaj dhe pati mjaft pasues, iu dëgjua fjala dhe hyri në radhën e shqiptarëve më të shquar të dy dekadave të para të shek. XX.

Është thënë se I. Boletini u trajtua shumë mirë në Stamboll në vitet 1903-1905, sepse merrte 45 lira në muaj nga Porta e Lartë..., por nuk thuhet se kjo ishte një praktikë e zakonshme në atë Perandori, që për arsye shtetërore e personale do të zbatohej dhe në Shqipërinë e viteve '20 -'30 nga A. Zogu e që, në forma të ndryshme privilegjesh, aplikohet edhe sot kudo në botë për të ndikuar nga pushtetmbajtësit në elitën politike respektive. Gjithashtu nuk thuhet se në rastin e I. Boletinit interesi i Portës së Lartë ishte për të siguruar një mbështetës potencial në një rajon kufitar me popullsi etnikisht të përzier dhe përballë një shteti agresiv si Serbia. Dhe, çka është më e rëndësishme, nuk është theksuar sa duhet se miklimet e Stambollit nuk e squllën, nuk ia prishën karakterin dhe nuk e larguan I. Boletinin nga rruga e angazhimeve dhe përpjekjeve për liri dhe të drejta kombëtare e sociale të popullit të tij.

Është thënë më tej se Isa Boletini pas shtypjes së kryengritjes kundër xhonturqve të vitit 1910 u strehua në Mal të Zi dhe në prag të kryengritjes së 1912 mori armë nga Serbia. Por nuk thuhet sa duhet se ky trajtim "preferencial" për të dhe për drejtues të tjerë të kryengritjes shqiptare, prej qarqeve drejtuese të Beogradit dhe të Cetinës, bëhej në kuadër të interesave të këtyre shteteve për të influencuar te I. Boletini dhe përgjithësisht te paria e shquar e Kosovës, për shkak të prestigjit që gëzonin dhe peshën që kishin për të ushtruar trysni ndaj Perandorisë Osmane. Nuk thuhet edhe se kur kërkoi armë e angazhime të tjera nga Serbia, Isa, sikurse pohonte vetë konsulli serb në Prishtinë D. M. Gj. Millojeviq, më

12/25.04.1912 (në letrën për ministrin Milovan Millovanoviq) “nuk premtoi asgjë”¹. Madje shqiptarët paguan për armët që ofroi Serbia. Është përmendur se kapiteni serb Rasha Pantiq, i pranishëm në shpërndarjen e armëve, arkëtoi 2-10 lira ari për çdo armë të dorëzuar në Kosovë luftëtarëve shqiptarë. Nuk thuhet gjithashtu se në Beograd qysh në shtator 1908 Isën e llogarisnin si njeriun e Austro-Hungarisë dhe planifikonin ta likuidonin fizikisht. Kërkesën për likuidimin e tij më 1909 e gjejmë edhe te shtypi malazez i Cetinës. I. Boletini, pavarësisht nga interesat e Serbisë ose Malit të Zi, ishte ndër organizatorët e qëndresës kundër pushtimit serb e malazez, qoftë gjatë Luftës Ballkanike, qoftë më vonë. Edhe nëse kjo qëndresë nuk ishte aq e fortë dhe aq e suksesshme sa do të dëshirohej, kjo nuk varej nga I. Boletini, por nga situata e krijuar në rrjedhat e koniunkturave ndërkombëtare dhe ngjarjeve të viteve 1912-1916 në rajon, kur mbrojtja e Perandorisë Osmane u dëshmuar e kalbur në çdo pikëpamje, apo kur, më pas, ishte e pamundur të çlirohej Kosova nga sundimi serbo-malazez.

Është thënë gjithashtu se I. Boletini ishte korrekt e tolerant, ose “e mbronte”, minoritetin serb në Kosovë, madje pretendohet se ai kërkoi që 14 pikat e H. Prishtinës të bëheshin 15, duke shtuar pikën që edhe serbët të siguronin të gjitha të drejtat që do t’u jepeshin shqiptarëve. Disa familje serbe ishin bujq të tij, ose të rrethit familjar e miqësor të tij. Por, nuk ishin vetëm marrëdhëniet njerëzore dhe të biznesit. Trajtimi i minoritetit serb në Kosovë nga shumica shqiptare që banonte Kosovën, shihej me vëmendje nga Beogradi. Dhe Serbia ishte fqinji në kufirin verior e lindor. Si do të duhej vepruar në këto rrethana? Është e vërtetë që agjentët serbë Popi Angjellko Neshiq, Ognjar Radenkoviçi dhe Alimpije Bozhoviçi bënë lojën e Serbisë kur i silleshin rreth I. Boletinit dhe përpiqeshin të ndikonin te ai, por

¹*Isa Boletini dhe koha e tij*, botim i Institutit të Historisë, Prishtinë, 1998, f. 249.

a nuk ndodh kjo sot e kësaj dite? Dhe e rëndësishme është vetëm përgjigjja e pyetjes: A e devijuan Serbia dhe Mali i Zi, Isanë nga qëllimet dhe veprimet e tij atdhetare?

I. Boletinit i merret për të madhe se donte të nisej nga Shkupi (ku hyri më 13 gusht) e të mësynte Selanikun për të liruar sulltan Hamitin. Për këtë e ka akuzuar edhe H. Prishtina (te kujtimet) edhe Mustafa Kruja (në letërkëmbimin e at Paulin Gjomarkaj), por e ka mohuar kategorikisht nipi i tij, Tafil Boletini. Si është e vërteta? Konsulli serb në Selanik Zhivojin Ballukxhiq, njohës i mirë i çështjes shqiptare dhe person shumë i informuar, vlerësonte si absurd interpretimin se shqiptarët do të shkonin në Selanik për të shpëtuar sulltanin e përmbysur, të cilin kundërshtarët lehtësisht mund ta transferonin gjetiu brenda natës. Sipas Ballukxhiqit shqiptarëve as që u shkonte në mend inkursioni drejt Selanikut. Qëllimi i tyre ishte një marshim në vijën Veles-Përlep-Manastir-Dibër për të gjallëruar në ato vise Lëvizjen Kombëtare dhe për t'i dhënë asaj karakterin e luftës për autonominë e Shqipërisë me katër vilajete.

Ajo çfarë tregon kronika e jetës së I. Boletinit në vitet 1912-1916 dëshmon bindshëm patriotizmin e pa qenë të tij. Në dokumentet e çdo kancelarie ku bëhet fjalë për kryengritjen e vitit 1912 emri i I. Boletinit renditet i treti pas H. Prishtinës dhe Riza Beg Kryeziut. Natyrisht i pari ishte njeri i shkolluar, deputet dhe ideolog i Lëvizjes Kombëtare në Kosovë, kurse Riza Begu ishte një figurë e shquar e një familjeje të madhe me potencial politik dhe ekonomik. Nuk ishte pa rëndësi edhe mosha më e madhe e tij krahasuar me Isën 48 vjeçar, që përbënte një element jo pa rëndësi në hierarkinë e elitës, të cilën e respektonte vetë atdhetari i shquar I. Boletini.

Gjithsesi, I. Boletini, pavarësisht nga vendi që zinte në hierarkinë e Kryengritjes së vitit 1912, nuk toleronte kur ishte fjala për të mbrojtur pikëpamjet e tij. Ai, krahas B. Currit dhe Riza Beg

Kryeziut, ndryshe nga H. Prishtina dhe një pjesë e parisë qytetare, kërkoi në gusht 1912 që armët t'i kishte çdo individ dhe jo të vendoseshin ato në depot shtetërore nga do të shpërndareshin në rast nevojë. Sot gjykojmë se pikëpamja e I. Boletinit ishte e drejtë. Ai ishte shprehur se grumbullimi i armëve në depo do t'i vinin drejtuesit e kryengritjes para alternativës: ose të dilnin përsëri në mal, ose të rrezikonin të humbnin autoritetin të kryengritësit dhe të populli në përgjithësi... Dhe ndodhi e dyta. Pas kësaj kohe, veçanërisht gjatë Luftës Ballkanike, natyrisht edhe për arsye të tjera, Isa dhe prijësit e tjerë tradicionalë të Kosovës nuk mundën më të tubonin dhjetëra mijë vetë si në verën e vitit 1912. Kur provokacionet malazeze në kufi i ulën tensionet në marrëdhëniet shqiptaro-turke dhe udhëheqja e kryengritjes u detyrua të pranonte marrëveshjen me Qeverinë osmane, duke u kënaqur me arritje të reduktuara, Isait dhe pasuesve të tij u mbetej veç të ktheheshin në vendbanimet e veta. Pasi u largua nga Shkupi më 19 gusht, së bashku me Riza Beun, Bajram Currin dhe Idriz Seferin, ai nuk do të mundte më të tubonte përsëri pas vetes 30 mijë luftëtarë. Vetë Stambolli e kishte sabotuar forcën që do të duhej të shërbente për të mbrojtur kufirin dy muaj më pas.

Në prag të Luftës Ballkanike, i bindur, me sa duket, se qarqet diplomatike e ushtarake të Serbisë nuk e kishin mbajtur fjalën e dhënë gjatë kontakteve me të në periudhën shkurt - korrik 1912. I. Boletini u tërhoq në kullën e tij në Boletin dhe nga fundi i gushtit kërkoi nga Ibrahim Pasha 20 mijë pushkë e municion për të organizuar mbrojtjen kundër serbëve. Përflitet se I. Boletini mori 63 mijë armë sipas një pohimi të 24 tetorit që i atribuohet Ali Riza Pashës, komandantit të Frontit Perëndimor gjatë Luftës Ballkanike. Përflitet gjithashtu se nga fundi i tetorit ai shpartalloi afër Pejës rreth 8 000 ushtarë të Xhavit Pashës. Por, i njëjti burim konsideron se më

18 tetor, I. Boletini ishte në Merdar, në front për të penguar ofensivën serbe.

Asgjë nuk ishte e verifikuar në pohimet e mësipërme, aq më tepër kur ato vijnë nga publikime të një burimi, apo, madje, të një publicisti si Jasha Tomiq. I diskutueshëm është edhe pohimi i Dimitrije Tucoviqit se reagimi deri diku indiferent i shqiptarëve kundrejt depërtimit të ushtrisë serbe “ishte rezultat i garancive të marra nga Vjena dhe Roma se Autonomia e Shqipërisë është e garantuar dhe se trupat serbe patjetër do të kthehen ...”². A ishte iluzionuar I. Boletini nga propaganda serbe se ushtria serbe vinte si mike në viset shqiptare? Është absurditet të besohet. Ajo që është e sigurt lidhet me largimin e Isait nga Kosova. Ai nuk e priti në shtëpinë e tij pushtuesin, por u largua drejt trevave perëndimore shqiptare me bashkëluftëtarët më të afërt që i shkuan pas. Rrugëtimi i I. Boletinit nga Luma në Vlorë jepet i detajuar nga nipi i tij Tafili. Sipas tij I. Boletini, për gati dy javë, mbrojti viset në vijën e kufirit nga Rashka drejt Podujevës. Pas rënies së saj u tërhoq drejt Prishtinës. Prej andej u tërhoq në Mitrovicë ku ishin grumbulluar 6 mijë vullnetarë. Por ushtria osmane nuk kishte ndërmend të rezistonte. Komanda kishte zgjedhur strategjinë e tërheqjes drejt kalave dhe bregdetit, duke nxitur edhe me mashtrime rezistencën shqiptare për të mbuluar tërheqjen. Në këto rrethana I. Boletini strehoi familjen në konsullatën e Austro-Hungarisë në Mitrovicë dhe me të gjithë meshkujt e rritur të familjes dhe pasuesit e tij në ditët e fundit të tetorit iu drejtua Grykës së Carralevës për të organizuar qëndresë. Por, në Sedllar u informua për pushtimin e Grykës nga trupat serbe, ndaj përmes Podrimës arriti në Prizren.

Kur më 30 tetor serbët morën qytetin, Isai me disa dhjetëra luftëtarë (sipas Tafilit 400 luftëtarë), u zhvendos në Gjakovë dhe prej

² Dimitrije Tucoviq, *Sërbija e Shqipëria*, Prishtinë, 1968, f. 123.

andej në Gjonaj (te Rexhë Zymeri). Konakun e dytë e gjeti në Kukës (te Sul Elezi) dhe të tretin në Bicaj (te Nexhip Ahmeti). Prej këndej së bashku me Islam Spahiun (pari e Lumës) mori rrugën drejt Vlorës. Në Kolesjan dëbora i ndali tri net në shtëpinë e Islam Spahisë. Pastaj u zhvendos në Ujmisht, në Kala të Dodës dhe 2 net në Dibër (te Elez Isufi). Në Dibër grupit iu bashkuan Zenel Begolli, Mehmet Pashë Dërralla, Hasan Hysen Budakova dhe të tjerë kosovarë, si dhe myftiu i vendit Vehbi Dibra, i cili do të vinte në Vlorë si delegat i Dibrës. Duke udhëtuar e bujtur në Dorovë, e më pas në Rrapun, ditën e tretë mbërritën në Elbasan. Pas dy ditë qëndrimi këtu iu drejtuan Belshit dhe në mesditën e nesërme mbërritën në Lushnjë. Natën u strehuan në Imshtë dhe të nesërmen në mbrëmje arritën në Fier. Më 28 nëntor në mëngjes gjithë grupi mori rrugën e Vlorës. Sipas dokumenteve të kohës Isa Boletini mbërriti në Vlorë më 29 nëntor 1912.

Kronologjia e lëvizjes së Isa Boletinit e treguar nga Tafil Boletini gjatë nëntorit nuk rezulton fort e saktë, por itinerari pa dyshim është i vërtetë. Po ashtu të konfirmuara janë edhe veprimet që ndërmori I. Boletini në të mirë të Shqipërisë së Pavarur që nga 29 nëntori i vitit 1912 e deri në ditët e fundit të jetës (23 janar 1916). Karakteri i I. Boletinit ishte i njohur për I. Qemalin. Jo rastësisht ai e vlerësoi, i besoi shumë dhe e angazhoi si rrallëkënd në shërbim të shtetit të ri shqiptar. Fotoja e veçantë e I. Qemalit dhe I. Boletinit e bërë në oborrin e shtëpisë së Xhemil Vlorës (besohet kushëri i dytë i I. Qemalit), nuk është rastësore. I. Qemali ishte një politikan me përvojë dhe e njihte mirë simbolikën në diplomaci. Atë ditë të 4 dhjetorit kur u krijua qeveria dhe kur besoj është bërë në oborrin e sarajeve fotoja e 57 delegatëve pjesëmarrës në kuvendin e asaj dite, I. Qemali ka vendosur në të majtë dom Nikoll Kaçorin (zv. kryeministër në Qeverinë e Vlorës), prelatin e njohur katolik, dhe në të djathtë myftiun Vehbi Dibra (kryetar i senatit). Më tej, në të majtë

është beu i fuqishëm i Libohovës, Mufiti (ministër i Punëve të Brendshme), kurse në krahun e djathtë i dyti, renditet Luigj Gurakuqi (sekretar i Kuvendit dhe ministër i Arsimit), pas tij Mehmet Pashë Dërralla (ministër i Luftës) dhe i katërti Isa Boletini. Ndonjë ministër tjetër ndodhet më larg I. Qemalit se I. Boletini, madje, ndonjëri (Lef Nosi) ndodhet në këmbë në rreshtin e dytë.

Asgjë nuk është rastësore. Nuk është e rastit gjithashtu që nga ajo ditë nuk kemi foto tjetër të I. Qemalit me delegatë të veçantë, përveç asaj me I. Boletinin. Këto foto i dëshmonin Isait konsideratën e I. Qemalit për të, por u tregonin edhe të tjerëve vlerësimin e veçantë që arkitekti i Kuvendit të pavarësisë i bënte burrit të shquar të Kosovës. Pak rëndësi ka nëse janë të sakta fjalët që i atribuohen I. Qemalit të thëna para të gjithëve në momentin e takimit të tyre të parë në Vlorë, më 29 nëntor 1912. Sipas Skënder Luarasis, që ka qenë mik me Tafil Boletinit dhe ka vjelë kujtime prej tij, ai paska thënë: “Isai më dha krahun dhe fuqinë”³. Por është i padiskutueshëm fakti se dy njerëz të I. Boletinit, Halim Musa Bajgora dhe Ahmet Ali Llapi, me kërkesën e I. Qemalit u caktuan roje personale të tij. Njerëz të tjerë të tij, në mungesë të policisë, apo xhandarmërisë, mbanin rendin në qytet.

Kjo detyrë do të vijonte edhe pas krijimit të armës së xhandarmërisë. Është gjithashtu i njohur fakti se nën drejtimin e Jonuz Boletinit, luftëtarët kosovarë zunë bregun jugor të lumit Vjosë dhe ndalën, apo u dhanë të kuptojnë trupave të Xhavit Pashës të grumbulluara në Myzeqe (rreth 20 mijë), se nuk do të lejoheshin të hynin në Vlorë. Më pas ushtria osmane u detyrua të imbarkohej prej derdhjes së Semanit për t’u evakuar nga Shqipëria, kurse flota greke nuk kishte më pretekstin për të bombarduar Vlorën, kinse aty po

³ Skënder Luarasi, *Tri jetë, koloneli Tomson, Ismail Qemali, Isa Boletini*, Tiranë: botimet “Migjeni”, 2007, f. 296.

vinin ushtarë osmanë. Pjesëmarrja e I. Boletinit, madje bashkë me dy djem të tij, Mujën dhe Ademin, në delegacionin që formoi I. Qemali për të shkuar në Londër në fund të marsit 1913, është një fakt tjetër domethënës për peshën e atdhetarit karizmatik. Natyrisht I. Qemali në mënyrë simbolike donte që në përbërje të delegacionit të përfaqësohej edhe Kosova, por zgjedhja e I. Boletinit nuk ishte rastësore. Ai u vlerësua si përfaqësuesi më i denjë ndër burrat e atyre trevave, që ishin të pranishëm në Vlorë, por edhe për qëndrimin e tij të palëkundur në mbështetje të Qeverisë së Vlorës, pavarësisht nga problemet e shumta që i duhej të përballonte aso kohe, përfshi edhe problemet shëndetësore, që i shkaktoi klima e qytetit bregdetar.

Gjatë rrugës për në Londër, nëpër disa vende të Evropës dhe në kryeqytetin e Britanisë së Madhe, ku zhvillohej Konferenca e Ambasadorëve, që diskutonte fatet e Shqipërisë, I. Boletini, ndonëse i paarsimuar, ishte dinjitoz në të gjitha takimet me personalitetet e politikës, përfshi deputetin Aubrey Herbert, mik i shqiptarëve (në shtëpinë e të cilit u akomodua), ministrin e Thesarit Lloyd George, dhe ministrin e Jashtëm britanik Eduard Grey, njëherësh drejtues i Konferencës së Ambasadorëve. Kujtimet e Tafil Boletinit lidhur me qëndrimin në Londër të I. Boletinit, pasqyruar në replikat me E. Grey-n, kur u shpreh se: “Nuk kam ardhur në Londër vetëm për Mitrovicën, por për çdo pëllëmbë toke shqiptare”⁴, ose në deklaratat me korrespondentët e medias, të cilëve u tha se nuk pajtohej me vendimet e Konferencës për kufijtë e Shqipërisë dhe se nuk do të rrinte në prehje sa kohë që shumë vise shqiptare mbeteshin nën zgjedhë, i konfirmon indirekt A. Herberti. “Të gjithë sa erdhën në Angli lanë një përshtypje të shkëlqyer, shkroi ai. Por, figura më piktoreske e delegacionit ishte Isa Beg Boletini, Robin Hudi i

⁴ Tafil Boletini, *Kujtime, pranë Isa Boletinit - përballë sfidave të kohës*, Tiranë: KLEAN, 2011, f. 159.

Shqipërisë. Qe mysafiri im për sa kohë që ndenjën në Angli ...”⁵. Dhe shton: “Kishte thjeshtësinë e një fëmije dhe kurajën e qëndrueshmërinë e një burri, të fortë dhe besnik gjer në fund. Ata që e njohën nuk do ta harrojnë kurrë”⁶. Delegacioni i qeverisë së I. Qemalit u kthye në Vlorë më 28 qershor 1913. Në fillim të korrikut I. Boletini nënshkroi protestën që shqiptarët e Kosovës i dërguan fuqive evropiane, me lutjen që të çohet një komision hetues në Kosovë. (Protestën e nënshkruan edhe delegatë të tjerë të Kosovës, Mehmet Dërralla e Ajdin Draga). Afërsisht në këtë kohë, I. Boletini i kërkoi leje I. Qemalit të largohej për 2-3 muaj në Krasniqe për të ndërruar klimën, por me sa duket për më tepër se kaq. Më 16 korrik 1913 ai bashkë me H. Prishtinën e B. Currin iu drejtuan malësisë pranë viseve të kufirit. Dhe për dy muaj vijoi puna për të lidhur besë e organizuar kryengritjen. Në fund të gushtit bashkë me B. Currin ndodhej në Vlorë, pastaj sërish në Malësi, e në mes të nëntorit në Shkodër. Është faktuar roli i Isait në kryengritjen antiserbe të 22 shtatorit 1913.

Dokumentet dhe korrespondenca midis dy burrave flet qartë për këtë. “... lus zotin t’ju mbajë shëndeti, i shkruante I. Boletini, I. Qemalit, në tetor ose nëntor të atij viti... Siç e dini shkëlqesia juaj... jemi përpjekur e po përpiqemi për ta nxjerrë në breg të shpëtimit... Shqipërinë... Ne e dimë, shtonte më tej atdhetari i Kosovës, se ju veç nesh s’keni të tjerë që të përbuzin jetën e të marrin parasysh çdo flijim... E dini se qëllimi për të cilën dolëm në malësi ishte të shpëtonim... atdhenë... Disa çeta të vogla tonat janë në lëvizje...”⁷. Duke përfunduar I. Boletini i kërkonte I. Qemalit t’i furnizonte me

⁵ S. Luarasi, *Tri jetë ...*, f. 301.

⁶ Po aty.

⁷ Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (AQSH), Fondi 245, dosja 53, f. 37, origjinali osmanisht; shih edhe Ismail Qemali, Përmbledhje dokumentesh, përgatiti Teuta Hoxha, Tiranë: 8 nëntori, 1982.

drithë viset e Gashit, Krasniqes, Hasit, Bytyçit, Plavës e Gucisë, sepse burimet për të vijuar qëndresën kishin shteruar plotësisht. Sipas I. Boletinit goditja serbe për shtypjen e kryengritjes kishte qenë e rëndë. Vetëm në Gjakovë ata kishin pasur të stacionuar 40 - 50 batalione, të cilat më pas i kishin larguar drejt Shkupit. Ndërkohë I. Qemali mbajti në Vlorë rreth 50 luftëtarë të Kosovës nën drejtimin e Tafil Boletinit. Edhe pse të sëmurë nga ethet, ata nuk munguan t'i shërbenin I. Qemalit, i cili u interesua për shëndetin e tyre duke i çuar dy-tri javë për ndërrim klime në teqenë e Kaninës. Në pranverën e vitit 1914 I. Boletini ndodhej në Shkodër, së bashku me B. Currin. Por më 7 mars 1914, ditën kur princ Vidi, i caktuar për të mbajtur kurorën e Principatës shqiptare zbriti në Durrës, ai ndodhej në këtë qytet për t'i uruar monarkut gjerman mirëseardhjen. Një foto e asaj dite ka fiksuar dy patriotët e mëdhenj, krahas disa të tjerëve dhe diplomatëve të huaj të akredituar në Durrës, ose anëtarëve të Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit. Edhe njëherë luftëtarët kosovarë, ndër të cilët shumë pasues të I. Boletinit, do të bëheshin forca mbrojtëse e shtetit shqiptar të përfaqësuar nga Vidi dhe qeveria e tij (dy qeveri në fakt, të dyja me kryeministër Turhan Pashë Përmetin). Ata ishin pjesë e rëndësishme e rreth 1 100 burrave të armatosur, të dislokuar në Durrës, grupimit më besnik e me vlera luftarake më të spikatura, që dispononte Vidi në 6 muajt e qeverisjes së tij⁸.

Në maj 1914, I. Boletini ndodhej sërish në Shkodër. Turbullirat që shkaktoi fillimi i rebelimit të Shqipërisë së Mesme e bënë të domosdoshme ardhjen e tij në Durrës. Pas thirrjes që iu bë

⁸Arkivi i Institutit të Historisë, Haus und Hof. Staats Archiv, Wien, Politisches Archiv, Albanien (HHSTa,PA,A), Vj. 24-25-2571. Forca të tjera llogariteshin 800 vetë të Preng Bib Dodës në Lezhë, 2 000 vetë të Ahmet Zogollit dhe 1 000 vetë të Azis Pashë Vrionit në Lushnjë.

me telegram, më 2 qershor, përmes Shëngjinit, ai nisi me det Tafilin me rreth 100 kosovarë në ndihmë të qeverisë.

Më 12 qershor mbërriti edhe vetë në Durrës. Fotot e tij pranë Vidit, oficerëve holandezë dhe personaliteteve politike të kohës të realizuara në prill dhe qershor 1914, si edhe kostumet kombëtare të burrave të Kosovës që dallohen në foton kur Vidi ndodhet midis trupave shqiptarë që e mbështetnin, dëshmojnë qartë, krahas dokumenteve të shkruara të kohës, të kancelarive të ndryshme, apo memoareve të botuara, për rolin e rëndësishëm të I. Boletinit dhe të luftëtarëve nga Kosova në mbështetje të shtetit shqiptar. Edhe pse i sëmurë, më 15 qershor, I. Boletini ishte në krah të kolonelit Tomson për të prapsur rebelët që mësynin Durrësin, te Ura e Dalanit.

Në rrjedhën e këtyre ngjarjeve u formua në Durrës edhe Komiteti Ushtarak për Shpëtimin e Shqipërisë, në të cilin nga trevat veriore krahas B. Currit, Ali Shefqet Shkupit dhe Ded Cokut, bënte pjesë edhe I. Boletini. Sipas kujtimeve të T. Boletinit në prag të Luftës së Parë Botërore austriakët donin ta përdornin I. Boletinin për diversion kundër Serbisë nga jugu. Së bashku me Hasan Prishtinën, me kërkesën e diplomatit austro-hungarez Kral, ai shkoi në Kotorr. Aty, pasi iu kërkuar një mendim për situatën dhe disa të dhëna për gjendjen e rrugëve në Sanxhak, iu propozua të vepronte me çeta në kufi dhe të organizonte popullin në Kosovë, duke iu siguruar gjithçka i nevojitej për këtë. I. Boletini nuk pranoi dhe u tha miqve “Mirë a keq këtë punë s’e mora përsipër, nuk ma muer mendja për me lanë Durrësin, se kur të prishet Shqipëria çfarë shprese do të kemi për Kosovën... Kosova shpëton vetëm me ekzistencën e një Shqipnie të fortë”⁹. Kurse, kur i kërkuar mendim për largimin e Vidit, Isa u shpreh: “Mbreti të dalë në mal bashkë me ne”¹⁰.

⁹ T.Boletini, *Kujtime...*, f. 177.

¹⁰ Po aty, f. 179.

Ditën e 3 shtatorit kur Vidi la Shqipërinë edhe I. Boletini e pasuesit e tij lanë Durrësin. Me një arritje italiane iu drejtuan Shëngjinit dhe prej andej morën rrugën për në Malësinë e Gjakovës. Pas 6 ditë udhëtimi, më 9 shtator, Isa me njerëzit e tij mbërritën në Has. Rrethi ishte mbyllur. Qershori i 1915, pas një dimërimi tepër të vështirë, e gjeti në Shkodër. Historia më tej, që përfundoi me vrasjen e tij, vetë i tetë, më 23 janar, në Podgoricë te ura e Ribnicës, është e njohur. (U vra bashkë me bijtë, Halilin dhe Zahidin, nipat Jonuzin dhe Halitin dhe tre luftëtarë të tjerë). Duke përfunduar këtë kumtesë, vlen të ritheksohet se veprimtaria e I. Boletinit në mbrojtje të Shqipërisë së pavarur, edhe sikur kurrgjë mos kish bërë më parë ky burrë i fortë, e vendos atë në radhën e atdhetarëve më të mëdhenj të kombit. Vepra e tij i bën nder të veçantë Kosovës, e cila i ka borxh vlerësimin më të lartë të merituar. Një ditë kur të shkruhet historia, theksonte revista "L'Albanie" (botuar në Lozanë të Zvicrës, nr. 9, 16 shkurt 1916), I. Boletini do të zërë një vend nga më të nderuarit në mos më të nderuarin... I. Boletini gjithnjë i ka shërbyer vendit të vet me një përkushtim të madh pa kurrfarë kompensimi, me sadisfaksionin që ta shihte atdheun duke realizuar aspiratat e tij¹¹.

¹¹ L'Albanie, 9, Lausanne, 16.02.1916.

Akad. assoc. Marenglen VERLI

SUMMARY

ISA BOLETINI DEFENDING AN INDEPENDENT ALBANIA (IN VLORA, LONDON, DURRËS...)

The 20th century was characterized by a new generation of patriots and leaders of the National Albanian Movement. Educated men like Hasan Prishtina in Kosovo, or men of tradition like Bajram Curri and Isa Boletini, became leaders of Albanians in this region, only to gradually become leaders of the entire nation. Isa Boletini was initially very influential in Mitrovica in the beginning of the 20th century, who by 1910 - 1912 became a central figure in the developments in Kosova. The biography of Isa Boletini before and after 28th of November 1912, prior and after the Declaration of Independence of Albania is publicly known. A number of monographs and many research articles and papers have been devoted to this figure of the National Albanian Movement. His name is present in many published documents or memoirs. Other documents regarding his personality are being researched and published day by day.

Thanks to the information acquired from the abovementioned sources, it can be said without a doubt that Isa Boletini, regardless of the accusations he faced throughout his lifetime, always acted according to traditional and human morals, from the traditional Kanun and the national interests. He was a man of strong character,

with positive qualities which were quite valued at the time, which is why he had many followers and is considered one of the most renowned Albanians of the last two decades of the 20th century.

His activity honors Kosova, who owes him the highest merited valorization. “One day when history will be made, according to the newspaper ‘L’Albanie’ (published in Lausanne in Swiss, no. 9, date 16th February 1916), I. Boletini will take a special place amongst the honored... I. Boletini always served his country with a great dedication without any compensation, with a great satisfaction in seeing his fatherland realizing its aspirations”.

Prof. dr. Fatmira MUSAJ
(Tiranë)

**QËNDRIMI I ISA BOLETINIT NDAJ POLITIKËS SË
BEOGRADIT DHE ELEMENTIT SERB NË KOSOVË
(1912-1916)**

Ndryshe nga popujt fqinjë, shqiptarët në luftën për pavarësi u gjendën të vetëm. Ata nuk u mbështetën as nga Fuqitë e Mëdha të cilat ishin kundër ndryshimit të status quo-së së Perandorisë Osmane në Evropën Juglindore, dhe as nga shtetet fqinjë të cilët panë përpjekjen e shqiptarëve për pavarësi e shtetet kombëtar, rrezikun e dështimit të planeve për zgjerim territorial në kurriz të trojeve shqiptare. Megjithatë shqiptarët edhe ashtu të vetëm hynë sërish në organizimin e Kryengritjes së vitit 1912 e cila i kaloj kufijtë e Kosovës dhe mori përmasa kombëtare. Porta e Lartë nuk i dha rëndësinë e duhur situatës në Shqipëri dhe Ballkan ku ndërthureshin interesa që lidheshin drejtpërsëdrejti edhe me fatin e saj. Ajo neglizhoi plotësimin e kërkesave të kryengritësve shqiptarë në marrëveshjen e vitit 1911. Duke e ndier veten të pasigurt, mori masa për çarmatimin e krerëve të Kosovës dhe mbështetësve të tyre. Kjo dhe masa të tjera në fushën ekonomike, politike çuan në

përkeqësimit e mëtejshëm të gjendjes së shqiptarëve. Situatën e krijuar midis turqve të rinj dhe shqiptarëve Isa Boletini, e shihte të papajtueshme, pasi midis tyre ishte mbledhur shumë urrejtje dhe mosbesim. Shpëtimin e Shqipërisë ai e shihte në bashkimin e shqiptarëve në një lëvizje të përgjithshme të armatosur, për krijimin e shtetit autonom shqiptar¹. Në fund të korrikut 1911, me iniciativë të Hasan Prishtinës, i cili pas pjesëmarrjes në pritjen e Sulltanit, qëndroi në Kosovë, u organizua takimi me Isa Boletinin dhe krerë të tjerë të Kosovës. Aty u vendos të shfrytëzohej pakënaqësia e shqiptarëve, për organizimin sërish të një kryengritje të përgjithshme për të fituar autonominë e Shqipërisë².

Pas kthimit në Stamboll, H. Prishtina dhe grupi i deputetëve shqiptarë në janar të vitit 1912, ngritën edhe njëherë në Parlamentin osman çështjen shqiptare dhe kërkuan zbatimin e kërkesave të tyre të garantuara në kushtetutë, zbatimin e reformave në Shqipëri për të shmangur ngjarje më të rënda që do të pasonin³. Të gjendur para kokëfortësisë së xhonturqve të cilët njohjen e kërkesave të shqiptarëve i konsideronin baras me shpërbërjen e Perandorisë, deputetët shqiptarë u larguan përfundimisht nga parlamenti. Ajo theksoi H. Prishtina “forcoi rezistencën tonë e na detyroi të luftojmë për ekzistencën”⁴. Në mbledhjen e organizuar në lagjen “Taksim”, midis çështjeve që kishin të bënin me organizimin e kryengritjes, për arritjen e fitores, ishte e nevojshme mbështetja e ndihma e faktorit të

¹ *Arkivi i Kosovës* (më tej: A.K.) Raport nr. 531 i konsullit serb, drejtuar Ministrisë së Jashtme të Serbisë, Prishtinë 15/28 .7. 1911.

² Fatmira Musaj, *Isa Boletini (1864 - 1916)*, Botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, Urtësia Bektashiane, 2004, f. 110.

³ Ramiz Abdyli, *Lëvizja Kombëtare Shqiptare 1911-1912*, Libri 2, Prishtinë, 2004, f. 150.

⁴ *Po aty*, f. 151.

jashtëm. Për këtë qëllim I. Qemali e H. Prishtina iu drejtuan përkatësisht, kancelarive evropiane dhe lëvizjes bullgaro-maqedone.

Diplomacia evropiane e priti me indiferencë shqetësimin e I. Qemalit. Ato, në këto momente interesoheshin për ruajtjen e status quo-së dhe nuk i ofruan qoftë dhe mbështetje morale. Përgjigje negative dhanë dhe përfaqësuesit bullgaro-maqedonas, pasi qarqet politike të Sofjes ishin vënë në lëvizje për të qenë pjesë e Aleancës Ballkanike. Angazhimi i drejtpërdrejtë i personaliteteve të tilla të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, si: I. Qemalit, H. Prishtinës, Ali, Nexhip e Ajdin Dragës, Jahja efendi Prizrenit, Musa Shehzades të cilët në bashkëpunim me udhëheqësit e lëvizjes së armatosur kundërosmane në Kosovë e treva të tjera shqiptare, arritën t'i jepnin Kryengritjes së vitit 1912, një dimension të gjerë si në frymën e bashkëpunimit, për shtrirjen territoriale të saj, në kërkesat e programit politik, që iu paraqitën Portës së Lartë.

Ndryshe nga Bullgaria dhe shtetet tjera fqinje, Serbia nisur nga interesat e saj politike, ndoqi një politikë afrimi me kryengritësit duke iu ofruar atyre bashkëpunim. Qëndrimi i saj lidhej me rritjen e lëvizjes antixhonturke të shqiptarëve pas vitit 1908, e veçanërisht pas shpalljes në maj të vitit 1911 në Greçë, të programit autonomist dhe këmbënguljen e shqiptarëve për realizimin e tij. Prandaj, fill pas Kryengritjes së 1911, qarqet serbe ndoqën me vëmendje të madhe çdo lëvizje të krerëve të Kosovës. Kështu qysh në korrik, konsulli serb informonte Beogradin për një përpjekje të I. Boletinit dhe H. Prishtinës etj., për një kryengritje të re në Kosovë, për programin dhe kohën e fillimit të saj⁵. Fillimi i përgatitjeve të kryengritjes i shtyu qarqet serbe të hartonin planin, për të ndërhyrë e goditur pikërisht programin e lëvizjes.

⁵AK, Raport i konsullit serb drejtuar Ministrisë së Jashtme të Serbisë, Prishtinë, 15/28.7.1911.

Kjo pasqyrohet në telegramin që konsulli serb në Kosovë i dërgonte Beogradit ku midis të tjerave theksonte: “Pikëpamja jonë e përgjithshme është që zgjerimi i lëvizjes shqiptare të përkrahet sa të sigurohen kushtet që Serbia të mund të ndërhyjë me sukses nga ana diplomatike dhe në mënyrë të armatosur. Derisa të sigurohen këto, lëvizja shqiptare të mbahet brenda kufijve që nuk do të lejojnë që rëndësia e saj të rritet dhe të kalojë në një revolucion të përgjithshëm shqiptar”⁶. Në realizim të synimeve të tyre, qarqet politike dhe ushtarake serbe, shfrytëzuan nevojën e kryengritësve për armë e municion dhe u orvatën të shtinin në dorë prijësit e kryengritjes dhe veçanërisht Isa Boletinin, të cilin e konsideronin më të fortin ndër udhëheqësit e tjerë dhe me ndikim të madh tek ta⁷. Krahas kësaj, Serbia dhe shtetet e tjera të Ballkanit sido që të vinin rrethanat, duke përfutur nga indiferenca e shteteve perëndimore, u shtynë drejt formësimit të një Aleance, që synonte t’u mohonte shqiptarëve gjithçka që ishte qartësisht shqiptare. “Shqipëria duhej të bëhej një shtet vetëm sa për emër, i zhveshur nga gjithçka që do ta bënte të jetonte i pavarur”⁸. Qysh në korrik 1911, pa filluar ende përgatitjet e kryengritjes, Qeveria serbe u përpoq t’i hiqte lëvizjes shpirtin e saj, kërkoi ta tërhiqte Isa Boletinin në Serbi, duke i premtuar se atje do të ishte më i sigurt nga autoritetet osmane, madje për ta bindur, vunë në dispozicion dhe një shumë të madhe të hollash⁹. Meqenëse dokumentacioni nuk na ofron ndonjë informacion për përgjigjen e Isait, fakti që ai nuk u largua për as një çast nga Kosova, dëshmon për refuzimin e ofertës së Beogradit.

⁶*Po aty*, Telegram i konsullit serb drejtuar Ministrisë së Jashtme të Serbisë, Prishtinë 30/13.5.1912.

⁷ Joseph Swire, *Shqipëria ngritja e një Mbretërie*, Tiranë, Dituria, 2004, f.115.

⁸*Po aty*, f.107.

⁹ Fatmira Musaj, *Isa Boletini*.....f.116.

Nisur nga shtrija e organizimit të kryengritjes në pjesën më të madhe të krahinave të Kosovës dhe gatishmëria e popullsisë për të marrë pjesë në luftë për autonominë e Shqipërisë si dhe nga nevoja e kryengritësve për ndihmë e sidomos për armatim dhe për një mbështetje politike në kushtet kur gjithkush ua mohoi, e përligjin vendimin e Boletinit për t'u takuar më të dërguarit e organizatës "Dora e Zezë", e cila ishte instrument i qarqeve politike serbe. Ajo luftonte jo vetëm për bashkimin e serbëve siç pretendonin ata, por për krijimin e Serbisë së Madhe. Pikërisht angazhimi i këtyre forcave të rrezikshme për bisedime me të, e shtynë Isanë t'u vinte si kusht që takimet të zhvilloheshin në Boletin. Kështu në pranverën e vitit 1912 në Boletin erdhën, majori Tankosiç, Dragutin Dmitrijeviç Apis, Bogdan Radenkoviç dhe Milan Zavajdil. Ata i shtruan Isait nevojën e një lufte të përbashkët të serbëve dhe shqiptarëve për të çliruar vendin nga sundimi osman¹⁰.

Por, Isa Boletini, dyshues në qëllimet e vërteta të palës serbe, i përcolli ata pa u dhënë ndonjë përgjigje konkrete. Në prill 1912, kur udhëheqësit e kryengritjes po u jepnin fund përgatitjeve, Beogradi dërgoi pranë Isa Boletinit përfaqësuesin e Qeverisë Bozhin Simiç, me mision për të marrë një përgjigje pozitive për bashkëpunim në luftë kundër osmanëve¹¹. Nga dokumentet e deritanishme të shfrytëzuara, nuk kemi të dhëna se çfarë kërkesash ai i shtroi I. Boletinit. Por, përpara paraqitjes së kërkesave të tij, Isai i bëri të qartë Simiç, karakterin antiosman të kryengritjes dhe se shqiptarët dëshirojnë të jenë vetë zot në krahinat e tyre¹².

¹⁰*Po aty*, f.118.

¹¹ Dokumenti o spolnoj politici kraljevine Srbije 1903-1914. Dok.281. Knjiga V. Sveska 1. Beograd, 1984, f.514 - 516.

¹²*Po aty*.

Kërkesat e paraqitura prej I. Boletinit ishin: 1) Serbia të furnizonte kryengritësit me armë, municion dhe materiale të tjera; 2) Në rast nevojë, Serbia të strehonte kryengritësit në vendin e saj; 3) Duke nxjerrë një pjesë të ushtrisë në kufi dhe duke ndërhyrë në Evropë t'i ndihmonte moralisht kryengritësit. Isa Boletini e ndjente rrezikun serb, prandaj u tregua i kujdesshëm. Në relacionin dërguar qendrës në Beograd, Simiç shprehej se te Isai gjeti një njeri të zgjuar, trim e të fjalës që si kompensim për kërkesat e mëdha që bëri, nuk dha asnjë premtim konkret. Mesa duket Isai nuk ka pranuar ndihmën e ushtrisë serbe, por vetëm daljen e saj në kufi si presion ndaj forcave osmane. Në lidhje me këtë, Simiç shprehej se ndryshe nga “njerëzit e Mahmut Zajmit të cilët do të pranonin ndihmën e ushtrisë serbe, kjo nuk mund të thuhej për Isa Boletinin se është një fanatik i madh”¹³.

Gjatë përgatitjes së kryengritjes Isa Boletini e krerët e tjerë të saj, bënë përpjekje për të tërhequr në kryengritje pakicat serbe, pasi e shihnin atë, si detyrim që ata kishin si qytetarë të Kosovës dhe ashtu si shqiptarë të cilët do të gëzonin lirinë, pas çlirimit të vendit nga sunduesi osman. Angazhimin e tyre Isai e shihte dhe si një arsye më shumë për të siguruar armë nga Serbia, prandaj u kërkoi emisarëve serbë që të ndikonin pozitivisht në këtë drejtim. Me gjithë premtimet, në realitet Beogradi bëri të kundërtën. Nga njëra anë këshillonte pakicat serbe të mbanin marrëdhënie të mira me kryengritësit, por nga ana tjetër i udhëzonte të mos bashkëpunonin me ta. Ajo synonte që pakicat serbe t'i përdorte si mbështetje për veprime të mëtejshme ushtarake të saj, ndaj trojeve shqiptare.

Qeveria serbe ndiqte hap pas hapi veprimtarinë e I. Boletinit në përgatitjen dhe organizimin e kryengritjes e cila tashmë ishte shtrirë jo vetëm në Kosovë, por edhe në krahina të tjera të vendit. Konsulli serb në Prishtinë njoftonte Beogradin se: “Në të gjitha anët

¹³*Po aty*, dok 356, f. 610.

e Shqipërisë, po përgatitet një lëvizje serioze. Në Malësi krerët po përgatiten të paraqesin projektin e tyre prej 12 pikave që ka për qëllim krijimin e një Shqipërie autonome”¹⁴. Zhvillimi i ngjarjeve me shpejtësi dhe zgjerimi i kryengritjes e detyroi Qeverinë serbe që në 15 maj, të dërgonte pranë I. Boletinit Angjelko Neshiç dhe Ognjen Radenkoviç¹⁵. Në këmbim të përgjigjes pozitive ndaj kërkesave të Isait, Beogradi vuri kushte në interes të politikës së tij. Ajo kërkonte t’i lihej të vendosë vetë kur aksioni mundej të fillonte, sepse vetëm ajo ishte në gjendje të vlerësonte drejt nëse ishin pjekur kushtet evropiane për një lëvizje të tillë kundërosmane. “Përderisa qeveria serbe nuk do të vendosë për fillimin e kryengritjes, miqtë tanë shqiptarë që janë në marrëveshje me ne, duhet të mënjanojnë të gjitha ato që mund të ndezi një kryengritje të përgjithshme”¹⁶.

Pranimi i kushteve të Serbisë do të thoshte ndërhyrje në punët e kryengritjes dhe minimi i saj. Kërkesat e saj pala serbe i justifikoi me rrezikun që i kanosej Kosovës nga një ndërhyrje e mundshme ushtarake në Kosovë nga ana Austro-Hungarisë. Por, qëndrimi i Isa Boletinit ishte i prerë: ”kryengritja, theksoi ai, nuk do të shtyhet. Kemi lidhur besën të gjithë vilajetet dhe kemi vendos me dalë faqebardhë. I pari do të fillojë luftën Vilajeti i Kosovës”¹⁷. Edhe në rast të një sulmi nga Austro-Hungaria, gjysma e kryengritësve, theksoi ai, do të drejtohej kundër saj. Ajo çka vihet re në dokumentacionin e gjerë diplomatik serb, por edhe të shteteve të tjera, vërejmë se Isa Boletini në marrëdhënie me Serbinë, nuk bëri asnjëherë kompromis me qëllimet e kryengritjes për hir të ndihmës së marrë në armatim dhe municion të ofruar prej saj, pasi forcën e

¹⁴*Po aty*, dok 366, f. 385.

¹⁵*Po aty*, dok. 281, f. 314-316.

¹⁶*Po aty*.

¹⁷ *Po aty*, dok. 344, f. 595.

kryengritjes e shihte tek vetë shqiptarët. Në respektim të premtimeve të bëra nga Beogradi, Isai u kërkoi të dërgonin 1 000 pushkë, por në të njëjtën kohë u la të kuptonin se ndihma e tyre nuk ishte përcaktuese në fillimin e as në zhvillimin e kryengritjes. “Ne, theksoi Isai, do të luftojmë edhe me spata kush nuk ka pushkë, do të luftojmë edhe pa pushkët tuaja”¹⁸.

Duke qenë se furnizimi me armë nga ana e Serbisë ishte i pakët e i parëndësishëm, Isa Boletini e krerët e tjerë të kryengritjes e humbën interesin për kontakte të mëtejshme me palën serbe dhe e përqendruan vëmendjen tërësisht në zhvillimin e mëtejshëm të kryengritjes, ku spikati roli i tij në propagandimin e programit autonomist, si organizator e drejtues i veprimeve luftarake etj. Sukseset e kryengritësve e detyruan Portën e Lartë të hynte në bisedime me krerët e saj. Por, zhvillimet e shpejta politiko-ushtarake në Ballkan, i detyruan një pjesë të mirë të krerëve kryengritës të tërhiqeshin përkohësisht nga kërkesa e drejtpërdrejta për autonomi dhe të dilnin me kërkesa më të moderuara.

Në qëndrimin e tyre ndikuan faktorë politikë, ekonomikë e shoqërorë që u krijuan për shqiptarët dhe Shqipërinë gjatë Kryengritjes së vitit 1912. Shtetet ballkanike të lidhura në Aleancën ushtarake të mbështetura nga Rusia e Franca, kishin nisur sulmin në kufijtë veriorë të vendit dhe shtuan presionin diplomatik ndaj Qeverisë osmane për të mos plotësuar kërkesat e shqiptarëve, sepse në të kundërt do të kishin punë edhe me shtetet ballkanike që ishin të gatshme për aksionin e armatosur. Arsyen e tërheqjes nga kërkesa për autonomi, Isai ia përsëriti Aubrey Herbertit në gusht të atij viti. Pyetjes së tij nëse shqiptarët duan apo jo autonominë, iu përgjigj: ”Jo, ajo që duan shqiptarët është që të mos trazohen nga të tjerët”¹⁹.

¹⁸*Po aty.*

¹⁹A. Herbert. Ben Këndim, a record of eastern travel. London 1924.

Mesa duket, krerët kryengritës gjykuan që në ato momente rreziku i copëtimit të vendit mund të përballohej duke qëndruar ende nën Perandorinë Osmane. I. Boletini mori pjesë në mbledhjen e përgjithshme të krerëve, në Kuvendin e Ferizajt të gushtit 1912, ku u propozuan dhe u hartuan, 14 pika të cilat iu paraqitën Portës së Lartë në formën e një memorandumit.

Tërheqja e I. Boletinit dhe krerëve të tjerë kryengritës nga programi autonomist ishte e përkohshme, e diktuar tërësisht nga rrethanat e përmendura më lart. Këtë e vërteton më së miri e gjithë veprimtaria e tij e mëvonshme. Pa kaluar ende tre muaj ai, mbështeti pa rezerva shpalljen e pavarësisë dhe formimin e shtetit shqiptar. Ai asnjëherë nuk u pajtua me vendimet e Konferencës së Londrës (korrik 1913) për copëtimin e trojeve shqiptare dhe kalimin e Kosovës nën sundimin serb. Gjatë udhëtimit për në Londër, në Milano delegacioni shqiptar hodhi poshtë kërkesat e diplomatit serb Zhivojin Ballugxhiç, i cili u kërkoi atyre të njihnin vijën kufitare të caktuar nga Serbia dhe ta njoftonin atë botërisht, të pranonin që Durrësi të bëhej skelë tregtare e Serbisë dhe më pas të deklaroheshin pozitivisht për bashkimin e Shqipërisë me fqinjin verior.

Isa Boletini, ashtu si Ismail Qemali, i deklaroi emisarit serb se shqiptarët nuk do të rrinë duarkryq, do të çojnë krye dhe do t'i tregojnë Evropës se nuk duan të jetojnë nën zgjedhën serbe dhe do ta mbrojnë atë që është e tyre²⁰. Në përbërje të delegacionit shqiptar ai, nëpërmjet takimeve me autoritetet më të larta të politikës evropiane dhe në intervista për gazetatat më prestigjioze, kritikoi vendimet e Konferencës së Londrës dhe iu kundërvu propagandës antishqiptare të qarqeve shoviniste fqinje. Pas kthimit në atdhe, Isai i qëndroi në krah Isamil Qemalit dhe dha kontributin e tij të çmuar për forcimin e shtetit të ri shqiptar, të cilin e konsideronte një faktor të rëndësishëm

²⁰ Fatmira Musaj, *Isa Boletini*.....f. 171.

dhe garanci për vazhdimin e luftës me të gjitha format për çlirimin e trojeve shqiptare dhe bashkimin e tyre me shtetin amë.

Në shërbim të këtij qëllimi Isa Boletini, në bashkëpunim me H. Prishtinën, B. Currin e patriotë të tjerë, të larguar nga Kosova në Shqipëri, u bënë nismëtarë për fillimin e lëvizjes irredentiste për çlirimin dhe bashkimin e trojeve shqiptare të mbetura jashtë kufijve politikë të shtetit shqiptar, protestuan tek Fuqitë e Mëdha për vendimet e padrejta në dëm të trojeve shqiptare dhe bënë përpjekje për të shfrytëzuar në interes të çështjes kombëtare kontradiktat midis shteteve ndërluftuese gjatë Luftës së Parë Botërore. Në të njëjtën kohë ai ndoqi me vëmendje të veçantë, politikën shkombëtarizuese që Serbia kishte ndërmarrë ndaj shqiptarëve duke i detyruar ata edhe me dhunë të shpërnguleshin nga trojet e tyre. Mesazhi që I. Boletini u drejtonte bashkatdhetarëve nëpërmjet bashkëluftëtarëve të tij, ishte qëndresë dhe vetëm qëndresë. “Duhet të përballojmë të gjitha vështirësitë, shprehej Isai, edhe duke u varfëruar në truallin tonë se vetëm në këtë mënyrë do t’i qëndrojmë qytetarë të zgjuar dhe besnik atdheut, pasi në asnjë vend tjetër nuk do të gjejmë klimë e bukuri si në Kosovë”²¹.

Pas largimit nga Shqipëria të Princ Vedit në shtator të vitit 1914, I. Boletini, B. Curri etj., bënë edhe njëherë përpjekje për organizimin e një kryengritje në Malësinë e Gjakovës. Por qarqet serbe vunë në lëvizje Esat Pashën i cili në bashkëpunim me Ceno Kryeziun në nëntor i sulmuan në Has pranë kufirit me Kosovën, për t’i asgjësuar ata fizikisht. I ndjekur nga reaksioni, Isai e mbështetësit e tij u detyruan të zbrisnin në Shkodër. Serbia përdori të gjitha format për ta tërhequr në Kosovë e për ta vënë në shërbim të politikës së saj. Ushtri presion mbi pjesëtarët e familjes në Boletin, i premtoi ofiqe,

²¹ Dokumenti o spolnoj politici.....dok. 221, Knjiga VII, sveska 2, Beograd 1980, f. 354 - 355.

para, por nuk ia arriti qëllimit. Fillimi i Luftës së Parë Botërore dhe rrethimi i Shkodrës nga forcat malazeze në qershor të vitit 1915, e detyruan I. Boletinin t'i drejtohej konsullatës britanike. Në pamundësi kontakti me diplomatë të saj, ai u detyrua të kërkonte strehim dhe ndihmë në konsullatën franceze. Dorëzimi i Isait nga konsulli Bilëkok te Mali i Zi, ndërpreu rrugën e tij për në vendlindje dhe në të njëjtën kohë, paracaktoi fundin e jetës së këtij veprimtari të shquar të Lëvizjes Kombëtare, i cili sakrifikoi pasurinë dhe më të shtrenjtën jetën e tij, për pavarësi dhe bashkim kombëtar. Mbërritja e eshtrave të tij në Kosovë, i dha fund rrugëtimit që ai nisi nga Durrësi, 100 vjet më parë në drejtim të Mitrovicës e Boletinit, në shtator 1914.

Prof. dr. Fatmira MUSAJ

SUMMARY

ISA BOLETINI'S STANCE REGARDING BELGARDE'S POLITICS AND THE SERBIAN ELEMENT IN KOSOVA (1912-1916)

The paper titled “The stance of Ismail Qemali in regards to the politics of Belgrade and the Serbian element in Kosova in the years 1912-1916” treats the factors that led Isa Boletini to engage in negotiations with the Serbian representation in the spring of 1912. The refusal of Ismail Qemali’s and Hasan Prishtina’s request on behalf of the Great Powers and neighboring countries in the former’s plight to gain support for Albanians in their road towards autonomy made it necessary to ensure ammunition and arms for the upcoming uprising. To this endeavor contributed the necessity to carefully organize an uprising in the spring of 1912 in the main regions in Kosova and to enlist as many soldiers as possible.

For this reason Isa Boletini accepted to contact the representative of Serbia who, unlike the other neighboring countries, seemed eager to support and collaborate with the insurgents. Serbia aimed to intervene in internal Albanian affairs through the main Albanian leaders, and as such it aimed to channel its influence on the developments of the uprising. Referencing Albanian archival documents and Serbian ones, it becomes evident that in the discussions between Isa Boletini and the Serbian representative, the former made requests to gain material support for the insurgents, and

encourage the Serbian minority in Kosova to fight alongside Albanians, so that after the land would become independent, the Serbs too would enjoy their rights and freedom equal to Albanians.

Isa Boletini refused to negotiate his conditions so that they would favor the Serbs, and he adamantly refused the Serbian interference in Albanian internal affairs. Seeing that being supplied with ammunition by the Serbs was minimal and consequently insignificant, Isa Boletini and the other Albanian leaders quickly lost interest in collaborating with the Serbs, thusly focusing all their energy in further planning their uprising independently.

The paper also treats Isa Boletini's unchanging stance in regards to defying the Serbian attempts to annex Kosova to their land throughout the Balkan Wars and after the formation of the Albanian state. He refused to come to terms with the decisions made at the Conference of London, which left Kosova out of the official borders of Albania, and consequently Isa Boletini became one of the initiators in organizing the irredentist movement for national liberation and unification, up until he was assassinated by the Serbs and Montenegrins in January of 1916.

Dr. Ledia DUSHKU
(Tiranë)

SHOQËRIA “SHKIPNIA” DHE ISA BOLETINI

Viti 1913 nuk qe i lehtë për shqiptarët në Kosovë. Shpresat dhe optimizmi i shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, më 28 nëntor 1912, u venitën shpejt. Konferenca e Ambasadorëve në Londër dhe vendimi i 22 marsit të 1913 për kufirin verior të shtetit shqiptar, i vendosi ata nën një sundim të ri, atë serb. Duke lënë mënjane interesat strategjike, të cilat influencuan vendimin e Fuqive të Mëdha, absolutisht që, vija e kufirit shkonte në linjë të kundërt, si me përbërjen etnike, edhe me arsyet ekonomike të zonës. Krah ndjenjës nacionaliste të papërmbyshur, çka do të nxiste reagimin e vazhdueshëm të shqiptarëve, ata kishin më shumë se një shkak të fortë dhe të përhershëm pakënaqësie. Një numër i madh i banorëve të pjesës fushore u shkëputën nga qytetet e tyre tregtare. Kuptoj, shprehej zëvendës konsulli britanik në Shkup Peckham, se Fuqitë do të propozojnë masa për të krijuar kushte të veçanta tregtie në Gjakovë, Pejë e Prizren, por vijonte ai, dyshoj që Qeveria serbe të ndërmarre ndonjë nga detyrimet e saj dhe, akoma më shumë nëse zyrtarët e vegjël të xhandarmërisë dhe të doganës, tek bashkëpunimi

besnik i të cilëve do të varet zbatimi i këtyre masave, do t'i trajtojnë shqiptarët në mënyrë të drejtë¹.

Nga ana tjetër, duket se kufiri ishte ravijëzuar në mënyrë të tillë që të linte të gjithë tokën e mirë bujqësore jashtë Shqipërisë. Shqiptarët që banonin pranë tij, në vijë paralele me zonën midis Prizrenit dhe Gjakovës, duke parë realisht tokën pjellore, prej së cilës ishin dëbuar nga pushtimi sllav, kishin arsye të irritoheshin². Pa asnjë justifikim të arsyeshëm ekonomik, kufiri i ri do të ndërpriste lidhjet e popullsisë së Matit, Lurës, Dardhës, madje edhe një pjesë të Lumës, me zonën e Dibrës, i vetmi treg i hapur vendas në momentin që flasim. Në kushtet kur shteti shqiptar ishte i varfër dhe qeverisja e tij jo fort e konsoliduar, mundësia që ata të bindeshin si qytetarë të rregullt, qe thuajse zero.

Kalimi i kufirit të pakonceptueshëm dhe të papranuar prej tyre, mbetej alternativa e vetme, veprim ky që do t'i etiketonte ata si të pabindur dhe renegatë nga fqinjët e tyre serbë. Gjithashtu, vija kufitare i përjashtonte banorët edhe nga vendet e shenjta përreth Dibrës, ku zakonisht shehlerët zgjidhnin, pa ankime të mëtejshme, konfliktet e të gjitha llojeve. Shpeshherë këto veprime kishin vlerë praktike më të madhe se manastiret e boshatisura dhe kishat e papërdorura, mbi të cilat bazoheshin shpeshherë pretendimet territoriale të shteteve të krishtera ballkanike. Efektet e vijës së re të kufirit qenë të menjëhershme. Doganat filluan të zbatojnë tarifat

¹ *Dokumente britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët (tetor-dhjetor 1913)*, përgatiti për botim Valentina Duka, Tiranë: Botimet "Toena", 2012, f. 120, Raport i zëvendës konsullit britanik në Shkup, Peckham për Crakanthorpe në Beograd, Shkup, 22 shtator 1913; Gazmend Rizaj, *Shqipëria e Sipërme 1800 - 1913. Në projektet dhe traktatet e Fuqive të Mëdha dhe shteteve ballkanike*, Prishtinë: Instituti Albanologjik, 2011, f. 460.

² *Dokumente britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët (tetor - dhjetor 1913)*..., f. 120, Raport i zëvendës konsullit britanik në Shkup, Peckham për Crakanthorpe në Beograd, Shkup, 22 shtator 1913.

serbe për mallrat e padeklaruar, që kishin hyrë përpara aneksimit. Ky veprim shokoi ndjenjat e banorëve dhe tregtarëve të ndryshëm, për të cilët detyrimet doganore konsideroheshin pjesë e sistemit të kapitulacioneve, ende në fuqi. Nga ana tjetër, serbët filluan të mblihdnin detyrimet e prapambetura të taksave osmane, edhe pse një pjesë e tyre ishin anuluar në mënyrë formale prej Portës së Lartë³. Ata filluan të aplikojnë taksën mbi tokën, pavarësisht sasisë së prodhimit. Zbatimi i një politike të tillë fiskale, në mënyrë të përsheptuar, mbi një vend të mësuar me taksa të buta dhe të paaftë për të paguar për shkak të varfërisë dhe trazirave të Luftërave Ballkanike, rriti natyrshëm pakënaqësinë e shqiptarëve. Me politikën e ndjekur, duket se serbët e kishin harruar historinë e tyre të një shekulli më parë, e cila përbënte një provë dhe tregonte sesa i rrezikshëm mund të bëhej një popull, kur vendosej me shpatulla pas murit. Nëse ushtarët serbë kishin qenë më të zotë se jeniçerët, trupat e paorganizuara të shqiptarëve mund të ishin, gjithashtu më të aftë sesa taksat e Karageorgjeviçit, shprehej britaniku Peckham në raportin dërguar eprorëve të tij në Londër⁴.

Sakaq shqiptarët ndjenë edhe dhunën verbale serbe e malazeze, si një politikë të mirëmenduar për t'i hedhur ata në revolta, në mënyrë që më tej të justifikoheshin përdorimi i dhunës fizike ndaj tyre. Në letrën dërguar Ismail Qemal Vlorës, më 26 gusht 1913, Rexhep Mitrovica vinte në dukje se në Dibër, Tetovë e Mitrovicë shtypjet, të rrahurat e torturat nën të cilat vuanin popullsitë e këtyre krahinave, bëheshin përditë e më të rënda. E ndërsa barbarizmat në popull dita-ditës zgjeroheshin, morali dobësohej dhe popullsia

³Po aty. f. 123, Raport i zëvendës konsullit britanik në Shkup, Peckham për z. Crakanthorpe. Ky i fundit ia transmeton ministrit të Jashtëm, Grey, Beograd më, 2 tetor, 1913.

⁴Po aty.

largohej. Krahas shtetit amë, Shqipërisë, një pjesë e konsiderueshme largohej në drejtim të Perandorisë Osmane. Mirëpo, edhe aty ata që nuk ishin itihatçinj, dëboheshin e të mjerët merrnin rrugët e Selanikut, Pireut e Aleksandrisë, ku fatkeqësisht i priste një fat më i lig⁵. Në ambientet publike në Kosovë e zonat përreth, nuk vonuan të artikuloreshin deklarata që flisnin hapur edhe për shpërndarjen e kamionëve me dinamit, me qëllim shfarosjen e të gjithë shqiptarëve, apo kërcënime për të burgosur gratë e Hasan Prishtinës, Isa Boletinit dhe të tjerëve, nëse burrat e tyre nuk dorëzoheshin. Në rastin e H. Prishtinës, veprimi konsiderohej veçanërisht skandaloz, pasi ai ishte larguar nga territori serb me leje nga Beogradi⁶.

Shtimi i veprimeve agresive serbe dhe situata në Ballkan, e favorizuar nga shpërthimi i Luftës së Dytë Ballkanike, nxiti reagimin e shqiptarëve, i cili erdhi duke u përshkallëzuar derisa kulmoi me Kryengritjen e Dibrës, në shtator 1913. Kryengritësit çliruan Dibrën, Gjakovën, rrethuan Prizrenin e marshuan në drejtim të Gostivarit e të Strugës. Qeveria e përkohshme e Vlorës u ndodh përballë një situatë mjaft delikate e të vështirë. Në gjirin e saj kishte anëtarë si Hasan Prishtina (ministër i Bujqësisë), por edhe të tjerë rreth saj si Bajram Curri e Isa Boletini që kërkonin mbështetje të hapur e të fuqishme për kryengritësit⁷. Nga ana tjetër presioni nga Beogradi zyrtar që i madh. Për të përligjur politikën e tij dhe dhunën ndaj popullsisë shqiptare, ai akuzoi drejtpërsëdrejti Qeverinë e përkohshme të Vlorës, austro-hungarezët, bullgarët e osmanët, se qëndronin prapa

⁵ Arkivi i Institutit të Historisë (më tej: AIH), A-IV-335 (Materiale arkivale (maj 191-shtator 1913), Letër e Rexhep Mitrovicës për Ismail Qemalin, Selanik, 13 gusht 1329\ 26 gusht 1913.

⁶ Dokumente britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët (tetor - dhjetor 1913)..., f. 123 - 124, Raport i zëvendës konsullit britanik në Shkup, Peckham për z. Crakanthorpe. Ky i fundit ia transmeton ministrit të Jashtëm, Grey, Beograd më, 2 tetor 1913,.

⁷ Paskal Milo, *Politika e Jashtme e Shqipërisë (1912 - 1939)*, Tiranë: Botimet "Toena", 2013, f. 76.

kryengritësve si nxitës, frymëzues dhe mbështetës të tyre. Sipas profesor Paskal Milos, në rrethanat e krijuara I. Qemali mbajti të vetmin qëndrim që mund të gjykohej i matur.

Qeveria nuk u angazhua hapur në përkrahjen e kryengritjes, nuk i dërgoi armë dhe bëri thirrje për një rregullim paqësor të konfliktit, tërheqjen e forcave serbe dhe shmangien e përplasjeve nga ana e shqiptarëve⁸. Kryengritja e Dibrës nuk vazhdoi gjatë. Ajo u shtyp nga kundërveprimi i trupave serbe. Sipas studiuesit bullgar George Georgiev, arsytet e dështimit duhet të kërkojnë në mungesën e planeve dhe veprimeve të përbashkëta dhe të harmonizuara; mungesën e bashkëpunimit ndërmjet njësive, mungesën e artilerisë dhe të një komandanti të njohur dhe të mbështetur nga të gjithë, mungesa e përkrahjes së premtuar nga Esat Pashë Toptani dhe mobilizimi i shpejtë i trupave serbe⁹. Mungesa e ndihmës financiare dhe e mbështetjes ndërkombëtare ishte gjithashtu një problem.

Në morinë e arsyeve të lartpërmendura, do të veçonim mungesën e organizimit dhe drejtimit të kryengritjes. Kjo arsye mund të ketë shërbyer si shkas për veprimtarët nacionalistë shqiptarë për të themeluar një komitet apo shoqëri, që do të bashkërendonte aksionet e tyre në të ardhmen. Pikërisht këtu nis e merr jetë edhe “Shkipnia”, krijimi i së cilës relatohet nga zëvendës konsulli britanik në Manastir, në raportin e datës 14 tetor 1913, mbi trazirat në kufirin serbo - shqiptar¹⁰. Ky informacion përforcohet në janar e shkurt të vitit 1914, në dy raporte vijuese, ku diplomati i lartë jep statutin e

⁸Po aty.

⁹ Gabor Demeter, Csaplar-Degovics Kristzian, “*Marrëdhëniet shqiptaro-bullgare gjatë Luftërave Ballkanike dhe kryengritja shqiptaro-maqedonase (Lufta e Tretë Ballkanike)*”, në: 100 vjet Pavarësi. Aktet e Konferencës Shkencore Ndërkombëtare, Tiranë: Botimet Albanologjike, 2014, f. 271.

¹⁰ *Dokumente britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët (tetor-dhjetor 1913)*..., f. 242-243, Raport i zëvendës konsullit britanik në Manastir, Greig për z. Crakanthorpe në Beograd, Manastir, 14 tetor 1913.

shoqërisë, disa prej anëtarët, shtrirjen dhe disa aspekte të veprimtarisë së saj¹¹.

Duke u mbështetur në këto relacione, “Shkipnia” u themelua në vjeshtën e 1913, në kuadrin e reagimit të shqiptarëve ndaj sundimit serb e malazez. Modeli i krijimit të shoqërive apo komiteteve të fshehta, që funksiononin si grupime revolucionare e politike, ishte i njohur në Ballkanin e kohës. Të tillë kishin vepruar e vepronin edhe në territoret e njohura, si: në Maqedoni, në Bullgari apo Perandorinë Osmane. Qëllimi final i tyre ishte rimarrja e territoreve të konsideruara si të humbura. E në këtë aspekt “Shkipnia” nuk bënte përjashtim. Ajo ishte një shoqëri e fshehtë revolucionare, e përkushtuar për të arritur qëllimin e shprehur në statutin e saj: vendosjen e lidhjeve të forta mes shqiptarëve dhe promovimin e bashkimit dhe të progresit të tyre, kundrejt çdo mjeti¹².

Shoqëria do të funksiononte si një qendër, e cila do të luftonte të gjithë kundërshtarët e interesave të shqiptarëve dhe do të mbronte të gjithë ata që punonin për mëmëdhenë, pra Shqipërinë. Flamuri i kuq me shkabën dykrenore, që simbolizonte idealin e shqiptarëve, konsiderohej “i shenjtë” në nenin 6 të statutit, sipas të cilit, të gjithë ata që ishin armiqësorë ndaj tij dënoheshin “me zjarr dhe gjak”.

“Shkipnia” drejtohej nga presidenti, i cili ruante anonimatin. Organi më i lartë drejtues ishte komitetit qendror. Në janar të 1914, ajo ia kishte dalë të krijonte degë në Vlorë, Shkodër, Mat, Durrës, Elbasan dhe në disa zona shqiptare në Serbi e Mal të Zi, që në

¹¹ *Dokumente britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët (janar - dhjetor 1914)*, përgatiti për botim Valentina Duka, Tiranë: Botimet “Toena”, 2012, f. 182-183, Raport i zëvendës konsullit britanik në Manastir, Greig për Crakanthorpe në Beograd, Manastir, 29 janar 1914; f. 200 - 201, Raport i zëvendës konsullit britanik në Manastir, Greig për Crakanthorpe në Beograd, Manastir, 12 shkurt 1914.

¹² *Dokumente britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët (janar-dhjetor 1914)*..., f. 183, Raport i zëvendës konsullit britanik në Manastir, Greig për Crakanthorpe në Beograd, Manastir, 29 janar 1914.

dokumentacionin e kohës nuk specifikohen. Përpyekja për të vendosur një degë në Manastir duket se kishte dështuar. Çdo degë kishte si trup qeverisës këshillin, detyra e të cilit ishte të zbatonte udhëzimet e komitetit qendror. Në nenin 9 të statutit, specifikoj se anëtarët duhej të mbeteshin të fshehtë, sipas betimit që i kishin bërë presidentit, derisa “me ndihmën e Zotit, bashkimi dhe qëllimi i shqiptarëve të realizohej”¹³. Duket se sekreti nuk ishte ruajtur, përderisa diplomati britanik ia kishte dalë të mësonte disa nga emrat. Lista nis me Isa Boletinit, nga Mitrovica, për të vijuar me Hasan Prishtinën, Mahmut Gjurën nga Peja, Bajram Currin dhe Riza Beun nga Gjakova, Mersin Demën dhe Ali Pustinën nga Dibra¹⁴. Pjesë thelbësore e anëtarësisë së shoqërisë ishin shqiptarët e Kosovës, të larguar në kohën e Luftës së Parë Ballkanike dhe refugjatët nga Dibra, shtëpitë e të cilëve ishin plaçkitur dhe shkatërruan nga serbët në vjeshtën e 1913.

Kryeqendra e shoqërisë, sipas nenit 10 të Statutit, do të mbahej sekret, por ajo do të ishte përherë në Shqipëri. Për zëvendës konsullin britanik, nuk kishte dyshim se këtë funksion e luante Shkodra, e cila cilësohej si qendër tepër e rëndësishme e veprimtarisë së “Shkipnisë”. Nuk mendojmë se ky përcaktim lidhet vetëm me faktin se qyteti ishte pjesë e njësisë territoriale të shtetit shqiptar. Zgjedhja ka sens historik e logjik. Shkodra kishte një pozicion të rëndësishëm gjeografik, shumë afër Malit të Zi dhe Serbisë, prej nga ku mund të drejtohej veprimtaria politike, organizative dhe e armatosur. Njëkohësisht ajo mbante lidhje edhe me Mirditën e

¹³ Po aty.

¹⁴ *Dokumente britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët (tetor-dhjetor 1913)*..., f. 242, Raport i zëvendës konsullit britanik në Manastir, Greig për Crakanthorpe në Beograd, Manastir, 14 tetor 1913; *Dokumente britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët (janar-dhjetor 1914)*..., f. 182, Raport i zëvendës konsullit britanik në Manastir, Greig për Crakanthorpe në Beograd, Manastir, 29 janar 1914.

Malësinë dhe, ishte qendra natyrore dhe tregtare e Shqipërisë së Veriut. Si një pikë e gjallë tregtare, qyteti verior ishte vend grumbullimi i të gjithë tregtarëve nga Maqedonia Perëndimore¹⁵. Gjithë pellgu i Drinit të Zi më shumë ishte i lidhur me Shkodrën sesa me ndonjë qytet në Maqedoni. Duke qenë se administrohej nga ndërkombëtarët, fillimisht nga Këshilli i Admiralëve e më pas nga Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit, Shkodra konsiderohej qytet i qetë dhe i sigurt. Si i tillë ai shërbente si vend grumbullimi i veprimtarëve shqiptarë e bullgarë, kundërshtarë të serbëve e malazezëve. Po ashtu, deri në prill 1914, aty nuk kishte konsullatë serbe¹⁶, çka e mbante atë larg syrit të drejtpërdrejtë vëzhgues të Beogradit zyrtar.

Veprimtaria e shoqërisë “Shkipnia” nuk është pasqyruar dukshëm në dokumentacionin e kohës, të konsultuar deri më tani. Këtu mund të ketë ndikuar karakteri i fshehtë që ajo kishte. Megjithatë nisur nga informacionet e diplomatit të lartë britanik, të lartpërmendura dhe anëtarët të njohur të saj, nuk është e vështirë të kuptosh lidhjet dhe bashkëpunimin që “Shkipnia” kishte me bullgarët dhe komitetin maqedonas. Në raportin e 12 shkurtit 1912, diplomatit Creig nga Manastiri, bën me dije se prania e drejtuesve bullgarë, Pavel Hristov, Liapçev e Tatarçev në Shqipëri, “jetët e të cilëve i janë përkushtuar zbatimit të interesave bullgare në Maqedoni si edhe ekzistenca e shoqërisë “Shkipnia”, e cila synon rimarrjen e

¹⁵ Arkivi i Institutit të Historisë, A.IV.449. Dokumentet serbe. Libri VII, (14 janar 1914 - 13 maj 1914), Ambasada e Serbisë në Mal të Zi për Ministrinë e Punëve të Jashtme në Beograd, Cetinë, 24 prill 1914.

¹⁶ Po aty.

Shqipërisë serbe, janë një burim i vazhdueshëm shqetësimi për autoritetet serbe”¹⁷.

Në tërësinë e veprimtarisë së shoqërisë “Shkipnia”, vend të rëndësishëm zë ajo e Isa Boletinit, i cili në raportin e Shtabit të Përgjithshëm Serb, përshkruhet në këtë mënyrë: “Është trim. Figura e tij lë përshtypje të thellë tek udhëheqësit shqiptarë. Është shumë i gjatë, ka kokë të vogël, duar dhe këmbë të gjata. Kur ulet mblidhet i tëri dhe i ngjan bishës së egër, e cila bëhet gati për t’u hedhur në gjahun e vet...Të befason me çiltërsinë e tij. Në prill të këtij viti (1913) kur ishte në Paris dhe, në maj (kur qëndroi në Londër), çdo njërin që takonte e pyeste se a ishte për Shqipërinë apo kundër saj. Pastaj menjëherë fillonte ankesat për padrejtësitë që i bëheshin shqiptarëve dhe kanosej, se për gjithçka ai do të hakmerrej. Por, pas kësaj rreptësie qëndron një mençuri e fshehur. Boletini më shumë se udhëheqësit e tjerë, krijon plane dhe merr vendime...”¹⁸. Po cila ishte veprimtaria e kësaj shoqërie përtej pranverës së vitit 1914? Sa jetëgjatë ishte “Shkipnia”? Cilët ishin aleatët e saj? Me informacionin që zotërojmë deri më sot, përgjigjet e këtyre pyetjeve i kemi të vështirë t’i japim. Por, nisur nga qëllimi i krijimit, përmbajtja e statutit dhe veprimtaria e njohur tashmë, shoqëria “Shkipnia” mund të konsiderohet si pararendëse e “Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”, krijuar në rrjedhat e Luftës së Parë Botërore.

¹⁷ *Dokumente britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët (janar-dhjetor 1914)...*, f. 200 - 201, Raport i zëvendës konsullit britanik në Manastir, Greig për Crakanthorpe në Beograd, Manastir, 12 shkurt 1914.

¹⁸ Muzafer Bislimi, *“Kryengritja e Dibrës e vitit 1913 në bazë të dokumenteve të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Serbe”*, në: 100 vjet Pavarësi..., f. 283 - 284.

Dr. Ledia DUSHKU

SUMMARY

THE SOCIETY “SHKIPNIA” AND ISA BOLETINI

The year 1913 was not easy for Albanians in Kosova. The hope and optimism that came with the Declaration of Independence of Albania in Vlora on the 28th of November 1912 soon faded away. The decision taken by the Ambassadors Conference in London on the 22nd March 1913 regarding the northern border of the Albanian country, detached Kosova from Albania and it gave away the territory to a new conqueror, the Serbs. Displeased by this decision, the Albanians from Kosova reacted. In the midst of groups through which the Albanians of Kosova reacted was also the society “Shkipnia”, the formation of which is known to us through the reports of the British Vice Consul in Manastir, specifically through the report dating from 14th October 1913. More information is given in other reports dating from January and February of 1914, where the diplomat concedes to it the status of a society, informs us regarding some of its members, gives information regarding the region in which it had influence and some views on its activity. “Shkipnia” was a secret revolutionary society, dedicated to achieve its goals as declared in its statute: the establishment of strong relations between Albanians, promoting their unification and progress. According to the documents pertaining to the period that have been researched, the activity of the society “Shkipnia” was not completely portrayed. This

must have been due to its secret nature. However, stemming from the information given by the British diplomat, as mentioned above, as well by knowing the name of its members, it is not difficult to understand the connections and cooperation between “Shkipnia” and Bulgarians as well as the Macedonian Committee.

In the entirety of activity of “Shkipnia” society, an important role is played by Isa Boletini. But what was the activity of this society after the spring of 1914? How long did “Shkipnia” operate? Who were its allies? With the information we possess today, it is difficult to answer these questions. However, knowing the reason of its formation, the entailment of its statute and its activity, the society “Shkipnia” could be considered as a predecessor of the “Committee National Defense of Kosova” created during the First World War.

MA. Sokol GJERMËNI
(Tiranë)

ISA BOLETINI DHE KRYENGRITJA E VITIT 1911

Mënyra sesi Perandoria Osmane e trajtoi Kryengritjen e shqiptarëve gjatë vitit 1910 në Vilajetin e Kosovës, krijoi një gjendje tepër të vështirë dhe të papërballueshme jo vetëm nga ana fizike, por edhe nga ana psikologjike. Ngado shihej tym e flakë. Kudo kishte djegie, plaçkitje, vrasje, varje, rrahje dhe mizori që populli në ato vise (Vilajetin e Kosovës) nuk i pati provuar kurrë ndonjëherë më parë në atë shkallë¹. Të njëjtin perceptim dëshmon në faqet e ditarit të tij personal dhe konsulli serb Jovan Jovanović në Shkup². Kjo ishte pamja që shfaqej në Vilajetin e Kosovës gjatë dhe në përfundim

¹ Skënder Luarasi, *Isa Boletini (jetëshkrim i shkurtër)*, Tiranë: “Naim Frashëri”, 1971, f. 117.

² Ushtria rrafshoi 2 fshatra Zborc dhe Kraishtë?. Në Kaçanik ushtria i dogji shtëpitë. Nga ana e Moravës ushtria dogji fshatrat Sadovinën dhe Vërbën. U shkatërruan dhe u dogjën katër fshatra Binça, Stagova, Pozharani dhe Kabashi, Runjeva. Fshatrat Gushicë, Ramjan, dhe Ninkovc janë bërë pluhur. Jezerca është bombarduar dhe rrënuar. Belinca dhe Budakova janë në flakë. Zekeria Cana, *Lëvizja Kombëtare Shqiptare në Kosovë 1908 - 1912*, Tiranë: “Mihal Duri”, 1982, f. 270 - 289.

të Kryengritjes së vitit 1910. Pavarësisht gjendjes së krijuar nga kushtet e vështirësive të përditshme, nga mungesa e burimeve të domosdoshme, nga pamjaftueshmëria e municioneve dhe armëve, nga mungesa e kapaciteteve luftarake dhe ajo e sigurisë së jetës, Isa u mundua të strehohej në vende të ndryshme dhe të mos e linte veten në duart e rastësisë. Por, kjo situatë nuk mund të ishte më aleate me të. Sipas një raporti të drejtorit të policisë së Trieshtit, arriti një moment që me gjithë rezistencën e vazhdueshme s'mund t'i bëhej më dot ballë trupave osmane në Kosovë³. Për afro një muaj, ai qëndroi në bjeshkë i bllokuar nga forcat osmane në afërsi të kufirit me Malin e Zi. Në stanet e Isniqit u mblodh paria e kryengritësve. Pasi biseduan ata kuptuan se veç mungesës së bukës, nuk ekzistonin më mundësitë, prandaj dhe e prenë shpresën për qëndresë. U vendos që të kërkohej strehim në Mal të Zi⁴.

Në këto kushte Isa Boletini u përpoq të hynte në lidhje me qeverinë malazeze, së cilës i kërkoj strehim në emër të të gjithë krerëve të kryengritjes së Kosovës⁵. Qeveria malazeze e pranoi kërkesën e tij dhe të krerëve të tjerë kryengritës. Më 13 qershor 1910, Isa së bashku me djemtë e tij dhe 13 shokë kaloi në Velikë, e prej andej autoritetet kufitare malazeze e çuan atë në Andrijevicë ku qëndroi për afro 10 ditë. Meqenëse Andrijevicë ishte në afërsi të kufirit me tokat shqiptare, ministri i Brendshëm malazez urdhëroi që

³ Haus und HofStaatsArchiv, Wien, PolitischesArchiv, Albanien (më tej: HHSt.A.PA.A), në Arkivin e Institutit të Historisë (më tej: AIH), Tiranë, Vj. 21-9-941, Raport i drejtorit të Policisë në Trieshtë për Presidiumin e mëkëmbësisë, Trieshtë, 20 shkurt 1911.

⁴ S. Luarasi, *Isa* ..., f. 119 - 120.

⁵ Fatmira Musaj, *Isa Boletini (1864 - 1916)*, Tiranë: "Shtypshkronja e re", 1987, f. 92.

Isa Boletini të dërgohej në brendësi të vendit, në Nikshiq⁶. Kjo ngjarje tërhoqi dhe vëmendjen e shtypit malazez. Gazeta “Glas Crnogroca” e datës 12/25 qershor 1910, theksonte se Isa Boletini i përndjekur ditë e natë nga ushtria e policia osmane kaloi në sektorin kufitar të Velikës⁷. Qeveria malazeze i dha azil me qejf të madh Boletinit, sepse me këtë veprim shpresonte që t’i bënte për vete shqiptarët, duke shfrytëzuar situatën e krijuar dhe nevojat më të domosdoshme të tyre. Pas Isait erdhën turma të tjera emigrantësh⁸. Largimi i tij nga Kosova nuk kishte qenë i lehtë. Ai ikte i dëshpëruar psikologjikisht dhe emocionalisht. Ai linte prapa kullën të rrëzuar për të dytën herë brenda 2 vjetëve, dhe gratë e fëmijët e familjes të shpërndarë nëpër fisin e tij në Pejë, e Shalë⁹.

Kalimi për në Mal të Zi në masë i shqiptarëve ndodhi për shumë arsye, duke filluar që nga trajtimi i dhunshëm ndaj tyre, reprezaljet e gjithfarshme, pamundësia për të jetuar në kushtet kur nuk kishin asgjë me se të jetonin, dhe ku shpëtimi i jetës së grave, fëmijëve dhe i të moshuarve ishte largimi. Vendosja shpërndarja dhe qëndrimi i emigrantëve shqiptar në Mal të Zi, por sidomos ai i krerëve të tyre ishte gjithmonë nën vëzhgimin dhe kujdesin e autoriteteve malazeze. Madje Qeveria malazeze bën çmos që të fitonte dhe të ruante simpatinë e këtyre personave, dhe i jepte secilit nga 2-3 korona, ndërsa bajraktarëve nga 5 korona në ditë¹⁰.

⁶ ZekeriaCana, *Politika e Serbisë kundrejt çështjes shqiptare 1908-1913*, Prishtinë: “KGT”, 2006, f. 81; F. Musaj, *Isa...*, f. 92.

⁷ Gjergj Nikprelaj, *Kryengritja e Malësisë së vitit 1911*, New York: “Gjonlekaj Publishing Co.”, 2004, f. 67.

⁸ HHSt.A.P.A.A, Vj. 21-9-941, Raport i drejtorit të Policisë në Trieshtë për Presidiumin e mëkëmbësisë, Trieshtë, 20 shkurt 1911.

⁹ S. Luarasi, *Isa...*, f. 120.

¹⁰ HHSt.A.P.A.A, Vj. 21-9-941, Raport i drejtorit të Policisë në Trieshtë për Presidiumin e mëkëmbësisë, Trieshtë, 20 shkurt 1911.

Udhëheqës të ndryshëm të Lëvizjes Kombëtare po projektonin idenë e organizimit të një kryengritjeje të re gjatë pranverës së vitit 1911. Në kushtet në të cilat ndodheshin shqiptarët e zonave veriperëndimore dhe verilindore kërkohej më shumë sesa një dëshirë dhe vullnet individësh për një nisëm të tillë. Duheshin siguruar aleatë dhe mbështetje. Isa iu bashkua kësaj ideje. Ai tok me Sokol Bacin dhe Mirash Lucën, ishin duke u përpjekur prej kohësh që ta kandisin Malin e Zi, të bashkohej në ndërmarrjen e një aksioni energjik (kupto: kryengritje e re) në Shqipëri. Mbret Nikolla nuk ishte kundër një aksioni të tillë, por ai do të ruajë idenë se kjo ndërmarrje nuk vjen nga Mali i Zi¹¹. Për shkak të një çarmatimi shumë të fortë nga forcat osmane, një nga elementet më bazike në rast të një organizimi tjetër kryengritës për shqiptarët armët dhe municionet ishin më të domosdoshmet për një realizimin e një iniciative të tillë. Edhe pse në mërgim Isa kishte arritur të krijonte kontakte dhe rrugë për të mundësuar pajisjen e bashkatdhetarëve të vetë me armë.

Aktiviteti dhe prurjet e herëpashershme që u siguronin atë çka u duhej shqiptarëve në Mal të Zi na bënë të mendojmë se ndërmjet këtij shteti dhe Isai mund të ketë pasur një marrëveshje për të mos e penguar furnizimin me armë të shqiptarëve. Shpjeguar kjo nga qëndrimi i gjatë i Isait në Cetinë përgjatë vitit 1910, nga propaganda e gjallë, të cilën mbret Nikolla po e zhvillonte tash prej shumë vitesh në malet e Mbishkodrës, si dhe nga dobia, që mund të kishte ky i fundit nga një kryengritje shqiptare e përgjithshme eventuale¹². Mesa duket transportimi dhe lëvizja e armëve i kishte

¹¹ Po aty.

¹² HHSt.A.PA.A, Vj. 21-14-1441, Informacion i konsullit austro-hungarez, Bornemisza në Manastir, për ambasadorin Pallavicini në Kostandinopojë, Manastir, 19 janar 1911.

bërë përshtypje dhe konsullit austro - hungarez në Manastir, Bornemisza-s. Në një informacion që ai i dërgon ambasadorit të tij, Pallavicinit, në Kostandinopojë, ai njofton se: “tani po e mësoj mënyrën me të cilën shumë prej këtyre armëve i sigurohen Shqipërisë. Isa Boletini po fut një sasi të madhe pushkësh me përsëritje dhe shumë municion në Malin e Zi, prej ku ato pastaj kalojnë në Shqipëri nëpër kufirin e thatë. Të gjitha këto pa pëlqimin e autoriteteve malazeze janë të pamundshme”¹³.

Për të arritur qëllimet e veta Mali i Zi u mundua që të shfrytëzonte personalitetin dhe autoritetin e krerëve të shqiptarëve, të cilët po qëndronin si emigrantë në këtë vend. Jo vetëm për t'i pasur si aleatë, por që nëpërmjet tyre të ndikonin te ndjekësit dhe te masa e emigrantëve të tjerë. Vëmendja e Cetinës ndaj Isait ishte vërtetë e prekshme dhe e veçantë. Autoritetet e këtij vendi u përpoqën që t'i plotësonin atij çdo nevojë. Madje dy ministri të këtij shteti ajo e Brendshme edhe ajo e Punëve të Jashtme iu dhanë porosi prefekturave që jo vetëm të tregonin kujdes për I. Boletinin dhe emigrantët, por edhe të siguronin jetët e tyre. Kjo politikë nuk ishte e rastësishme. Ajo ishte rrjedhojë e peshës dhe e fuqisë që figura e Isa Boletinit kishte në mesin e shqiptarëve.

Sipas konsullit serb në Prishtinë, ndikimi i tij në radhët e emigrantëve ishte aq i madh saqë ata dëgjonin dhe i bindeshin çdo këshillë të tij¹⁴. Përpos angazhimit dhe punës që bënte me emigrantët në Malin e Zi, Isa përpiquej të ndiqte me vëmendje dhe përgatitjet që po bëheshin brenda vendit për kryengritjen e re. Ai mbante lidhje të vazhdueshme me krerët shqiptarë që vepronin në Kosovë, me të cilët këshillohej për zgjerimin e propagandës kundër regjimit xhonturk¹⁵.

¹³ Po aty.

¹⁴ F. Musaj, *Isa...*, f. 99 - 100.

¹⁵ Po aty, f. 95.

Pavarësisht se Perandoria Osmane ishte shkaktarja kryesore e gjendjes, së krijuar, ajo ishte mjaft e interesuar dhe e kujdesshme rreth mënyrës, mjeteve metodave dhe politikës sesi duheshin trajtuar shqiptarët dhe krerët e tyre azilantë. Nëpërmjet rrjetit të saj të informimit dhe agjentëve të terrenit, ajo kishte rënë në gjurmët e veprimtarisë së komiteteve të fshehta brenda dhe jashtë vendit.

E shqetësuar nga ideja e një përplasje të re me shqiptarët dhe e krijimit të ndonjë fronti antiosman, Porta e Lartë filloi politikën e miklimit, e cila kishte rezultuar e suksesshme edhe më parë me shqiptarët. Me qëllimin që t'i paqësonte shqiptarët me veten, dhe të pengonte shpërthimin rishtazi të një kryengritjeje në shkurt 1911, ajo shpalli amnistinë dhe e njoftoi Qeverinë e Malit të Zi se të gjithë shqiptarët që ishin arratisur mund të ktheheshin lirisht në vendin e tyre mbasi ishin falur nga sulltani. Ndërsa, Isa Boletini, Sulejman Batusha, Bajram Daklani, etj., edhe pse ishin dënuar me vdekje, në rast se dorëzoheshin do t'ju falej jeta, veçse do të internoheshin në Azinë e Vogël. Isai dhe krerët e tjerë nuk e pranuan amnistinë e ofruar nga Qeveria turke dhe nuk lejuan kthimin e malësorëve në Shqipëri. Madje pranimin e “faljes” nga ana e sulltanit të cilitdo malësor, ai e cilësonte si tradhti dhe sabotim të kryengritjes¹⁶.

Në histori shpeshherë kombinimi i koniunkturave, i shkakësive dhe i të papriturave ndryshojnë në mënyrë dhe shkallë të ndryshme kahjen e lëvizjeve dhe reagimet e udhëheqësve të tyre. Nga shqyrtimi i dokumentacionit arkivor dhe i burimeve të tjera historiografike të kohës është pohuar se një ndër shkaqet kryesore që çuan në shpërthimin e parakohshëm të kryengritjes së Malësisë së Mbishkodrës në 1911 ishte orvatja, ndërhyrja, presioni dhe qëndrimi trysnues i Malit të Zi, duke mos i lënë asnjë rrugëzgjidhje tjetër

¹⁶ F. Musaj, *Isa..*, f. 98.

krerëve të shqiptarëve. Çfarë qëndrimi mbajtën udhëheqësit e Vilajetit të Kosovës? Dhe si shpjegohet fakti i mungesës së Isa Boletinit krah krerëve të tjerë, ndërkohë që ai kishte qenë pjesë aktive e masave për organizimin e kryengritjes së re më 1911? Mbret Nikolla i propozoi Isait, që ai në kryengritjen e afërme që do të organizohej të mobilizonte dhe të merrte pjesë duke prirë emigrantët e Plavës, Gucisë dhe Gashit.

Ai i arsyetonte Isanë se këto qytete mund të merreshin lehtësisht pasi trupat osmane ishin të pakta. Isa i ndërgjegjshëm për gjendjen faktike të Kosovës, për mundësitë reale që kishte dhe për situatën në të cilën ndodhej popullsia dhe vendi e refuzoi idenë e mbretit malazez pavarësisht ndihmës me armë dhe ushtri që ky i fundit i ofroi Isait¹⁷. Shenjat dëshmonin se shqiptarët e Vilajetit të Kosovës, jo vetëm që nuk ishin përfshirë në kryengritje, por madje nuk dukej se mund të ndërmerrnin ndonjë hap konkret në këtë drejtim. Insistimit të mbretit malazez për të marrë pjesë në kryengritje Isa iu përgjigj: “sikurse e dini vitin e kaluar Kosova u çarmatos, është e lodhur dhe hëpërhë nuk është në gjendje të luftojë”. Përkundër këtij shpjegimi, Nikolla i përgjigjet: “Kjo çështje rregullohet lehtë. Ju vetëm i shtini një herë në dorë, pastaj unë dërgoj ushtrinë time, ju vjen ajo pas në Prizren dhe i mban ato vende”. Isa ia kthen: “Gospodar, vendet tona t’i mbaj ushtria juaj”? Nikolla i përgjigjet: “Po unë i dua shqiptarët, i kam miq”. Isa ngrihet në këmbë ballë për ballë krajlit dhe i thotë: “Gospodar më falni për mërzinë që ju kam bërë. Ju faleminderit që na keni mbajtur në vatrën tuaj me zemër për këta 6-7 muaj. Nesër herët unë e të mitë po kthehem në vatrën tona. Lamtumirë”¹⁸.

¹⁷ Po aty, f. 99-100.

¹⁸ S. Luarasi, *Isa..*, f. 122.

Lëvizja Kombëtare Shqiptare akoma nuk ishte kristalizuar si e njëkohshme dhe njëtrajtshme në qëllimet dhe objektivat e saj. Aksioni dhe nismat e udhëheqësve shqiptarë vuanin ende nga mungesa e koordinimit dhe nga mospërputhjet e qëllimeve individuale. Shqiptarëve u mungonte një qendër drejtuese, e cila do të sendërtonte një politikë dhe qëndrim të njëjtësuar si ndaj Malit të Zi, si ndaj Portës së Lartë ashtu dhe ndaj vet synimeve dhe njerëzve që drejtonin. I zhgënjyer nga vendimi i Isait dhe nga pamundësia që ta bënte për vete, mbreti malazez kërkoi largimin sa më të shpejtë të tij së bashku me emigrantët e Vilajetit të Kosovës¹⁹. Prania e tij në Malin e Zi nuk përligjej më dhe s'ishte dobiprurëse për interesat e këtij shteti. Çfarë kuptimi kishte t'i ofrohej sërish Isait, strehim, ushqim, ndihma, armë dhe të holla? Për më tepër ai mund të kthehej në një pengesë apo dhe në një kundërshtar që do i kundërvihej ambicieve të Nikollës. Për riatdhesimin sa më të shpejtë mbreti ndërhyri pranë konsullit osman në Cetinë²⁰.

Përballë një situatë, ku imponimi po kalonte çdo kufi fqinjësie, bashkëpunimi, mirëkuptimi dhe reciprociteti, kundrejt mungesës së përkrahjes e pamundësisë ekonomike, përballë përzënies nga Mali i Zi, por edhe për shkak të pakënaqësisë dhe mosmarrëveshjeve me krerët e Malësisë së Mbishkodrës, Isa Boletini në fund të muajit marsit 1911 vendos të largohet në Kosovë dhe hyn në krahinën e Gucisë²¹. Megjithëse u largua për në Kosovë, ai u tërhiqte vëmendjen shqiptarëve të Toskërisë, të cilët nuk po tregoheshin aktivë dhe pjesëmarrës në aksionet antiosmane. Në një letër që iu dërgon këtyre të fundit ai iu kërkon që të marrin masa për të organizuar popullin dhe të bëhen gati për mundësinë që po iu

¹⁹ F. Musaj, *Isa...*, f. 101.

²⁰ Po aty.

²¹ Po aty, f. 104.

krijohet shqiptarëve nga situata e tanishme. Ky është teksti i letrës së Isa Boletinit:

“Miq të dashur!

Këtu ne kemi marrë të gjitha masat e nevojshme dhe nuk kemi frikë qoftë sikur qeveria të dërgojë krejt ushtrinë e saj. Ne jemi të përgatitur mirë dhe shpejt do të kemi një ndihmë më të mirë. Ç’po bëni Ju? Ju duhet të nisni sa më parë njerëzit dhe të përgatitet populli në Toskëri, mbasi deri tani ne akoma nuk kemi parë shumë nga këto. Ju nuk duhet të flini, ne nuk duhet ta humbasim çastin e favorshëm, që ne kemi sot”²².

Mospjesëmarrja e drejtpërdrejt dhe mungesa e kontributit të Isait dhe e udhëheqësve të tjerë të Kosovës në Kryengritjen e Malësisë më 1911, veç shkaqeve të lartpërmendura mendojmë se shpjegohet dhe me disa arsye të tjera. Pas kthimit nga Mali i Zi, Isa Boletini në një deklaratë që i drejton kajmekamit të Kumanovës zbulon zhgënjimin dhe ashpërimin që ai ka përjetuar së brendshmi. Përmbajtja e deklaratës që ai bëri në zyrën e zyrtarit osman është kjo:

“Unë betohem në besën time se nuk kam marrë pjesë as në agresionin e malësorëve katolikë kundër ushtarëve as në propagandën e të arratisurve. Unë vërtetoj se revolta e katolikëve ndodhi vetëm nga intrigat e agjentëve malazez. Me sytë e mi kam parë, se si oficerë malazezë u vunë në krye të kryengritësve dhe si këta pastaj, duke marrë përforcime malazeze, hynë në vend e mësyrë fortifikatat. Kur unë pashë gjithë këto, u ktheva, i penduar, i frymëzuar nga dëshira, të vija në dispozicion të sulltanit e të kalifit, veten time, shokët e mijëra shqiptarë, të cilët që të gjithë janë gati të

²² HHSt.A.PA.A. AIH, Vj. 21-14-1444, Informacion i zëvendës konsullit Zitkowski, në Manastir, për Ladislaus Freiherr Müller von Szentgyörgy, Rudnay, shef i seksionit të parë në Ministrinë e Jashtme Perandorake Manastir, 28 prill 1911.

ngarendin mbas një shenje time, për mbrojtjen e atdheut kundër të pabesëve”²³.

Një arsye tjetër ka të bëjë me zbatimin e politikës së kulaçit nga ana e Perandorisë Osmane, e cila shpeshherë i joshte shqiptarët me anë të dhuratave, parave, posteve dhe mundësive të tjera duke arritur të realizonte përçarjen në mesin e tyre dhe dështimin e kauzave të tyre. Qëllimi i saj ishte të dobësonte forcën ose të neutralizonte veprimet e shqiptarëve të Vilajetit të Kosovës nëpërmjet propagandës, duke e paraqitur veten e saj para tyre si një aleate dhe mbrojtëse, kurse Malin e Zi e portretizonte si një armik të përbashkët. Gjithashtu ajo u mundua që të përfshinte përfaqësues të udhëheqjes së Kosovës në radhët e hierarkisë ushtarake osmane. Për këtë qëllim Zejnel Beu dhe Jashar Pasha u emëruan komandantë të njësive të mustafizëve që do të formoheshin në rast nevojë²⁴.

Gjithashtu, mendojmë se një arsye tjetër gjendet në vet psikologjinë dhe të menduarit që ka të bëjë me atë se çfarë dhe si mendonte vet paria e shqiptarëve të Kosovës. Në ç’mënyrë e projektonte ajo veten gjatë kësaj kohe në raport me lëvizjen, kërkesat kombëtare që kishin filluar të artikuloreshin publikisht dhe politikisht. Kjo gjë na shpjegohet nga një bisedë e zhvilluar ndërmjet Xhafer Tajarit, prefekt e komandant i garnizonit në Pejë dhe Tafilit, nipit të Isa Boletinit, për shkak të mungesë së këtij të fundit në takim. Ndër të tjera Xh. Tajari i tha Tafilit se: “Edhe unë shqiptar jam, s’e mohoj, por s’kemi arritur në atë shkallë sa të jemi më vite. Është

²³ HHSt.A.PA.A. AIH, Vj. 21-14-1484, Relacion i zëvendës konsullit austro-hungarez Gregoviç, në Selanik, për, La dislaus Freiherr Müller von Szentgyörgy, Selanik, 8 prill 1911.

²⁴ HHSt.A.PA.A. AIH, Vj. 21-19-1992, Njoftim i gjerentit austro-hungarez Rudnay, në Prizren, për, Ladislaus Freiherr Müller von Szentgyörgy, Prizren, 3 maj 1911.

tepër herët, populli ynë është shumë mbrapa”²⁵. Nuk duhet të harrojmë se shqiptarët e Kosovës sapo kishin dalë nga një kryengritje e lodhur dhe e sflitur. Koha ishte e pamjaftueshme dhe populli nuk ishte i përgatitur për një kryengritje të re, ai nuk e kishte marrë ende veten dhe nuk kishte armë dhe municion. Për më tepër mbizotëronte një skamje e madhe, të cilën Isa e kishte vërejtur²⁶. Protagonizmi dhe personaliteti i Isa Boletinin para dhe gjatë kryengritjes kundër osmane të vitit 1911, u përballën dhe u sfiduan nga një sërë faktorësh të brendshëm dhe të jashtëm. Për sa i takon atyre të brendshëm mund të përmendim, gjendjen e paorganizuar të grupimeve të ndryshme politike-shoqërore në vend, kushtet e vështira sociale, ekonomike dhe njerëzore, të cilat ishin krijuar për shkak të politikës osmane pas masave vijuese dhe të reja si edhe kushtet e rënduara nga përplasjet e armatosura me trupat osmane gjatë viteve 1909-1910.

Ndër faktorët e jashtëm mund të përmendim ndërhyrjet dhe aksionet e ndryshme ushtarake dhe diplomatike të ndërmarra nga Mali i Zi dhe ambiciet e qëllimet e fuqive të tjera ballkanike si ndaj shqiptarëve ashtu dhe ndaj shtetit osman. Ndryshimi i qasjes nga ana e Portës së Lartë ndaj krerëve shqiptarë, ishte në përshtatje me kontekstin dhe fuqinë që ata paraqisnin në rrafsh lokal apo më gjerë, parësinë e interesave dhe vet pozitën e brendshme dhe ndërkombëtare të Perandorisë Osmane. Pleksja e këtyre faktorëve e bën dhe më të komplikuar qëndrimin dhe rrugëtimin e Isa Boletinit dhe të krerëve shqiptarë të Vilajetit të Kosovës si në drejtim, si në pjesëmarrje, si në organizim, ashtu dhe në qëndrim kundrejt situatave të ndryshme që u krijuan nga dinamika e Kryengritjes së vitit 1911. Pozita e tij ndryshoi duke kaluar nga një pjesëmarrje direkte dhe aktive në një gjendje të tërhequr dhe pasive, nga një prijës luftimi në

²⁵ S. Luarasi, *Isa...*, 1971, f. 126.

²⁶ Z. Cana, *Lëvizja Kombëtare...*, f. 295.

terren në një organizator çetash. Në jetën e popujve trashëgimia e heronjve ndër të tjera është kujtimi i një emri të madh dhe trashëgimia e një shembulli madhështor. Isa Boletini na i ka dhuruar të dyja këto cilësi, jo thjeshtë si relikte të kujtesës sonë historike, por si vlera ku mund të gjejmë frymëzim dhe komunikim që të përballim veten me zgjedhjet që duhet të bëjmë si individ dhe si komb, për të sotmen dhe për të ardhmen.

MA. Sokol GJERMËNI

SUMMARY

ISA BOLETINI AND THE UPRISING OF 1911

The National Albanian Movement during 1911 had a different approach in regards to the armed retaliation against the occupying forces. The representators of this movement who overviewed the development of the uprising in 1911, served as a means to have a different approach in regards to the Ottoman Empire, particularly having in mind the political, social and national future. The circumstances present at the time made it able for this uprising to take place. The anti-Ottoman uprising of 1911 included one of the most important personalities of the Vilayet of Kosova and the Albanian movement. His protagonism in the uprising was challenged by many inner and outter factors, before and after the uprising of the Highlands of Shkodra in 1911.

As far as the inner factors are concerned, we should take into account the lack of organization between various political and social groups in the country at the time, the social and economical hardships, which were created as a result of the Ottoman policies throughout the years 1909-1910. The foreign Montenegrin military and diplomatic interventions can be considered as outer factors that made the progression of the uprising difficult. The convergence of these factors made the travels of Isa Boletini and other Albanian

leaders, both in leadership and organization of the uprising, much more difficult throughout 1911.

Prof. dr. Nebi DERVISHI
(Tiranë)

**VEPRIMTARIA ATDHETARE E ISA BOLETINIT NË VITET
1912-1913**

Përvoja jetësore, varësisht nga dimensionimi dhe thellësia e përjetimit, nga mosha dhe kohëzgjatja e përjetimit, mund të shërbejë si faktor relevant për të krijuar një pasqyrë sado besnike për ngjarje dhe personalitete të një periudhe të cilat mund t'u hyjnë në punë studiuesve që merren me lëvizjet historike të një faze të caktuar, për të nxjerrë prej saj premisa e veçori plotësuese¹, apo për t'i pasuruar ato me të dhëna më reale e më objektive.

Një ndër personalitetet më të shquara të popullit shqiptar në çerekun e fundit të shek. XIX dhe të një dekade e gjysmë të shekullit XX është kreshniku i maleve të Kosovës - Isa Boletini². Ai u lind, u rrit dhe u kalit në një nga periudhat më të rëndësishme të historisë sonë kombëtare, ku shihej në horizont se po vendosej edhe fati i

¹ Mahmud Hysa, *"Njeriu që përjetoi ferrin dhe iu kthye përsëri jetës"*, Gazeta "Fakti", 17. 03. 2005 f. 5.

² Xheladin Shala, *Veprimtaria kombëtare e Isa Boletinit në vitet 1917-1916*, Prishtinë, 2008, f. 106; *Isa Boletini dhe koha e tij*, Instituti i Historisë - Prishtinë.

popullit tonë. Që në fillim të rinisë u brumos me idealet e lirisë dhe të pavarësisë kombëtare, duke mos pushuar në asnjë moment për 35 vjet rresht, plotë përpjekje e luftëra të përgjakshme në Kosovë dhe në trevat e tjera shqiptare. Isa Boletini vuri vulën kombëtare dhe është ndër më të merituarit për Kosovën e mbetur shqiptare si vatër më e përgjakshme e lirisë dhe e pavarësisë së Shqipërisë.

Ideologët kryesorë dhe populli shqiptar në vitin 1912 me të drejtë gjykuan se vetëm me luftë të pandërprerë mund të fitohet liria dhe pavarësia, pasi Perandoria Osmane e gërryer dhe e destabilizuar nga brenda, si dhe nga ndërhyrjet e jashtme linte të kuptohej se sundimit të saj në Gadishullin Ballkanik, i kishte ardhur fundi³. Për Isa Boletinin kanë shkruar më shumë të huajt, qoftë për të përdhosur, qoftë për të lavdëruar. Pseudohistorianët dhe publicistët e huaj të shtypit të verdhë nuk kanë hezituar ta kthejnë të vërtetën e kulluar në gënjeshtëri, as nuk kanë ngurruar ta paraqesin këtë figurë të shquar si “kapedan hajdutësh” apo si “një hyzmeqar prej bashibuzuki” që gjallëronte me rrogë të sulltanit dhe me parat e krajlive. Vrasja e tij aq e dëshiruar më 23 janar 1916, te ura e Ribnicës, në Podgoricë, nga armiqtë e tërbuar të popullit shqiptar, në krye me Rusinë, bëhet e ditur nga shtypi jo si ngjarje tragjike, as si vrasje tinëzare prej cubash, po si larje hesapesh midis komitësh dhe xhandarësh⁴.

Isa Boletini, trimi, strategu, prijësi, atdhetari, idhulli dhe shtylla ndër më kryesoret mbi të cilën qëndron uni ynë kombëtar, që në moshën 17 vjeçare mori pjesë si luftëtar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në betejën e Slivovës kundër forcave osmane. Përkrahu Haxhi Zekën dhe atdhetarët e tjerë në themelimin e Lidhjes Shqiptare

³Po aty.

⁴ Emine Arifi - Bakalli, “*Shkrime disomante për Isë Boletinin*”, në përmbledhjen me material të Sesionit shkencor kushtuar 80 - vjetorit të rënies së Isa Boletinit, mbajtur në Prishtinë më 23. XI. 1996, Instituti i Historisë, Prishtinë 1998, f. 49 - 50.

të Pejës dhe në qëndresën e saj kundër sunduesve osmanë dhe synimeve grabitqare të Serbisë e Malit të Zi. Më 1901-1902 u vu në krye të qëndresës popullore në Kosovë kundër ndërhyrjes të Serbisë, Malit të Zi dhe Austro-Hungarisë në Shqipëri. Ngritja e Isa Boletinit si udhëheqës i Lëvizjes Kombëtare fillon me revolucionin xhonturk. Si shumë krerë të tjerë, ai i dha krah kësaj kthese historike duke ushqyer shpresën se me përmbysjen e absolutizmit të Sulltan Hamitit do të vendosej autonomia kombëtare. Ngjarjet e mëpastajme treguan se kredoja politike e xhemijetlive “Liri dhe barazi” - ishte një parullë boshe, se ishin turqit e rinj po ata që vazhdonin politikën e regjimit të vjetër. Përpyekjet e tyre për ta vënë Isa Boletinin nën tutelën dhe për ta kthyer në përkrahës besnik të politikës osmanizuese qenë të kota. Prandaj artileria turke provoi t’ia shkurtonte jetën nën gërmadhat e Kullës, por ai me një dorë trimash, edhe pse i plagosur, çau rrethimin.

Në qoftë se Isa Boletini ishte kundërshtar i papajtueshëm i Xhemijetit, ai nuk bëri asnjë hap në përkrahje të kundërrevolucionit dhe rikthimit të Abdyl Hamitit në fron. Ky qëndrim i patundur i bënë krejtësisht të paqëndrueshme pikëpamjet e historianëve të djeshëm dhe të sotëm se Isai ishte gjoja reaksionar dhe partizan i sulltanit të përmbysur⁵. Madhështia e tij si prijës e hero kombëtar shfaqet gjatë kryengritjeve të viteve 1910-1912, sidomos në betejat e zhvilluara në Grykën e Carralevës e njohur me emrin “në Termopilen shqiptare”, në prill-maj të vitit 1910. Veprimet e tij luftarake do të zhvillohen në maj-korrik 1912 në hapësirën nga Tregu i Ri (turq, Jeni Pazar, sot: Novi Pazar) deri në Shkup. Thënë shkurt Isa Boletini ishte udhëheqës

⁵Po aty; Fatmira Musaj, *Isa Boletini*, Tiranë, 2004.

më i shquar ushtarak i luftimeve të përgjakshme në tërë Vilajetin e Kosovës⁶.

Qeveria osmane pas shtypjes me gjak të Kryengritjes së vitit 1910 dhe kalimit të Isa Boletinit me disa bashkëluftëtarë në Mal të Zi, ishte shqetësuar shumë për zërat e shpërthimit të kryengritjes së re shqiptare nën udhëheqjen e këtij drejtuesi të shquar të kryengritjeve shqiptare⁷. Sipas informacioneve të shërbimit sekret, Isa Boletini pasi kishte kaluar kufirin osmano-malazez në fillim të qershorit 1910, ishte rikthyer sërish në Shqipëri për të organizuar kryengritje. Më pastaj ishte konfirmuar se ai me bijtë e tij dhe bashkëluftëtarë të tjerë gjendej në Mal të Zi⁸.

Qeveria osmane kërkonte përmes ambasadës së saj në Cetinë që të intervenonte tek Qeveria malazeze për dorëzimin e Isa Boletinit organeve të saj të sigurimit, që kështu ta parandalonte shpërthimin e sërishëm të kryengritjes shqiptare. Ndërkohë, autoritetet osmane përmes rrjetit të sigurimit shtetëror konfirmonin se Isa Boletini nga gjysma e qershorit kishte kaluar sërish në Shqipëri në përpjekje për të organizuar kryengritje të armatosur. Kalimi i tij në Shqipëri u morë seriozisht nga autoritetet osmane, për çka pasoi një fushatë e gjerë për konfirmimin e këtij lajmi dhe vendndodhjen e tij, që të kapej ose të likuidohej, rrjedhimisht të pamundësohej shpërthimi i kryengritjes së re në Shqipëri. Emri i Isa Boletinit përmendet në dosjen e tij e cila gjendet në Arkivin e Kryeministrisë së Republikës së Turqisë në Stamboll. Autoritetet osmane e hapin dosjen e Isait (që në vitin 1902) duke e lidhur atë me njëfarë Ismaili, djalë të Arifit nga Malësia e

⁶ Vangjel Kasapi, “Në kujtim të tribunit të lirisë - Isa Boletini”, në gazetën “Rilindja”, 11. 02. 1996, f. 19.

⁷ Eugen Shehu, “*Isa Boletini - simbol i qëndresës antiserbe*”, Gazeta “Bota sot”, 24-25 nëntor 1999, f. 18.

⁸ Ramiz Abdyli, “*Isa Boletini në dosjen e Portës së Lartë*”, Gazeta “Koha”, 8-9 qershor, 2015.

Gjakovës, i cili dënohet me vdekje. Aktgjykimin e tij e mori gjyqi ushtarak osman në Gjakovë, ndërsa në arsyetim për ekzekutimin e tij thuhet se Ismaili kishte marrë pjesë në kryengritjen shqiptare kohë më parë dhe se ishte parë i shoqëruar nga Isa Boletini⁹.

Në fund të dosjes së Isa Boletinit gjendet një dokument i datës 13 mars 1912¹⁰. Sipas këtij dokumenti rezulton se për çështjen e quajtur Isa Boletini u thërrit Këshilli i Ministrave në Stamboll, i cili solli vendim për konfiskimin e mjeteve të akumuluar nga fabrika e mullirit të gurëve të tij gjatë periudhës që ky drejtues i papërkulur i lëvizjes kryengritëse shqiptare edhe më tej nuk kishte pranuar t'u dorëzohej autoriteteve osmane që ato mjete t'i jepeshin, atij pa vendim gjyqësor dhe në kundërshtim të qëndrimit të autoriteteve lokale. Ky vendim u morë në kohën kur Lëvizja e çetave të armatosura shqiptare në Malësinë e Gjakovës dhe në Rrafshin e Dukagjinit po merrte gjithnjë e më shumë përmasa dhe po e shqetësonte shumë qeverinë e Stambollit. Këtë pohim e provon arsyetimi i vendimit të Këshillit të Ministrave të Qeverisë osmane, në të cilën thuhet se fabrika e gurëve të mullinjve në Boletin ishte pronë e Isa Boletinit, çështje kjo e vërtetuar me ferman të veçantë të Sulltanit, në vitin 1905, dhe tashti mjetet e akumuluar nga të ardhurat e saj të destinuar deri atëherë padrejtësisht nga autoritetet osmane personit tjetër në kundërshtim me ligjin, t'i ktheheshin Isa Boletinit. Këtë nismë e ngriti Adil Beu, ministër i Punëve të Brendshme të Perandorisë Osmane gjatë udhëtimit të tij nëpër Shqipëri, kur ai po qëndronte në Pejë (7 mars 1912), në përpjekje për të parandaluar tashmë zjarrin e Kryengritjes së Përgjithshme shqiptare antiosmane. Në dokument thuhej se ndonëse Isa Boletini nuk pranoi të shkonte t'i përkulet padishahut me rastin e vizitës që ai

⁹Po aty.

¹⁰Po aty.

ia bëri në qershorin e vitit të kaluar në Kosovë, shuma e të hollave të akumuluar duhej t'i ktheheshin atij si pronar i fabrikës së përmendur¹¹.

Nga sa u tha më sipër del qartë se autoritetet osmane me pronën e fituar nga trashëgimia familjare luajtën deri në fund me kartën për ta bërë Isanë për vete, ose të paktën për ta pamundësuar kyçjen e tij në organizimin e Kryengritjes së Përgjithshme antiosmane të vitit 1912¹². Isa Boletini punoi intensivisht për organizimin e Kryengritjes së Përgjithshme të vitit 1912, përkrah Hasan Prishtinës, Bajram Currit etj.¹³ Ai mori pjesë në Kuvendin e Junikut përkrah grupit autonomist dhe miratoi programin politik me kërkesën themelore për autonominë e Shqipërisë. Për realizimin e këtij programi, ai në bashkëpunim me Hasan Prishtinën e krerë të tjerë, drejtuan forcat kryengritëse për çlirimin e qyteteve kryesore të Kosovës. Sukseset e njëpasnjëshme të Kryengritjes e detyruan Portën e Lartë të ulej në bisedime me shqiptarët. Në bisedimet e gushtit të vitit 1912, midis komisionit turk të kryesuar nga Ibrahim Pasha dhe krerëve kryengritës, në Kuvendin e Ferizajt, Isa Boletini dhe një pjesë e mirë e krerëve kryengritës u tërhoqën nga programi autonomist dhe u shprehën për kërkesa të moderuara. Kjo tërheqje u kushtëzua, kryesisht nga rrethanat politike të jashtme që u krijuan¹⁴. Kryengritja e Përgjithshme e vitit 1912 e tronditi nga themelet sundimin e Perandorisë Osmane, duke hapur rrugën për shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë.

¹¹Po aty.

¹² Xheladin Shala, *“Unë jam mirë, Kur asht mirë Shqypëria”*, në Revistën “Albania”, nr. 62, 2006, f. 91-94.

¹³ Shukri Rrahimi, *Lufta e shqiptarëve për autonomi (1897-1912)*, Prishtinë, 1978, f. 189 - 191; *Historia e popullit shqiptar*, Vëll. II, Tiranë, 2007.

¹⁴ Shukri Rrahimi, *Vilajeti i Kosovës*, Prishtinë, 1969, f. 137-141.

Shqiptarët në verën e vitit 1912 dhe në fillim të asaj vjeshte ishin vërtet në kulm të fitores, por nga ana tjetër edhe në kulmin e rrezikut, sepse Fuqitë e Mëdha kishin planë të tjera. Duke e parandier rrezikun nga fqinji verior, Isa Boletini u mundua që këtë situatë ta shfrytëzojë me mençuri dhe të nxjerrë përfitime për lëvizjen e armatosur kundër Turqisë¹⁵. Karakteristikë në marrëdhëniet e Isait me serbët është se ai, asnjëherë nuk u bashkua me ta në pikëpamje politike dhe nuk u dha asnjë koncesion në dëm të tërësisë territorial të vendit. Serbët, nga ana e tyre në raport me të kanë synuar të përfitojnë me kontakte, demagogji, shantazhe e kërcënime dhe sa më tepër ta dobësojnë kreun e kryengritjes shqiptare, në mënyrë që më pas të realizojnë synimet e tyre pushtuese ndaj territoreve shqiptare. Isa Boletini ato kontakte i zhvillonte sipas logjikës “tërhiq e mos e këput, duke bërë shumë zigzag”.

Pra, Isa Boletini në Kryengritjen e Përgjithshme të vitit 1912 u vu në përkrahje të Hasan Prishtinës e Bajram Currit deri, në arritjen e Marrëveshjes shqiptaro-osmane të Shkupit, sipas së cilës gjuha shqipe do të ishte gjuhë zyrtare, krahas osmanishtes, që gjyqet shqiptare do të gjykonin në gjuhën shqipe, ishte paralelisht me atë osmane, etj. Mirëpo, Marrëveshja nuk u jetësua për shkak të shpërthimit të Luftës së Parë Ballkanike, kur ushtritë serbe e malazeze iu vërsulën tokave shqiptare. Në këto çaste kritike, Isa Boletini do të qëndrojë në nivel të detyrës. Me njerëzit e tij do t'i kundërvihet pushtimit të Kosovës, dhe për dy javë u përball me sulmin serb në linjën e frontit nga Tregu i Ri e Kopauniku, në veri të Mitrovicës, nga Merdari e deri në Kumanovë. Ishte shpirti dhe prijësi i luftëtarëve shqiptarë në luftimet kundër pushtuesve serbë në Lumë, Opojë, Has dhe Malësinë e Gjakovës¹⁶.

¹⁵ Xheladin Shala, “Unë jam mirë, kur asht mirë Shqypnia”, f. 91.

¹⁶ Fatmira Musaj, *Isa Boletini, Tiranë*, 2004, f. 109-163.

Në Sllovë të Dibrës, Isa Boletini mësoi për aktin e madh politik kombëtar që po përgatitej në Vlorë. Vetëm aty ai pa shpëtimin e Kosovës e të viseve të tjera shqiptare të pushtuara nga Aleanca Ballkanike. I zgjedhur delegat i Kosovës në krye me 300-400 luftëtarë kosovarë u nisë për në Vlorë, ku arriti më 29 nëntor¹⁷. Ardhja në Vlorë më 29 nëntor të vitit 1912 shënoi fundin e etapës së luftës së pandërprerë të Isait kundër sundimit osman e shteteve shoviniste fqinje, e cila u kurorëzua me shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë. Ajo shënoi për Isën fillimin e një periudhe të re luftërash e përpjekjesh përkrah patriotëve të tjerë për konsolidimin e shtetit shqiptar, për çlirimin e trojeve të pushtuara dhe bashkimin kombëtar¹⁸.

Në kohën kur Qeveria e Përkohshme e Shqipërisë së përgjysmuar s'kishte as më të voglën forcë ushtarake, as polici, as financa, as gjë prej gjëje, kur Vlora kishte përballë ushtritë ballkanike nga toka dhe deti, duke qenë njëkohësisht e rrezikuar nga ushtria turke e Xhavit Pashës, ishte Isa Boletini me gardën e tij kosovare që qëndronte si roje e sigurisë së Qeverisë dhe e shtetit të pavarur¹⁹.

Pa asnjë paragjykim, por me hak, historiografia jonë dhe e huaj daljen e Shqipërisë në skenën Evropiane më 1912, ia kushton kryekëput veprës së shqiptarëve të Kosovës, që me shqiptarizëm të kulturuar, autentik, i sfiduan kohët. Me këtë lajtmotiv - Isa Boletini, u përvesh misionit në periudhën e pavarësisë²⁰. Brenda kabinetit të parë shqiptar, Kosova përfaqësohej jo thjesht me një strateg ushtarak.

¹⁷ Bardhosh Gaçe, *Ata që shpallën pavarësinë kombëtare*, Tiranë, 2012, f. 41-42.

¹⁸ Fatmira Musa, *Isa Boletini...*, f. 162-163.

¹⁹ Xheladin Shala, *"Veprimtaria kombëtare e Isa Boletinit në vitet 1912-1916"*, Isa Boletini dhe koha e tij, Prishtinë, 1998, f. 113.

²⁰ Tafil Boletini, *Pranë Isë Boletinit*, Kujtime nr. 1, Tetovë, 1996, përshtatur dhe përgatitur për botim nga dr. Marenglen Verli.

Gjithsesi, ajo përcillte plotfuqishmërinë e një krahine nëpërmjet Boletinit të mprehtë e kategorik. Qeveria e kryeministrit, Ismail Qemali shqyrtonte pikëpamjet që sillte Isa në qëndrimet ndaj ambasadorëve e milionerëve të huaj të akredituar në Vlorë. Veç shumë fakteve domethënëse rezulton udhëtimi i delegacionit qeveritar shqiptar në pranverën e 1913 nëpër kryeqytetet e Evropës (Romë, Vjenë, Paris, Londër, etj.) për të argumentuar arbitraritetin që ushtrohej mbi copëtimin mëdysh të Shqipërisë. Kryediplomati Ismail Qemali nga Jugu dhe Luigj Gurakuqi nga Veriu, plotësoheshin me Isën nga trevat Lindore e Verilindore shqiptare.

Dhe ndërsa Ismail Qemali protestonte, duke theksuar se “Shqipëria nuk mund të qëndrojë me kufijtë e tanishëm, prandaj kam marrë me vete Isanë, që në emër të shqiptarëve të Kosovës të bëjë deklaratë të ngjashme dhe të kërkojë korrigjimin e kufirit”. Kurse Isa, përballë autoritetit e fuqisë së aktorëve të Fuqive të Mëdha të Konferencës së Ambasadorëve në Londër guxoi të jap deklaratë²¹. “Serbia i rrëmben viset tona. Ajo robëroi gjysmë milion shqiptarë. Po këta s’do rrinë duarkryq. Ata do të ngrejë krye e do t’i tregojnë Evropës se nuk duan të jetojnë si robër të Serbisë. Shqiptarët do të ngrihen në këmbë për të mbrojtur atë që është e tyre”²². Pra, Isa Boletini ka pasur një qëndrim të formuar e të prerë të cilin e ka deklaruar në të gjitha rastet sa herë që pati takime e intervista, duke e qëlluar fort faktin se “Nëse Evropa nuk do ta zgjidhë drejt çështjen e kufijve të Shqipërisë, Ballkani nuk do të ketë kurrë qetësi”²³. Sa i përket tërësisë dhe integritetit territorial të shqiptarëve, është e njohur deklarata e dhënë në Londër para ministrit të Jashtëm të Anglisë, Eduard Greit: ”Nuk jam ardhur vetëm për Mitrovicën, por për çdo

²¹ Xheladin Shala, “*Veprimtaria kombëtare...*”, f. 92.

²²Po aty.

²³Po aty.

pëllëmbë toke shqiptare”²⁴. Isa Boletini edhe pas kthimit nga Londra në Vlorë, fare nuk i shkonte mendja të hiqte dorë nga përpjekjet për të demonstruar pakënaqësinë pranë Fuqive të Mëdha.

Ai së bashku me delegatët e tjerë të Kosovës, Ajdin Dragën, Mehmet Pashë Dërrallën u dërguan një telegram proteste qeverive të gjashtë Fuqive të Mëdha të Evropës, në të cilin kërkonin rishikimin e kufijve veriorë dhe verilindorë të Shqipërisë. Duke parë gjendjen e vajtueshme të trevave të okupuara nga serbo-malazezët, Isa Boletini dhe prijësit e tjerë vendosën që t’i kundërshtojnë me forcë vendimet e Konferencës së Londrës. Duke shfletuar “*Perlindja e Shqipëniës*” - organ i Qeverisë së Përkohshme të Vlorës²⁵, lexojmë artikullin “Një fjalë e Isa Boletinit, nga kronisti Sazani i cili shkruan: “Luanët e Malësisë së Kosovës dhe Malësisë së Shkodrës mendohen të ngrihen e të luftojnë burrërisht kundër tiranëve, për t’u bashkuar me vëllezërit e tjerë të Shqipërisë së Lirë. Këta patriotë përherë kanë luftuar dhe kanë derdhur gjakun e tyre për të drejtat shqiptare duke nderuar të gjithë Shqipërinë e Lirë, mirëpo me hidhërim të madh themi, që e gjykoi Evropa të mbeten jashtë kufivet të Shqipërisë së Lirë”.

Më pas vazhdon: “Derisa nuk ishte vendosur në konferencën e Londrës, këta patriotë rrinin në ankth, duke shpresuar se Evropa do u japte të drejtë të bashkohen me shtetin e ri shqiptar, për krijimin e të cilit kaq shumë janë përpjekur. Por sot, kur u pa që mbledhja e Londrës nuk i mori para syve të drejtat e tyre, por, përkundrazi, pa ndonjë të drejtë, vendosën që të mbesin nën dhespotismën e armiqve, janë gati, të ngrihen, të rrokin armët mizore, për të mbrojtur ato të drejta të natyrshme, të cilat Evropa e qytetëruar s’deshi t’ua njihte. Le të dijë, fort bukur Evropa, që gjer sa t’i përmbushin qëllimet dhe

²⁴ Eugen Shehu, “*Isa Boletini - simbol i qëndresës antiserbe*”, Gazeta “Bota sot”, 25 nëntor, 1999.

²⁵Gazeta “*Perlindja e Shqipëniës*”, nr. 1, 21-23, Vjeshtë e parë, 1913, Vlorë.

dëshirat e tyre, shqiptarët e Kosovës dhe të Hotit e të Grudës kurrë nuk do të qetësohen, por do të luftojnë gjer në frymën e fundit, sa të mos mbetet këmbë burri dhe kështu paqja në Ballkan për ditë do të jetë në rrezik”. Ja edhe trimi i Shqipërisë, z. Isa Boletini që i është përgjigjur një korrespondenti të “Albanesische Korespondez” të cilën ne po e përkthejmë fjalë për fjalë:

“Na shqiptarët s’ marrim as një barrë përsipër për luftërat që duhet t’i bjerë e pritmja. Neve u tham qeveritarëve të Romës, të Vjenës, të Parisit dhe të Londrës, që populli ynë kurrë nuk mundet të duronjë të copëtohet. Pas trembëdhjetë kryengritje të përgjakshme, në të cilat derdhëm kaq gjak për lirinë tonë, na dha më në fund Evropa çarjen tonë. Por, gjysëm më të madhe të kombit duan t’ia bëjnë therror armiqvet. Kosova, zemra e Shqipërisë, po na humbet. Fiset e Hotit e të Grudës të cilat luftuan kaq trimërisht për çështjen shqiptare, po i jepen Malit të Zi. Tridhjetë e katër (34) qytete shqiptare u dhanë në duart e armiqve tanë. Me gjithë këtë, serbët po i vdesin urie Malësorët. Ju mbajtën udhët për në Gjakovë, Prizren dhe të gjitha pazaret e tjera, me të cilat rrojnë, dhe në qoftë se ndonjë merr rrugën për në qytet menjëherë vritet.

Na shqiptarët duam paqe: po duhet të mbrojmë vehten, në qoftë se popullin tonë e copëtojnë, e vdesin urie dhe e vrasin”²⁶. Më 16 gusht 1913 Isa Boletini në një letër dërguar Ismail Qemalit nga Malësia e Gjakovës i flet për mjerimin dhe urinë që i ka plagosur malësorët e Gjakovës dhe kërkon ndihmë. Në të ndër të tjera thuhet: “Çdo skutë e Malësisë, gurë, shkëmb, gjithandej, është mbushur plot me emigrantë të mjerë, të cilët kanë ardhur në gjendje jo të lypin, por të vdesin. Nuk ka zemër që duron përpara vajtimit të këtyre bijve të

²⁶Po aty; “*Perlindja e Shqipëniës*”, Prishtinë, 2012 (Ribotim përmbledhës), Biblioteka kombëtare dhe Universitare e Kosovës.

atdheut...”²⁷. Ndërkaq në fund të muajit gusht 1913 udhëheqësit kosovarë, Isa Boletini, Bajram Curri etj., ndodheshin në Vlorë²⁸.

Në fillim të shtatorit nga viset verilindore dhe lindore shqiptare raportohej për një lëvizje që dukej në horizont. Shtytje të madhe lëvizjes i jepnin kosovarët në krye të të cilëve ndodheshin Isa Boletini, Elez Jusufi, Bajram Curri, Sadik Rama, Ramdan Zaskoci etj. Kryengritja antiserbe e njohur në histori Kryengritja e Shtatorit ose Kryengritja e Dibrës filloi më 20 shtator 1913 në Peshkopi dhe brenda ca ditëve u përhap në një shtrirje vertikale nga Ohri në jug e deri në Prizren e Gjakovë²⁹. Mbas luftimesh të ashpra, qyteti i Dibrës u çlirua. Trupat serbe u detyruan të tërhiqeshin edhe nga Ohri, Struga e Gostivari. Kryengritësit, numri i të cilëve kishte arritur në disa mijëra, marshuan në drejtim të Kërçovës. Në dokumentet austro-hungareze dhe serbe të kohës, thuhet se në sulmin për çlirimin e Dibrës kishte marrë pjesë edhe Isa Boletini në krye të një kolone shqiptarësh. Historian serb Bogomil Hrabrak³⁰, thotë se Isa Boletini më 24 shtator 1913 hyri në Strugë. Një pohim i tillë nuk është i saktë, sepse në këtë kohë Isa Boletini sipas të dhënave ndodhej në Malësinë e Gjakovës.

Veprimet luftarake të çetave të krahinave të Kosovës, të udhëhequr nga Isa Boletini dhe Bajram Curri, si dhe sukseset e kryengritësve në Dibër e detyruan Qeverinë serbe të merrte masa më serioze. Ajo mobilizoi afro 3 divizione dhe i përqendroi ato në viset shqiptare të aneksuara. Aty nga fillimi i tetorit, forcat ushtarake serbe, filluan operacionet luftarake kundër luftëtarëve shqiptarë dhe

²⁷ Fatmira Musa, *Isa Boletini*, Tiranë, 2004, f. 176-188.

²⁸ Po aty.

²⁹ Nebi Dervishi, “*Kryengritja e Shtatorit 1913 dhe Lufta e Petrinjës*”, Gazeta “Lajm”, 21-23 shtator, 2013.

³⁰ Богомил Храбрак, *Арбанашики упад и побуме на Косову, и у Македонија од краја 1912 год. Да краја 1915 год.* стр.13 бране, 1988.

ushtruan një terror të paparë ndaj popullsisë shqiptare. Me gjithë qëndresën që bënë si çetat e Isa Boletinit ashtu edhe kryengritësit e Dibrës, serbët mundën ta shtypnin kryengritjen³¹. Me ndjenjën e rëndë të hidhërimit në zemër, Isa Boletini, Bajram Curri dhe shumë familje kosovare u detyruan të largohen nga Malësia e Gjakovës dhe zbritën në Shkodër. Aty, me vështirësi të mëdha Isa Boletini mundi të sistemonte disa familje kosovare dhe nëpërmjet të njohurve të vet, u siguroi atyre mjetet minimale për jetesë.

Sipas të dhënave Isai qëndroi në Shkodër deri në mesin e nëntorit të vitit 1913, dhe ato ditë niset për në Vlorë. Dokumentet nuk japin datë të saktë, por sipas kujtimeve të Tafil Boletinit³², ai mund të ketë mbërritur në Vlorë në ditët e fundit të nëntorit të 1913. Me sa duket, Isa Boletini në Vlorë shkoi të takojë me Ismail Qemalin për të trajtuar problemin e organizimit të mëtejshëm të qëndresës antiserbe³³. Gjatë qëndrimit në Vlorë, Isai pa nga afër vështirësitë dhe ndërlikimet që iu krijuan Qeverisë së Përkohshme, mbas mbërritjes në tetor të 1913 të Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit që nuk ishte gjë tjetër veç se zbatues i politikës së Fuqive të Mëdha në Shqipëri. Në nëntor 1913 Fuqitë e Mëdha vendosën përfundimisht që prijës i Shqipërisë të ishte gjermani Vilhelm Vidi. Si rezultat i gjendjes së krijuar në Shqipëri, më 22 janar 1914, Ismail Qemali dha dorëheqje, duke ia dorëzuar pushtetin KNK. Edhe Isa Boletini me bashkëluftëtarët e vetë u largua nga Vlora dhe shkoi në Shkodër. Isa Boletini e shihte princin gjerman si simbolin e Shqipërisë së pavarur dhe të bashkuar. Për këtë arsye ai bashkë me Bajram Currin dhe kosovarët e tjerë, shkuan në Durrës në pallatin

³¹ Liman Rushiti, *"Isa Boletini dhe kryengritjet shqiptare të viteve 1913-1915"*, botuar në Isa Boletini dhe koha e tij, Instituti i Historisë, 1998, Prishtinë, f. 135 - 141.

³² Tafil Boletini, *Pranë Isë Boletinit*, (Kujtime n-1), Tetovë, 1996.

³³ Fatmir Musaj, *Isa Boletini*, Tiranë, 2004, f. 185 - 186.

mbretëror të Vedit³⁴ dhe me takimin që patën me të i premtuan se do të përpiqeshin për të mirën e gjithë kombit dhe të fronit të Shqipërisë. Dhe vërtetë qëndruan në Durrës derisa Vidi u largua nga Shqipëria, më 3 shtator 1914.

³⁴Po aty, f. 189 - 193.

Prof. dr. Nebi Dervishi

SUMMARY

THE PATRIOTIC ACTIVITY OF ISA BOLETINI DURING 1912-1913

Isa Boletini was a supporter of the Young Turks in 1908, and was one of the founders of the Convention of Ferizaj which played a major role in the declaration of Huriyet. He opposed the reactionary politics of the Young Turks. In the years that passed after the Young Turks revolution, he was distinguished as a leader of national anti-Ottoman uprisings in 1910-1912 and was the “soul of these uprisings”.

He led the warriors in the battles against the Ottomans in Carralevë-Shtimje in 1910, he supported the anti-Ottoman uprising of 1912, led the forces in the region of Drenicë-Mitrovicë and Prishtinë - Podujeve in 1912. During the First Balkan War in October of 1912, he was appointed head of the volunteer forces for the defense of Albanian lands against the Serbs. In 1913, as a member of the Albanian delegation, together with Ismail Qemali he went to London, where he forcefully protested against the decision taken by the Great Power for the division of Albania. In September of 1913 Isa Boletini crossed once again through Kosova, where he organized the general Albanian uprising against the Serbs and Montenegrins.

After the Uprising of September 1913 ceased, Isa Boletini left to Shkodër where he stayed until mid-November of 1913. It was the time when Esat Pashë Toptani wen openly against the Government of Vlora and settled in Durrës.

Doc. dr. Qerim LITA
(Shkup)

KRYENGRITJA E SHTATORIT MË 1913 DHE ROLI I ISA BOLETINIT

Kryengritja e Shtatorit të vitit 1913, padyshim se përbën ndër ngjarjet më të rëndësishme kombëtare të zhvilluar pas shpalljes së pavarësisë dhe vendimeve arbitrare të Konferencës së Fuqive të Mëdha në Londër (1913). Përkundër asaj se territori shtetëror dhe popullsia e Mbretërisë së Serbisë gati u dyfishua si rrjedhojë e luftërave ballkanike dhe nga pazarllëku i Fuqive të Mëdha, Serbia nuk ishte e kënaqur duke pretenduar aneksimin e tokave tjera shqiptare, që ajo i konsideronte si “pika strategjike”¹. Një pretendim i tillë doli nga vet kryeministri i Serbisë Nikolla Pashiq, i cili në ekspozenë e tij dhënë para deputetëve, menjëherë pas shuarjes së kryengritjes, veç tjerash u shpreh: “Qeveria e Mbretërisë Serbe, ka menduar të kërkojë nga Fuqitë e Mëdha të bëhet petrifikimi i kufijve, në përputhje me interesat si të njërës po ashtu edhe të palës tjetër, si

¹Halim Purellku, *Zona e pushtimit jugosllav në Shqipëri (1918-1921)*, Botime Albanologjike, Tiranë 2012, f. 17-19.

dhe për qëllim që t'i qetësoj Fuqitë e Mëdha, sipas së cilëve Shqipëria duhet të ekzistoj..."².

Rrjedhimisht, edhe Kryengritja e shtatorit e vitit 1913 u nxit nga qarqet ushtarake e policore serbe, të cilët pas ultimatumit të marrë nga Fuqitë e Mëdha, që trupat serbe të tërhiqen brenda kufijve të përcaktuar në Konferencën e Londrës, ata si kundërpërgjigje, shtetasve shqiptarë ua ndaluan shfrytëzimin e tregjeve në Dibër dhe Gjakovë³. Më 5 (18) shtator të vitit 1913, Qeveria e Mbretërisë serbe, përmes një qarkore njoftonte përfaqësuesit e saj diplomatikë të akredituar në vendet e Fuqive të Mëdha, në të cilën thuhej: "Serbia ka filluar të tërhiqet nga Shqipëria, me qëllim të pengimit sa më të lehtë të sulmeve arnautë në territorin tonë. Mirëpo, në kufi ndodhën çrregullime dhe arnautët filluan të sulmojnë në masë trupat tona dhe nga raportet që i posedojmë përgatitet një sulm serioz dhe i organizuar. Prandaj vendosëm t'ua ndalojmë arnautëve nga Shqipëria çfarëdo lloj qasjeje në tregjet tona, përderisa nuk kthehet gjendja normale..."⁴.

Një vendim i tillë revoltoi tej mase popullsinë lokale, e cila revoltë së shpejti kaloi në një kryengritje të përgjithshme kundër pushtuesit serb. Zyrtarët politikë e ushtarakë serbë nga Shkupi, Manastiri, Ohri, Prizreni raportonin për një lëvizje të madhe që dukej në horizont. Shtytje të madhe lëvizjes i jepnin shqiptarët në krye me

² Државе архив на Република Македонија (më tej ДАРМ). 1.17.6.228/681-688, EXPOSE de Monsieur Pachiitch, President du Conseil et Ministre des Affaires Etrangères - Sur la politique extérieure de la Serbie.

³ ДАРМ.1.18.5.214/414-424, POST OFFICE TELEGRAPHS, SSS BELGRADE MIN 603-1028-28/9-3, LEGATION SERBE LONDON

⁴ Agjencia Shtetërore e arkivave të Kosovës (më tej ASHAK), A. Diplomati i Sekretariatit Federativ të Punëve të Jashtme - Beograd, Korrespondenca sekrete (MPJ) 1913-1915, РЕФЕРАТ о упаду Арнаута, 95/1-4.

Isa Boletinin, Elez Isufin, Bajram Currin etj.⁵ Kryengritja filloi natën e 18-19 shtatorit 1913 në rrethin e Peshkopisë⁶. Kryeshefi i Qarkut të Dibrës, përmes telegrameve të 7 (20) dhe 8 (21) shtatorit, njoftonte se “rreth Peshkopisë po zhvillohen luftime me shqiptarët”. Më 9 (22) shtator, Ministria e Punëve të Brendshme të Mbretërisë serbe, njoftonte se “shqiptarët janë 10 kilometra në afërsi të Dibrës” ndërsa “Peshkopia dhe Zhirovica janë marrë”. Po këtë ditë, Qeveria serbe, i porositi përfaqësuesit e saj diplomatikë, që t’i njoftojnë Fuqitë e Mëdha, se shqiptarët kanë sulmuar në mbarë brezin kufitar “menjëherë pas tërheqjeve të trupave tona nga pikat strategjike, që ishim të detyruar t’i lëshojmë pas kërkesës së F. të Mëdha”⁷.

Grofi Bertholld, më 24 shtator 1913, përmes një qarkore njoftonte përfaqësitë diplomatike austro-hungareze në Londër, Hagë, Berlin, Romë, Paris dhe San Petersburg, se kryengritja shqiptare ishte provokuar nga “fortësia serbe”. Një pjesëmarrje e shqiptarëve nga Shqipëria, thuhej më tej “mund të ketë vetëm për territore të pushtuara nga ana e serbëve që janë në kundërshtim me vendimet e Londrës”, ose popullsinë e zonave të cilave u është ndërprerë furnizimi me ushqime “për shkak të pengesave për të shkuar në tregun e Dibrës e të Gjakovës”⁸. Një qëndrim të tillë pati edhe Komisioni Hetimor i Fondacionit Kanerxhi, i cili në raportin kushtuar kësaj ngjarjeje shkruante: “Më 20 të shtatorit të kaluar, ushtria serbe, duke u tërhequr përmes kufirit në afërsi të Dibrës, duke zbatuar pa dëshirë kërkesat e Fuqive të Mëdha, mori të gjithë

⁵Xheladin Shala, “*Veprimtaria kombëtare e Isa Boletinit në vitet 1912-1916*”, Gjurmime albanologjike, Seria e shkencave historike 26, 1996, Prishtinë, 1997, f. 139 - 140.

⁶ Halim Purellku, f. 17.

⁷Po aty.

⁸ ДАРМ, F. Arkivi i Vjenës: HHStA WIEN Polit. Archiv I Fasz. 1114 Ende, Vm=14 M F S., Graf Berchtold an die k.u.k. Missionen in Berlin, Haag, Paris, Rom un St. Petersburg, Telegramm, Wien, 24 September 1913.

bagëtinë nga Malësia e Dibrës. Barinjtë u shtrënguan të mbroheshin dhe të luftonin, por ata u vranë të gjithë. Serbët vranë gjithashtu dy krerë të fisit të Lumës, Mehmet Ademin dhe Xhafer Elezin, dhe pastaj filluan të grabisnin dhe digjnin të gjithë fshatrat në rrugën e tyre, si: Peshkopinë, Pletzën dhe Dohoshishtin në Dibrën e Poshtme dhe Allajbegin, Maçin, Parën, Obokun, Kllobçishtin dhe Sollokiçin, në Dibrën e Sipërme”.

Në të gjitha këto fshatra, vihej në dukje më tej në raport: “serbët kryenin veprime të tmerrshme masakrimi dhe dhunë mbi gratë, fëmijët dhe pleqtë...etj.”⁹. Ndër krerët më të dalluar që i prinë kësaj ngjarjeje me rëndësi historike, duhet veçuar: Hasan Prishtinën, Isa Boletinin, Bajram Currin, Elez Isufin, Mehmet Pashë Dërrallën, Sefedin Pustinën, Shaqir Jegenin etj.¹⁰ Është e rëndësishme të thuhet, se kryengritësve shqiptarë do t’iu bashkëngjiten edhe disa krerë të shquar të organizatës maqedonase VMRO, si Millan Matev, Petar Çaulev, Stefan Hoxhov etj.

Lidhur me kyçjen e këtyre personaliteteve në organizimin e kryengritjes, në një dokument serb, veç tjerash thuhej: “nga 17 shtatori në Elbasan qëndrojnë vojvodët bullgarë Millan Matov dhe Stefan Hoxhov së bashku me tre oficerë dhe një numër të madh të çetnikëve bullgarë, se Petar Çaulev në marrëveshje me Dervish Himën përgatit çetën prej 300 vetë dhe se po pret ardhjen e Pop Hristovit me çetnikët e rijë nga Bullgaria...”¹¹. Gjithnjë duke ju referuar burimeve diplomatike e ushtarake serbe, kuptojmë se Kryengritja e Shtatorit fillimisht shpërtheu në Dibër, që më pas e

⁹ Joseph Swire, *Shqipëria - Ngritja e një mbretërie*, Dituria, Tiranë 2005, f. 151.

¹⁰ASHAK, A. Diplomati i SFPJ - Beograd, Korrespondenca sekrete (MPJ) 1913-1915, Списак имена вицених арнаута, бугарских војвода и других значајних лица, 14/III/1914 г. Битољ.

¹¹ ДАРМ.1.18.5.214/414-424 по ату.

njëjta të zgjerohet në mbarë brezin kufitar, nga bashkimi i dy drive e deri në Ohër, përkatësisht në relacionin Prizren-Dibër-Ohër.

Ndër shkaqet përse kryengritja së pari filloi në Dibër e jo edhe në Prizren, sipas kryeshefit serb të këtij qarku, ishin mosmarrëveshjet midis Riza Beut dhe Isa Boletinit në njërën anë, të cilët ishin të mendimit që “t’i sulmojnë trupat kufitare” serbe dhe t’i “dëbojnë përtej Drinit të Bardhë”, dhe Bajram Currit në anën tjetër, i cili siç vihet në pah “ishte kundër këtij sulmi”¹². Më 20-21 shtator, rreth 6 000 kryengritës kaluan Drinin e Zi dhe u futën në qarkun e Dibrës. Kryengritësit fillimisht çliruan Peshkopinë dhe më pas edhe Dibrën dhe Zhirovnicën.

Në ballë të kryengritësve siç thuhej në raportet ushtarake serbe, qëndronin dy ushtarakët e mirënjohur shqiptar Isa Boletini dhe Elez Isufi. Për marrjen e Dibrës nga ana e kryengritësve shqiptarë, Ministria e Punëve të Jashtme të Mbretërisë serbe, përmes një qarkore njoftonte të akredituarit e saj në botën e jashtme, në të cilën thuhej: “Të nxitur nga agjitorët nga Vlora dhe Elbasani nën udhëheqjen e një anëtarit të Qeverisë së Vlorës dhe disa oficerëve dhe çetnikëve të huaj rreth 10 mijë shqiptarë ditëve të fundit kanë sulmuar territorin serb. Shqiptarët janë futur në qytetin e Dibrës të cilin e kanë mbrojtur vetëm dy çeta serbe...” Më tej në të thuhej se për shkak “mbrojtjes së territoreve dhe të krenarisë së saj” Qeveria mbretërore është e detyruar të mobilizoj një pjesë të ushtrisë së saj të cilës “do t’i jepet për detyrë t’i shpartalloj sulmet dhe ta sigurojë rendin dhe qetësinë në kufijtë”¹³. Me një retorikë të ngjashme do të shprehet edhe Nikolla Pashiqi, i cili për sulmin e shqiptarëve, fajësoi

¹²ASHAK, A. Diplomati i SFPJ - Beograd, Korrespondenca sekrete (MPJ) 1913-1915; По ату; Министерство Унутрашних Дела, ПОВЕРЛИВО, 10 септембра 1913 год Београд.

¹³ ДАРМ.1.18.5.204/380-384, POST OFFICE TELEGRAPHS, BELGRADE Min 497 249/248 26 1.

Qeverinë e Vlorës, që sipas tij “lejoi formimin e grupeve të fuqishme” të armatosura shqiptare, të cilat “lirisht mund ta merrnin atë që ju nevojitej, si dhe armatim modern që qe blerë apo marrë, me qëllim të marrjes së qyteteve të cilët në Konferencën e Londrës nuk ju dhanë Shqipërisë”¹⁴.

Edhe gazeta opozitare serbe, “Radničke Novine” në shkrimin me titull “Lufta e Tretë Ballkanike”, botuar më 12 (25 shtator) shkruante: “Më 8 (21) shtator shqiptarët në numër prej 6 000 kryengritës kaluan Drinin e Zi dhe u futën në qarkun e Dibrës. Fillimisht morën qytetin e Peshkopisë dhe më pas u futën edhe në Dibër. Nga Dibra kolona shqiptare u nda në dy pjesë; njëra është nisur kah Struga, Ohri dhe Manastiri, ndërsa tjetra kah Kërçova, Gostivari, Tetova dhe Shkupi. Luftimet janë shumë të përgjakshme. Shqiptarët tashmë kanë arritur në territorin ndërmjet Resnjës dhe Manastirit, prandaj nuk përjashtohet mundësia që të futën edhe në Manastir”¹⁵. Më 24 shtator inspektori i policisë serbe nga Shkupi, njoftonte se shqiptarët janë nisë në dy drejtime, një kolonë nga Elbasani për Ohër, ndërsa e dyta nga Dibra për në Strugë, dhe se shqiptarët e kanë marrë Mavrovën¹⁶. Ndërsa, më 26 shtator, autoritetet policore serbe nga Ohri, njoftuan se shqiptarët nga Qafë Thana janë nisur për Strugë dhe Ohër, ndërsa grupi i dytë nga Elbasani për Pogradec. “Me shqiptarët nga Elbasani” thuhej në njoftim “shkojnë vojvodët bullgarë me çetnikët, me qëllim të nxisin revoltë te shtetasit tanë kundër nesh dhe t’i detyrojnë të kërkojnë autonomi së bashku me shqiptarët”¹⁷. Po këtë ditë kryeshefi i rrethit

¹⁴ ДАРМ.1.17.6.228/681-688.

¹⁵ ДАРМ.1.766.27.92/419-422, „Радничке новине“, бр. 189, од 12 септемра 1913, XIII, ТРЕЧИ РАТ НА БАЛКАНУ.

¹⁶ АШАК, А. Дипломатик и Секретариатит Федератив të Punëve të Jashtme - Beograd, Korrespondenca sekrete (MPJ) 1913-1915, РЕФЕРАТ о упаду Арнаута, 95/1-4.

¹⁷ ДАРМ.1.18.5.214/414-424; По ату.

të Prespës informonte se çetat shqiptare i udhëheqin Petar Çaulev dhe Kërste Trajçev me çetnikët e tyre. Edhe kryeshefi i Qarkut të Prizrenit bënte me dije se shqiptarët nga Shqipëria kanë filluar të kalojnë nga ana e majtë e Drinit të Zi në krahinën e Lumës dhe të grumbullohen në masa më të mëdha te fshati Ratkajë. Plani i tyre është të koncentrohen për ta sulmuar Prizrenin”¹⁸.

Katër ditë pasi u çliruar Dibra, Millan Matov së bashku me katër shokët e tij shkoi në këtë qytet për të arritur një marrëveshje me parinë dibrane që i prinin Sefedin Pustina, Shaqir Jegeni etj. Sipas një dokumenti serb, në marrëveshje përfshinte katër pika, edhe atë:

1. Krijimi i komiteteve të përbashkëta, të cilët në harmoni do të veprojnë për çlirimin e viseve të pushtuara nga Serbia;

2. Të zhvillojnë agjitacion të përbashkët brenda territoreve të pushtuara;

3. Të bëjnë organizimin e përbashkët të popullsisë shqiptare e bullgare (maqedonase - Q. L.) dhe t’i armatosin dhe në momentin e dhënë t’i sulmojnë trupat ushtarake serbe; dhe

4. Përmes Kryengritjes së Përgjithshme t’i çlirojnë ato vise, e më pas ta ftojnë Evropën që të ndërhyjë në favorin e tyre¹⁹.

Këto ngjarje tronditën thellë autoritetet e atëhershme pushtuese të Beogradit, të cilët fajësuan faktorin ndërkombëtar, sidomos Austro-Hungarinë dhe Turqinë, se gjoja kjo kryengritje e shqiptarëve është përgatitur me mbështetjen e tyre. Lidhur me këtë, Nikolla Pashiqi, i porosiste përfaqësuesit diplomatikë serbë, që të reagojnë tek qeveritë e Fuqive të Mëdha, se “në Ballkan kemi një dukuri të aventurës qoftë nga Turqia apo nga cilido të qenët e saj

¹⁸Po aty.

¹⁹ASHAK, A. Diplomati i SFPJ - Beograd; Po aty; Извештај Инспектора полиције у Битољу, 8 октобра 1913 г.

lidhur me ngjarjet e tanishme në kufirin serbo-shqiptar” dhe se “sulmi shqiptar në territorin tonë është organizuar nga Shqipëria”²⁰.

Në qarkoren që Spalajkoviç, më 28 shtator ua dërgoi të akredituarve serbë në botën e jashtme, vihej në dukje se: “.. sulmi i shqiptarëve në kufirin e Serbisë dhe sulmi i tyre brenda territorit serb, në mënyrë sistematike është përgatitur shumë më herët” dhe se i njëjti: “është organizuar nga Vlora nën drejtimin e drejtpërdrejtë të dy anëtarëve të Qeverisë së Përkohshme, ministrit Hasan Prishtina dhe Isa Boletinit...”. Më tej në të thuhej se: “shqiptarët në tre muajt e fundit kanë arritur të furnizohen me një sasi të madhe të armatimit dhe municionit, se bëhet fjalë për kryengritje të shqiptarëve brenda territorit të Serbisë, se atyre armatimi ju ka ardhur nga jashtë dhe se mu për këtë arsye shqiptarët nga Shqipëria angazhoheshin që sa më parë t’ju mundësohet hyrja e lirë në Serbi me pretekst që të kenë qasje të lirë në tregjet e Dibrës e të Gjakovës”, se “Qeveria e Serbisë që nga 28 korriku ua ka tërhequr vëmendjen Fuqive të Mëdha për propagandën e ndryshme që shpërndahet në Vlorë ku në atë kohë qëndronte revolucionari i mirënjohur bullgar Sandanski i cili zhvilloi negociata me Qeverinë e Përkohshme të Shqipërisë, për organizimin dhe armatosjen e çetave kundër Serbisë dhe zgjerimin e kufijve të Shqipërisë.”, se më 15 gusht “Bajram Curri, Isa Boletini dhe Riza Beu udhëtuan për në Vlorë me ftesë të qeverisë së atjeshme për shkak aksioneve të mëtejshme ...etj.”²¹.

Gjithnjë në mbështetje të burimeve arkivore, sulmi i kryengritësve shqiptarë përfshiu mbarë zonën kufitare nga bashkimi i dy drive e deri në Ohër, përkatësisht në relacionin Prizren-Dibër-Ohër²², dhe se brenda një periudhe të shkurtë kohore kryengritësit

²⁰ ДАРМ.1.18.5.207/329-331.

²¹ ДАРМ.1.18.5.214/414-424; По аты.

²² По аты.

shqiptarë nën komandën e Isa Boletinit, Mehmet Pashë Dërrallës, Hysni Currit dhe Elez Isufit, çliruan një pjesë të madhe të qyteteve shqiptare përfshirë këtu edhe Shkupin dhe Pejën. Në një letër që Jani Vruho e pranon nga një mik i tij veç të tjerave thuhej: “Këto ditë kënduam do lajme të mira, begët nën komandën e të madhit Isa Boletinit zaptuen Dibrën, Ipekun dhe Isqypin tuke luftua për at vend që na i dha i madhi Zot - dhe na e rymbyen kta anti-kristijanët. Rroftë Isa Boletini i cili po mbaron porosit e të madhit Gjergj Kastriotit...”²³.

Menjëherë pas sulmit të befasishtëm në Dibër dhe më pas edhe në Strugë, Ohër, Prizren, Gjakovë dhe në qendra tjera, Qeveria serbe vendosi të mobilizoj divizionin e Moravës, përkatësisht, njësitë e saja të këmbësorisë I, II, III dhe XIV. Radničke Novine, në shkrimin e sipërpërmendur, vinte në dukje se sulmi i shqiptarëve, te “qarqet qeveritare dhe ato ushtarake mbisundon një hidhërim i madh”, dhe se ato “janë të vendosur që shqiptarëve t’u hakmerren në mënyrë të paskrupullt. Njësitë shqiptar për detyrë do të ketë jo vetëm t’i ndërpres sulmuesit por edhe t’i dënojnë”²⁴.

Më 29-30 shtator 1913, filloi kundërofensiva e ushtrisë dhe e çetave çetnike serbe. Në luftimet disaditore, ushtria serbe e pajisur me armatim bashkëkohor, arriti t’i thyej forcat kryengritëse fillimisht në frontin e Strugës, Ohrit e Dibrës e më pas edhe të Prizrenit e Gjakovës. Më 2 tetor, kryeshefi serb i Qarkut të Prizrenit, njoftonte Ministrinë e Punëve të Brendshme në Beograd, për luftimet e ashpra të zhvilluara një ditë më parë midis forcave serbe dhe atyre shqiptare në Opojë të Prizrenit²⁵. Një ditë më pas, Inspektorati i Policisë së Shkupit, njoftonte se ushtria serbe është futur në Pogradec dhe se “i

²³AQSH. F. 22.v.1913.D.7,fl 167-171.

²⁴Радничке новине; По ату.

²⁵ASHAK, A. Diplomatik i SFPJ - Beograd, МИНИСТАРСТВО УНУТРАШЊИХ ДЕЛА - ПВР. ПОВЕРЛИВО, 20 септембра 1913 год., Београд.

tërë qarku i Manastirit është pastruar nga arnautët dhe çetnikët bullgarë”²⁶. Gjithnjë duke ju referuar burimeve serbe, kryengritësi, në pamundësi për t’iu bë ballë forcave të shumta pushtuese serbe në pjesën e parë të tetorit qenë detyruar të tërhiqen. Tërheqja e tyre u bë në dy drejtime, një pjesë kah Topojani²⁷, ndërsa pjesa tjetër kah Bulçiza. Është e rëndësishme të thuhet, se forcat ushtarake serbe në shenjë hakmarrje vranë dhe masakruan një numër të madh të popullsisë civile, ku vetëm në vendin e quajtur “Dudllëk” në afërsi të Gostivarit, janë varrosur në një gropë qindra shqiptarë të vrarë e të masakruar²⁸.

Vrasje masive të popullsisë civile, djegie të vendbanimeve të tëra ishin të shumta. Sali Hoxhë Vuçitërna, i shkruante Luigj Gurakuqit, se: “Riza beu s’luftoj fare veç se i liroj rrugën anmikut me kalue sa ma lehtë...”²⁹. Më tej ai në letër shtonte: “Lufta e përgjithshme u ndalue. Hysni Curri tash erdhi. Krasniqja, Gashi, Hasi, Bytyçi janë djegë fare. Robni e madhe ash tuj ardhë këtu”³⁰. Autoritetet ushtarake serbe, krahas djegies e plaçkitjes të vendbanimeve shqiptare, arrestuan edhe një numër të madh të prijësve fetarë në Kosovë e më gjerë. Në një dokument shqiptar shprehimisht thuhej: “Deveria serbe ka zënë e internue gjithë klerin mysliman e katolik të Kosovës, bashkë me kryepeshkopin e Shkupit Monsinor Mjeda”³¹. Radničke Novine, më 22 tetor 1913, botoi letrën e një ushtari serb, në të cilën veç tjerash thuhej: “Nuk kam kohë t’ju shkruaj gjatë, por mund t’ju them që këtu po ndodhin gjëra ngjethëse.

²⁶Po aty; 21 септембра 1913 год., Београд.

²⁷ Fshat në krahinën e Lumës.

²⁸AQSH. F. 266.D.160.v.1942.fl. 5.

²⁹Po aty, f. 273.

³⁰Po aty.

³¹AQSH. F.34.v.1913.D.35.fl.202.

Unë jam i tmerruar prej tyre dhe vazhdimisht pyes veten time se si njerëzit mund të jenë kaq barbarë, sa të kryejnë mizori të tilla.

Është e tmerrshme, unë nuk guxoj t'ju them më shumë, por mund t'ju them se Luma nuk ekziston më. Ka fshatra me njëqind, njëqind e pesëdhjetë apo dyqind shtëpi, ku nuk ka ma asnjë burrë, në kuptimin e drejtpërdrejtë të fjalës asnjë. Ne i grumbulluam ata në grupe nga dyzet deri në pesëdhjetë veta dhe pastaj i shpuam me bajoneta tona..."³². Vrasjet masive, djegiet e fshatrave shqiptare përshkruheshin edhe në raportin e Komandës së Divizionit të Moravës, dërguar më 8 tetor Shtabit të Përgjithshëm ushtarak serb, ku veç tjerash në të thuhej: "Më 7 tetor në ora 9,55 para dite filloi sulmi në frontin e gjerë kështu që krahas eliminimit të kryengritësve eliminuam edhe fshatrat. Veprimi të këmbësorisë i parapriu sulmi altierik që filloi së pari me gjuajtje ndaj kryengritësve e më pas kaloi në rrënimin e shtëpive, që u krye me shumë sukses. Njësitë pasi depërtuan në pozitën në veri të fshatit Tërbaç u ndalën në atë pozicion dhe filluan me vrasje masive"³³.

Trupat serbe, nën pretekstin e ndjekjes së kryengritësve sërish depërtuan brenda kufirit të shtetit shqiptar, duke i zënë përsëri "pikat strategjike". Komandanti i Divizionit të Moravës, më 8 tetor i shkruante një raport të detajuar ministrit të Luftës, për zhvillimet luftarake në mbarë brezin kufitar, si dhe për marrjen e sërishme të "pikave strategjike" brenda kufirit të Shqipërisë. Sipas tij, këto pika "detyrimisht" duhej të ngeleshin si linja kufitare të Serbisë "nëse dëshirohet të garantohet siguria në viset kufitare me Shqipërinë dhe shqiptarët". Më tej ai e njoftonte ministrin, për një ekspeditë deri në Elbasan dhe Mat, me qëllim siç pohon: "dënimin e shqiptarëve të

³² Joseph Swire, *Shqipëria - Ngritja e një mbretërie*, po aty, f. 152.

³³ ASHAK. F. Главни Ценералштаб, к. 11, Релација Албанског Одред за време арнаутске побуне.

cilët kanë kaluar në territorin tonë”. “Mirëpo, kjo ekspeditë” thuhet më tej në raport “nuk do të zgjaste shumë, sepse menjëherë do të ktheheshim prapa, nëse nuk do të kishim mundësi që ato vise t’i ruanim për ne”³⁴.

Për rimarrjen e pikave strategjike, nga ana e ushtrisë serbe njoftohemi edhe nga telegrami i Nikolla Pashiqit, dërguar legatës serbe në Londër, ku thuhej: “Ushtria e Mbretërisë së Serbisë pasi i dëboi grupet armiqësore shqiptare nga territori serb dhe i mori pozitat strategjike më se të nevojshme nga ku më lehtë mund të përmbysset sulmi i sërishëm eventual i shqiptarëve në tokat serbe mori urdhëresë të ndalet dhe të mos vazhdojë më tej në Shqipëri. Në ato pozita do të ngelë përkohësisht përderisa nuk merret garancia përfundimtare për paqen e mëtejshme të kufijve”³⁵. Duke e pas parasysh faktin se Qeveria serbe nuk i tërhiqte trupat e veta ushtarake nga territori shqiptar, Qeveria austro-hungareze, përmes përfaqësuesit të vetë të akredituar në Beograd, gojarisht ia tërhoqi vërejtjen Qeverisë serbe “për pasojat shumë serioze nga aksioni luftarak kundër Shqipërisë me të cilën do të shkeleshin vendimet e Konferencës së Londrës dhe se në atë rast Serbia do të sillej në mënyrë kontradiktore ndaj vendimeve të kësaj Konference”³⁶.

Më 15 tetor 1913, diplomati austro-hungarez në Beograd, përmes telegramit njoftonte Grofit Betchold për takimin e tij me Nikolla Pashiqit, si dhe sqarimin e këtij të fundit rreth vendosjes së trupave serbe brenda kufirit shqiptar, që ishte me sa vijon: “Urdhri për ndalimin e depërtimit të ushtrisë serbe në Shqipëri është dhënë.

³⁴ASHAK, F. 3.1.1. Arkivi i ish-Ushtrisë Jugosllave, A. Diplomati i SFPJ - Beograd, Извештај до Министар Војске Краљевине Србије, 26 септембра 1913 год. у Београду.

³⁵ ДАРМ.1.18.6.13/18-20.

³⁶ ДАРМ.1.18.5.211/395-399, POST OFFICE TELEGRAPHS, S S S BELGRAD MIN 52-521. - 1.-8- LEGATION SERBE LONDRES.

Çështja se kur forcat serbe që gjenden në territorin shqiptar duhet të tërhiqen, do të varet nga zhvillimi i rrethanave në Shqipëri. Përderisa forcat shqiptare të gatshme për luftim do të qëndrojnë përballë forcave serbe, nuk do të ndodhë kjo tërheqje”³⁷.

Si rrjedhojë të qëndrimit të tillë nga vetë kryeministri Nikolla Pashiq, më 17 tetor Qeveria e austro-hungareze, i dërgoi një notë verbale, Qeverisë së Serbisë, të cilën në vazhdim po e paraqesim në tërësi:

“Legata e I dhe R³⁸ në Beograd, me kërkesën e Qeverisë së saj, pati nderin që në më shumë raste t’ia tërheqë vëmendjen Ministrisë Mbretërore për Punë të Jashtme, lidhur me nevojën për respektimin e rreptë të vendimeve nga Takimi i ambasadorëve në Londër dhe të abstenohet nga çfarëdo lloj aktiviteti ushtarak në territorin që i është dhënë Shqipërisë, sipas dëshirës së Fuqive të Mëdha”. Ky qëndrim i Qeverisë së I dhe R aq më tepër është i arsyeshëm për faktin se në takimin e Londrës, në përmasa të mëdha dhe në dëm të Shqipërisë, janë marrë parasysh kërkesat e Serbisë lidhur me këtë delimitim. Austro-Hungaria në asnjë rast nuk do të dakordohej që vendimi ndërkombëtar për territorin e Shqipërisë të modifikohet në mënyrë plotësuese në favor të Serbisë. Përgjigjja e fundit lidhur me çështjen, që Qeveria Mbretërore e Serbisë ia dha Legatës së I dhe R është po aq e pamjaftueshme si edhe Nota dërguar Ministrisë për Punë të Jashtme të I dhe R nga ana e ministrit të Serbisë.

Në fakt, urdhëresa që iu lëshua trupave serbe që ta ndërpresin marshin e tyre nuk mund të vlerësohet si e mjaftueshme. Sipas

³⁷ ДАРМ, F. Arkivi i Vjenës: HHStA WIEN Polit. Archiv I Fasz. 1114 Ende, Vm=14 M F S., Legationstrat von Storck an Graf Berchtold, Telegramm, Belgrad, 15 Oktober 1913.

³⁸ Legata e Qeverisë së Austro - Hungarisë në Beograd.

Qeverisë së I dhe R, Qeveria e Serbisë e ka të domosdoshme të kërkojë që menjëherë të tërhiqen trupat të cilat e kanë kaluar kufirin që është përcaktuar në takimin e Londrës dhe të cilat kanë okupuar territore që i takojnë Shqipërisë. Qeveria e I dhe R shpreh besimin se Qeveria e Serbisë pa u vonuar do të tërhiqet në tërësi nga territori shqiptar, në afat prej tetë ditësh. Në të kundërtën, Qeveria e I dhe R për fat të keq do të jetë e detyruar të ndërmerr masat e saja për ta siguruar realizimin e kërkesës së saj”³⁹.

Kjo notë verbale, në fakt përbënte ultimatum të prerë të Austro-Hungarisë ndaj Beogradit, dhe si rrjedhojë pasoi vendimi i Qeverisë serbe për tërheqjen e menjëhershme të trupave ushtarake të tyre brenda territorit shqiptar. Lidhur me këtë, Grofi Bretchold, më 20 tetor ua përcolli telegramin e marrë nga i ngarkuari me punë në Beograd, ambasadave të Austro-Hungarisë në Berlin, Londër, Paris, Romë dhe San Petersburg, ku thuhej: “Sekretari i përgjithshëm z. Stefanoviq sapo më sqaroi që qysh dje qenka sjellur urdhri për evakuimin nga Shqipëria dhe sot në mëngjes u qenka dërguar trupave serbe. Pastrimi do të ndodhka në afat prej 8 ditësh”⁴⁰. Në favor të kësaj bën fjalë edhe dokumenti i hartuar në vitin 1920, nga Ministria e Punëve të Brendshme në Beograd, ku në të shprehimisht thuhej: “Me ardhjen e ushtrisë tonë në vitin 1912 dhe okupimin e Kosovës dhe Metohisë, ju dha një grusht vdekjeprurës idesë së Shqipërisë së Madhe, mirëpo paria shqiptare të përkrahur, kryesisht prej Austrisë, arritën ta krijojnë një Shqipëri të vogël si shtet të pavarur, e cila në sytë e krejt shqiptarëve luante rolin e “Piomenit”. Përveç asaj se populli serb është tepër i rrallë, ndërsa numri i madh i shqiptarëve

³⁹ ДАРМ, F. Arkivi i Vjenës: HHStA WIEN Polit. Archiv I Fasz. 1114 Ende, Vm=14 M F S., Graf Berchtold an Legationsrat von Storck in Belgrad, Telegramm, Wien, 17 Oktober 1913.

⁴⁰ Graf Berchtold an die k.u.k. Botschaften in Berlin, London, Paris, Rom und St. Petersburg, Telegramm, Wien, 20 Oktober 1913.

ngelën jashtë kufirit të Shqipërisë, kufijtë e përcaktuar politikisht ndërmjet Serbisë dhe Shqipërisë, nuk kanë pasur thuajse as çfarë rëndësie për shqiptarët e tokave tona, të cilët dëshironin që edhe ata të jenë pjesë përbërëse e shtetit shqiptar, nga e cila solli deri te revolta e shqiptarëve menjëherë pas vendosjes së paqes me Bullgarinë”⁴¹.

⁴¹ ДАРМ.Ф.В.И.М.344.К.Пов.Ц.Бр.2637: Меморандум о развоју садашње стање Албанско питање, Shkup, 16 qershor, 1920.

Doc. dr. Qerim LITA

SUMMARY

THE UPRISING OF SEPTEMBER 1913 AND THE ROLE OF ISA BOLETINI

The Albanian uprising of September 1913, based on archival sources, can be considered as an event of national Albanian importance after the declaration of independence. It was incited by Serbian military and police forces, who were given an ultimatum by the Great Powers for the Serbian forces to retreat within the borders defined by the Conference of London. As a response, Albanian citizens were not allowed to use trade in Dibër and Gjakovë. The uprising began on the 18-19th September of 1913 in Dibër, and later spread throughout the bordering area where the two Drina conjoin all the way to Ohër, in the axis Prizren-Dibër-Ohër. The uprising was under the command of Isa Boletini, Mehmet Pashë Deralla, Hysni Curri and Elez Isufi, who liberated the large part of Albanian lands including Shkupi and Peja.

Meanwhile, the Serbian military forces equipped with a modern artillery of the time, managed to reoccupy the liberated lands overtaken by the Albanian uprising, which action the Serbs killed and massacred thousands of Albanian civilians, as well as plundered and burned down entire Albanian villages in Lumë, Dibër, Strugë, Kërçovë, Gostivar etc.

These saddening events shocked the Austro-Hungarian authorities, who asked from the Government of Serbia that within a “period of 8 days to retreat its military forces from the Albanian territories', or the Austro-Hungarian Government 'would be obligated to undertake its own measures to ensure the fulfillment of the request”. As a result, the Serbian government withdrew its military forces from the Albanian land, and thereafter undertook an action to “disarm” the Albanian population in: Dibër, Strugë, Kërçovë, Gostivar etc. During this action, under the constant pressure of torture thousands civilians left their homes and moved to Tiranë, Durrës and Elbasan.

Prof. dr. Halim PURELLKU
(Shkup)

ZHVILLIMET POLITIKE NË SHTETIN SHQIPTAR DHE ISA BOLETINI NË VITET 1913-1915

Ndonëse më 12 dhjetor 1912, në Konferencën e Londrës, u njoh pavarësia formale e Shqipërisë, çështja e saj aty nuk u zgjidh përfundimisht¹. Shteti shqiptar gjatë viteve 1912-1915 ballafaqohet me një sërë sfidash si: mosdefinimi i kufirit shtetëror; caktimi i kryeqytetit të shtetit dhe çështja e caktimit të princit të Shqipërisë etj., të cilat stimulonin dhe më shumë kundërthëniet e brendshme politike, por dhe ndërthurjet e faktorëve të jashtëm në punët e brendshme shqiptare². Ndaj dhe për të siguruar njohjen e sovranitetit të Shqipërisë “në të gjitha territoret shqiptare” dhe për përshpejtimin e zgjedhjes së një mbreti, Ismail Qemali i shoqëruar nga Isa Boletini e Luigj Gurakuqi, në prill të vitit 1913 udhëtuan në një turne

¹ Андреј Митровић, Албанци у политици Аустро-Угарске према Србији 1914-1918, Срби и Албанци у XX веку, Београд, 1991, ф. 82, 85 - 88.

² ЦДА, Софија, ф. 176К, оп. 2, а е. 1376, л. 6, 11, 22, 41-43; а. е. 1378. л. 88, 141, 146, Рапорт Nr. 17 i konsullit të përgjithshëm bullgar Pavlov, kryeministrit bullgar Vasil Radoslavov etj., nga Vlora, më 12 nëntor 1913.

diplomatik në Romë, Vjenë, Paris e Londër³. Nga shtetet më të angazhuara rreth çështjeve shqiptare ishte dhe Mbretëria e Serbisë, e cila ishte fare e pakënaqur me rrjedhën e ngjarjeve në shtetin shqiptar dhe me kufijtë shtetëror të tij. Qeveria e Vlorës dhe veprimtaria atdhetare e Isa Boletinit ishin fort irrituese për Serbinë, sepse konsideroheshin si pengesa të mëdha në jetësimin e objektivave serbomëdha në Shqipëri, ndaj dhe serbët Ismail Qemalin e kishin vënë në shënjestër për ta likuiduar⁴.

Pas Luftës së Parë Ballkanike, udhëheqësit kryesorë të Lëvizjes Kombëtare nga viset e pushtuara nga Serbia u grumbulluan në territorin e shtetit shqiptar⁵, dhe po vazhdonin aktivitetet e tyre politike. Mehmet pashë Dërralla, ministër i Luftës në Qeverinë e Vlorës, në marrëveshje me Isa Boletinin, nga fundi i qershorit 1913, propagandonte haptazi për luftë kundër sllavëve në “Shqipërinë Verilindore”⁶. Pas shumë përpjekjesh, nga fundi i qershorit dhe fillimi i korrikut të vitit 1913, qe organizuar në Vlorë një konferencë e rëndësishme e prijësve shqiptarë nga të gjitha viset e Shqipërisë nën pushtimin serb e grek. Si duket, në atë konferencë prijësit shqiptarë deklaruan unitetin e tyre rreth Ismail Qemalit, sa që edhe

³ Ismail Qemal Vlora, *Kujtime*, Tiranë, 1997, f. 360.

⁴ [FO 195/2453], Nr. 42, (Konfidenciale), Zëvendës-konsulli Greig, drejtuar ambasadorit britanik Sir G. Lowther, Manastir, 5 korrik 1913, në: Lufrat ballkanike, Raporte Konsullore Britanike nga Maqedonia në vitet e fundit të Perandorisë Osmane, përgatitur për botim nga Robert Elsie dhe Bejtullah Destani, Përkthet nga anglishtja: Majlinda Nishku, Ilir Nishku, 2013, f. 203 - 204.

⁵ Државен Архив на Република Македонија (мë tej: ДАРМ), Скопје, Микрофилм бр. (мë tej: М) 30/465, Kraljevsko-Srpsko, Poverljivo, Br. 758. 8 oktobra 1913 god. Debar, Gospodinu Inspektoru Policije Gospodinu Gospodinu Dušanu Alimpiću, Bitolj, Načelnik Okruga, Nenshkrimi, (N. Ćirković^{-H.P.}).

⁶ [FO 294/51], Nr. 41, (Konfidenciale), Kopje për Konsullin e Përgjithshëm britanik, Selanik, Zëvendës-konsulli Greig drejtuar Sir G. Lowther, Kostandinopojë, 28 qershor 1913, në: Luftërat ballkanike, Raporte Konsullore Britanike nga Maqedonia...f. 188.

Esat Pasha që i detyruar formalisht të pranonte postin e ministrit të Brendshëm në Qeverinë e Vlorës.

Njëkohësisht, në këtë konferencë që arritur edhe pajtimi midis Bajram Currit e Riza Beut me Ismail Qemalin. Në këtë konferencë, pos që u zgjidhën disa çështje thjeshtë me karakter të brendshëm shqiptar, u morën edhe vendime të rëndësishme, dhe atë: të krijohet një Komitet/Këshill Qendror i veçantë, i obliguar për ta drejtuar luftën e armatosur çlirimtare kundër Serbisë e Malit të Zi deri në çlirimin e plotë të territoreve shqiptare. Në krye të këtij Komiteti që emëruar Irfan Ohri, i cili do të qëndronte në Elbasan dhe do të drejtonte veprimtarinë përtej kufijve shtetëror të Shqipërisë. Në konferencë u vendos të formohen “këshilla” brenda territorit shtetëror të Shqipërisë si dhe në trevat e pushtuara shqiptare, me në krye komisarët e tyre. Detyra kryesore e këtyre “këshillave” dhe komisarëve të tyre ishte të organizojnë dhe të përgatisin popullin për kryengritje e cila do të shpërthen kur do të vendos për të Këshilli/Komiteti Qendror⁷.

Nga ana tjetër, Serbia në forma të ndryshme dhe me mjete të ndryshme vazhdonte sabotimin e ngritjes së shtetit shqiptar dhe të Lëvizjes Kombëtare e irredentiste shqiptare. Për të arritur këto objektiva, Qeveria serbe kishte rekrutuar dhe disa figura politike shqiptare të kohës, nga të cilët edhe Esat Pashën. Për t’i qëndruar në krah Esat Pashës dhe për të ndihmuar forcimin politik të tij, që nga fundi i majit 1913 kishte arritur në Durrës edhe M. Balluxhig⁸. Ashtu që, po sa Komiteti/Këshill Qendror në fjalë filloi veprimtarinë

⁷ ДАРМ, Скопје, 30/М-465, Кралjevsko-Srpsko, Poverljivo, Br. 758. 8 oktobra 1913 god. Debar, Gospodinu Inspektoru Policije Gospodinu Dušanu Alimpiću, Bitolj, Načalnik Okruga, Nenshkrimi, (N. Ćirković^{-H.P.})

⁸ [FO 371/1827], Nr. 36, (Konfidenciale), Zëvendës-konsulli Greig drejtuar Sir G. Lowther - (Marrë nga Foreign Office më 24 qershor), Manastir, 14 qershor 1913, në: Luftërat ballkanike, Raporte Konsullore Britanike nga Maqedonia...f. 178.

e tij pasoi sabotimi i tij nga ana e Esat Pashës për interesa të ngushta personale⁹. Qe krijuar një opozitë e drejtuar nga Esat Pasha, qëllimi i së cilës ishte grushti i shteti kundër Ismail Qemalit¹⁰. Këto përplasje të brendshme, gjithsesi të mbështetura dhe nga faktorë të jashtëm, rezultuan me krijimin e kaosit politik-administrativ në vend. Ashtu që në aspektin politik e administrativ shteti shqiptar u copëtua në pesë rajone të veçanta dhe të pavarura nga njëra-tjetra, dhe atë: rajoni i Vlorës, i Durrësit, i Shkodrës, i Mirditës dhe i Matit¹¹. Lidhur me këtë, Esat Pasha i shkruante Hasan Prishtinës se populli i qarkut të Durrësit është “bashkuar e janë lidhur që urdhri tij (Ismail Qemalit-H.P.), në këto vende, të mos zbatohet me asnjë mënyrë”¹².

Ndërkaq, përgjatë muajve shtator-tetor revolta shqiptare kulmoi me Kryengritjen e njohur të Shtatorit të vitit 1913, e ndihmuar në formë jo zyrtare nga Qeveria e Vlorës¹³. Sipas historianit serb Dushan Batakoviç, kjo kryengritje qe organizuar me insistimin e Ismail Qemalit, si dhe me insistimin e tij Bajram Curri, Isa Boletini, Riza Beu, Isuf Elezi me fuqitë e tyre kishin sulmuar trupat serbe¹⁴. Kështu, forcat kryengritëse shqiptare çliruan përkohësisht nga pushtimi serb rrethet e Peshkopisë, të Dibrës, të Zhernanicës (Rekës), të Strugës dhe atë të Ohrit, ku dhe qe vendosur

⁹ ДАРМ), Скопје, 30/М-465, Кралjevsko-Srpsko, Poverljivo, Br. 758. 8 oktobra 1913 god. Debar, Gospodinu Inspektoru Policije Gospodinu Gospodinu Dušanu Alimpiću, Bitolj, Načalnik Okruga, Nenshkrimi, (N. Čirković-H.P.)

¹⁰ Hakif Bajram, Si e okupoi Serbia Kosovën më 1912, 1, Prishtinë, 2003, f. 141.

¹¹ ЦДА, София, ф. 176К, оп. 2, а е. 1376, л. 6, 11, 22, 41-43; а. е. 1378. л. 88, 141, 146, Raport Nr. 17 i konsullit të përgjithshëm bullgar Pavlov, kryeministrit bullgar Vasil Radoslavov etj., nga Vlora, më 12 nëntor 1913.

¹² АИИ, Тiranë, А-IV-335, Nr. inv. 1930, Materiale Arkivale II, 11.734, 13 Vjeshtë e parë 1329/1913.

¹³ АИИ, Тiranë, Vj. 23.18.1870, Dok. Nr. 116, Vlorë, 24. shtator 1913, konsulli austro - hungarez, Leibanec-Vlorë.

¹⁴ Душан Батаковиљ, *Косово и Метохија у србско-арбанашким односима*, Друго допуњено издање, Београд, 2006, f. 205 dhe 300.

pushteti kryengritës shqiptar¹⁵. Isa Boletini, që asokohe konsiderohej nga Qeveria serbe si një nga armiqtë e Serbisë¹⁶, në burimet dhe shtypin serb të kohës vlerësohet se ishte i angazhuar drejtpërdrejt në Kryengritjen e Shtatorit 1913¹⁷, sa që konsiderohej një nga drejtuesit kryesor të saj dhe një nga autorët e Planit të Kryengritjes¹⁸.

Sipas një raporti të von Stork, diplomat austro-hungarez në Beograd, 24 shtator 1913, shqiptarët nën komandën e Isa Boletinit “po përparonin në dy drejtime dhe pikërisht njëra pjesë për në Ohër, Resnjë dhe Prespë dhe pjesa tjetër kundra Tetovës dhe Gostivarit”¹⁹. Po kështu, edhe dr. Shajnoviq, diplomat serb, pohonte se: “Arnautët nën Isa Boletinin... që kishin ardhur nga Durrësi po përparojnë me sukses drejt liqenit të Ohrit dhe drejt Kërçovës respektivisht Galiçnikut-Mavrovës...”²⁰. Por, si duket misioni i M. Ballugxhiq, në Durrës, përkatësisht në territorin e shtetit shqiptar, që filloi nga maji i vitit 1913, rezultonte me suksese në thellimin e kundërthënieve ndër shqiptare. Kështu, nga gjysma e parë e muajit tetor 1913,

¹⁵ Qeveria e Përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj (28 nëntor 1912 - 22 janar 1914), Tiranë, 1963, dok. nr. 266, 275, 277, 280, 281, 282, 285, 286 dhe 296; AIH, Tiranë, A-IV-335, Nr. inv. 1930, Materiale Arkivale II, 11.759, Telegram nga Qukësi Nr. 390, 15 Vjeshtë e parë 1329/1913, Isufi, nëpunës (kryetar) i Qeverisë provizore civile të Ohrit, Prefekturës Elbasan; A-IV-336, Nr. inv. 1931, Materiale Arkivale, 11.961, 13 Vjeshtë e dytë 1329/1913, Prefekti i Elbasanit Aqif; Zekeria Cana, Populli shqiptar në kapërcyell të shekullit XX, Prishtinë, 1990, f. 175 - 176; Lajme të Brendme, “Perlindja e Shqipëniës”, Nr. 18, Vlonë, 28/11 Vjeshtë e I 1913; ; Богумил Храбак, Арбанашки упади и побуне на Косову и у Македонији од краја 1912. до краја 1915 године, Врање, 1988, f. 62.

¹⁶ Bogumil Hrabak, “*Elaborat srpskog Ministarstva inostrani dela o pripremanju srpske okupacije severne Albanije 1915 godine*”, Vjetar, I, II, Prishtinë, 1970, f. 11.

¹⁷ Душан Т. Батаковић, Косово и Метохија у српско-арбанашким односима..., f. 205

¹⁸ “Radničke novine”, Beograd, 13/26. 09. 1913.

¹⁹ AIH, Tiranë, Vj. 23.18.1866, Dok. Nr. 608, Belgrad, më 24 shtator 1913, Telegram shifër, nga von Stork, diplomat austro - hungarez.

²⁰ AIH, Tiranë, Vj. 23.18.1855, Dok. Nr. 615, Belgrad, më 25 shtator 1913, Telegram shifër.

mosmarrëveshjet midis anëtarëve të Qeverisë së Vlorës po thelloheshin dhe rezultuan edhe me largimin e shumë prej tyre nga qeveria, ndër ato edhe Hasan Prishtina dhe Mehmed Dërralla, ndonëse ky i fundit formalisht nuk kishte dhënë dorëheqje.

Largimi i Hasan Prishtinës nga Qeveria e Vlorës, dukshëm dobësoi pozitën e Ismail Qemalit²¹. Në janar 1914 Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit i mori kompetencat e Qeverisë së Vlorës²², kurse në mars 1914 arriti Princ Vidi në Shqipëri²³. Ardhja e Vedit në fronin shqiptar u pritë në mënyra të ndryshme në radhët e prijësve dhe të grupimeve politike shqiptare. Sipas një raport të komandantit serb të “trupave maqedono-kosovare”, Smiljanij: “Me rastin e pritjes së Princ Vedit në Durrës, Esat Pasha, Mehmed pashë Dërralla dhe Hasan beu Prishtina dukeshin shumë të padisponuar, ndërkaq shumë të disponuar ishin Bajram Curri, Isa Boletini dhe Musa Efendiu nga Prizreni, të cilët veç a veç ishin pranuar në audiencë”²⁴. Gjithashtu, rreth Vedit ishin tubuar të gjithë anëtarët e Qeverisë së Vlorës, të cilët u përfshinë dhe hynë në qeverinë e re në krye me Turhan Pashën²⁵. Por, përpara kaosit që po thellohej në Shqipëri, i shkaktuar nga

²¹ ЦДА, София, ф. 176К, оп. 2, а. е. 1376, л. 6, 11, 22, 41-43; а. е. 1378. л. 88, 141, 146, Raport Nr. 17 i konsullit të përgjithshëm bullgar Pavlov, kryeministrit bullgar Vasil Radoslavov etj., nga Vlora, më 12 nëntor 1913; САНУ, Документи о спољној политици Краљевине Србије, Књига VII, Свеска 2, 1/14 мај-22.јули/4. август 1914, Приредили Владимир Дедијер и Живота Анић, Београд, 1980, dok. nr. 364 f. 497.

²² Душан Т. Батаковић, *Косово и Метохија у српско - арбанашким односима, Друго допуњено издање*, Београд, 2006, f. 205.

²³ Душан Т. Батаковић, *Косово и Метохија у српско-арбанашким односима...*, f. 205,

²⁴ САНУ, Документи о спољној политици Краљевине Србије, Књига VII, Свеска 1, 1/14 јануар-30.април/13. мај 1914, Приредили Владимир Дедијер и Живота Анић, Београд, 1980, dok. nr. 466, f. 608.

²⁵ Shukri Rahimi, *Një elaborat i konsullit serb...*

“Lëvizja epirote” dhe “Kryengritja osmaniste” kundër Princ Vedit,²⁶ më 3 shtator 1914 princ u largua nga Durrësi (Shqipëria), dhe tani pushteti nominalisht kaloi në duart e Komitetit Ndërkombëtar të Kontrollit (KNK). Pas largimit të Vedit, Bajram Curri dhe Isa Boletini me fuqitë vullnetare nën komandën e tyre, u larguan nga Durrësi në drejtim të veriut²⁷. Pra, edhe gjatë vitit 1914, në kohën e të quajturit “kontrolli fiktiv” nga ana e Fuqive të Mëdha, shtetin shqiptar e kishte kapluar kriza e brendshme politike e shoqërore që e çonte vendin drejt anarkisë dhe kaosit²⁸. Nga faktorët kryesor motivues dhe nxitës të trazirave apo dhe krizave në shtetin shqiptar, ishin propagandat serbe, greke dhe aksioni i xhonturqve²⁹. Epilog i të

²⁶ САНУ, Документи о спољној политици Краљевине Србије..., Књ. VII, свеска I, dok. nr. 596, f. 761: Документи о спољној политици Краљевине Србије..., Књ. VII, свеска 2, dok. nr. 38, f. 162, nr. 37, f. 169-170. nr. 152, f. 287, nr. 248, f. 381.

²⁷ Ismail Qemal Vlora, Kujtime, f. 371.

²⁸ САНУ, Документи о спољној политици Краљевине Србије..., Књ. VII, свеска I, dok. nr. 24, f. 140. nr. 64, f. 189 - 191 dhe nr. 271, f. 407-408; САНУ, Документи о спољној политици Краљевине Србије, Књ. VII, свеска 2, 1/14 мај- 22 јули/ 4 август 1914, Приредио Владимир Дедијер, Живота Антић, Београд, 1980, dok. nr. 75, f. 206.

²⁹ Документи о спољној политици Краљевине Србије..., Књ. VII, свеска 2, dok. nr. 48, f. 178-179; Државен Архив на Република Македонија (мë tej: ДАРМ), Скопје, Фонд бр. (мë tej: Ф) 18- Краљевско српско посланство-Лондон (1879-1918), Кутија (мë tej: К.) 6, арх. един. 4, лист 5 (нë vazhdim sipas këtij shembulli: ДАРМ, Скопје, 18.6.4/5), Шифрирана телеграма Бр. 4527, 21.08./3.09.1914, Ministria e PJ, Legatës në Londër; САНУ, Документи о спољној политици Краљевине Србије..., Књ. VII, свеска 2, dok. nr. 48, f. 178-179; nr. 391, f. 526-536, nr. 392, f. 536, nr. 398, f. 541-542, nr. 443, f. 580-581, nr. 453, f. 587-588 dhe nr. 481, f. 617-620; Душан Т. Батаковић, Косово и Метохија у српско-арбанашким односима..., f. 207. (Administrata shtetërore serbe njësimin e kohës e bënte sipas kalendarit të vjetër gregorian, i cili dallonte nga ky i sotmi për 13 ditë).

gjitha këtyre zhvillimeve dhe të situatës së krijuar ishte, mbetja e shtetit shqiptar asokohe pa asnjë pushtet qendror³⁰.

Situatat e krizave të brendshme në shtetin shqiptar synonin t'i shfrytëzonin armiqtë e jashtëm. Nën pretekstin se shqiptarët nuk janë në gjendje të konsolidojnë shtetin dhe të sigurojnë ekzistimin e tij, që në fillim të vitit 1914 Italia hodhi idenë e pushtimit italo-austriak të Shqipërisë³¹. Menjëherë pasuan kërkesat e Serbisë për një okupim ndërkombëtar të Shqipërisë me pjesëmarrje të barabartë të të gjitha Fuqive të Mëdha, si dhe për rektifikimin e vijës së kufirit shtetëror në favor të sajë te Dibra, Luma dhe Prizreni³². Mirëpo, ideja e pushtimit të Shqipërisë nga fuqitë e jashtme nuk qe mbështetur nga Anglia dhe Franca³³, kurse kërkesës së Serbisë për rektifikim e vijës së kufirit shtetëror secila nga Fuqitë e Mëdha iu përgjigjën në varësi të pozicioneve dhe interesave të tyre³⁴. Ashtu që, kur Serbia nuk gjeti mbështetje për realizimin e pretendimeve territoriale tani ndaj shtetit shqiptar, jo vetëm nga ana e Fuqitë e Mëdha, por as edhe nga ana e Greqisë, në maj të vitit 1914 modifikoi kërkesat e saja dhe tani

³⁰ САНУ, Документи о спољној политици Краљевине Србије..., Књ. VII, свеска I, dok. nr. 24, f. 140.

³¹ ДАРМ, Скопје, 18.6.4/5, Шифрирана телеграма Бр. 28, Београд, 12/25.1.1914, Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ), Legatës serbe në Londër; САНУ, Документи о спољној политици Краљевине Србије, Књ. VII, свеска I..., dok. nr. 24, f. 140, nr. 64, f. 189-191. nr. 77, f. 201, nr. 98, f. 228-229.

³² САНУ, Документи о спољној политици Краљевине Србије, Књ. VII, свеска I..., dok. nr. 18, f. 137, nr. 108, f. 230 - 231, nr. 141, f. 271; САНУ, Документи о спољној политици Краљевине Србије, Књ. VII, свеска 2..., dok. nr. 13, f. 138 - 142.

³³ САНУ, Документи о спољној политици Краљевине Србије, Књ. VII, свеска I..., dok. nr. 66, f. 193 - 194, nr. 116, f. 245, nr. 453, f. 596.

³⁴ САНУ, Документи о спољној политици Краљевине Србије, Књ. VII, свеска I..., dok. nr. 71, f. 201 - 202.

deklarohej për autonominë e Shqipërisë vetëm me kusht, që të sigurohet dalje e lirë ekonomike në detin Adriatik³⁵.

Ndërkaq, Lëvizja Kombëtare Shqiptare vazhdonte përpjekjet për të sfiduar pretendimet hegjemoniste e territoriale të fqinjëve dhe të mbështetëseve të tyre. Që nga mesi i janarit 1914, ekzistonte një komitet ilegal shqiptar i quajtur “Shkipnia”, që kishte dhe programin e vetë. Duket se ky komitet njihej dhe me emrin Komiteti Shqiptar “Besa”? Komiteti/Shoqata “Shkipnia” kishte degët e tij në disa qytete dhe vise shqiptare brenda e jashtë kufijve të shtetit shqiptar. Ndër anëtarët e saj mendohej se ishin Isa Boletini (nga zona e Mitrovicës), Hasan Prishtina, Mahmud Gjura (nga zona e Pejës), Bajram Curri (nga zona e Gjakovës), Riza Beu (nga zona e Gjakovës), Mersim Dema (nga Malësia e Dibrës), dhe Ali Pustina (nga Dibra) etj. Programi politik i këtij komiteti ishte çlirimi dhe bashkimi i pjesëve të okupuara të Shqipërisë me shtetin shqiptar³⁶. Ndërkaq, fillimi i Luftës së Parë Botërore (fillimi i gushtit 1914), e gjeti shtetin shqiptar (Shqipërinë) pa kufij të përcaktuar përfundimisht dhe të pranuar ndërkombëtarisht. Ndaj dhe menjëherë pas fillimit të luftës, integriteti territorial i shtetit shqiptar qe kontestuar jo vetëm nga fqinjët, por edhe Antanta nuk i respektonte

³⁵ ДАМ, Скопје, 18.6.13/18-19, Пов. N=1810, Београд, 17/30.05.1914, Letër e Nikolla Pashiqit për Boshkoviqin, legati serb në Londër.

³⁶ [FO 294/53], Nr. 173, Z. Crackanthorpe drejtuar Sir Edward Grey - (Marrë më 16 shkurt), Beograd, 11 shkurt 1914 dhe 173. 1, Shtojcë në nr. 173, Zëvendëskonsulli Greig drejtuar Z. Crackanthorpe (Konfidenciale), Manastir, 29 janar 1914; në: Luftërat ballkanike, Raporte Konsullore Britanike nga Maqedonia...f. 313 - 315 Luftërat ballkanike; ДАМ), Скопје, 30/M-465, Kraljevsko-Srpsko, Poverljivo, Br. 758. 8 oktobra 1913 god. Debar, Gospodinu Inspektoru Policije Gospodinu Gospodinu Dušanu Alimpiću, Bitolj, Načalnik Okruga, Nenshkrimi, (N. Ćirković H.P.).

me konsekuencë marrëveshjet e Londrës mbi Shqipërinë³⁷. Kështu, Serbia, edhe në kushtet e luftës me Austro-Hungarinë, nuk hoqi dorë nga pretendimet territoriale ndaj shtetit shqiptar, që sipas ambasadorit francez dhe atij rus “nuk ekzistonte më”. Kështu p.sh. nga fundi i gushtit dhe në dhjetor të vitit 1914, Serbia iu kërkoi leje fuqive aleate për pushtimin e Shqipërisë, por për këtë, qe penguar nga qeveritë e fuqive aleate dhe të qarqeve të caktuara ushtarake serbe³⁸.

Ndërkohë, aksionet e çetave shqiptare kundër pushtuesit serb vazhdonin edhe gjatë viteve 1914-1915³⁹. Pas atentatit të Sarajevës, Austro-Hungaria përgatiste sulme (ndërhyrje) të reja nga territori i Shqipërisë kundër shtetit të Serbisë, me qëllim të hapjes së një fronti të dytë nga jugu kundër saj (Serbisë). Për këtë qëllim i pajiste me armë edhe parinë shqiptare, si: Isa Boletinin, Bajram Currin, Hasan Prishtina⁴⁰. Për të përfutur nga rasti i sulmit të Austro-Hungarisë ndaj Serbisë, nga mesi i korrikut 1914 filluan përgatitjet për një kryengritje çlirimtare në pjesën e Shqipërisë nën pushtimin e Serbisë. Përgatitjet dhe drejtimi i kryengritjes u ishin besuar Hasan Prishtinës, Isa Boletinit, Mehmed Dërrallës, Bajram Currit etj.⁴¹ Në kuadër të përgatitjeve për mësymje mbi ushtrinë serbe në “kufi”, më 17 korrik

³⁷ Драгослав Димитријевић Бели, Албанци у Србији и Југославији од 1912. до 1941. Године, Београд, 5. септембар 2014. Године, fq.20.; Срђан СЛОВИЋ, Косово и Метохија од 1900. године до почетка Првог светског рата, БАШТИНА, Приштина - Лепосавић, св.28, 2010, f. 289.

³⁸ ДАРМ, Скопје, 18.6.38/55, Телеграма Пов. Бр. 171, 27.08./...1914, Telegram i Legatës serbe, në Londër, МРЈ, në Nish; По ату, 18.6.21/32-33, Шифрирана телеграма N=. 355, Атина, 11/24.08.1914, Ballugxhiq, МРЈ; Душан Т. Батаковић, Косово и Метохија у српско-арбанашким односима..., f. 213.

³⁹ Душан Т. Батаковић, Косово и Метохија у српско-арбанашким односима, f. 205

⁴⁰ Душан Батаковић, *Косово и Метохија у српско-арбанашким односима...*, f. 206-207

⁴¹ Tahir Abdyli, *Hasan Prishtina, 1908-1933*, Prishtinë, 1990, f. 189.

1914 Isa Boletini me 60 veta u nisë nga Durrësi me vapor austriak për në Shëngjin, për të dal në kufirin me serbët, por qe detyruar të kthehet prapa. Ashtu që nga fundi i korrikut të vitit 1914 Isa Boletini dhe Bajram Curri ndodheshin ende në Durrës⁴². Ndërkaq, Hasan Prishtina, Selim Batusha, Bajram Daklani, Qerim bej Begolli, Halim bej Dërralla, me suitat e tyre, më 6 gusht 1914 shkuan nga Durrësi për në kufirin me Serbinë, përkatësisht përgjatë “vijës së demarkacionit” me Serbinë. Me vete morën armë e municione⁴³. Sipas shtypit të Vjenës dhe informatave tjera, në fillim të nëntorit 1914, kryengritësit shqiptarë tri herë i kishin sulmuar forcat serbe në trevën e Dibrës, dhe se çeta shqiptare vepronin për rreth Tetovës⁴⁴.

Rezultat i kësaj lëvizje kryengritëse të armatosur ishte çlirimi i Bregut të Matit nga trupat serbe⁴⁵. Përkatësisht, Serbia përpara ofensivës austro-hungareze dhe të lëvizjes kryengritëse shqiptare, deri nga fundi i tetorit 1914 i tërhoqi trupat e saja edhe nga të ashtuquajturat “pikat strategjike” në Shqipëri, por pas veti la në Durrës qeverinë proserbe të Esat Pashës. Pushtimi i Vlorës nga Italia më 25 dhjetor të vitit 1914, do të rezultonte me ndërlikimin edhe më të madh të pozitës ndërkombëtare të shtetit shqiptar gjatë vitit 1915, por dhe ashpërsimin e rivalitetit italo-serb në Shqipëri⁴⁶. Që nga mesi i shkurtit të vitit 1915 vazhduan përgatitjet ushtarake të Serbisë për

⁴² Hasan Prishtina, *Dokumente*, 1983, dok. Nr. 53, f. 94-96; Богумил Храбак, Арбанашки упади и побуне на Косову и у Македонији ..., f. 127.

⁴³ Богумил Храбак, *Арбанашки упади и побуне на Косову и у Македонији...*, f. 127.

⁴⁴ Богумил Храбак, *Арбанашки упади и побуне на Косову и у Македонији...*, f. 149-150.

⁴⁵ Tahir Abdyli, *Hasan Prishtina*, f. 189-190.

⁴⁶ ДАРМ, Скопје, Фонд бр. 17-Министерство за надворешни работи-Београд: (Јован Јовановиќ-Пижон), Кут. 2, арх. един. 38, стр. 80 (нë vazhdim sipas këtij shembulli: ДАРМ, Скопје, 17.2.38/80), Телеграм N= 60, Пов. Бр. 887, из Лондона-Ниш, 25.01/1915, Nga Ballugxhiq, ministri serb në Londër, Ministrisë së Punëve të Jashtme në Nish, Mbi qëndrimin e qeverisë angleze.

invadim në Shqipëri, nën pretekstin e mbrojtjes nga gjoja sulmet dhe provokimet e shqiptarëve ndaj trupave serbe përgjatë kufirit. Në shkurt 1915, në rajonin: Resnjë-Ohër-Strugë, Qeveria serbe kishte përqendruar rreth 3 000-4 000 trupa ushtarake shtesë⁴⁷, kurse në maj ishin të përqendruara aty rreth 15 000 trupa serbe, me synim të pushtojnë Pogradecin dhe pastaj Elbasanin⁴⁸. Përgatitjet e Qeverisë serbe për invadim në Shqipëri apo “për t’u mbrojtur nga Shqipëria”, si thoshte Grey, ministri britanik, ishin aprovuar edhe nga Britania që në maj të vitit 1915⁴⁹, duke e këshilluar Qeverinë serbe që trupat e saj të mos depërtojnë përtej “pikave strategjike” apo “rajonit strategjik”, e as në Elbasan⁵⁰.

Por, kur filloi pushtimi serb në shtetin shqiptar, dhe kur më 1 qershor të vitit 1915 serbët pushtuan Pogradecin dhe po përgatiteshin të pushtonin Elbasanin⁵¹, Italia rreptë e kundërshtoi invadimin serb në shtetin shqiptar⁵². Përballë rrezikut të angazhimit ushtarak italian në Shqipëri, me kërkesën e Britanisë (më 16 qershor 1915)⁵³, Rosisë dhe të Francës⁵⁴, Serbia qe e detyruar të ndërpres invadimin ushtarak të

⁴⁷ ДАРМ, Скопје, 1034.9.88/553-554, Nr. 26128, Raport i vice konsullit britanik në Manastir, Manastir, 16.02.1915 (i pranuar më 6. 03. 1915).

⁴⁸ ДАРМ, Британски конзули во Македонија 1797-1915, Документи, Редакција М-р Драги Ѓорѓиев, Скопје, 2002, dok. nr. 230, f. 442.

⁴⁹ ДАРМ, Скопје, 18.6.184/248, Пов.Бр. 476, Лондон, 25.04/...1915, Letër e Legatës (Boshkoviqit), nga Londra, MPJ, në Nish.

⁵⁰ ДАРМ, Скопје, 17.2.203/421-423, Телеграма N= 595, Лондон, 30/05.1915, Nga Boshkoviq, Londër, personalisht për Pashiqin, kryeministër i Serbisë, përkatësisht përgjigje për telegramin e tij nr. 1436.

⁵¹ Британски конзули во Македонија 1797 - 1915..., dok. nr. 230, f. 442.

⁵² ДАРМ, Скопје, 18.6.14/21, Шифрирана телеграма N= 123, из Београда, 24 maj/...1915, Pashiqi, Legatës serbe në Londër.

⁵³ ДАРМ, Скопје, 17.3.20/35-36, Телеграма N=612, Лондон, 4/17.06.1915, Nga Boshkoviq, Londër, personalisht për Pashiqin, kryeministër i Serbisë, përkatësisht përgjigje për telegramin e tij nr. 1477.

⁵⁴ Душан Т. Батаковић, Косово и Метохија..., f. 214.

Shqipërisë⁵⁵. Njëkohësisht agresioni serb ndaj shtetit shqiptar qe kundërshtuar në forma të ndryshme edhe nga shqiptarët. Sipas burimeve serbe, me nxitje të Isa Boletinit, Hasan Prishtinës, Bajram Currit etj., gjatë tërë muajit korrik 1915 po përqendroheshin me fuqi të armatosura shqiptare për së gjati kufirit me Serbinë, përkatësisht në zonat e Lumës dhe të Prizrenit, me qëllim të përgatitjeve për sulm ndaj Serbisë⁵⁶. Ndërkaq, përplasje midis fuqive kryengritëse shqiptare me trupat dhe xhandarmerinë serbe kishte edhe në gjysmën e parë të vitit 1915. Më 6 maj 1915 një grup më i madh kryengritësish të cilët ishin nga treva e Gostivarit (çeta e Gostivarit), kishin kaluar kufirin shtetëror lindor të Shqipërisë dhe kishin hyrë në Pollog dhe pas një shkëmbimi zjarri një kohë më të gjatë me forcat serbe mbetën të vrarë një oficer dhe dy ushtarë serbë. Pastaj çeta u rikthye në fshatin Radomir të Lumës dhe menjëherë qe vënë nën komandën e Mehmed Dërrallës. Ndërkaq, trupat serbe në ndjekje të Çetës së Gostivarit depërtuan drejt Lumës, përkatësisht drejt “Urës së Vezirit”, në Kukës, ku çeta ia doli të ndalon marshin e trupave serbe. Nga këtu Çeta marshoi në drejtim të Shkodrës, ku në luftë me malazezët qe rrethuar dhe u detyrua të dorëzohet. Gjithashtu, edhe Mehmed Dërralla me të birin Halimin si dhe Isa Boletini, iu dorëzuan malazezëve dhe pas një kohe qëndrimi në Shkodër u dërguan në Cetinë⁵⁷.

⁵⁵ ДАРМ, Скопје, 17.3.18/30-31, Телеграма N= 306, Пов. Бр. 6273, Софија, 5/18.06.1915, Nga Çollak Antiq, МРЈ, në Nish, mbi komentet në gazetën “Bëllgaria” pushtimi i Shqipërisë.

⁵⁶ Bogumil Hrabak, *Elaborat srpskog Ministarstva inostrani dela...*, f. 11.

⁵⁷ ДАРМ, Скопје, Фонд: Дипломатски Архив Белград, Микрофилм (më tej: М) бр. 472, Пов. N= 934, 31. Августа 1915 године, Ниш, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministrisë së Punëve të Jashtme; Богумил Храбак, *Арбанашки упади и побуне на Косову и у Македонији од краја 1912. до краја 1915 године*, Брање, 1988, f. 173 dhe 178.

Prof. dr. Halim PURELLKU

SUMMARY

THE POLITICAL DEVELOPMENTS IN ALBANIA AND ISA BOLETINI DURING 1913-1915

Albania found itself in an indefinite state after the independence, without any capital city, and with the pressing issue of appointing a prince, as well as with armed confrontation between rival groups within the country and the general stance against foreign intervention. As such, the years 1912-1915 are characterized with a series of events that unfolded in the political context, as well as in the form of armed confrontation within the country as well as against foreign military troops. Referring to consulted archival and literary sources, we value that Isa Boletini was the head of troops during these political developments which defended Albania's independence. Isa Boletini accompanied Ismail Qemali in April of 1913 in a diplomatic tour in Rome, Vienna, Paris and London, at a time when he supported Ismail Qemali and the Government of Vlora for as long as this government existed.

Isa Boletini strongly opposed the political division of Albania in London, which is why he is considered one of the most renowned personalities of Albanian irredentism. At the end of June 1913, he was engaged in organizing the war for liberation of Albania under Serbian and Montenegrin occupation. For this reason, at the beginning of July 1913 the Central Committee in Vlora was formed,

where Boletini was a member. As a result, a great anti-Serbian uprising was organized in September-October of 1913, which resulted with the temporary liberation of five sub-prefectures in which process Isa Boletini played an important role.

In March 1914 when Prince Wied arrived in Albania, Isa Boletini sided with the Prince and was admitted in the welcoming audience. However, after Wied left Albania in September of 1914, at a time when Albania was left with no central administration, Serbia's activities in achieving its territorial claims were intensified. As a result, Isa Boletini left from Durrës towards the northern border, where he focused on organizing his troops in actions against the Serbs throughout 1915.

Prof. dr. Hakif BAJRAMI
(Prishtinë)

PSE DHE SI U VRA ISA BOLETINI NË PODGORICË MË 23
JANAR 1916

Përfaqësuesi serb në Durrës, Panta Gavrilloviq, alarmoi qeverinë e Nikolla Pashiqit se Esat Pasha është në rrezik nga sulmi i dibranëve patriotë. Ndërsa, Prenk B. Doda do të ndryshojë qëndrim dhe do të pozicionohet në luftë kundër Serbisë, sepse ushtria serbe e kishte djegur një lokalitet në Mirditë. Por, ofensiva serbe kundër fshatrave shqiptare e kishte zemëruar komandantin rus Nikollaj Nikollajeviq. Kështu hyrja e ushtrisë serbe si okupatore në tokat e Shqipërisë bregdetare e pranuar në Londër më 1913 do t'i afroi në qëndrime austriakët dhe italianët që në momente të caktuara kishin qëndrime të njëjta kur ishin në pyetje shqiptarët. Kështu më 24 prill 1915 me kërkesë të E. Pashës forcat serbe okupuan Elbasanin dhe u drejtuan kah Tirana. Kështu ekspedita serbe prej 35 000-40 000 ushtarëve të armatosur shumë mirë, bëri plojë mbi fshatrat shqiptare.

Duke e vërejtur këtë zgjerim të ushtrisë serbe në tokat shqiptare pranë Antantës do të reagojë Athina dhe Roma zyrtare¹.

Gjatë muajit maj-qershor 1915 do të “harrohet” çështja e hapjes së Frontit të Dytë kundër Serbisë okupatore. Por, çuditërisht Hasan Prishtina dhe Isa Boletini do të maskohen në Lumë për një kohë në familjet patriotike lumjane, me ndërrime, herë në një lagje e herë në tjetrën, pa asnjë frikë se do të tradhtohen në besë. Pas një jave në fillim të qershorit Isa Boletini do të strehohet në Bytyç e pastaj largohet për në Shkodër. Në këtë kohë Isa Boletini qëndroi një kohë në Mirditë dhe Mat te Ahmet Zogu dhe Alush Lehja përkrahës i E. Pashës. Në këto rrethana Isa Boletini për t’i ikur duarve të serbëve që e kishin okupuar Lezhën dhe rrethuar Mirditën, nuk i mbeti rrugë tjetër përpos të kërkojë ndihmën e Kral Nikollës të cilin e njihte qysh nga viti 1911.

Meqë ushtria malazeze e okupoi Shkodrën, Isa Boletini kërkoi azil politik në përfaqësinë franceze. Francezët pastaj e dorëzuan në shtabin e Ushtrisë malazeze “për siguri të lartë”². Në kushte të një kapitullimi total nga ana e ushtrisë së Serbisë, agjentet e saj do të arrijnë që t’i konfrontojnë deri në luftë vëllavrasëse forcat e Esat Pashës me ato të Prenk B. Dodës. Për fat ky konflikt nuk zgjati, sepse shumë shpejt kapitulloi Serbia (15 nëntor 1915) dhe Mali i Zi (në janar 1916). Duke vërejtur kapitullimin, Hasan Prishtina dhe Bajram Curri do të përpiqen me forca solide t’i sulmojnë brigadat e Ushtrisë serbe në tërheqje nga pusitë dhe vendet strategjike sepse nuk kishin as municion e as numër të mjaftuar ushtarësh³.

¹DASIP B. “A. Odsek” za 1915. F. VII - Raport nga Durrësi, maj 1915.

² B. Hrabak, *Albanski upadi i pobune na Kosovu i Makedoniji od kraja 1912 do kraja 1915*, Vranje, 1986, f. 178.

³ A. Odsek, *Biografija Ise Boletinca*.

Kah mesi i tetorit 1915 Vilhelm Vidi si ushtar gjerman qëndroi një kohë në Vilajetin e Kosovës me qëllim që t'i organizojë me armë 150 000 kreshnikë shqiptarë. Vidi kishte llogaritur se para kësaj force së bashku me ushtrinë gjermane dhe bullgare, Serbia do të pësonte humbje duke llogaritur në atë se shqiptarët donin një Shqipëri që ishte e vizatar në Institutin e Berlinit me 1876 e që kufijtë veriorë shtriheshin deri në Nish. Në fund të nëntorit 1915 edhe Mirdita do të rreshtohet andej kah e ftonin për një kohë të gjatë oficerët e Vjenës. Më 16 tetor 1915 ushtritë e Bullgarisë e kishin okupuar Vrajën. Kështu, Esat Pasha arriti t'i bindë mirditasit mos ta sulmojnë ushtrinë e Serbisë. Jo vetëm kaq, më 17 tetor 1915 Ahmet bej Zogolli shkoi në Nish për të garantuar se nuk do t'i sulmojë ushtarët serbë në tërheqje kah deti Adriatik (kah Durrësi). Në këto rrethana edhe Esat Pasha urdhëroi forcat e veta që të sillen me korrektësi ndaj matjanëve të shitur te Pashiqi në Nish më 17 tetor 1915, përmes Ahmet Zogollit⁴.

Shqiptarët pas tërheqjes së ushtrisë serbe u ngriten fuqishëm kundër elementeve serbe që kishin bërë mizori për tri vite me radhë. Në Kosovë u ftuan Hasan Prishtina, Bajram Curri dhe Isa Boletini. Por, duke e vërejtur se shqiptarët do të riorganizohen, forcat malazeze dhe serbe organizuan sulm ndaj Isa Boletinit në Shtabin e Malit Zi dhe e likuiduan. Për këtë likuidim nuk do të dinë për dy muaj Hasan Prishtina dhe Bajram Curri. Pas tërheqjes së forcave serbe nga të gjitha qytetet e Vilajetit të Kosovës për të kaluar nëpër Malësinë e Madhe drejt detit, shqiptarët menduan se ka ardhur momenti historik për ta dëbuar Serbinë përgjithmonë nga trojet shqiptare. Një orientim i tillë zgjati gjatë tetorit-dhjetorit 1915,

⁴ B. Hrabak, v. cit. f. 183; *DASIP*. B. "A. Odsek" F IX 1915; D. Vasiq, *Dva meseca u Jugoslovenskom Sibiru*, 1916.

atëherë kur edhe Mbreti Petri dhe qeveria nga Merdari u orientuan për Prizren drejt Durrësit. Sulme ndaj reparteve të fundit serbe në tërheqje kanë ngjarë në vijat strategjike: Tullar-Prishtinë; Perpellac-Merdar-Prishtinë-Prizren.

Sulmi më i fuqishëm ndodhi në vijën strategjike Mitrovicë-Istog-Pejë-Deçan-Gjakovë-Prizren-Kukës. Sidomos kreshnikët e Junikut do t'i dëshmojnë aftësitë e tyre më 20 nëntor 1915 kur austriakët do t'i afrohen vijës strategjike Pazari i Ri-Ribar. Sulmet më të rëndësishme u ndërmorën nga pusitë dhe çetat e vogla, por efektive. Çka është me rëndësi, kreshnikët shqiptarë asnjë njeri me origjinë sllave nuk e kanë privuar nga jeta, e që nuk kishte armë në dorë, ose që nuk është ekspozuar në krime ndaj civilëve shqiptarë, si e kishin zakon oficerët dhe ushtarët serbo-malazezë.

Në këto rrethana do të ngriten shqiptarët e Istogut, Runikut dhe Pejës deri në Rozhajë. Vala kryengritës do të përhapet nga kreshnikët e Gjakovës, Hasit dhe Priernit më 27 nëntor 1915. Kështu një divizion i Moravës i thirrjes së dytë do të paaftësohet në tërësi. Nikolla Pashiqi pas një viti do t'i drejtohet Esat Pashës dhe Ahmet Zogollit se shqiptarët në tërheqje, në çdo pëllëmbë të tokave shqiptare na kanë sulmuar pa paralajmërim. Në lidhje me këtë situatë, dokumentet e kohës vërtetojnë se më 3 dhjetor 1915 kryengritja shqiptare ishte në kulm sidomos në trevat e Deçanit, Pejës dhe Plavës. Atëbotë llogaritej se 1 800 kryengritës të armatosur me sëpata dhe kmesa ishin dalë në front, sepse u mungonte armatimi. Isa Boletini në këtë kohë ishte azilant në Podgoricë, sepse francezët e dëshironin një fat të tillë për heroin shqiptar. Isa Boletini do të vritet më 23 janar 1916 në prag të Shtabit Madhor të Ushtrisë malazeze me urdhër të Kral Nikollës, Kral Petrit dhe agjentëve francezë e rusë. Nuk kanë munguar edhe punëtorët e Esat Pashës dhe Ahmet Zogollit sipas adjutantit të Nikollë Pashiqit. Të përfundojmë se askush nuk

mund t'i kuptonte sjelljet e Esat Pashës, Ahmet Zogut, Prenk B. Dodës.

Këta, sot ishin me një qëndrim, nesër e ndryshonin, sot ishin me një “gospodar”, të nesërmen ishin me një “senijor” ose “hazretleri”. Po kjo politikë është dukuri normale kur të merret shembulli i Italisë, e cila e filloi luftën në Bllokun me Gjermaninë dhe Austro-Hungarinë dhe për interesa, më 26 prill 1915 në Londër u kthye kundër aleatëve të deridjeshëm. Me këtë nuk dua ta arsyetoj tradhtinë, por dua të them që kujdesi ndaj tradhtarëve duhet të llogaritet në çdo çast të historisë⁵. Në prag të mbarimit të vitit 1915 në Peterburg, Beograd dhe Cetinë kishte filluar të qarkullojë një karikaturë ku Isa Boletini shihet duke e prerë me sharrë një pashë të Stambollit, i cili nuk kishte lejuar që Shqipëria të shpallet e pavarur.

Në karikaturën vijuese, Isa Boletini shihet duke u përgatitur për ta prerë me sharrë N. Iganitivein, sepse i kishte shfarsosë 714 fshatra shqiptare të Sanxhakut të Nishit më 1877-78, në saje të tradhtisë së Jilldyzit të Stambollit. Isa Boletini shihet duke u përgatitë që ta presë me sharrë Knjaz Nikollen e Malit të Zi se i kishte okupuar viset më të mira shqiptare: Tivarin, Ulqinin, Plavën, Gucinë, Istogun, Pejën, Deçanin dhe gjysmën e Gjakovës, nga viti 1881 e deri më 1912. Isa Boletini shihet në karikaturë duke e prerë me sharrë Vlladan Gjorgjeviqin, se po përhapte shpifje nëpër Evropë se “shqiptarët kanë bisht”. Prandaj, Isa Boletini kërcënohet se “Vlladanit Shumadisë do t'ia ngjes bishtin në lule të ballit me koburen që e mbaj në brez qe 30 vjet”. Isa Boletini shihet duke e prerë me sharrë Nikolla Pashiqin se kishte bërë krime mbi muhaxhirët shqiptarë, se i kishte okupuar dy vilajetet më të mira të trojeve shqiptare: atë të Kosovës dhe Manastirit. Isa Boletini shihet duke e kërcënuar me dy koburet e tij çdo individ që ishte konsideruar

⁵AVIIB. P. 4. F. 12.

armik i Shqipërisë. Në këtë propagandë qëndron prapavija e vrasjes së Isa Boletinit në Podgoricë, gjithnjë në shenjë hakmarrjeje ndaj parisë politike shqiptare, më 23 janar 1916.

Isa Boletini, propagandohej në fund të vitit 1915 në shtypin e disa shteteve të Ballkanit dhe nëpër zyrtarë e disa fuqive evropiane kinse kishte deklaruar se: “Nuk kam sharrë tani për tani: për sulltanin e Stambollit për Kral Petrin e Shumadisë, për Kral Nikollën e Cerna Gorës, sepse janë kah shkojnë në varr”⁶. Beogradi nuk do t’ia falë Isa Boletinit që e shoqëroi Ismail Qemalin nëpër Evropë (me veshjen karakteristike kombëtare), me çka tregonte se është përfaqësues i Vilajetit të Kosovës, të cilin Serbia e kishte okupuar. Madje hapur Isa Boletini theksoi në Romë, Vjenë, Paris dhe Londër, se Kosova është dhe do të mbetet pjesë e Shqipërisë. Beogradi dhe Cetina nuk do ta falin kurrë Isa Boletinin sepse qëndroi me kreshnikët e tij të Kosovës deri në çastet e fundit me mbretin Vid, edhe atëherë kur të gjithë përfaqësuesit e Evropës ishin larguar nga Durrësi. Beogradi, Cetina dhe Peterburgu nuk do ta falin Isa Boletinin pse nuk doli në përkrahje të tradhtarit Esad Pasha, i cili pretendonte të kthehet në krye të fronit shqiptar më 1915⁷.

Disa supozime për arsyet e vrasjes së Isa Boletinit do të rreshtohen si në vijim:

1. Isa Boletini duhej të likuidohej sepse gjatë viteve 1881-1892 i ka ndihmuar mbi 200 000 muhaxhirë të Sanxhakut të Nishit, të Sanxhaut të Pirotit me ushqim, veshmbathje dhe ndërtim e shtëpish;

2. Isa Boletini duhej të vritej sepse më 28 qershor 1889 në Mitrovicë vritet një serb i moshës 25-vjeçare nga muhaxhirët e

⁶*Arkivi i Jugosllavisë*, Personalitet politike të shqiptarëve në formë leksikoni (1910-1929).

⁷*Po aty*; Biografia e East Pashës: “Svi albanci ne misli kao Esat Pasha 1919”.

armiqësuar në Serbinë. Dhe valiu i Kosovës pas vizitës në Mitrovicë në fund deklaroi se: “Ju serbët jeni në besë të Isa Boletinit”, duke e njohur autoritetin e Isa Boletinit në radhët e muhaxhirëve dhe shqiptarëve në përgjithësi.

3. Isa Boletini duhej të vritet sepse më 26 qershor 1890 në Prishtinë vritet konsulli serb nga një muhaxhir me urdhër të Isa Boletinit. E vërteta është se konsulli serb vritet pas një fyerje që ia bën shqiptarit nga dera e konsullatës.

4. Isa Boletini duhet të vritej sepse më 1897 në fshatin Strellec së bashku me Haxhi Zekën, e ftojnë parinë shqiptare që të rreshtohen politikisht kah Anglia. Ky rreshtim politik e solli parinë politike shqiptare deri te “Besa-Besa” e Pejës më 1899, ku Isa Boletini ishte një nga krerët kryesor.

5. Isa Boletini u dënua me vdekje sepse më 1899 në “emër të tij janë vrarë 132 serbë” nëpër tërë Vilajetin e Kosovës. Për këtë akuzë shqiptarët akuzohen në Gjykatën e Drejtësisë në Hagë. Qeveria osmane e themelon një komision ku janë: ministri i Punëve të Brendshme nga Porta, valiu i Kosovës dhe dy popët serbë me përfaqësuesin e lokalitetit përkatës. Komisioni pas hulumtimit detal dymujor nëpër lokalitete, vjen në përfundim se e tërë akuza është e fabrikuar.

6. Isa Boletini dënohej me vdekje sepse më 1903 organizon vrasjen e konsullit rus në Mitrovicë (Shqerbinit);

7. Isa Boletini akuzohej për vdekje sepse më 1908 u angazhua me financat e tij të shumta që të mbahet Kuvendi i Ferizajt dhe Kongresi i Manastirit, me moton se “Tash e tutje duhet të punojmë për Shqipëri, duke e realizuar profecinë e ambasadorit Goshen” më 1880 në Stamboll kur thotë se: “Duhet të themelohet një Shqipëri nga Selaniku e deri në Jeni Pazar”. Të shënojmë këtu se Isa Boletini me

shitjen e gurëve të mullirit kishte të ardhura vjetore në mbi 4 000 pesëlirshe ari;

8. Isa Boletini dënohej me vdekje sepse më 26 dhjetor 1909 në Kullën historike të Hys Popovës vendosë sipas kërkesës së Isamil Qemalit dhe Hasan Prishtinës se në Vilajet duhet të fillojë kryengritja: “Kur bjen dushku prej rremit”, në stilin e Revolucionit Borgjez Francez (14 korriku 1789). Siç dihet Kryengritja filloi në Kulinë në prill 1910 atëherë kur dushku i malit fillon të bjerë;

9. Isa Boletini duhet të vritet sepse në gusht 1912 në Shkupin e çliruar ishte kundër Delegacionit të Fuqive Evropiane (rusi dhe austriaku) të cilët e stopuan marshimin e shqiptarëve kah Manastiri, me kërcënim: “çfarëdo rezultati të ketë lufta e juaj, ndryshim të kufijve të Perandorisë Osmane nuk ka”;

10. Isa Boletini duhet të vritet sipas Beogradit, Peterburgut, Podgoricës dhe Parisit sepse më 18 tetor 1912 nga forcat e tij u likuidua një brigadë e Serbisë dhe 6 oficerë të lartë të fuqive evropiane si instruktorë në Merdar të Llapit. Ai vend nga serbët edhe sot quhet Prevar, kinse shqiptarët kanë tradhtuar dhe se kinse paskan luftuar për ta mbrojtur padishahun.

11. Isa Boletini duhej të likuidohej sepse është përkrahës dhe krah më i fortë me kreshnikët e tij për Ismail Qemalin me rastin e shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë në Vlorë, më 28 nëntor 1912;

12. Isa Boletinit nga serbët nuk i falej për kërcënimet që i bënë përfaqësuesit diplomatik serb Ballugjiçit në Milano në prill 1913 në prani të Ismail Qemalit, Luigj Gurakuqit dhe Gjon Marka Gjoni se: “Derisa të jam gjallë nuk do të pajtohem me okupimin e çdo pllambë të tokave shqiptare”;

13. Isa Boletini nuk i falet që me veshjen e tij, me deklaratimet e tij ka bërë që të kuptohet kudo nëpër Evropë se deri ku shtrihen trojet e Shqipërisë, duke thënë se: “Nuk kam ardhë ta kërkojë

Mitrovicën, për çdo pllambë të tokave shqiptare të okupuara nga fqinjët”;

14. Isa Boletini duhet të ndëshkohet me vdekje sepse i ndikuar nga Hasan Prishtina, së bashku me Bajram Currin dhe Elez Isufin veprojnë publikisht me ndihmën e austriakëve që ta themelojnë Frontin e Dytë kundër Serbisë më 1915 në sektorin: Dibër-Tetovë-Shkup-Prizren-Pejë-Rozhajë.

15. Isa Boletini duhet të likuidohet sipas politikës pansllaviste, sepse në mënyrë sistematike është skalitë nëpër gazeta në formë dhe pamje karikature: duke i prerë me sharrë të gjithë ata pashallarë që e pengojnë themelimin e Shqipërisë autonome; duke e prerë me sharrë princin serb Millan Obrenoviq që i spastroi viset e Sanxhakut të Nishit nga shqiptarët; duke e prerë me sharrë Princin Nikollë Petroviq, sepse ia kishte aneksuar viset më të bukura bregdetare: Tivarin dhe Ulqinin; duke e prerë me sharrë Nikolla Pashiqin sepse e okupoj pjesën më të madhe të trojeve shqiptare, tërë Vilajetin e Kosovës dhe një pjesë të Vilajetit të Manastirit; duke e prerë me sharrë Valladan Gjorgjeviçin që bënte propagandë nëpër Evropë se: “Shqiptarët kanë bisht”. Isa vizatohet duke u kërcënuar: “Me këtë kobure do ta ia vejë në ballë një vrimë Vlladanit dhe aty do t’ ia nguli bishtin e tij të derrit”.

Prof. dr. Hakif BAJRAMI

SUMMARY

THE CIRCUMSTANCES SURROUNDING THE ASSASSINATION OF ISA BOLETINI

Isa Boletini was assassinated in Podgoricë while seeking asylum like Ymer Prizreni in 1886 at the French Consulate. The French authorities surrendered him to the Montenegrin authorities and they murdered him the exact same day when the Viennese authorities entered Mitrovicë and freed a group of Albanian politicians from the Montenegrin prisons, on the 23rd of January 1916. Isa Boletini was surrendered to the Montenegrin authorities on 10th of January 1916. He was sent to the Montenegrin Main Headquarters where a guard was appointed to him. According to available sources, Nicolas Djilas shot Isa Boletini with five bullets, which attack left him lifeless.

Prof. dr. Lush CULAJ
(Prishtinë)

**BASHKËPUNIMI I PATËR ËNGJËLL PALAJT DHE ZEF
GJIDODËS ME ISA BOLETININ**

Lëvizja Kaçake lindi si formë e rezistencës kundër pushtuesit të huaj. Me këtë emër njihet në periudhën turke në shekullin XV-XVI, e cila kishte më tepër karakter ekonomik se sa politik. Kjo lëvizje zgjerohet gjithnjë e më tepër dhe merr formën e rezistencës politike në truallin shqiptar, posaçërisht në gjysmën e dytë të shekullit XIX, e bëhet masive pas shuarjes së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Fjala “kaçak” me kuptimin etimologjik është e përbërë prej dy fjalëve turke “akt-kaçti” që do të thotë iku u duk. Por, fjala “kaçak” nuk jep shpjegimin se për ç’kategori të arratisurish bëhet fjalë, por vetëm do të thotë i arratisur nga pushteti. Organet shtetërore për shkak të interesave politike e përdornin këtë terminologji në kuptim të cubit, hajnit etj., duke tentuar që në popull për këta njerëz të mos ketë dashuri dhe të mos gëzojnë përkrahje, por

në të kundërtën, populli për ta të ketë urrejtje¹. Cilido që ka ngritur dorë kundër krerëve e nëpunësve në shërbim të pushtetit është quajtur nga pushtuesi hajn. Në një këngë popullore thuhet:

Nuk u vrava për hajni,

Vrava agën turqeli.

Mirëpo, lëvizja kaçake në Kosovë ishte lëvizje e masave popullore e mbështetur në traditat dhe luftërat e popullit shqiptar për liri nacionale. Ishte vijimi i luftës shekullore të popullit shqiptar kundër sunduesve të huaj. Kjo ishte luftë e grupeve të armatosura, në popull e njohur me emrin çeta. Forma e veprimit të tyre ishte lufta guerile, e sulmonin armikun në pika më të dobëta të tij, duke bërë sulme të furishme e tërheqje të shpejtë. Rrethana shoqërore dhe ekonomike në të cilat lëvizja kaçake lindi dhe u zhvillua ishin të ndryshme, varësisht nga koha e veprimit. Ndër shqiptarë kjo lëvizje forcohet posaçërisht në vitin 1908-1912 kundër Perandorisë Osmane².

Ishte koha kur në Kosovë u vendosen raporte të reja të ushtrisë turke që pretendonin shkatërrimin e lëvizjes shqiptare dhe ndërprerjen e komunikimit të trevave shqiptare në mes veti. Lëvizjet shqiptare për çlirim e kishin vënë në dukje propagandën e Qeverisë së Beogradit e cila frikësohej nga lidhja dhe bashkëpunimi i krerëve shqiptarë me Austrinë. Serbinë në mënyrë të veçantë e pengon aktiviteti i klerikëve katolikë që mund të shërbenin si urë ndërlidhje me Austrinë. Në shërbim të kësaj ishte edhe vendosja e lidhjeve në mes të Isa Boletinit dhe patriotit Patër Engjëllit të Gjakovës. Veprimtaria e këtyre dy atdhetarëve shqiptarë kishte filluar në Strellec, në fillim të vitit 1909. Engjëll Palaj u lind në Janjevë. Pas

¹ Limon Rushiti, *Lëvizja kaçake në Kosovë, (1918-1928)*, Instituti i Historisë, Prishtinë, 1981, f. 9.

² Po aty.

përfundimit të shkollimit më 1892 filloi shërbimin fetar në kishën katolike të Pejës, ndërsa prej vitit 1897 si prift shërbente në kishën e Zllakoqanit të Klinës. At Engjëll Palaj gjatë veprimtarisë së tij nuk u mur thjesht vetëm me shërbime fetare. Ai e orientoi veprimtarinë e vetë edhe në shërbim të interesave kombëtare³. Sipas të dhënave të gazetës “Vardar” të Shkupit të datës 18 janar 1909 dhe 11 mars 1909 Petër Engjëll Palaj kishte formuar një çetë luftarake antiosmane në Budisalc të Dukagjinit dhe e kishe vënë nën komandën e Zef Gjiododës dhe Çelit të Lukës. Këtë njësi që kishte afro 400 luftëtarë shqiptarë të besimit katolik, Patër Engjëlli e dorëzoi në komandën supreme të Isa Boletinit⁴.

“Lud Përlaska, (1918-1995) në Zllakuqan, duke cituar kujtimet e lëna nga babai i tij Marku, dëshmon për disa nga luftëtarët të cilët kanë marrë pjesë në brigadën kryengritëse antiosmane 400 anëtarëshe, të udhëhequr nga Zef Gjiododa, Qeli i Lukës (Pjetër Qeli) dhe Pjetër Gjiododa, disa prej të cilëve ishin: Mark Kolë Kqira nga Zllakuqani, Zef Mark Laska nga Zllakuqani, Mark Palush Palina nga Zllakuqani, Mark Ndue Përlaska nga Zllakuqani, Tomë Skeli nga Krusheva e Vogël, Ndrecë Lleshi nga Jagoda, Ndue Ndrecaj nga Jagoda, Bardhec Shllaku nga Paskalica, Musë Laci nga Dobërdoli, Bardhec Doda nga Dobërdoli, Canë Leci nga Dobërdoli Mark Buzhala nga Çabiqi, Tomë Pren Kola nga Budisalci, Llesh Ndrecja nga Jagoda, Gjokë Dedë Gjini nga Jagoda, Dedë Përlleshi nga Jagoda, Mark Përlleshi nga Jagoda, Dedë Grabanica nga Shtupeli, Llesh Grabanica nga Shtupeli etj”⁵. Formimi i kësaj çete antiosmane me përbërje të shqiptarëve katolikë, për kohën dhe rrethanat

³ Don Lush Sopi, *Famullia e Zllakuqanit*, Zllakuqan, 1997, f. 49.

⁴ Tahir Abdyli, “*Me rastin e 70-vjetorit të vrasjes së Isa Boletinit*”, Kosova, Instituti i Historisë-Prishtinë, nr. 15, Prishtinë, 1986, f. 19.

⁵ Don Lush Sopi, *Famullia....* f. 51.

ekzistuese kishte një rëndësi të veçantë, dhe ishte përkrahje konkrete që i bëhej luftës për çlirim kombëtar.

Çeta zhvilloi aktivitete luftarake dhe propagandistike shqiptare në rrethin e Pejës dhe para se të sulmohej nga ushtria osmane, e cila ishte duke i vënë në rreth, u tërhoqën nga Kosova dhe me Isa Boletinin në krye, shkoi në vise të Plavës⁶. Vetëvendosja e Isa Boletinit në ballë të njësisë shqiptare kryesisht katolike ku e kishte përkrah edhe Zef Gjiododën që e admironin shumë⁷, ishte dëshmi para faktorit ndërkombëtar mbi qëllimet kombëtare e jo fetare islame të lëvizjes. Nga ana tjetër patriotizmi i Patër Engjëllit dhe lufta vetëmohuese e Zef Gjiododës dhe Çelit të Lukës e bashkëpunimi i tyre me Isa Boletinin, ishte gjithashtu dëshmi bindëse dhe mohim i propagandës antishqiptare, në ballë të të cilave qëndronte Perandoria Osmane dhe Serbia, se shqiptarët katolikë luftonin për interesa të Evropës së krishterë. Pra, bashkimi i forcave ushtarake për një të vetmin qëllim - lirinë e popullit shqiptar dhe kultivimin e tolerancës vëllazërore midis shqiptarëve myslimanë dhe katolikë, ishte synimi kryesor i këtyre krerëve udhëheqës. Së këndejmi lidhja e Isait me krerët e kryengritësve katolikë në Kosovë i shërbeu atij për lidhje me Mirditë dhe me Malësi të Mbishkodrës, e kështu tërthorazi edhe me Komitetin e Kombit të formuar më 1909 në Bukuresht. Ai komitet kryesohej nga pretendenti për fronin shqiptar, princi rumun me prejardhje shqiptare Albert Gjika, i cili kishte ndikim në viset shqiptare të banuara me katolikë⁸.

⁶ Tahir Abdyli, *“Me rastin e 70-vjetorit të vrasjes së Isa Boletinit”*, f. 19; Fehmi Pushkolli, *Ati luftarak i gjeneral Boletinit*, Prishtinë, 1996, f. 56.

⁷ Raportet e mira që ishin në mes Isa Boletinit dhe Zef Gjiododës, u vazhduan me familjen Buletini edhe pas vrasjes së Isait. Kjo dëshmohet edhe nga kujtimet e Tafil Boletinit.

⁸Tahir Abdyli, pun. i cit. f. 19-20.

Sipas gazetës “Vardar” të 2 majit 1910 në Betejën e Carralevës të 22-23 prillit 1910, me kryengritës komandonte Isa Boletini, Hasan Hyseni, Musë Rahoveci, Adem Astrozubi dhe Mark Doda⁹. Dyshohet që gjatë marrjes së informatave rreth emrave gazetari të ketë gabuar sepse nuk njihet ndonjë udhëheqës me emrin Mark Doda. Vetë emri Doda na jep për të kuptuar se këtu është fjala për Zef Gjiododën, e aq më tepër kur dihen raportet dhe aktivitetet e përbashkëta të Zef Gjiododës dhe Isa Boletinit gjatë vitit 1909. Kjo mund të ndërlidhet edhe me migrimin e tyre të përbashkët në Plavë ku realisht mund të përgatishnin plane për kryengritjet vijuese.

⁹Po aty, f. 22.

Prof. dr. Lush CULAJ

SUMMARY

THE COLLABORATION BETWEEN FATHER ENGJËLL PALAJ AND ZEF GJIDODA WITH ISA BOLETINI

The Albanian movements for liberation had instigated the government released propaganda of Belgrade who feared the collaboration of Albanian leaders with Austro-Hungary. Serbia in particular was thrown off by the activity of the Catholic clerics who served as a connective bridge for establishing relations with Austro-Hungary. In attempts to establish these relations, Isa Boletini was in contact with the patriot, Father Engjëll from Gjakova. Their collaborative activity between these two patriots started off in Strelle at the beginning of 1909. Engjëll Palaj was born in Janjevë. After he finished his studies in 1892 he began his service as a clergyman at the Catholic Church in Peja, whereas from 1897 he served as a priest in the church of Zllakuqan in Klina. Father Engjëll Pali's activity was not limited to merely religious service. He oriented his activity towards national interests.

According to the data given by the newspaper 'Vardar' of Skopje dating 18th of January 1909 and 11th of March 1909, Father Engjëll Pala formed an anti-Ottoman fighting group in Budisallc of Dukagjini, under the leadership of Zef Gjidoda and Çeli of Luka.

This unit had about 400 Catholic Albanian fighters, and was later on under the leadership of Isa Boletini. The creation of this anti-Ottoman unit with Catholic Albanian soldiers had a particular importance in the road of national liberation.

Mr. sc. Fitim RIFATI
(Prishtinë)

**BASHKËPUNIMI I ISA BOLETINIT ME KRERËT E
TREVAVE LINDORE GJATË KRYENGRITJEVE TË
VITEVE 1910-1912**

Komunikimi dhe bashkëpunimi ndërmjet drejtuesve të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, ka qenë një ndër faktorët e rëndësishëm që kanë përcaktuar realizimin e programit të Rilindjes. Ngadhënjimi i Revolucionit Xhonturk më 1908, në fitoren e të cilit shqiptarët dhanë kontribut të çmuar e luajtën rol vendimtar, solli në qeverisje të Perandorisë Osmane partinë “Bashkim e Përparim” dhe njëherazi një fazë të re në marrëdhëniet ndërmjet shqiptarëve dhe regjimit të ri. Rrethanat e përgjithshme që mbizotëronin në viset shqiptare, si: operacionet ushtarake të Xhavit Pashës gjatë vitit 1909, taksat dhe tatimet e reja, përfshirja dhe angazhimi i detyruar ushtarak, veprimet e dhunshme për çarmatimin e shqiptarëve, përndjekjet policore kundër klubeve e veprimtarëve atdhetarë, reaksioni xhonturk kundër shkollave dhe alfabetit, tensionuan raportet ndërmjet shqiptarëve dhe regjimit xhonturk. Kjo situatë ngriti shkallën e pakënaqësisë, qëndrimeve të papajtueshme dhe veprimeve të armatosura kundër pushtetit e administratës osmane

dhe diktoi nevojën e organizimit dhe koordinimit të fuqive mendore, fizike dhe materiale të krerëve popullorë më me ndikim në nivel kombëtar.

Pozita gjeostrategjike e trevave verilindore shqiptare, që qonte në kufirin verior osman, ishte objektiv kryesor për Lëvizjen Kombëtare në Vilajetin e Kosovës që të paralizonte forcat ushtarake e administratën osmane dhe të ndërpriste komunikimin me Stambollin. Në këtë kontekst, si në Kryengritjen e vitit 1910 dhe Kryengritjen e Përgjithshme kundërosmane të vitit 1912, Gryka e Kaçanikut ishte pika kyçe që grumbullonte mijëra kryengritës për të realizuar strategjinë luftarake të hartuar nga Isa Boletini, Idriz Seferi etj. Ndonëse vinte nga pjesa veriore e Vilajetit të Kosovës, Isa Boletini shumë shpejt u bë i njohur brenda dhe jashtë Perandorisë Osmane. Si prijës kryesor i Lëvizjes Kombëtare, ai mori përsipër procesin e organizimit të lëvizjeve kryengritëse dhe u angazhua të sensibilizonte forcat më përparimtare të kohës përkrah programit të Lëvizjes.

Në këtë aspekt, ishte i pashmangshëm kontakti me krerët e trevave lindore, si: Idriz Seferi, Adem e Mustafë Kabashi, Islam Pira, Abdullah Presheva, Sali Aga, Mehmet pashë Dërralla etj. Isa Boletini kishte një bashkëpunim të ngushtë e të frytshëm veçanërisht me Idriz Seferin, i cili edhe pse ishte më i shtyrë në moshë tregonte respekt të vazhdueshëm për të. Kazaja e Gjilanit ishte arterie kryesore e trevave verilindore përfshirë kazatë e Preshevës, të Kumanovës e më gjerë në kuadër të Lëvizjes Kombëtare. Vështruar nga rrethanat politike të kohës, karakteristikë e këtij bashkëpunimi ishte formimi i komiteteve klandestine, organizimi i tubimeve të hapura dhe të fshehta, hartimi i planeve luftarake, lëvizja e forcave të armatosura nga një rajon në tjetrin dhe realizimi i synimeve kombëtare.

Pjesëmarrja e Isa Boletinit në kuvendet e tubimet kryesore që organizoheshin në Vilajetin e Kosovës, i dha atij rolin kryesor në Kryengritjen e vitit 1910. Për këtë çështje, bashkëpunimi i tij me krerët e trevave lindore sipas burimeve të kohës spikat në mbledhjen që u mbajt afër Shkupit në dhjetor të vitit 1909, ku përpos tij morën pjesë edhe Idriz Seferi, Bajram Curri e Hasan Hysen Budakova. Pas diskutimeve u morë vendimi për kundërshtimin e taksave të reja, për kryengritje kundër regjimit reaksionar xhonturk, duke nxjerrë edhe platformën për autonominë e Shqipërisë dhe formimin e një ushtrie kombëtare shqiptare¹.

Zinxhiri i tubimeve të ngjashme u forcua edhe me organizimin e tyre në rrethinën e Gjilanit në mars të vitit 1910, të cilat drejtoheshin nga Idriz Seferi. Në njërin nga këto tubime kishte marrë pjesë edhe Isa Boletini e krerë të tjerë të kësaj zone si: Adem Kabashi, Bislim Hogoshti, Sali Kupina, Ramë Pozherani, Fetah Proshi nga Kaçaniku i Vjetër, Zejnë Libishta, Zenel Aga nga Ballanca, Murat Bilalli nga Bresalci, Ismajl Biçaku, Bislim Hogoshti nga Hogoshti dhe Latif Matoshi nga Gmica etj. Aty u vendos të ndërmerreshin masa të shpejta për organizimin e kryengritjes si: vizita e çdo krahine dhe fshati për t'u kumtuar prijësve të tyre programin e kryengritjes dhe domosdoshmërinë e mbështetjes së tij; pajisja me armë të çfarëdo lloji në mungesë të tyre; krijimi i formacioneve të para vullnetare, të cilat do të ishin të gatshme për aksion në çdo moment që ndjehej e nevojshme; moslejimi i djegies së fshatrave shqiptare sikurse gjatë operacioneve të Xhavit Pashës

¹ Ramiz Abdyli, *Lëvizja Kombëtare Shqiptare 1908 - 1910*, Instituti i Historisë - Prishtinë, Prishtinë, 2004, f. 317.

dhe vënia e kontaktit me kazanë e Preshevës dhe Karadakun e Shkupit për të bashkërenduar zhvillimin e kryengritjes².

Qëndrimi i kohëpaskohshëm i Isa Boletinit në kaza të Gjilanit, i dha krerëve të kësaj zone rëndësi dhe përgjegjësi specifike përballë trevave lindore në kuadër të planit strategjik të kryengritjes. Përkundër vështirësive, tashmë kontaktet e Isa Boletinit me udhëheqës të trevave lindore, sidomos me Idriz Seferin, u bënë të pandërprera. Ndër rastet e bashkëpunimit të tyre, ishte edhe takimi së bashku me Hasan Hysen Budakovën në fshatin Sedllar afër Grykës së Carralevës, në të cilin përveç çështjes së furnizimeve me ushqim dhe armë, u hartua plani i përgjithshëm dhe u ndanë detyrat kryesore të veprimeve të armatosura, ku Idriz Seferi mori përgjegjësinë të përqendrohet me forcat e tij kryengritëse në të gjitha hyrjet e daljet e Grykës së Kaçanikut dhe në lindje të saj, ndërsa Isa Boletini dhe Hasan Hysen Budakova do të koncentroheshin në terrenet malore në perëndim të Grykës së Kaçanikut drejt Grykës së Carralevës. Në momentin që do të merrej Gryka e Carralevës, përmes lajmëtarëve të tij, Isa Boletini e Hasan Hysen Budakova do ta informonin dhe sugjeronin Idriz Seferin për të marrë nën kontroll Grykën e Kaçanikut³. Për të sensibilizuar dhe përhapur në masë kryengritjen në prag të fillimit të saj, dhjetëra përfaqësues të Lëvizjes Kombëtare të

² Aliriza Selmani, *Gjilani me rrethinë 1908 - 1912*, Lidhja e Historianëve Shqiptar “Ali Hadri”, Prishtinë, 1998, f. 111; Naim Musliu, “*Gjilani me rrethinë në Kryengritjen e Kosovës të vitit 1910*”, në *Kryengritja e vitit 1910 në Kosovë*, Instituti i Historisë - Prishtinë, 2012, f. 110 - 111.

³ Fatmira Musaj, *Isa Boletini (1864-1916)*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë & Instituti i Historisë, Tiranë, 1987, f. 82-83; Shaban Hashani, “*Isa Boletini dhe rezistenca shqiptare kundër pushtuesve turq në Ferizaj dhe rrethinë më 1908-1910*”, në *Isa Boletini dhe koha e tij*, Instituti i Historisë-Prishtinë, 1998, f. 70.

kazasë së Gjilanit shkuan në kazanë e Preshevës për t'i lajmëruar dhe kërkuar që sa më parë të përgatiteshin për kryengritjen e armatosur⁴.

Kështu, rreth 3 000 kryengritës të trevave lindore u grumbulluan përkrah Idriz Seferit në Grykë të Kaçanikut. Drejtuesit kryesorë të kësaj kryengritje kishin vendosur që ata të cilët do ta tradhtonin procesin e kryengritjes do të dënoheshin me konfiskim dhe shkatërrim të pasurisë dhe masa të tjera ndëshkimore si marrja e pushkës e të lëçiturit. Çdo shqiptar i aftë për pushkë duhej të dilte për të luftuar kundër ushtrisë osmane.

Tashmë grupe kryengritësish kishte kudo në Vilajetin e Kosovës, ndërsa numri i tyre arrinte deri në 30 000⁵. Koncentrimi i kryengritësve të viseve lindore ishte Gryka e Kaçanikut. Futja nën kontroll e Grykës së Kaçanikut më 23 prill 1910, nga ana e kryengritësve të trevave lindore, në krye me Idriz Seferin, alarmoi qeverinë në Stamboll, e cila urdhëroi forcat ushtarake të vepronin⁶. Edhe në Grykën e Carralevës, ku forcat kryengritëse qëndronin përkrah Isa Boletinit, mbështeteshin edhe prej grupeve kryengritëse nga kazaja e Gjilanit, kazaja e Preshevës etj., madje ndër drejtuesit e Betejës së Carralevës ishte edhe Abdullah Presheva, udhëheqës kryesor i Lëvizjes Kombëtare në kazanë e Preshevës. Ndonëse u thyen në pikat kryesore të qëndresës, si rezultat i epërsisë numerike dhe arsenalit më të sofistikuar luftarak të forcave osmane dhe përkundër persekutimeve që autoritetet osmane bënë ndaj familjeve

⁴ Arkivi i Institutit të Historisë Tiranë (më tej: AIHT), fondi: Arkivi i Vjenës, Vj. 20-5-5, Raport i konsullit austro - hungarez nga Shkupi dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, 23 maj 1910.

⁵ A. Selmani, Gjilani..., f. 117.

⁶ AIHT, Vj. 20-5-537, Telegram i konsullit austro - hungarez nga Mitrovica dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, 6 maj 1910; Zekeria Cana, *Lëvizja Kombëtare Shqiptare në Kosovë 1908-1912*, Prishtinë: "Rilindja", 1979, f. 108.

të tyre⁷ ruajtja e kontakteve dhe përpjekjet për bashkëpunim ndërmjet Isa Boletinit dhe Idriz Seferit, si përfaqësues i trevave lindore, vazhduan edhe më tej. Kështu, në gjysmën e dytë të qershorit të vitit 1910, ata ishin pjesëmarrës në një takim që u realizua në Kolesjan të krahinës së Lumës, ku sërish lidhën "Besën e Madhe" për t'i rezistuar ushtrisë osmane që po depërtonte drejt kësaj krahine⁸. Se bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet tyre ishte i papranueshëm dhe i rrezikshëm për autoritetet osmane, tregon edhe fakti se ata u dënuan me vdekje në mungesë, ndërsa disa prijës të tjerë u ekzekutuan me varje nga gjyqi ushtarak i formuar ekskluzivisht për dënimin e drejtuesve, pjesëmarrësve të kryengritjes si dhe familjeve të tyre⁹.

Kalimi i Isa Boletinit për strehim në Malit të Zi¹⁰ ndërpreu përkohësisht lidhjet e tij të drejtpërdrejta me krerët e Lëvizjes Kombëtare të trevave lindore, mirëpo ato u rigjallëruan sidomos në vitin 1912. Pretendimet e qeverisë xhonturke për të komprometuar Isa Boletinin, Idriz Seferin dhe krerë të tjerë në prag të Kryengritjes së Përgjithshme kundërosmane, nuk patën sukses. Ata, si një trup i bënë ballë manovrave të tilla¹¹. Në trevat e rrethinës së Gjilanit dhe më gjerë, që nga koha kur Kryengritja e vitit 1910 ishte shuar nga ana e ushtrisë osmane, urrejtja dhe kujtimi mbi vrasjet dhe masakrat ndaj atdhetarëve shqiptarë në këto anë nuk ishte harruar. Idriz Seferi mendonte se një kryengritje e re kundër regjimit xhonturk ishte e

⁷AIHT, Vj. 20-5-527, Telegram i konsullit austro-hungarez nga Shkupi dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, 2 maj 1910.

⁸R. Abdyli, Lëvizja..., f. 394.

⁹Po aty, f. 396; AIHT, Vj. 20-5-537, Telegram i konsullit austro-hungarez nga Shkupi dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, 9 maj 1910.

¹⁰F. Musaj, Isa..., f. 91 - 92.

¹¹Po aty, f. 122 - 123.

pashmangshme dhe se ai do të ishte ndër të parët e kësaj ane që do t'i rrokte armët dhe të luftonte sërish atë.¹²

Ndonëse veprimet e para kryengritëse nisën në trevat perëndimore të Vilajetit të Kosovës grupe çetash nga trevat verilindore po angazhoheshin me pjesëmarrjen e tyre në zonën e kryengritjes. Situata përgjithësisht e tensionuar, që kishte kapluar Vilajetin e Kosovës, po paralajmëronte se shqiptarët tashmë kishin vendosur për një kryengritje me përmasa mbarëkombëtare dhe jo sikur ato të mëparshmet, prandaj kjo formë e lëvizjes kishte ndikuar në mobilizimin e gjithë udhëheqësve shqiptarë. Kështu, në gjysmën e parë të majit të vitit 1912, mbi dyzetë krerë nga rrethet e Drenicës, Gjilanit, Llapit e viseve të tjera, po prisnin shenjë e kryengritjes në Boletin nga Isa Boletini¹³. Ndërkaq, më 21 maj 1912, Idriz Seferi me bashkëluftëtarët e tij, pasi që kishte braktisur Gjilanin, ishte bashkuar me forcat kryengritëse të drejtuara nga Isa Boletini në Drenicë¹⁴.

Krerët e Gjilanit, kohë pas kohe po qëndronin në Boletin tek Isa Boletini¹⁵, ndërsa më së tepërmi në këtë drejtim shquhej Idriz Seferi¹⁶. Gjatë punimeve të Kuvendit të Junikut (21-25 maj 1912), në të cilin mori pjesë edhe Isa Boletini shqiptarët e kazasë së Gjilanit dhe Sanxhakut të Shkupit deklaroheshin telegrafisht se i pranonin paraprakisht të gjitha vendimet që do të dilnin nga punimet e tij¹⁷.

¹²AIHT, Vj-22-11-1104, Telegram i konsullit austro-hungarez në Shkup dërguar MPJ në Vjenë, më 8 shkurt 1912.

¹³*Kryengritja shqiptare e vitit 1912 në dokumente serbe*, Përgatitur nga Zekeria Cana, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2008, f. 183.

¹⁴ R. Abdyli, *Lëvizja Kombëtare Shqiptare 1911-1912*, Instituti i Historisë-Prishtinë, Prishtinë, 2004, f. 234.

¹⁵AIHT, Vj-22-20-2095, Raport i konsullit austro-hungarez në Mitrovicë dërguar Ambasadës së Austro-Hungarisë në Stamboll, 18 qershor 1912.

¹⁶AIHT, Vj-22-10-1027, Raport i ambasadës austro-hungareze në Stamboll dërguar MPJ në Vjenë, 24 qershor 1912.

¹⁷ *Dokumente serbe...*, f. 256.

Veprimtaria e tyre përcillej në çdo hap nga ana e autoriteteve lokale ose agjentëve të tyre, e në raste të ndryshme edhe pengohej. Konsulli austro-hungarez në Shkup, Heimroth, e konsideronte si revolucionar aktivitetin e Idriz Seferit për të propaganduar lëvizjen kryengritëse në këto anë dhe zënien e Grykës së Kaçanikut. Për këtë çështje, Idriz Seferi kishte arritur të manipulonte me autoritetet osmane në Gjilan, që të shkonte në Junik për gjoja “shërbimin informativ”, por i kishte gënjyer ato dhe se ishte bashkuar me kryengritësit në Rrafshin e Dukagjinit. “Në shtëpinë e Seferit - shkruante ky konsull - më pas u bënë përkufizime (kontrollime, F. R.) që nuk dhanë rezultat”¹⁸.

Ideja e vënies në dorë të qytetit dhe Grykës së Kaçanikut kishte të bënte me strategjinë luftarake të Idriz Seferit për të bllokuar depërtimin e forcave osmane në drejtim të viseve të tjera të Vilajetit të Kosovës. Prandaj, kur të arrihej bllokimi dhe marrja e kësaj gryke, çlirimi i qyteteve të tjera të Vilajetit të Kosovës, do të ishte më i lehtë. Për këtë çështje ai po interesohej që të çonte në këmbë tërë sanxhakun e Prishtinës¹⁹.

Ngjarja e Hogoshtit, në të cilën shqiptarët kishin vararë nëpunësin policor (mydyrin) e kazasë së Gjilanit, i kishte dhënë hov lëvizjes kryengritëse në trevat e Karadakut dhe kështu, në fund të këtij muaji e posaçërisht në fillim të muajit korrik 1912, do të shpinte këto treva në mesin e zonave kryengritëse. Në nxitjen e kësaj vale kishte reflektuar në masë të madhe qëndrimi i herëpashershëm i Isa Boletinit në këtë kaza, ku gjatë fundit të qershorit dhe fillimit të korrikut ishte takuar me krerët e Lëvizjes Kombëtare të këtyre viseve

¹⁸ AIHT, Vj-22-20-2033, Informacion i konsullit austro-hungarez në Shkup dërguar Ambasadës së Austro-Hungarisë në Stamboll, 11 qershor 1912.

¹⁹ *Dokumente franceze për Shqipërinë dhe shqiptarët më 1912*, Vëllimi I, zgjodhi, përgatiti dhe redaktoi prof. dr. Muhamet Shatri, Instituti i Historisë - Prishtinë, Prishtinë, 2004, f. 140.

si Idriz Seferi e Sali Aga. Me këtë rast bëhej edhe shpërndarja e armëve për kryengritësit.²⁰ Pas konsultimeve u vendos që të sulmohej Gryka e Kaçanikut ose qyteti i Prishtinës, si nyje kryesore e komunikacionit në drejtim të veriut. Këtij plani i ishin bashkuar edhe Mehmet Pashë Dërralla i Tetovës dhe ish-deputeti i Shkupit, Sait Idriz Hoxha²¹.

Meqenëse autoritetet osmane ishin të alarmuara për një lëvizje të kryengritësve të kësaj ane në drejtim të Kaçanikut, ato ishin detyruar të dërgonin forca ushtarake nga Kumanova për të përforcuar garnizonin në Grykën e Kaçanikut dhe kështu për të penguar marrjen e saj nga ana e shqiptarëve të këtyre trevave. Prandaj, për të qetësuar situatën në kazatë e Gjilanit dhe Preshevës ishin dërguar disa bateri artilerie nga Shkupi në drejtim të Kumanovës²². Mirëpo, më 23 korrik 1912 ishte zhvilluar një përleshje e armatosur ndërmjet kryengritësve të Shkupit, Gjilanit dhe të Tetovës me forcat e vendosura në Grykën e Kaçanikut. Të nesërmen forcat osmane kishin pësuar disfatë, ndërsa ushtarët e zënë rob, u çarmatosën dhe u liruan²³. Për më tepër, kryengritësit e kazasë së Gjilanit përmes të dërguarve të tyre kishin njoftuar fshatrat e Karadakut të Shkupit për të përgatitur sasi të mjaftueshme ushqimi, që tregonte planet e tyre për t'u nisur në drejtim të Shkupit, por edhe qyteteve të tjera²⁴.

²⁰Po aty; f. 154, 190; *Dokumente serbe...*, f. 311; Ramiz Abdyli, "Shtypi bullgar mbi Kryengritjen e Përgjithshme Shqiptare të vitit 1912", Gjurmime albanologjike - seria e shkencave historike, nr. 25-1995, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1997, f. 126; Sadulla Brestovci, *Lëvizja Kombëtare në Kazanë e Gjilanit - Islam Pira (1861-1931)*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2008, f. 149.

²¹ *Dokumente serbe...*, f. 395, 397.

²² *Dokumente franceze...*, f. 194.

²³ Po aty, f. 2008; AIHT, Vj-22-20-2026, Relacion i konsullit austro - hungarez në Shkup dërguar Ambasadës së Austro - Hungarisë në Stamboll, 28 korrik 1912.

²⁴ A. Selmani, *Gjilani...*, f. 258 - 259.

Pas çlirimit të Mitrovicës, më 26 korrik 1912, Isa Boletini u nis me forcat e tij drejt juglindjes së Vilajetit të Kosovës²⁵. Ndërsa, dy ditë më vonë u çlirua edhe qyteti i Gjilanit²⁶. Çlirimi i Gjilanit kishte ndikuar që autoritetet osmane në kryeqendrën e Vilajetit të Kosovës në Shkup të nxirnin topat në llogore në pjesën veriperëndimore të Shkupit në drejtim të kazave të Gjilanit dhe të Preshevës²⁷. Pasi që kishte ardhur komisioni qeveritar për të biseduar me kryengritësit rreth kërkesave të tyre, po përgatiteshin edhe përfaqësuesit e trevave lindore për të shkuar në Prishtinë. Një ditë pas u çlirua qyteti i Gjilanit, Idriz Seferi, së bashku me udhëheqës të tjerë të kësaj ane, kishte shkuar në Prishtinë. Ai, si përfaqësues i rrethinës së Gjilanit kishte marrë pjesë në bisedimet me anëtarët e Komisionit Qeveritar të cilat kishin filluar më 29 korrik pasdite. Aty merrte pjesë edhe Isa Boletini. Krahas qëndrimeve të ndryshme, ata si protagonist të shtresave progresiste kombëtare, u rreshtuan përkrah Hasan Prishtinës dhe programit të tij për autonomi²⁸.

Duke parë që “14 pikat e Hasan Prishtinës”, të paraqitura në Kuvendin e Ferizajt më 6 gusht 1912, nuk kishin marrë akoma përgjigje prej Komisionit Qeveritar, Idriz Seferi së bashku me Isa Boletinin po hartonin planin e fshehtë për çlirimin e Shkupit, plan ky që parashihte depërtimin në Shkup jo përmes Grykës së Kaçanikut ku ishte koncentruar një forcë e konsiderueshme ushtarake osmane, por përmes rrugëve të Kardakut të Gjilanit dhe Karadakut të Shkupit,

²⁵ F. Musaj, *Isa...*, f. 143-144.

²⁶ *Dokumente franceze...*, f. 223.

²⁷ “*Politika*”, Beograd, 3061, 27.VII/10.VIII. 1912.

²⁸ F. Musaj, *Isa...*, f. 145; *Dokumente franceze...*, f. 223; *Dokumente serbe...*, f. 436, 442, 447; “*Dokumente italiane për Lëvizjen Kombëtare gjatë gjysmës së dytë të vitit 1912*”, hulumtuan, përzgjedhën dhe përgatitën: Ramiz Abdyli dhe Muhamet Shatri, Arkivi i Kosovës, Vjetar, nr. XXXI-XXXII, Prishtinë, 2004, f. 255; Nevila Nika, *Përmbledhje dokumentesh mbi kryengritjet shqiptare (1910 - 1912)*, Instituti i Historisë - Prishtinë, Prishtinë, 2003, f. 286-288, 297.

Preshevës e Kumanovës²⁹. Kështu, krerët e kryengritësve shqiptarë nga Ferizaj u nisën për në Shkup. Në mesin e kryengritësve ishin edhe ata të rrethinës së Gjilanit. Me porosinë e Idriz Seferit ishin grumbulluar rreth 1 000 shqiptarë kryengritës nga kazaja e Preshevës për t'u nisur drejt Shkupit, e nëse do ishte nevoja edhe për ta sulmuar atë³⁰. Një pjesë e kryengritësve të zonës së Gjilanit, me Sali Agën në krye, çliruan qytetin e Kumanovës dhe më pas u nisën në drejtim të Shkupit³¹. Konsulli francez në Shkup P. Karlie, konsideronte se Idriz Seferi pritej ta rrethonte Shkupin me një kolonë që do të kalonte nga krahina e Moravës dhe Karadakut përmes fshatrave Bllata (Bllaca, F. R.), Stankovec e Lubanc së bashku me Hasan Prishtinën, Isa Boletinin e Mehmet Pashë Dërralën³².

Çlirimi i Shkupit pasoi edhe me disa dilema në mesin e drejtuesve të kryengritjes. Ndër ta, Isa Boletini, Idriz Seferi e Bajram Curri, edhe pse fillimisht ishin përkrahës të idesë së Riza Beut për marshim drejt Selanikut për të liruar nga burgu Abdyl Hamitin II, duke kuptuar rrezikun e një ndërmarrjeje të tillë, hoqën dorë dhe nga kjo ide dhe vendosën të ktheheshin në rajonet e tyre. Ai, së bashku me Sali Agë Gjilanin, Bajram Currin e Islam Spahiu, përmes një letreje dërguar valiut kërkuan plotësimin e 14 pikave të memorandumit, në të kundërtën do të ktheheshin përsëri, duke kërcënuar edhe me shkëputje në rast se kërkesat e tyre nuk do të pranoheshin dhe zbatoheshin. Kryengritësit treguan disiplinë të jashtëzakonshme me rastin e hyrjes së tyre në Shkup dhe gjatë tërë kohës sa qëndruan aty³³.

²⁹ A. Selmani, *Gjilani...*, f. 258-259.

³⁰ *Dokumente serbe...*, f. 469, 503.

³¹ A. Selmani, *Gjilani...*, f. 264.

³² *Dokumente franceze...*, f. 239.

³³ F. Musaj, *Isa...*, f. 152.

Kryengritja e Përgjithshme shqiptare kishte marrë fund me pranimin, për disa ndryshime, të 14 pikave të Hasan Prishtinës nga ana e Komisionit Qeveritar që kryesohej nga Ibrahim Pasha. Tërheqja e shqiptarëve u bë më 20 gusht, ndërsa 24 orë më vonë nuk u pa asnjë kryengritës në qytetin e Shkupit³⁴. Për sa më sipër, mund të përfundojmë se Isa Boletini pati një bashkëpunim të suksesshëm me krerët e trevave lindore, në mënyrë të veçantë me Idriz Seferin, të cilët me rolin e tyre në kryengritjet e viteve 1910 dhe 1912, i dhanë shembullin më të mirë forcave përparimtare shqiptare se krahas vështirësive të përgjithshme, vetëm të bashkuar do të mund të përmirësonin statusin e shqiptarëve përbrenda Perandorisë Osmane dhe në perspektivë të realizonin aspiratat kombëtare.

³⁴AIHT, Vj-22-14-1402, Raport i konsullatës austro - hungareze në Shkup drejtuar MPJ në Vjenë, 8 shtator 1912.

Mr. sc. Fitim RIFATI

SUMMARY

ISA BOLETINI'S COLLABORATION WITH THE LEADERS OF THE EASTERN ALBANIAN TERRITORIES (1910 - 1912)

The re-declaration of the Constitution in 1908 which established the Young Turks' 'Unification and Progress' movement at the head of the Ottoman state, was followed with a reaction of the latter towards the National Albanian Movement. The years 1910, 1911, and 1912 mark a period where the main fronts of the military developments were taking place between the Ottoman forces and the Albanian insurgents. To coordinate the military capacities of the Albanian forces, it was of utmost necessity to establish cooperation and unity between the most influential Albanian leaders.

The preferable geostrategic position of the north-eastern Albanian lands bordering Ottoman administrated territories was the main objective of the National Albanian Movement in order to paralyze the Ottoman forces and defunct communication with Istanbul. In this context, quite similarly to the Uprising of the Vilayet of Kosova in 1910 and the General Anti-Ottoman Uprising of 1912, the canyon of Kaçanik and Carralevë were the main points where thousands of insurgents rallied to wage war headed by Isa Boletini, Idriz Seferi etc. A characteristic of this collaboration were the open and hidden rallies, the preparation of war strategies, and the strategic

movement of the armed forces from one region to the other to fulfill the national aspirations.

Cases such as: the rallying in Gjilan, where Isa Boletini, Idriz Seferi and other leaders participated; the meeting in Carralevë where once again Isa Boletini, Idriz Seferi and Hasan Hysen Budakova participated, portray the most striking figures of collaboration against the Ottoman forces in the Uprising of 1910. The most fruitful collaboration between Isa Boletini and the leaders of the north-eastern territories (in particular Idriz Seferi), was demonstrated at the General Anti-Ottoman Uprising of 1912, which resulted with the liberation of cities and the main centers of the Vilayet of Kosova, Shkup, during August 1912. The liberation of Shkup came as a result of the secret strategy planned by Isa Boletini and Idriz Seferi. Isa Boletini successfully collaborated with the leaders of the eastern territories, in particular with Idriz Seferi, both of whom became the best examples of a progressive Albanian unit despite the remaining difficulties. They realized that only unified could they better the status of the Albanians within the Ottoman Empire and accomplish their national aspirations.

Gjet NDOJ
(Tiranë)

**ISA BOLETINI UDHËHEQËS KRYENGRITËS, POLITIKAN
DHE NACIONALIST I SHQUAR**

**Bazuar në dokumentet e Arkivit Qendror të Shtetit Shqiptar
(AQSH)**

Isa Boletini është një nga personalitetet më të spikatura të nacionalizmit shqiptar. Roli i tij ka qenë parësor në lëvizjen dhe në konsolidimin e Pavarësisë së Shqipërisë në afro dy dekadat e para të shek. XX. Fuqia e këtij lideri nacionalist duket në mbështetjen e jashtëzakonshme që i bënë shqiptarët, duke u rreshtuat nën komandën e tij mijëra luftëtarë të lirisë. Kjo mbështetje buronte jo vetëm në besimin që kishin shqiptarët tek vetitë e shquara dhe tiparet e rralla të këtij komandant - strategu legjendar, shpirti i tij atdhetar, burrëri dhe kurajo, por sidomos tek qartësia dhe vizioni i tij si politikan.

Më poshtë gjatë leximit të disa dokumenteve që kemi përzgjedhur në AQSH, do të shohim se Isa Boletini ka qenë i qartë në qëndrimet dhe në veprimet e tij duke luftuar kundër ushtrisë turke, ushtrive shoviniste ballkanike, kundër forcave të Lëvizjes

Konservatore me frymëzim anadollak të Haxhi Qamilit dhe nga ana tjetër ka mbështetur fort Qeverinë e Vlorës, më vonë dhe Princ Vidin, ka mbajtur anën e Perandorisë Austro - Hungareze, etj. Dokumentet që ne posedojmë janë me qindra, por nga përshkrimi i tyre në mënyrë kronologjike na rezulton se ato grupohen në:

- a) Dokumente që flasin për origjinën e familjes Boletini;
- b) Dokumente që tregojnë veprimtarinë prej udhëheqësi kryengritës të luftës për Pavarësinë e Shqipërisë; Kontributi i Isa Boletinit në themelimin e Lidhjes së Vlorës dhe bashkëpunimi i ngushtë i tij me Ismail Qemalin dhe udhëheqës të tjerë nacionalistë shqiptarë;
- c) Dokumente që flasin për rrethanat e vrasjes dhe jehonën që pati kjo vrasje e Isa Boletinit me të birin, nipin dhe pesë të tjerë nga malazezët duke bashkëpunuar dhe me tradhtarë shqiptarë;
- d) Vlerësimi i Isa Boletinit nga institucionet e shtetit shqiptar dhe dokumente që na sjellin përjetësimin e veprës heroike të këtij kolosi nacionalist në këngët popullore.

a) Dokumente që flasin për origjinën e familjes Boletini

Për origjinën e kësaj familje ka dokumente në AQSH. Ato janë dokumente në formë kujtimesh, por që hedhin dritë mbi prejardhjen dhe historinë e mbijetesës dhe të triumfit të kësaj familje dhe e brinjëve të saj.

* 20.10.1937 - Kujtime *(të shkruara në shqip)*, nga nipi i Isa Boletinit që flet për jetën dhe aktivitetin e tij (daktilografuar më 1984).

* Data ... Shënim (shqip) i një personi ku flet për origjinën e familjes Boletini.

* 1908-1921 - Në kujtimet e tij Elmaz Plava, ndër të tjera ka shënime dhe për Isa Boletinin...

Nga sa kemi kërkuar na rezulton se kujtimet më të plota dhe më afër të vërtetës janë ato të nipit të Isa Boletinit. Kështu për sa i përket prejardhjes së familjes Boletini ndër të tjera thuhet:

“Si mbas gojdhanejave mbas brezeve të deri tashëm par 370 vjetë kan ardhun prej Pecit Shalës e shkue në Katundin Isniç pran kishës Deçanit dy orë në jug të Pejës. Këtu ka ardhun një i quajtuni Leka me tre djem 1) Nik Leka, 2) Prek Leka, 3) Can Leka. Nga këta tre jan ba 3 lagje me emën Nik Leka, Prek Leka, Can Leka, na sod jemi te Nik Lekaj. Isniçi tash përbahet prej mase 150 shpijash, jan të dalun edhe deri 100 shpi nëpër nahije të Pejës.

Nga barku i (baca Pepës) Lekës, rrjedhën (kështu djalë mas djali) të bit.

- 1) Pepa, 2) Nika, 3) Deda, 4) Stako, 5) Leka, 6) Vuka, 7) Leka, të bijtë e tij Nika - Preka - Cana, Muja - Preka - Cana, Dema - Preka - Cana, Hajdari - Halili - Ahmeti, Murseli, Ademi, Jashari, Nimani, Zahiti, Abdiu, Osmani, Muftari.*

Të bit e Ahmetit, Tafili, Januzi, Haliti.

Të bit Isa,

Halili, Muja, Ademi, Zahidi, Musa, Bajaziti, Faiku, Asllani, Kapllani. Aproximativisht para 180 vjetë të bit e Dem Mujës, Halili, Ahmeti, Hajdari, për arsye se Katundi Isniç qysh se kur kanë ngul në atë vend kan ba shumë gjaqe në Katundit Deçan e Cernobreg për Ujtë e Bistricës Deçanit qi vaditën Tokat pse nuk janë bindur me hjek dorë nga ky ujë në një kohë që janë shtërngue dhe nga qeveria turke duke ju dhan si shpërblim katundin Lekish në krahin tjetër të katundit Isniç. Me qillim qi të shuente shamataja jan shtrëngue me u largue nga Isniçi e me ngel në vendin e quajtn sot Boletin një orë larg në veri të Mitrovicës, një vend pa banorë por mjaft i fortë për luftë e me

klime e ujë shumë të mirë. Këta tre vllazën duke shkue në Boletin kan lan një nip në katundin Tonas të quajtur Shatër ku sod prej këti jan banun mase 30 shpja. Qi dhe tashti quhen Shatrajt, një katund mjaft pasunik e me burra të fort po si kurIsniçiqi mban rekordin në çdo pik pamje si në pasuni ashtu dhe në burra me fam e në djemuri shumë të fortë, të zgjutë, të pastër e krenar.

Emni i të bive të Dem Mujës, Xurre Halilit, Ahmeti dhe sod për flitet në Goj të Popullit Hajdari ka qen maj i vogli. Nga barku i Xurr Halilit rrjedh lagjia Zhazha prej 20 shpijash sod, e nga barku i Ahmet Demës rrjedh lagjia Musliaj, nga barku i Hajdar Demës rrjedh shpia e jon si shënohet në listë. Mursel Boletini në 7 djem në kohën e tij ka qenë me fam e i përmendur si shpi e fortë e në burni, ka ba dhe pasuni të mirë si Boletini krejt në male e bjeshk ashtu dhe Ruderin pran Lumit Ibër pjesën Fushore, kan qen do pem, pran një kë... pi të qujtun Dudi Kersh afër lumit Ibër qi këta vllazën i varshin armët e qi përmendet dhe ash. Adem Boletini në atë kohë ka marë dhe Madenin e Gurëve të Mullinit prej Gjinollit Prishtinës, kundrejt një taksi të vogël të cilin e kemi dhe tash në dokumenta zotnimi. Në kohën e Sadri Azemit para 110-115 vjetësh para 1820-1830, duket se asht babun ndo një operacion nga ndonji Sadri Azemi qi edhe sod ashtu quhet, koha e Sadri Azemit (mund të jetë fjala për Sasdrazem, veziri i madh). Adem Boletini asht prish prej këtij, janë djeg shpijat e plaçkit krejt pasunia. Me këtë ngjarje ka pasë përkrahjen e shpis Magjunit Vështërnes qi ka qenë shtëpia më e para e ma e forta në ato4 kohra në të cilin edhe sod kemi relacione familjare.

Këtu e mbrapa Adem Boletini e ka kalue jetën her me qetësi her me ngjarje të kobës tue vu në dorë prap pasunin e parë bashk me nadenin e gurve të Mullinit qi ju kishte marrë nga Qeveria në kohën e ngjarjes me Sadri Azemin.

Mbas vdekjes ka lan 4 djem:

Ahmeti lindur 1861

Halili 1862

Isa 1864

Muja 1867

Muja dhe Halili jon vra në moshë të re pa i mbushur 20 vjet. I nat Ahmet Boletini në vit 1886 kur ka ardhun në Kosovë Rexhep Pasha Myshir për (islahat) stabilizimin e qetësisë ka pas ba qendrën në Mitrovicë e banonte në një shpijë të mirë të Rabidief, pran lumit Ibër në mos te babçija të mir. Rexhep Pasha në këtë operacion kur ku s'ka ba pushk, por me mënyra pati ba disa internime e nxan shumë të arratisun. Në mes të internumve kishte vendos internimin e babës t'im por ky tue pa ç'bahesh kur u thirr nga Rexhep Pasha nuk digjoj me u taku me të. At herë administrata lokale tue ja mbush mendjen Abia Efon qi e kishim mik edhe Ymer Aga Devës nga tregt e vendit se Myshiri nuk ka ndërment të internonte, por vetëm sa me u takue një herë, këta e thrasën babën me besë, kur Baba shkon e piquet me Pashën pritet e përcillet prej tij mjaft mirë po i thot qi piqu edhe me kajmejkanin takohet Ahmeti me këtë mbasi pinë kafe kur del posht në avlli të sarajit i del Jyzbashi në derë të zyrës vet e i thotë Ahmet Boletini "Z. Jote, njerëzit udhoj i ban zjarret po te unë nuk ban (tenezire) denjon me pi një kafe, mbi kto fjalë Baba i gjë gjet po hajdi dhe fute në zyrën e tij, sa i sjellin kafen dyrt e havllis e sarajit ishin mbyllun dhe nxan me shumë gjindar e çaushllar të zgjedhun në momentin qi Baba okupon dorën duker marr kafen disa çaushllar qi ndodheshin në zyrë kinse për muhabet si vetina i hidhen sipri, mirë po tye qenë se baba ka qen shumë i shkoht e i zoti i për plasë për dhe dhe nxjerr revolverin e mbasi plagosë 3 nga kta i nxjerr prej havllije e kështu i hapë dyert e mer Pazarin ajo ditë ka ndodh ditë pazari, populli hapë rrugën ndërsa një katundar me një qerre dru e kishte nxan udhën për trup të cillën Ahmeti e këcen prap kur ku pa

prekë kët e pi sod dhe sod populli e mban në gojë, ku me kët rast i kan nxjerr dhe këngën e Ahmet Boletini trim Drague, djal asllan e tjera qi në të vërtetë ata qi e njoftin thonë si shoqin e Ahmet Boletinit nuk kemi pa me sy, kët fjal e ka than vet Rexhep Pasha.

Baba tue kujtue se kët të pa bes ja kan ba me qillim, drejt i ka shkue dyqan të Ymer Agës, por nuk e ka gjetun tue qenë edhe se fishekët e patllakeve i kishin mbarue, shkon në shpi të Ibrahim Agë Bakallit, i cili në atë kohë ndodhesh Juzbash i gjindarmërisë Vështërn, e qi aji mbante çupën e kushërinit babës për djalë, ndërkaq buri ja bjen ushtrijs, përgatitet, gjindarm bredhën tregut, sikurse din kah ka shkue.

Baba i kërkon Zojës Ibrahim Agës pushkën e cila ja bjen me një herë me 100 fishek dhe thot: për neve mos kije dert, po qindro se i ke than veti djaldai, nga këto fjalë të zonjës, thoshte baba në gjan si mu shtue edhe një zemër. Ndër kaq Isa qi priste në kodër të Lices me një fuqi me të ndigjue armët u turr drejt Lagjes qi ndodhesh Baba aty u takun dhe shëndosh e mirë këthyen në Boletin. Rexhep pasha kur pa shpëtimin e tij kaq gja kishte thanë “se me të vërtetë qenka i zoti dhe i pafajshëm e mbasi e qorton mirë autoritetin lokal edhe i transferon, pa përdorur makinë formuese kundër nesh. Në vitin 1894, shtëpisë sonë i kanë ngja shumë mgatëresa e luftime me fise të tjera dhe në Mars të këtij viti është vrarë Ahmeti me një luftë të ngjashme me katundin Zhazhë në Rahovë e Stantrk, në moshën 33 vjeçare”.

Kështu, kjo shtëpi, nga kjo kohë pati të parin e saj, Isa Boletinin. Nga kjo kohë kemi rindërtimin e Kullës së Boletinëve me gurë deri në më shumë se 1 metër gjerësi, me 2 metër gjatësi, një kala e vërtetë e ndërtuar nga ustallarë prej Golloborde të Dibrës. Që në fund të shek. XIX dhe sidomos në dhjetëvjeçarin e parë të shek. XX, Isa Boletin ishte një personalitetet me më shumë mbështetje nga njerëz të armatosur që luftonin për çlirimin e Shqipërisë prej

pushtimit shumëshekullor turk. Këtë e dëshmojnë dokumentet e shumtë që ne kemi.

b) Dokumente që tregojnë veprimtarinë prej udhëheqësi kryengritës të luftës për Pavarësinë e Shqipërisë, si dhe aktiviteti politik i Isa Boletinit, përkrah I. Qemalit dhe personaliteteve më të rëndësishëm të kohës...

*6.6.1910 - Njoftim i qeverisë Malazeze, mbi largimin e Isa Boletinit nga Mali i Zi për në Nikshiq, si rezultat i presionit që bëri Ambasadori Turk në Cetinjë (*shqip shtypshkrim*).

*8.10.1910. Letër e Filip Krajës nga Shkodra, dërguar Terenc Toçit, ku ndër të tjera i shkruan se Isa Boletini, Ded Gjo Luli e Hasan Jakup Ferri kanë deklaruar se në thirrjen e parë të luftës kundër Turqisë, mbledhin 50 000 luftëtarë (*dorëshkrime origjinale, italisht*).

*Viti 1910 - Njoftime të përfaqësuesit të Austro-Hungarisë në Stamboll nëpërmjet të cilave bëhet e ditur se Qeveria Turke ka shpresë që të fusë në dorë krerët e Lëvizjes Shqiptare si Isa Boletinin dhe Idriz Seferin (*e shtypur në shqip - kopje*).

*Viti 1911 - (Korçë) Në shënimet e Komisionit të 25 vjetorit të vetë qeverimit, thuhet se Isa Boletini organizoi lidhje me çetën e Qamil Panaritit (*shtypshkrim*).

*Viti 1911 shënime të Terenc Toçit (në Shqipëri, italisht) për Isa Boletinin, për forcat që disponon, detaje të ndryshme (*janë shënime për kryengritjen e vitit 1911*).

*25.01.1911 (italisht) letër e firmosur nga Bartolomeo, dërguar Terenc Toçit, ku ndër të tjera i shkruan një listë me emra të renditur, më kryesorët që kanë luftuar me fiset e tyre

kundër Turqisë, ku secili nga ata mund të nxjerrë mbi 1 000 luftëtarë, midis tyre është dhe Isa Boletini nga Mitrovica.

*24.05.1912 Veli Vasjari (Stamboll) i shkruan Dr. Ibrahim Temos, ku e njofton se u krijua një Komitet Drejtues i Kryengritjes, i udhëhequr nga Nexhip Beu, Hasan Beu, Zejnullah Beu, Jahja Efendiu dhe Isa Boletini (*dorëshkrime*).

*5.9.1912 - Njoftim i përfaqësuesit të Austro-Hungarisë (në Stamboll) nëpërmjet të cilit mësohet se Isa Boletini e ka krejt fuqinë në dorë dhe zotëron në Mitrovicë (*shqip e shtypur*).

*30.11.1912 - Proçesverbal i mbledhjes së dytë të Kuvendit Kombëtar të Vlorës, marr nga gazeta “Përlindje e Shqypnisë” ku ndër të tjera shkruhet se në këtë mbledhje si delegat ndër të tjerë ishte dhe Isa Boletini (*kopje e daktilografuar*).

*20.11.1912 - Telegram nga Dibra, drejtuar Mit’hat Frashërit, e Irfan Beut në Elbasan, me anën e të cilit i njofton se Isa Bej Boletini ndodhet në Dibër (*turqisht-shqip*).

*20.11.1912 - Telegram i Ajdin Dragës nga Dibra drejtuar Mit’hat Frashërit në Elbasan, me anën e të cilit njofton nisjen e Isa Boletinit (*turqisht-shqip*).

*21.11.1912. Në letrën që Xhemil Beu (nip i Syrja Vlorës) i ka dërguar një personi, ndër të tjera e njofton për ardhjen e Isa Boletinit në Vlorë për shpalljen e Pavarësisë (*dorëshkrim, turqisht*).

*21.11.1912 - Telegram (*turqisht*) i Mit’hat Frashërit, dërguar Syrja Vlorës, ku e njofton për ardhjen e tij dhe të delegatëve të Dibrës si Isa Boletini, Ajdin Bej Dragës dhe Mehmet Pashë Dërrallës në Vlorë, për të marrë pjesë në Kuvendin e Vlorës (*dorëshkrim*).

*21.11.1912 - Telegram i Mit'hat Frashërit, drejtuar Syrja e Xhemil Bej(Vlorës) me anë të të cilit i njofton, se me delegatët e Dibrës është edhe Isa Boletini (*turqisht-shqip*).

* Pjesëmarrja e Isa Boletinit në mbledhjen e Junikut 1912.

*26.11.1912 - Telegram i Kryetarit të Bashkisë Elbasan, drejtuar Dervish Beut me anën e të cilit e njofton dhe mbinisjen e delegatit të Dibrës, Isa Boletini për në Vlorë (*turqisht-shqip*).

*5.12.1912 - Në ditarin e një personi në Shkodër shfaqen edhe mendimet për qëndrimin e Isa Boletinit në periudhën e pushtimit Serbo-Malazet në Shqipëri (*dorëshkrim*).

*Maj 1912 - shtojcë e posaçme e gazetës turke “Shekulli i Ri” botuar, nga korrespondenti i saj në Ferizaj, ku shkruan edhe për Isa Boletinin si udhëheqës Kryengritës.

*24.11.1912 - Telegram nga Elbasani drejtuar Dervish Himës (Beut) në Peqin, ku tregon ndër të tjera se Isa Boletinin e ka mysafir (*turqisht-shqip*).

*4.12.1912 - Fletë votimi me emrat e personave që u propozuan nga përfaqësuesit e vendit në Kuvendin Kombëtar të Vlorës dhe listat me emrat dhe numrin e votave të fituara për tu zgjedhur në pleqësi, ndër të cilët Isa Boletini (*original*).

*2.1.1913 - Letër (*turqisht-shqip*) e Kryetarit të Kryesisë Qeverisë së Vlorës, e firmosur edhe nga Isa Boletini, që vërteton thëniet e kësaj letre; se janë të pranueshme nga ana e tij.

*8.01.1913 - Letër (*turqisht-shqip*) e Mehmet Qamilit, ku ndër të tjera përmend dhe Isa Boletinin.

*13.02.1913 Telegram i Ismail Qemalit aprovuar edhe nga Isa Boletini, drejtuar Esat Toptan Pashës, me anë të të cilit e

informon për gjendjen e Shqipërisë dhe i bën thirrje për shpalljen e Pavarësisë në Shkodër.

*15.03.1913 - Telegram i Aziz Vrionit (Prefekt i Beratit) dërguar kryesisë së Qeverisë Përkohshme të Vlorës ku ndër të tjera informon se (Xhavit Pasha) është interesuar për Isa Boletinin dhe Ismail Qemalin dhe pyet se ndodhen në Vlorë apo jo (*original turqisht, përkthim*).

*31.3.1913 - Telegram në Italisht (shtypshkruar), i Tom Stambollës, dërguar nga Bari Preng Doçit në Milano, ku e njofton mbi arritjen në Brindizi të Ismail Qemalit dhe të Isa Boletinit.

*20.06.1913 - Telegram i Ismail Qemalit në Romë (frëngjisht) drejtuar Myfit Libohovës në Vlorës, ku i njofton ditën e ardhjes së Isa Boletinit (*dorëshkrim*).

*22.06.1913 - Telegram i Mehmet Seitit në Fier dërguar Mehmet Pashës ku ndërmjet tjerave përmend dhe Isa Boletinin (*turqisht-shqip*).

*3.8.1913 - Letër e Isa Boletinit nga Gjakova ku flet për gjendjen e vështirë të Shqiptarëve të Gjakovës dhe dërgimin e ndihmave (*turqisht-shqip*).

*4.8.1913 - Letër (italisht) e Virgjilio Panelës dërguar nga Bari Terenc Toçit, ku e njofton mbi ndodhjen në Lezhë të Isa Boletinit dhe e porosit ta ketë në mbikëqyrje (*dorëshkrim*).

*8.8.1913 - Letër (italisht) e Spiridon Koçarazit dërguar nga Shkodra Torenc Toçit, ku e njofton se ka dëgjuar nga i biri i Isa Boletinit mbi vrasjen e Mehmet Pashës (*dorëshkrim*).

*25.09.1913 - Në letrën që Kosta Hotova, i dërgon Jani Vruhos (Egipt) ndër të tjera i shkruan edhe për Kryengritjen e vitit 1913 të udhëhequr nga Isa Boletini (*dorëshkrim, shqip*).

*25.09.1913 - Jani Vruho i shkruan (Shqipëri) - Kostë Hotovës (USA) për çlirimin e Dibrës, Pejës e Shkupit nga ushtria e Isa Boletinit dhe e vlerëson veprën e tij, duke e quajtur “plotësues i porosisë” të Madhit Gjergj Kastriotit.

*....1913 - Kërkesë (frëngjisht) e përfaqësueseve të Kosovës; Mehmet Pashë Dërrallës, Isa Boletinit e Qerim Begollaj, drejtuar Perandorisë së Austro-Hungarisë, për mbrojtjen e territoreve shqiptare, lidhur me vendimin e padrejtë të Fuqive të Mëdha, për kalimin e Kosovës në Serbi (*dorëshkrim, kopje*).

*. ... 1913 - Në fragmentin e letrës (se Hoxha Kadrisë), se një darkë Qerim Begolli u shpreh kundër krerëve të kryengritjes së Kosovës dhe kundër Isa Boletinit, Bajram Currit etj.

*Viti 1913 - Nga Vlora... Në shënimet Biografike të Leo Aleksandër Freundlich, thuhet se ky ka patur miqësi me Isa Boletinin (*dorëshkrim*).

*30.09.1913 - Telegram i Ministrit të Punëve të Brendshme Esat Toptanitdërguar Prefekturës së Elbasanit ku përmendet Isa Boletini.

*29.3.1913 - Dëftesë e nënshkruar nga Mehmet Ajdin Draga dhe Isa Boletini për një shumë të hollash të marra nga Ministria e Luftës në Vlorë, për t’ua ndarë oficerëve e Ushtarëve të Milicisë (*osmanishte në origjinal*).

*12.06.1914. Letër nga Lezha, dërguar At Ambroz Marlaskajt në Vienë, ku e njofton mbi ndodhjen Isa Boletinit, në Durrës me forcat e tij e më tej thekson se ky është pro Vidit e kundër Esat Pashës (*dorëshkrim*).

*Viti 1914 - Në shënimin e Komisionit 25 vjetët e vetëqeverimit thuhet se ky në takim me Hajdar Blloshmin e të tjerë luftoi kundër kryengritësve në ullahtet e Elbasanit (*shtypshkrim - Shijak*).

*4.08.1914 - Letër e Eshref Frashërit, dërguar nga Durrësi, Rexhep Mitrovicës dhe Rauf Ficos ku ndër të tjera i shkruan mbi vajtjen e Isa Boletinit në Kotorr me shpërthimin e Luftës Botërore (*dorëshkrime*).

*19.10.1914 - Letër (*osmanisht*) që Aqif Pasha i dërgon nga Bari, Mit'hat Frashërit, ku ndër të tjera i shkruan se Bajram Curri e Isa Boletini, kanë bërë një organizim ushtarak në Mitrovicë, Gjakovë e Has dhe se presin momentin për t'u futur në mbarë Kosovën.

*17.01.1919 - Letër (frëngjisht) shkruar Luigj Gurakuqit nga M. Kasneci, ku përmendet ndër të tjera dhe Isa Boletini (*dorëshkrim origjinal*).

*2.10.1919 - Letër e Hoxha Kadrisë drejtuar Hasan Prishtinës, ku ndër të tjera i shkruan se Qerim Begolli ka folur keq edhe për Isa Boletinin (i akuzon krerët e revolucionit në Kosovë për bashkëpunim me serbët (*osmanisht*)).

*..... (1937) - (nga Peja) Në shënimet e Komisionit "25 vjet vetëqeverimit thuhet se Isai kishte lidhje edhe me Salih Gashin për çështje Kombëtare (*dorëshkrim*).

a) Dokumente që flasin për rrethanat e vrasjes dhe jehonën që pati kjo vrasje e Isa Boletinit me të birin, nipin dhe pesë të tjerë nga malazezët duke bashkëpunuar dhe me tradhtarë shqiptarë.

Kontributi i jashtëzakonshëm që dha Isa Boletini në luftën për liri e pavarësi të shqiptarëve e kishte vënë atë në qendër të vëmendjes së elitës patriotike të Shqiptarisë, por shpesh edhe të personaliteteve të vendeve që ndikonin në ecurinë e ngjarjeve në Ballkanin Perëndimor. Kjo duket jo vetëm në relacionet që paraqitëm më lart,

por dhe në relacione të tjera ku shprehej frika se mos rrezikohej jeta e këtij protagonist të spikatur të nacionalizmit shqiptar. Kështu pa vdekur akoma ka patur “lajme” për vdekjen, apo dhe për pasigurinë e jetës së Isa Boletinit. Kështu ne po paraqesim disa prej këtyre relacioneve, por dhe te relacioneve të tjera që flasin për vrasjen, rrethanat dhe jehonën që shkaktoi kjo vdekje.

*.....shënime - dorëshkrime (*osmanisht*) me karakter studimor për vrasjen e Isa Boletinit.

*18.10.1912 - Vangjel Dede (*nga Ploeshti*), i shkruan Asdrenit (*Bukuresht*) ku ndër të tjera e njofton për vrasjen e Isa Boletinit.

*9.10.1913 - Telegram i Obrei Herbert (*anglisht*), (*dorëshkrim kopje, shqip*) i dërguar nga Londra, Ismail Qemalit në Vlorë ku e njofton se po boton krimet e bëra kundër Shqiptarëve; kërkon që të protestojë (Ismail Qemali) në Europë kundër ekzekutimit të të burgosurve dhe shkruan se ka frikë për jetën e rrezikuar të Isa Boletinit dhe se Isa Boletini ka shumë miq këtu (në Londër).

*23.08.1915 - Letër (*osmanisht*) dërguar nga Lozana, Mit’hat Frashërit, ku ndër të tjera e vë në dijeni për zënien rob të I. Boletinit (*dorëshkrim*).

*17.04.1916 - Letër (frëngjisht) nga Lozana, e Sotir Koleas - dërguar Mit’hat Frashërit në Bukuresht, ku e njofton për vrasjen e Isa Boletinit, njërit prej djemve të tij, nipit dhe 5 personave të tjerë në Podgoricë (*dorëshkrim*).

*.....1916 - Përshkrimi i vrasjes së Isa Boletinit dhe bashkëlufëtardë të tij nga Ushtria Malazeze.

b) Vlerësimi i Isa Boletinit nga institucionet e shtetit shqiptar dhe dokumente që na sjellin përjetësimin e veprës heroike të tij në këngët popullore.

Isa Boletini u mbush me lavdi ende pa vdekur. Kështu dëshmohet në këngët që populli ngrii për të që kur ishte gjallë, edhe pas vdekjes, e deri në ditët tona. Kur shikon relacionet, disa prej të cilëve ua paraqitem më lart, nuk është e vështirë të kuptohet rëndësia dhe vlerësimi që patën për të krerët e nacionalizmit shqiptar, si dhe personalitete të politikës evropiane për të. Ka patur më vonë vlerësime edhe nga politika zyrtare e shtetit shqiptar në kohën e Mbretit Zog (me rastin e 25-vjetorit të Pavarësisë), por veçanërisht në periudhën e pas Luftës së Dytë Botërore, në përvjetor të ndryshëm të Pavarësisë.

*26.11.1962 - (Vlorë) Dekret i Presidiumit të Kuvendit Popullor mbi dekorimin e disa personave të tjerë dhe Isa Boletinit me urdhërin “Për veprimtari Patriotike të klasit të I-rë”.

*...- 1974 - Proçesverbal i Mbledhjes së Presidiumit Kuvendit Popullor dt. 21.11.1974 me vendim e propozim të K. Q. P. P. SH për ti dhënë Isa Boletinit titullin “Hero i Popullit”, ku ka bashkëngjitur dhe motivacionin”.

*10.03.1979 - Vendim Kryesisë Këshillit Ministrave Nr. 56 dt. 10.03.1979 mbi ngritjen e monumentit të Isa Boletinit “Hero i Popullit”.

*10.03.1979 - Vendim i Kryesisë së Këshillit të Ministrave për vendosjen e Monumentit të Isa Boletinit në qytetin e Shkodrës.

*Dt... viti 1982 - Presidumi i Kuvendit Popullor. Patriotët e dekoruar më shumë se një here, ku përmendet dhe emri i Isa Boletinit...

*Datë1916 - Këngë Popullore të shkruara për Isa Boletinin.

Figura e Isa Boletinit është e skalitur mirë në vepra të ndryshme, filma, piktura e skulptura, vepra të spikatura të artit shqiptar.

Prof. dr. Dritan EGRO
(Tiranë)

**KOSOVA DHE ISA BOLETINI, SIPAS GAZETËS ZYRTARE
XHONTURKE “TANIN” (1910)**

Revolucioni Xhonturk, i vitit 1908, dhe fryma liberale që garantoj për disa kohë suksesi i tij, shënon një moment të rëndësishëm në marrëdhëniet osmano-shqiptare, moment i cili meriton një njohje më të madhe dhe më të thellë, pasi shënon momentin kur, falë rendit të ri që u krijua brenda shtetit osman, këto marrëdhënie u bënë edhe më të komplikuar se më parë. Megjithatë, në këndvështrimin osman një gjë mbeti e pandryshuar: vlerësimi gjeostrategjik për shqiptarët si kolona që mbante gjallë në Ballkan sundimin e rrënuar osman; kurse shqiptarët, në kuadrin e lirisë (hüriyet), për të cilën kishin dhënë kontributin e tyre të madh, tashmë prisnin një shkallë më të lartë emancipimi kombëtar, në të gjitha fushat. Kjo kontradiktë themelore për nga interesat i shoqëroi marrëdhëniet osmano-shqiptare deri në vitet 1920-21. Në fakt, në qasjen politike osmane ndaj shqiptarëve, viti 1908 nuk shënon ndryshim radikal kursi, pasi Perandoria Osmane me një përvojë të

madhe shtetadministrimi në territore multietnike¹, nga ana e saj kërkonte t'i përdorte shqiptarët për interesat e saj, veçanërisht kapacitetin e tyre luftarak². Vetëm lëvizja që u shoqërua me ardhjen në fuqi të Ataturkut në fillim të viteve '20 e ndryshoi cilësisht natyrën e marrëdhënieve turko-shqiptare³.

Gjithsesi, çlirimi nga sundimi perandorak osman në fund të dekadës së parë të shek. XX i ngjante një medaljeje me dy faqe: nga njëra anë, ishte çlirim nga një sundim disa shekullor perandorak, por që shqiptarët i konsideronte si një element etnik me rol të rëndësishëm për të ardhmen dhe përparimin e Perandorisë, pra, në logjikën politike osmane shqiptarët përbënin kolonën mbështetëse më të vlefshme të këtij shteti⁴, pasi shkëputja e shqiptarëve parakuptonte fundin e sundimit osman në Ballkan. Nga ana tjetër, pavarësia e shqiptarëve nga shteti osman parakuptonte ballafaqimin e vetë shqiptarëve me sfidat e kohës, domethënë përballjen e vetme të shqiptarëve me shtetet fqinje, dhe përtej tyre përballjen me Fuqitë e Mëdha që i mbështesnin hapur ato. Por, pavarësia do të parakuptonte edhe marrëveshje më vete aq e nevojshme për të unifikuar qëndrimet me të cilat Shqipëria do të dilte e vetme përballë fqinjëve dhe Fuqive të Mëdha.

Marrëdhënia e dyzuar shqiptaro-osmane prej afro një shekulli kushtëzohej nga fakti që osmanët ishin si armiku i shqiptarëve, ashtu edhe mikui vetëm i tyre për kohën. Ky dyzim shprehet qartë në

¹ R. Davison, "Nationalism as an Ottoman Problem and the Ottoman Response", Nationalism in a non-National State, eds. W. W. Haddad & W. Ochsenwald, Ohio State University Press 1977, f. 25-56.

² Âtîf Hüseyin Bey, *Sultan II. Abdülhamid'in Sürgün Günleri: Hususi Doktoru Âtîf Hüseyin Bey'in Hatıraları (1909 - 1918)*, Timaş Yayınları, İstanbul 2010, f. 254.

³ H. Özcan, *Atatürk Dönemi Türkiye-Arnavutluk İlişkileri, 1920-1938*, Atatürk Kültür, Dil ve Tarih Yüksek Kurumu *Atatürk Araştırma Merkezi, Ankara 2011.

⁴ Ahmet Şerif, *Arnavutluk'da, Sûriye'de, Trablusgarb'de Tanîn*, hazırlayan M. Ç. Börekçi, Türk Tarih Kurumu, Ankara 1999, f. 7.

traktatet historiko-politike të Pashko Vasës (1879)⁵ dhe Sami Frashërit (1899)⁶. Lufta I Ballkanike *de jure* filloi për të zbuar osmanët nga Ballkani, ndërsa *de facto* për t'i dhënë fund përgjithmonë realitetit shqiptar në rajon. Shqiptarët shpallën krijimin e shtetit të tyre të pavarur në nëntor 1912, si hapin vendimtar që dëshmonte në vazhdimësi kapacitetin e tyre të mendimit dhe veprimit politik, ndonëse në ato kushte historike ky akt i dha vetëm një zgjidhje të pjesshme çështjes shqiptare. E vërteta është që shqiptarët, menjëherë pas shpalljes së Pavarësisë mbetën të vetëm në prag të një lufte botërore, e një lufte që nuk ishte e tyrja dhe kurrsesi nuk deshën të përfshiheshin në të. Ata mbetën të vetëm dhe më të dobët se kurrë më parë. Në këtë kontekst gazetari xhonturk, Ahmet Sherif, që vizitoi Vilajetin e Kosovës në vitin 1910, viset e banuara nga shqiptarë i quan *toka jetime*⁷.

Gazetari turk u dërgua nga gazeta “Tanin”, organ i propagandës zyrtare xhonturke, të vizitonte Kosovën në vitin 1910, pasi siç shprehet ai, Kosova dhe situata në Shqipëri fitoi rëndësi të madhe⁸, madje aq të madhe sa zhvillimet në Kosovë ngjallën ankth në Stamboll. Por, duke përfutur nga fakti që shqiptarët nuk kishin

⁵ Kjo vepër në vitin 1879 u botua njëkohësisht në frëngjisht në Stamboll: Wassa Effendi, *Etudes sur l'Albanie et les albanais*, Constantinople 1879; dhe në Francë: idem., *La vérité sur l'Albanie et les albanais. Etudes historique et critique*, Paris 1879; në anglisht: idem, *The Truth on Albania and the Albanians. Historical and Critical Issues*, London 1879; dhe në gjermanisht: idem, *Albanien und die Albanesen. Eine historisch-kritische studie*, Berlin 1879. Versioni shqip i përkthimit nga frëngjishtja i shoqëruar me komentim u botua prej Mehdi Frashërit: Vassa Efendi, *E vërteta mbi Shqipërinë dhe shqiptarët, Shtypshkronja “Tirana”, Tiranë 1935.*

⁶ Sami Frashëri, *Shqipëria çka qenë, ç'është e ç'do të bëhet?* (Mendime për shpëtim të mëmëdheut nga reziket që e kanë rethuarë), Bukuresht 1899.

⁷ Ahmet Şerif, *Arnavutluk'da, Sûriye'de, Trablusgarb'de Tanîn*, f. 3.

⁸ Ahmet Şerif, *Arnavutluk'da, Sûriye'de, Trablusgarb'de Tanîn*, f. 1.

nga pas mbështetjen konstante të ndonjë fuqie të madhe, Stambolli përpiquej ta minimizonte peshën e ngjarjeve që po ndodhnin në Kosovë para syve të opinionit osman të kohës.

Ky korrespondent lufte citon ministrin osman të Luftës, Mahmut Şevket Pashën, të cilin ai e takoi personalisht, i cili i tha: "... (e sheh) nuk po dëgjoni krisma pushke. Stambolli mendon sikur këtu çfarë po ndodh"⁹. Gjithsesi gazetari xhonturk i nisur enkas nga Stambolli për të parë dhe kuptuar problemin shqiptar shprehet se ishte e domosdoshme që shteti osman të tregonte fuqinë e tij në këtë pjesë të territoreve osmane¹⁰. *Çështja shqiptare*, sipas tij, duhej zgjidhur sipas urdhrave të prerë të Stambollit, që sugjeronin përdorim të kontrolluar të forcës¹¹. Më tej ai shton: "Kjo popullsi nuk mund të shtrohet veçse me forcë. Të dalësh kundër kësaj politike do të thotë të tradhtosh interesat e Perandorisë Osmane"¹². Ndaj situata e krijuar për osmanët parashikohej të qetësohej përmes masave të mëposhtme:

1. Çarmatosja e popullsisë shqiptare, si e qytetarëve ashtu edhe e malësorëve; përndryshe ata do të dënoheshin nga Gjykata e Gjendjes së Shtettrrethimit me 5 vjet punë të detyruar¹³. Shqiptarët e Kosovës i fshihnin armët dhe municionet, jo vetëm nëpër shtëpitë e tyre, por edhe nëpër kubetë e xhamive, madje, po t'i pyesësh fëmijët dhe gratë - shprehet gazetari turk, ata ishin të prirur të të gënjejnë për të mos treguar vendin e saktë se ku gjenden ato¹⁴. Ndaj për të vendosur rendin dhe qetësinë duhet bërë gjithçka - përfundon ai.

⁹ Ahmet Şerif, *Arnavutluk'da, Sûriye'de, Trablusgarb'de Tanîn*, f. 3.

¹⁰ Ahmet Şerif, *Arnavutluk'da, Sûriye'de, Trablusgarb'de Tanîn*, f. 3.

¹¹ Ahmet Şerif, *Arnavutluk'da, Sûriye'de*, f. 1.

¹² Ahmet Şerif, *Arnavutluk'da*, f. 31.

¹³ Ahmet Şerif, *Arnavutluk'da*, f. 10, 13.

¹⁴ Ahmet Şerif, *Arnavutluk'da*, f. 14.

2. Kullat e shqiptarëve, vijon gazetari turk, janë ndërtuar për dy funksione: strehim dhe mbrojtje, nuk janë profiluar për të banuar, por për të qenë kështjella¹⁵. Në këtë kuadër, popullsisë i ishte dhënë urdhri të zgjeronte frëngjitë e kullave dhe t'i kthente ato në dritare. Kjo ishte e domosdoshme sidomos në Pejë dhe në rajonet malore, ku edhe numri i kullave ishte më i madh¹⁶. Në fshatin e Sulejman Batushës, kullën e tij dhe të vëllait të tij, por edhe kullat e larta të fshatit osmanët i kishin shkatërruar me lëndë shpërthyes¹⁷.

3.Rekrutimi i të rinjve shqiptarë për të luftuar larg territoreve shqiptare. Në kthim ata do të ndikonin mes bashkëqytetarëve të tyre përmes kulturës perandorake osmane dhe edukatës ushtarake që do të kishin marrë¹⁸.

Cinizmi i gazetarit xhonturk shkon edhe më tej kur pasqyron edhe qëndrimin e prerë osman ndaj shqiptarëve:

“...fishekët që dalin nga pushkët dhe predhat që dalin nga topat, në vendet që bien mbjellin qytetërim. Ky realitet ishte një domosdoshmëri përballë injorancës së shqiptarëve, një domosdoshmëri e fundit në fatin e Shqipërisë”¹⁹. Gjithsesi, debati mes shqiptarëve për të ardhmen politike të Shqipërisë dhe shqiptarëve zhvillohej në dy plane: në atë intelektual dhe në atë në terren. Debatet në Parlamentin osman për çështjen shqiptare i drejtonin Ismail Qemali, Myfit Libohova, Hasan Prishtina dhe Nexhip Draga. Kosova e kësaj kohe i kishte krerët e saj politikë, respektivisht Nexhip Dragën për negociata në tavolinë, Hasan Prishtinën për veprim politik dhe Isa Boletinin për luftën e armatosur. Kosova në të gjitha rastet në këto shënime udhëtimi

¹⁵ Ahmet Şerif, *Arnavutluk'da*, f. 27.

¹⁶ Ahmet Şerif, *Arnavutluk'da*, f. 13 - 14.

¹⁷ Ahmet Şerif, *Arnavutluk'da*, f. 8.

¹⁸ Ahmet Şerif, *Arnavutluk'da*, f. 14.

¹⁹ Ahmet Şerif, *Arnavutluk'da*, f. 7.

identifikohet me emrin Shqipëri, madje më specifíkisht si Shqipëria e Veriut²⁰. Gazetari turk në kuadrin e këtij udhëtimi në Vilajetin e Kosovës jep të dhëna të çmuara edhe për krahina që sot nuk janë pjesë e shtetit të Kosovës; ai vizitoi Ferizajn, Prizrenin, Gjakovën, Pejën, Mitrovicën, por edhe Novi Pazarin, Senicën, Prepolin, Tashllëxhan, Kolashinin, Beranen dhe Tërgovishtën²¹.

Shqiptarët, shprehet ai, ndonëse myslimanë, janë krejt të ndryshëm nga popullsia që banonte në fshatrat e Anadollit²². Sipas tij, shqiptarët kanë një edukatë kombëtare, madje një edukatë të fortë²³. Kanë lidhje të forta mes tyre, vetëdija e fortë etnike i çon ata drejt ruajtjes së karakterit të tyre kombëtar²⁴. Porse, sipas tij, jo të gjithë shqiptarët ishin rebelë, kryengritës. Ndaj përfundon ai, burimi i fuqisë së tyre kryengritëse duhet kërkuar jo në traditat e tyre çlirimtare, por në injorancën e tyre²⁵. Megjithatë, është vetë gazetari që e hedhë poshtë këtë pohim, kur për të kuptuar se deri ku kishin shkuar përmasat e organizimit shqiptar dhe të koordinimit të tyre politik, në kronikat e tij dërguar nga terreni, i jep vend edhe një deklaratë të Shoqërisë së Shqiptarëve që vepronte në Paris (qershor, 1910)²⁶. Në Gjakovë, thotë ai, nuk gjeta asnjë fëmijë që shkonte në shkollën fillore, i cili të dinte turqisht²⁷, ndaj menjëherë arrin në përfundimin se fuqia e traditës familjare dominonte mes fëmijëve

²⁰ Ahmet Şerif, *Arnavutluk'da*, f. 18.

²¹ Ahmet Şerif, *Arnavutluk'da*, f. 37 - 99. Për sa i përket shtrirjes territoriale të Vilajetit të Kosovës, shih: Osmanlı Arşiv Belgelerinde Kosova Vilayeti / Vilajeti i Kosovës në dokumentet osmane, Başbakanlık Devlet Arşivleri Genel Müdürlüğü, İstanbul 2007, f. 147 - 15.5

²² Ahmet Şerif, *Arnavutluk'da*, f. 5.

²³ Ahmet Şerif, *Arnavutluk'da*, f. 30.

²⁴ Ahmet Şerif, *Arnavutluk'da*, f. 30.

²⁵ Ahmet Şerif, *Arnavutluk'da*, f. 12.

²⁶ Ahmet Şerif, *Arnavutluk'da*, f. 4 - 5.

²⁷ Ahmet Şerif, *Arnavutluk'da*, f. 10.

shqiptarë, dominonte edhe mbi formimin që merrej në shkollë²⁸. Shqiptarët e Gjakovës, brenda në një kafene, bënëin përgjegjës për situatën e krijuar sulltan Abdyl Hamitin II²⁹. Në Gjakovë askush nuk di turqisht, kurse në Pejë çdokush flet turqisht - shprehet ai³⁰.

Sipas gazetarit xhonturk, njeriu më me ndikim në Kosovën e vitit 1910 ishte Isa Boletini³¹. Në datën 5 qershor 1910, u mësua se Isa Boletini gjendej i plagosur në të dy krahët, në një shtëpi në fshatin Bara të Malësisë³². Më 18 qershor, po nga burime të sigurt, u mësua se Isa Boletini bashkë me 20 trima të tij, i armatosur, ishte larguar për në Mal të Zi³³. Gazetari turk shprehet se ai nuk kishte se çfarë të bënte tjetër në kushtet e shpalljes së shtetrrrethimit.

Në rrëfimin e tij për Isa Boletinin gazetari vazhdon:

“Kullat e Isa Boletinit ishin në rrethinat e Mitrovicës. Aty ai kalonte pjesën më të madhe të kohës. Zotëronte në masë të konsiderueshme prona të paluajtshme tokësore. Për jetën që ka kaluar aty, për rrogat dhe për të mirat që ai ka përfutur nga sulltani, flitej shumë asokohe³⁴. Mitrovica e sipërme quhet “Lagjja Saraj”. Interesant është fakti që autori bën fjalë vetëm për praninë e refugjatëve boshnjakë në këtë pjesë të Mitrovicës dhe nuk ka arritur të identifikojë popullsi serbe³⁵, prezencën e së cilës e mësojmë nga burime të tjera³⁶.

²⁸ Ahmet Şerif, *Arnavutluk'da*, f. 10.

²⁹ Ahmet Şerif, *Arnavutluk'da*, f. 10.

³⁰ Ahmet Şerif, *Arnavutluk'da*, f. 23.

³¹ Ahmet Şerif, *Arnavutluk'da*, f. 10.

³² Ahmet Şerif, *Arnavutluk'da*, f. 14.

³³ Ahmet Şerif, *Arnavutluk'da*, f. 22, 28.

³⁴ Ahmet Şerif, *Arnavutluk'da*, f. 35.

³⁵ Ahmet Şerif, *Arnavutluk'da*, f. 34.

³⁶ F. Musaj, *Isa Boletini (1864-1916)*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë-Instituti i Historisë, Tiranë, 2004, f. 30.

Gjithsesi, me shumë vlerë është një konstatim që gazetari turk bën në Novi Pazar. Ai shpreh:

“Serbët dhe refugjatët e tjerë janë shumë punëtorë. Të tjerët janë dembelë, sikur jetesën e tyre e presin nga puna e këtyre. Përgjithësisht, fshatarët serbë nuk janë pronarë toke. Ata punojnë me gjysmatari tokat e boshnjakëve. Janë shumë të drobitur dhe të varfër. ...Nëpër fshatra të gjithë agallarët me ndikim janë boshnjakë. ...Fshatarët serbë, madje edhe në këtë moment, janë robër të boshnjakëve; boshnjakët, pasuritë dhe jetesën ia kanë borxh punës së fshatarëve serbë...”³⁷.

Me pak fjalë gazetari turk i ka dhënë kuptim një realiteti që shpjegon një fenomen shumë të rëndësishëm në Ballkan, atë të ardhjes dhe të ngulitjes së çifçinjve të krishterë në tokat e agallarëve e çifligarëve myslimanë. Ky konstatim që vjen nga terreni në fakt shpjegon politikën zyrtare që shteti osman për shekuj kishte ndjekur ndaj pronësisë mbi tokën dhe mbi çifçinjtë e krishterë. Konkretisht bëhet fjalë për rajonin e Sanxhakut, por një realitet identik ka ekzistuar në Mitrovicën e Isa Boletinit, por edhe në Dropull të Gjirokastrës dhe në Vurg të Sarandës. Pronësia në terma absolut e tokës në duart e elementit mysliman i hapi rrugë modelit të kolonizimit etnik të krahut të punës. Vendosija e kolonëve serbë në Mitrovicë, madje në tokat e Isa Boletinit, dhe e kolonëve grekë në tokat e familjeve Delvina, Abazi, Çiniu, janë në thelb të njëjtat realitete.

³⁷ Ahmet Şerif, *Arnavutluk'da*, f. 39.

Askush në Stamboll, madje edhe në vitin 1910, nuk e pranonte faktin që tokat shqiptare po shkonin drejt shkëputjes përfundimtare nga shteti osman.

Mentaliteti i një perandorie që nuk do të binte kurrë, dominoi edhe politikën zyrtare xhonturke. Megjithatë, gazetari turk në terren e pranon këtë realitet të ri që po shpërfaqej kur thotë: “Kosova, për mua tanimë ishte një vend i huaj. Do të desha të depërtoja në shpirtin e tyre dhe të shkruaj më gjerë”³⁸. Marshimi i Isa Boletinit drejt Vlorës për të marrë pjesë në ceremoninë e shpalljes së pavarësisë, përtej dimensionit heroik, shënon një veprim me fuqi të madhe simbolike për shqiptarët. Prania e tij në Vlorë si përfaqësues i Kosovës përmbyll aktin e përfaqësimit të të gjitha tokave shqiptare. Ky realitet shënoi hapin përfundimtar në procesin e formimit të kombit shqiptar.

³⁸ Ahmet Şerif, Arnavutluk’da, f. 13.

Prof. dr. Dritan EGRO

SUMMARY

KOSOVA AND ISA BOLETINI AS PORTRAYED BY THE OFFICIAL NEWSPAPER OF THE YOUNG TURKS “TANIN” (1910)

The uprising of 1910 in Kosova created a great discontent in Istanbul. Providing a solution to the Albanian requests became a political test to their newly established government immediately after the Young Turks came to power. Numerous armed forces were sent to investigate the situation created in Kosova, as well as a war correspondent of the gazette “*Tanin*”, which was the official newspaper of the Young Turks. In his war reports from Kosova, the correspondent offers an informative panorama of the situation created there, where he also devotes an important part of reporting to the figure of Isa Boletini as the head of the Albanian uprising.

Prof. dr. Frashër DEMAJ
(Prishtinë)

AKTIVITETET E ISA BOLETINIT SIPAS BURIMEVE BRITANIKE 1910-1912

Periudha në mes të viteve 1910-1912 karakterizohet me zhvillime të shumta politike, diplomatike, ushtarake dhe kryengritëse, jo vetëm në territoret e banuara me popullsi shqiptare, por në gjithë Gadishullin Ballkanik. Popujt ballkanikë të cilët kishin formuar prej kohësh shtetet e tyre kishin shfaqur pretendime për zgjerim territorial në dëm të tokave shqiptare. Vitet 1910-1912 janë kohë e përpjekjeve të vazhdueshme të rilindësve shqiptarë me qëllim të bashkimit të forcave në luftë për çlirim e shtet kombëtar¹.

Një nga figurat kryesore të kësaj lëvizje ishte edhe Isa Boletini. Ai u lind në fshatin Boletin të Mitrovicës më 15 janar të vitit 1864². Që nga mosha 17 vjeçare, në kohën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit tregoi tipare të një udhëheqësi popullor. Isa së bashku me Idriz Seferin, Dedë Gjo Lulin dhe Bajram Currin ishin figura

¹ Fehmi Rexhepi, “Isa Boletini dhe koha e tij”, botuar në: *Isa Boletini dhe koha e tij*, Prishtinë, 1998, f. 25.

² Fatmira Musaj, “Kontributi i Isa Boletinit në luftën për liri dhe konsolidimin e shtetit të pavarur shqiptar”, botuar në: *Isa Boletini dhe koha e tij*, Prishtinë, 1998, f. 29.

qendrore të organizimit të rezistencës antiosmane dhe kryengritjeve sidomos në Vilajetin e Kosovë dhe një pjesë të Vilajetit të Shkodrës.

Isa Boletini bëri përpjekje për bashkimin e forcave shqiptare kundër pretendimeve pushtuese të shteteve fqinjë, si: Serbia, Mali i Zi dhe Bullgaria. Prandaj duke qenë personalitet i rëndësishëm një tribun popullor, ai u bë figura qendrore në mobilizimin e përgjithshëm për luftë kundër armiqve të popullit shqiptar. Tiparet e një udhëheqësi ushtarak, ai i shfaqti edhe në kohën kur repartet ushtarake osmane e sulmonin kullën e Boletinëve, për t'u formësuar edhe më shumë gjatë kryengritjeve 1910-1912, sidomos në betejën e zhvilluar në Grykën e Carralevës në maj 1910 dhe në periudhën maj-korrik 1912³. Isa Boletini u bë personalitet atraktiv dhe i rëndësishëm edhe për konsullatat, ambasadat dhe nivelet tjera të përfaqësimit diplomatik të Fuqive të Mëdha të interesuara për shqiptarët dhe zhvillimet e përgjithshme si në territoret e okupuara nga Perandoria Osmane, po ashtu edhe për vendet e rajonit të Ballkanit. Isa e shihte si mundësi të vetme për t'u çliruar, bashkimin e lëvizjeve të armatosura të krahinave të ndryshme në një kryengritje të vetme me karakter mbarëkombëtar. Për këtë bashkim forcash Isa shprehej: “Kur të bashkohen të gjithë shqiptarët, të lidhin nder vedi një besë shqiptare, do të jemi të zotë të perzomë urdinë e turkut jo me armë por edhe me hunjtë e gardhit”⁴.

Isa Boletini u përpoq të bashkëpunonte edhe me popujt fqinjë për interesa të përbashkëta. Ai pati takime edhe me përfaqësues serbë dhe malazezë në përpjekje për të arritur ndonjë marrëveshje bashkëpunimi me interesa reciproke. Mirëpo, këto përpjekje rezultuan të dështuara meqë diplomatët serbë dhe malazezë pretendonin të shfrytëzonin shqiptarët e udhëhequr nga Isa Boletini

³*Po aty.*

⁴*Po aty*, f. 3.

në luftë kundër osmanëve pasi që interesat serbe e malazeze e kërkonin që të dobësoheshin të dy palët që pastaj monarkitë ballkanike të realizonin me lehtësi pretendimet e tyre për të pushtuar tokat e banuara me shqiptarë që i mbante Perandoria Osmane⁵. Serbia tanimë kishte shfaqur hapur kërkesat e veta dhe ngulmonte që bashkë me Vilajetin e Kosovës t'i merrte 50 kilometra dalje në Adriatik, kurse Mali i Zi kishte targetuar pushtimin e Shkodrës⁶. Çështja e kërkesave serbe dhe mundësisë së daljes serbe në një skele në detin Adriatik u trajtua edhe në komunikimin në mes ministrit të Jashtëm britanik Sir Edward Grey me diplomatin Sir F. Cartwright më 25 nëntor 1912.

Në këtë komunikim në mes tjerash thuhej: “Ambasadori austriak⁷ më njoftoi sot se konti Berchtold⁸ kishte marrë vesh prej burimeve të ndryshme, se ekzistonte përshtypja që Shëngjini mund të formonte objekt të një transaksioni në mënyrë që në një kohë të mëvonshme ai do t'i shkëputej Shqipërisë dhe do të bëhej një skelë serbe dhe Austria me këtë mund të pajtohej. Ambasadori që ngarkuar të deklaronte se puna nuk qëndronte kështu dhe se kjo nuk u përgjigjej qëllimeve austriake. Ministri italian i Punëve të Jashtme⁹ u

⁵ Valentina Duka, *Dokumente Britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët*, (tetor - dhjetor 1913), Tiranë 2012. f. 134.

⁶ *Arkivi i Institutit të Historisë në Tiranë* (më tej: *AIHT*), F. O. 52974/42842/12/44, Nr. 715 British Documents on the Origins of the War, V. IX, P. II, London 1934, d. nr. 369, f. 273-274. Fondi A. VI. 39.

⁷ Mensdorff-Pouilly-Dietrichstein, Albert Count (1861-1945), Sekretar në Ambasadën e Austro - Hungarisë në Londër, 1904; Ambasador në Londër, 1904-14.

⁸ Berchtold, Leopold, Count (Graf) von (1863-1942), Ambasador i Austro - Hungarisë në St. Petersburg, 1906-11; ministër i Punëve të Jashtme, 19 shkurt 1912-5. Arkitekti kryesor i krizës. Diplomati qytetar dhe me përvojë, por fare pak i përshtatshëm për rolin e ministrit të Jashtëm. Pas vrasjes së Franz Ferdinandit, u bë përkrahësi kryesor i një vije shumë të ashpër kundër Serbisë.

⁹ Imperatori, Marquis Guglielmo (1871-1942), Ambasador, përkatësisht ministër

shprehë gjithashtu kundër posedimit territorial të një skele serbe, megjithëse çdo lloj daljeje ekonomike do të pranohej. Më tej mbi mendimet ekonomike të Austrisë duket se ekzistonte një keqkuptim. Ajo nuk kishte dëshirë të pengonte pavarësinë ekonomike të Serbisë; gjithçka që dëshironte ishte që të mos humbiste tregjet që ajo kishte pasur më parë dhe ajo duhej të kishte të drejta tranziti për tregtinë e vetë. Unë thashë se kishte pasur një sugjerim për t'i dhënë Serbisë një rrip të ngushtë territori të neutralizuar drejt një skele të neutralizuar gjithashtu. Konti Mensdorff u shprehë se realizimi i kësaj do të qe shumë i vështirë. Austria kishte frikë se Shqipëria do ta ngacmonte rripin e neutralizuar dhe se Serbia pastaj këtë do ta merrte si pretekst për të kërkuar më tepër. Prej një skele tregtare do të bëhej një port ushtarak dhe ai nuk besonte se Austria mund ta aprovonte këtë...”

Mungesa e potencialit dhe vullnetit të Qeverisë së Stambollit për t'i mbrojtur dhe për t'ju njohur të drejtat kombëtare shqiptarëve, i nxiti këta të fundit edhe më shumë kundër Perandorisë. Prandaj vitet 1910-1912 u karakterizuan me përplasje të forta në mes shqiptarëve dhe autoriteteve osmane të cilët përdorën taktikën për “t'i disiplinuar shqiptarët” duke i mashtruar me premtimin se pas revolucionit xhonturk kërkesat e shqiptarëve do të merreshin në konsideratë. Mashtrimi xhonturk nxiti Isa Boletinin dhe atdhetarë të tjerë për të organizuar kryengritje të përgjithshme, kundër turqve të rinj me kërkesë kryesore, autonominë e Shqipërisë¹⁰. Lajmi për kryengritjen shqiptare nën udhëheqjen e Isa Boletinit u përhap shumë shpejt jo vetëm në Vilajetin e Kosovës, por edhe në vilajetet tjera shqiptare.

fuqiplotë i Mbretërisë së Italisë në Uashington, Bruksel, Sofje, Beograd, Kostandinopojë dhe në Londër (1910 - 1921).

¹⁰*AIHT* F. O. 52974/42842/12/44, Nr. 716 British Documents on the Origins of the War, V. IX, P. II, London 1934, d. nr. 369, f. 275. Fondi A. VI. 39.

Për përgatitjen e shqiptarëve dhe lëvizjet kryengritëse raportonin edhe ambasadorët, konsujt dhe përfaqësuesit tjerë diplomatikë¹¹.

Kështu, në një raport të konsullit austro-hungarez Tahy nga vendi i Isa Boletinit, Mitrovica, dërguar ministrit të Jashtëm Berchtold¹², njoftohej lidhur me përgatitjet për një kryengritje kundër osmane në Vilajetin e Kosovës, ku thuhet se veprimtaria e Isa Boletinit që shkon drejt një revolucioni, energjia e pashterur dhe heroizmi i tij, që po i nxjerrin aq shumë telashe regjimit të ri, e afrojnë më tepër mundësinë e një kryengritje me përmasa më të gjëra. Për lëvizjen kryengritëse shqiptare dhe drejtimin e saj nga Isa Boletini njoftonte edhe diplomati britanik Sir G. Buchanan¹³ i cili ishte agjent dhe konsull i përgjithshëm britanik në Bullgari, në raportin e gjatë dhe të detajuar dërguar ministrit të Punëve të Jashtme Sir Edward Grey¹⁴ në të cilin përveç tjerash fliste për gjendjen e Perandorisë Osmane në territoret e banuara me shqiptarë, pretendimet e Serbisë për “Serbinë e Vjetër” siç e quanin Kosovën dhe për vështirësitë e pengesat që po haste politika serbe për shkak të rezistencës së kryengritësve shqiptarë. Edhe ambasadori britanik në Vjenë Sir Fairfax Cartwright në raportin e dërguar Ministrisë së

¹¹ *AIHT* F. O. 50249/42842/12/44, Nr. 449, British Documents on the Origins of the War, Vol. IX, Part II, London 1934, d. nr. 270, f. 200-1. Fondi A.VI.39.

¹² Berchtold, Leopold, Count (Graf) von (1863-1942), Ambasador i Austro-Hungarisë në St. Petersburg, 1906-11; Ministër i Punëve të jashtme, 19 shkurt 1912-5. Arkitekti kryesor i krizës. Diplomati qytetar dhe me përvojë, por fare pak i përshtatshëm për rolin e ministrit të Jashtëm. Pas vrasjes së Franz Ferdinandit, u bë përkrahësi kryesor i një vije shumë të ashpër kundër Serbisë.

¹³ Buchanan, Sir George William (1854-1924), Agjent dhe konsull i përgjithshëm britanik në Bullgari, 1903-9; ambasador në St. Petersburg, 1910-8; në Romë, 1919-21.

¹⁴ Grey, Sir Edward (1862-1933). Që nga viti 1916, Viskonti I Grey i Fallodonit. Ministër i jashtëm britanik nga 11 dhjetori 1905 deri në 11 dhjetor 1916. Njeri i zgjuar, por shpesh naiv lidhur me punët e jashtme. Ishte antigjerman, kishte shumë kujdes lidhur me angazhimet e jashtme, por e përkrahte ndërhyrjen më tepër sesa shumica e anëtarëve të Partisë Liberale.

Punëve të Jashtme britanike më datë 25 nëntor 1912 i njoftuar me situatën më të re në rajonin e trazuar nga lufta ballkanike¹⁵.

Dokumenti në vazhdim trajtonte mobilizimin e shqiptarëve të cilët kishin ngritur krye. Ai përmendte në mes tjerash edhe Isa Boletinin dhe rolin e tij në udhëheqjen e kryengritësve. Diplomacia britanike e vlerësonte Isanë si një nga udhëheqësit kryesor në Vilajetin e Kosovës. Atë e përshkruanin si personalitet autoritativ pa ndonjë shkollim të veçantë, një burrë të besës e traditës që kishte ndikim në popull. Isa sa herë që donte i mobilizonte forcat kryengritëse jo vetëm kundër osmanëve, por edhe kundër forcave serbe, malazeze e bullgare¹⁶. Situata e përgjithshme në Ballkan dhe mundësitë e përhapjes së konflikteve në mes popujve dhe shteteve trajtoheshin edhe nga shtypi britanik përfshirë këtu gazeta prestigjioze si: "The Times", "Daily Mirror", "Daily Telegraph" etj. Shtypi britanik trajtonte në tërësi pozicionet e palëve. Në njërën anë Perandoria Osmane, dhe përballë saj monarkitë ballkanike që luftonin për të përfutur nga dobësimi i Perandorisë. Luftërat Ballkanike dhe përpjekjet e popujve për liri u bënë tema të përhershme në shtypin britanik.

Diplomacia britanike nga ana e saj i konsideronte shqiptarët si faktorë të rëndësishëm brenda Perandorisë Osmane duke vlerësuar se edhe stabiliteti i saj i brendshëm në territoret e banuara me shqiptarë varet në masë të konsiderueshme nga këta të fundit. Sipas burimeve britanike, kryengritjet shqiptare ende nuk kishin arritur ndonjë nivel të lartë të organizimit. Mirëpo, pavarësisht kësaj aty

¹⁵ *AIHT*, F. O. 52551/42842/12/44, Nr. 96 British Documents on the Origins of the War, V. IX, P. II, London 1934, d. nr. 345, f. 255-256. Fondi A. VI. 39.

¹⁶ Më gjerësisht shih: *AIHT*, Dokumente Diplomatieke Britanike për çështjen shqiptare në Konferencën e Ambasadorëve në Londër 1912-13. Fondi A. VI.39.

ishin të përfshirë një numër i madh i personaliteteve me autoritet nga të gjitha vilajetet e banuara me shumicë shqiptare.

Kur flitet për territoret që përfshinte Vilajeti i Kosovës, Isa Boletini përmendej si njëri nga personalitetet më autoritativ, i cili mund të mobilizonte në luftë një numër të madh kryengritësish shqiptarë brenda një kohe të shkurtër. Sipas burimeve britanike, Isa Boletini konsiderohej si një nga pengesat kryesore për realizimin e pretendimeve të Serbisë dhe Malit të Zi. Prandaj, diplomacia serbe dhe malazeze përdorën taktika të ndryshme për të minimizuar rolin e Isait në ngjarjet e rëndësishme siç ishte Kryengritja e Kosovës 1910, Kryengritja e Malësisë më 1911 dhe Kryengritja e Përgjithshme 1912¹⁷.

Në burimet britanike flitet edhe për mënyrën se si Serbia dhe Mali i Zi përdorën joshjen por në të njëjtën kohë edhe kërcënimin për Isanë dhe bashkëpunëtorët e tij. Diplomacia serbe dhe ajo malazeze mendohej që kryengritësit shqiptarë t'i dobësonte duke i nxitur kundër Perandorisë Osmane, që pastaj ta kishin më të lehtë të aneksonin territoret e tyre. Nga ana tjetër edhe autoritetet osmane alarmonin për rrezikun serb e malazez për shqiptarët, duke u munduar të bindin udhëheqësit politikë dhe kryengritës të mos e ndanin fatin e tyre nga ai i Perandorisë Osmane. Që Isa Boletini ishte bërë një personazh i rëndësishëm flet edhe Obri (Aubrey) Herbert në kujtimet e tij. Herbert ishte një udhëpërshkrues politikan e diplomat britanik, njohës i mirë i rrethanave shqiptare dhe njëkohësisht shquhej edhe si mik i Isa Boletinit dhe i shqiptarëve. Sipas Herbert, Isa Boletini një burrë shumë i gjatë me mustaqe, i shkathët, shqiptar tradicional verior, me një fytyrë të ashpër, në veshje gegë, në këtë kohë (1910-1912), ishte bërë një hero dhe emri i tij përmendej

¹⁷ Jusuf Bajraktari, "Kryengritja antiosmane e vitit 1910 në Kosovë", *Kryengritja e vitit 1910 në Kosovë*, Instituti i Historisë-Prishtinë, Prishtinë 2012, f. 14.

gjithandej. Herbert, Isa Boletinin e quajti edhe Robin Hudi i shqiptarëve. Ai përmend gjithashtu që në kontaktet e tij me Isa Boletinin, ky i fundit t'i ketë thënë se shqiptarët shpresojnë që Anglia do t'i ndihmonte në përpjekjet e tyre në mbrojtje të territoreve shqiptare. Herbert gjithashtu citon Isanë t'i ketë thënë se “veriu dhe jugu, toskët dhe gegët duhet të bashkohen se janë i njëjti popull”.

Në një dokument të datës 27 gusht 1912 në një raport diplomatik në të cilin flitej për marrëdhëniet e autoriteteve osmane me popullsinë vendëse thuhej se krerët lokal janë shumë të revoltuar ndaj pushtetit osman i cili i trajton shqiptarët në mënyrën më të keqe. Në mesin e krerëve të revoltuar përmenden krerët e Ipekut (Pejës), Prizrenit si dhe Riza beu nga Gjakova dhe Isa Mitrovica, pra është fjala për Isa Boletinin. Për rrethanat shqiptare, heroizmat e Isa Boletinit dhe për lidhjen shpirtërore të Miss Edith Durham fliste edhe gazetari britanik, Henri Nevinston, që e shoqëroi Durhamin kur ajo administronte ndihmat për malësorët shqiptarë, gjatë luftërave ballkanike të 1911-1913, duke përshkruar cilësitë që e shndërruan atë në legjendë, thekson: “Qysh kur vuri këmbën në Shqipëri, ajo u bë shqiptare me zemër dhe shpirt”¹⁸. Isa Boletini u njoh dhe u trajtua si personalitet i rëndësishëm i cili zuri vend edhe në raportet e përditshme dhe periodike të konsujve dhe ambasadorëve të Mbretërisë së Bashkuar. Isa Boletinin u munduan ta “bënin për vete” edhe Perandoria Osmane, Mali i Zi dhe Serbia, por ai ishte dhe mbeti personalitet i qëndrueshëm përballë sfidave dhe tundimeve duke lënë mënjanë gjithçka dhe duke u përkushtuar i tëri për liri e shtet

¹⁸ Edith Durham, *Njëzet vjet ngatërresa ballkanike*, Tiranë 2001; Enciclopedia Britanica, History of United Kingdom, www.british-history.ac.uk
Shanafelt, Gary W, An English Lady in High Albania: Edith Durham and the Balkans, *Academis Jurnal Article*, East European Quarterly. www.questia.com, parë më 1. 10. 2015.

kombëtar. Prandaj, për figurën e Isa Boletinit dhe kontributin e tij duhet edhe më tej të thellohen studimet e bazuara në burime arkivore jo vetëm britanike, por edhe austriake, franceze, italiane e ruse, në mënyrë që portreti historik i këtij personaliteti të jetë sa më i kompletuar. Prof.

Prof. dr. Frasher DEMAJ

SUMMARY

ISA BOLETINI'S ACTIVITIES ACCORDING TO BRITISH SOURCES 1910-1912

Isa Boletini became an attractive and important personality to report on for the consulates, the embassies and the other circles of diplomatic representations. For Isa Boletini and the preparations for an Albanian uprising the embassies and consuls were also informed, who reported for the former. The consular reports regarding the uprising in the Vilayet of Kosova, detail the activity of Isa Boletini in organizing a revolution. For the Albanian uprising and the direction it was headed by Isa Boletini, the diplomat Sir G. Buchanan also reported as a general British consul in Bulgaria. In his long and detailed report sent to the Minister of Foreign Affairs, Sir Edward Grey, regarding the situation within the Ottoman Empire inhabited by Albanians, he reports regarding the Serbian intentions in acquiring 'Old Serbia', a term used to refer to Kosova. The British ambassador in Vienna, Sir Fairfax Cartwright, in his report sent to the British Ministry of Foreign Affairs on the 25th of November 1912, informs the Ministry regarding the situation in the region troubled by the Balkan war. He mentions, among other things, Isa Boletini and his role in leading the insurgency.

Even Aubrey Herbert speaks of Isa Boletini's importance in his memoirs. Herbert was a traveler, politician and British diplomat,

who was quite well informed on the Albanian case, and was at the same time a friend of Isa Boletini and of Albanians. According to Herbert, Isa Boletini was a tall man, with a mustache, resourceful, a traditional northern Albanian, with a rough face, who wore Gheg clothing, and who at the time spanning from 1910 to 1912 had become a hero and his name echoed throughout the Albanian lands.

Herbert even called Isa Boletini the Albanian Robin Hood. He also mentioned his relations with Isa Boletini, where the latter apparently had told him that Albanians hoped that England would help them in protecting the Albanian territories. Herbert also cites him having said: 'North and South, Tosks and Ghegs need to unify because they are the same people'. For this reason, studies regarding the figure of Isa Boletini and his contributions need to expand further based on archival sources, not only British ones, but also Austrian, French, Italian and Russian, in order for the portrait of Isa Boletini's personality to be considered complete.

Prof. dr. Xheladin SHALA
(Prishtinë)

ISA BOLETINI NË DOKUMENTET SERBE 1914-1915

Me gjithë pushtimin dhe sundimin e më tepër së gjysmës së Shqipërisë Verilindore, politika serbe asnjëherë nuk e ka ndalur interesimin dhe vëzhgimin e personaliteteve me rëndësi të veprimtarisë kombëtare shqiptare. Njëri ndër ato personalitete kombëtare që u ndoq është edhe Isa Boletini, si alfa e omega e kryengritjeve shqiptare kundër pushtuesve të huaj. Mirëpo, duhet potencuar se dokumentet serbe nuk kanë për objekt analizash të thukshme në detaje për Isa Boletinin, megjithëse ne dyshojmë që dokumentet e tilla janë nën embargo në arkivat serbe. Për atë jam i sigurt lidhur me një arkiv tejet sekret për shqiptarët. Për shumë dokumente të rëndësishme për popullin tonë thuhet (“preneseno u strogo poverlivom Allbanskom Arhivu”). Dihet qëllimi i politikës serbe. Andaj, Isa Boletini, në bazë të hulumtimeve tona në fillim të viteve ‘80 të shekullit të kaluar, në katër arkivat e Beogradit (Arkivin e Serbisë, Arkivin e Jugosllavisë, Arkivin Diplomatik dhe në Arkivin e Institutit të Historisë Ushtarake), veprimtaria e tij përcillet vazhdimisht.

Ndjekja e veprimeve kombëtare të Isa Boletinit nga politika serbe më 1914

Pra, interesimi për Isa Boletinin vazhdon edhe gjatë vitit 1914 dhe 1915, ku në dokumentet serbe paraqiten veprimet e tij në çdo fshat dhe qytet të Shqipërisë së 1913, duke i përcjellur me shumë vëmendje lëvizjet e tij kombëtare. Kështu, Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë i raportonte kryeministrit të vetë më 1 janar 1914 se, sipas informatave nga pjesa e Shqipërisë së pavarur po bëhen përgatitje të mëdha që në pranverë të ngriten në kryengritje dhe se për çdo ditë arrinin armët nga Shkodra dhe Lezha në fshatin Rogovë të Hasit. Ky fshat ndodhej në skaj të kufirit të atëhershëm të 1913 afër Urës së Shenjtë jo fort larg nga Gjakova.

Sipas këtij raporti, Isa Boletini ndodhej në një fshat të Shqipërisë larg rreth dy orë nga kufiri. Urgjentisht kërkohet që të përqendrohet ushtria përgjatë kufirit shqiptar dhe në tërësi të ndërpritet çdo komunikim nëpërmjet rrugëve që shkojnë në fshatrat Mamushë, Xërxe dhe Piranë, andaj, duhet dërguar një numër të madh ushtarësh për bllokim. Gjithashtu, duhet kujdes i shtuar kah kufiri i pushtuesve malazez, ku thuhej se ata kinse janë të pakujdesshëm ndaj veprimeve të shqiptarëve¹. Po ajo ministri e Beogradit raportonte se dy-tri ditë para vitit të ri të 1914 nga Shkodra ka arritur në Has, Isa Boletini, i cili është vendosur në fshatin Gorozhupë, kurse në fshatin Gjonaj ka arritur Musa Efendiu nga Prizreni, që në muajin nëntor 1913 ka udhëtuar nga Shkupi për Selanik prej nga është vendosur në Shqipëri. Në Krasniqe ndodhej Bajram Curri, kurse Riza Gjakova

¹ DASSIP-AO Beograd 1914, fasc. II, dos. II, br. 15; Ai kufi do të shtyhet në majë të vargmaleve pas intervencionit jugosllav në verë - vjeshtë të vitit 1921, ku vendoset më 9 nëntor të atij viti.

gjendej në Spas. Thuhej që në Has janë grumbulluar disa qindra kryengritës shqiptarë të armatosur².

Asokohe, më 9 janar 1914 Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë lajmëronte se brenda kufirit shqiptar të 1913 ndodhen rreth 10 000 shqiptarë të larguar nga Kosova, të cilët kanë shprehur gatishmërinë të kthehen në vatrat e tyre, duke sugjeruar që për shkaqe politike të situatës së jashtme do të ishte mençuri që bashkë me familje të pranohet kthimi, nëse nuk kanë marrë pjesë në kryengritjen e fundit dhe në ato të mëparshme kundër Serbisë, të cilët shumë prej tyre janë tërhequr nga rreziku i pushtuesve serbo-malazezë si Isa Boletini etj.³ Mirëpo, pas dy dite më 11 janar 1914, ministri i Punëve të Brendshme lidhur me të kthyerit të rreth 10 000 shqiptarëve në vatrat e veta, urdhëron që atë përgjegjësi ta marrin inspektorët e qendrave të Shkupit, Mitrovicës dhe të Manastirit, d. m. th. të kalojnë njerëzit “në shoshë e sitë”. Përndryshe, hë për hë nuk lejohet kthimi nga frika se do të bëhej ndonjë çrregullim apo edhe diçka më tepër⁴.

Atëbotë, thuhej se nga Shqipëria ka ardhur në Mitrovicë njëfarë Bajram Fishekgjiu dhe se nënës së Isa Boletinit ia kishte sjellur një letër të dërguar nga kushëriri i Isait, Bislimi, ku pos tjerash bëhej me dije se “Prizreni dhe Kosova në përgjithësi do t’i takojnë Shqipërisë”⁵. Gjithashtu, pushteti serb i përcjellë edhe anëtarët tjerë të familjes së Isa Boletinit. Kështu, më 27 shkurt 1914 Ministria e Punëve të Jashtme e Serbisë me telegram lajmërohet nga kryeshefi i

² DASSIP-AO Beograd 1914, fasc. I, dos. IV, br. 17.

³ DASSIP-AO Beograd 1914, fasc. II, dos. IV, br. 651.

⁴ DASSIP-AO Beograd 1914, fasc. II, dos. IV, br. 214; Po aty, fasc. II, dos. I, br. 930.

⁵ DASSIP-AO Beograd 1914, fasc. II, dos. II, br. 234; Kryeshefi i Rashkës dhe Novi Pazarit e lajmëron Ministrinë e Punëve të Jashtme në Beograd më 23 janar 1914.

rrethit të Kosovës, nga Mitrovica: “Djali i Isa Boletinit, Pajaziti, ka udhëtuar sot me tren prej Shkupit për në Beograd. Ju lutem të urdhëroni organet dhe ndaj tij të kenë kujdes që nga Zemuni të mos lejohet të shkojë në Vjenë, ku ndodhet vëllai i tij më i vjetër në shkollë si 12 vjeçar”⁶.

Mirëpo, në Shqipërinë e vitit 1913 situata ishte mjaft e megjulluar, ku u krijuan shumë “qeveri” lokale. Ismail Qemali më 22 janar 1914 u detyrua të jap dorëheqje. Isa Boletini nga fundi i nëntorit 1913 nga Shkodra shkoi në Vlorë, ku qëndroi deri në fund të janarit 1914 dhe sërish kthehet në Shkodër, si një qendër e rëndësishme e tubimit të atdhetarëve të shumtë, derisa erdhi Princ Vidi në Durrës më 7 mars të vitit 1914. Edhe Isa Boletini e përkrahu ardhjen e Princ Vedit në krye të shtetit shqiptar, ashtu si shumica e atdhetarëve shqiptarë.

Pas shuarjes së kryengritjes së muajve mars-prill 1914, në qendër të Kosovës në rrethin e Malishevës, Therandës, Rahavecit dhe Drenicës, një pjesë e kryengritësve detyrohen të largohen nga Kosova dhe vendosen në Shqipërinë e 1913. Është një raport i gjatë prej katër faqesh që nga përfaqësuesi serb në Durrës, Panta Gavrilloviq, ia dërgoi Ministrisë së Punëve të Jashtme në Beograd. Në atë raport theksohet se ka shumë shqiptarë të shpërngulur nga Kosova në Turqi, por edhe në Shqipëri. Numrin e tyre të saktë askush nuk mund ta dijë. Mirëpo, më së shumti janë përqendruar në Shkodër, ku ndodheshin edhe Isa Boletini, Bajram Curri, Riza Gjakova etj., shumica prej të cilëve kanë marrë pjesë në kryengritjen e muajve shtator-tetor 1913 përgjatë kufirit dhe në kryengritjen në Kosovë gjatë muajve mars-prill 1914.

⁶ DASSIP-AO Beograd 1914, fasc. II, dos. IV, br. 509; Më 1 mars 1914, kryeministri serb, Nikolla Pashiq, urdhëron që Pajaziti të pengohet të kalojë në anën e Austro - Hungarisë, ku kufiri i saj ishte te Zemuni.

Ndërkaq, shqiptarët nga ana e Dibrës kryesisht ishin përqendruar në Tiranë dhe Elbasan⁷. Kurse, më 6 qershor 1914 në një raport prej tri faqesh përshkruhet qëndrimi i Tafil Boletinit në Shkodër së bashku me dy vëllezërit e tij që kinse ishte “i interesuar” të kthehet në Mitrovicë te familja dhe pasuria e vetë. Pastaj, bëhet fjalë se Tafil Boletini është njeri inteligjent, ka kryer gjimnazin ushtarak në Stamboll dhe konsiderohet dorë e djathtë e Isa Boletinit. Ai ishte sekretar personal i tij. Isa Boletini për çdo gjë konsultohet me të. Kështu që, Tafil Boletini si njeri shumë i vlefshëm për Isa Boletinin, dëshira e politikës dhe e diplomacisë serbe ishte që “të hyjnë disi në mes tyre” dhe ta joshin të kthehej Tafil Boletini me dy vëllezërit në Mitrovicë, me qëllim që t’i ndajnë nga Isa Boletini⁸.

Politika serbe gjithnjë ka punuar në atë drejtim - lisin më së miri e qanë pyka e vetë. Ndërkaq, në një dokument tjetër serb të datës 10 qershor 1914 për Isa Boletinin thuhet se është shumë vështirë të kuptohet pasi që si udhëheqës shumëvjeçar i kryengritjeve, është treguar i zhdërvjelltë dhe rrallë ndonjëherë ka treguar diçka të caktuar. Andaj, sikur Isa Boletini t’i kishte me vete 500 luftëtarë të regjur do të ishte në gjendje t’i jepte grusht vendimtar çdokujt, pra edhe Esat Pashës, kundër të cilit ishte Isa Boletini⁹. Për shkak të situatës jostabile në Shqipëri në fillim të qershorit 1914, përfaqësuesi serb në Durrës, Panta Gavrilloviq, më 18 qershor shkruan se Qeveria shqiptare po mendon që t’i thërrasë 1 000 shqiptarë nga Kosova, duke komentuar se kanë aftësi dhe përvojë luftarake, meqë shqiptarët nga Kosova e kanë treguar veten nën komandën e Isa Boletinit¹⁰.

⁷ DASSIP-AO Beograd 1914, fasc. II, dos. IV, br. 1084.

⁸ DASSIP-AO Beograd 1914, fasc. II, dos. IV, br. 1234.

⁹ DASSIP-AO Beograd 1914, fasc. I, dos. VII, br. 1265.

¹⁰ DASSIP-AO Beograd 1914, fasc. I, dos. VIII, br. 1321.

Ndërkaq, më 17 korrik nga Durrësi, P. Gavrilloviq, lajmëron Ministrinë e Punëve të Jashtme në Nish se Isa Boletini së bashku me 60 luftëtarë të vetë ka udhëtuar me një anije austriake për në Shëngjin, me qëllim të depërtimit në territorin e pushtuar nga Serbia. Gjithashtu, krerët shqiptarë të Kosovës po përpiqen që me kryengritësit antividist ta arrijnë një marrëveshje që bashkërisht të mësyjnë kufirin. Prandaj, sipas Gavrillovitqit thuhej se bashkë me Isa Boletin, Hasan Prishtinën, Bajram Currin është edhe Mehmet pashë Dërrallën që kanë mbajtur disa mbledhje (takime) me shqiptarët nacionalistë “proaustriak” si Dervish Himën dhe Jashar Erebarën, me qëllim të arritjes së marrëveshjes. Për këtë Pashiqi sugjeron që të informohet Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë dhe kryeshefi i rrethit të Prizrenit¹¹.

Në anën tjetër, politika serbe në “kundërofenzivë” i bënë me dije kryeshefit të rrethit të Shkupit, për afrimin e Esat Pashës me Qeverinë serbe të vendosur në Nish pas fillimit të luftës me Austro-Hungarinë. Ato lidhje do t’i vazhdojnë me sekretarin e Esat Pashës, Shahin Beun, i cili do të udhëton nga Dibra për Shkup prej nga me tren e vazhdon rrugën për në Nish¹². Ishte koha e muajve qershor-korrik të vitit 1914 e shfaqjes së një kryengritjeje fshatare në Shqipërinë e Mesme të vitit 1913, që ishte një pështjellim i madh për kohën. Përfaqësuesi serb në Durrës, Panta Gavrilloviq, i raporton qeverisë së vetë më 25 korrik lidhur me shqiptarët e Kosovës të shpërngulur në Shqipëri. Në Shkodër thuhej se janë koncentruar për të shikuar rrugën kah të shpërthehet kufiri. Me Hasan Prishtinën kanë udhëtuar Halim Dërralla - djali i Mehmet pashë Dërrallës, Qerim

¹¹ DASSIP-AO Beograd 1914, fasc. IV, dos. I, br. 14.

¹² DASSIP-AO Beograd 1914, fasc. IV, dos. I, br. 59; Beogradi si kryeqytet ishte shumë afër kufirit austro-hungarez, andaj Qeveria serbe u vendos më në brendi në Nish.

Mahmutbegolli, Selim Batusha dhe Tafil Boletini - djali i vëllait të Isa Boletinit. Pos tyre kanë shkuar edhe më tepër se 300 shqiptarë, shumica nga Kosova dhe disa nga Dibra. Kurse, sa i përket Isa Boletinit dhe Bajram Currit ata ende qëndronin në Durrës, por që edhe këta së shpejti me 200 vetë do të drejtohen për në Shkodër, ku do të bashkohen me të gjithë të shpërngulurit nga Kosova dhe Mali i Zi. Sipas një telegrami të nënkonsullit rus në Shkodër, Ferhmina, shqiptarët kryengritës do të koncentrohen në Lumë. Rolin kryesor në këtë ekspeditë e kishte Hasan Prishtina.

Ky aktivitet është marrë vetëm nga shqiptarët e shpërngulur prej territoreve të pushtuara nga serbo-malazezët, pasi që kryengritësit fshatarë refuzuan kategorikisht sulm të përbashkët në kufirin verilindor¹³. Më 26 korrik 1914, Turhan Pasha takohet me Gavrilloviqin, për ta bindur për masat që kishte marrë qeveria shqiptare lidhur me lëvizjet e shqiptarëve të Kosovës të vendosur në Shqipëri. Gjithashtu, intervenon që Isa Boletini dhe Bajram Curri me bashkëluftëtarët e vetë t'i mbajë pranë qeverisë në Durrës. Madje, Turhan Pasha intervenon te legata italiane në Shkodër, meqë Qeveria shqiptare nuk kishte kurrfarë ndikimi në Shkodër. Edhe Gavrilloviqi bindet që, Turhan Pasha e kishte marrë seriozisht kërcënimin serb për Qeverinë shqiptare¹⁴. Në të vërtetë, përgatitjet e të dy blloqeve të fuqive evropiane për Luftën e Parë Botërore, e shtynë Isa Boletinin, Hasan Prishtinën, Bajram Currin e të tjerë atdhetarë shqiptarë, që në lëmshin e kontradiktave midis shteteve të mëdha, tentonin të kapnin e të shfrytëzonin ato midis Austro-Hungarisë e Serbisë në Shqipëri,

¹³ DASSIP-AO Beograd 1914, fasc. IV, dos. I, br. 41: Raport i Panta Gavrilloviqit dërguar Nikolla Pashiqit më 25 korrik 1914; Në dokument thuhet se nga Austria kanë marrë 800 pushkë dhe një shumë të hollash dhe mbi 30 sëndeka me municion për pushkë dhe 4 sosh me eksploziv.

¹⁴ DASSIP-AO Beograd 1914, fasc. IV, dos. I, br. 43.

për çlirimin e Kosovës e të territoreve të tjera shqiptare dhe bashkimin e tyre me Shqipërinë.

Mirëpo, Qirkoviqi në bisedë me Qamil Efendinë (Haxhi Qamilin) raporton nga Ohri për zhvillimet e kryengritjes fshatare antividiste në Shqipërinë e Mesme nga Durrësi deri në Vlorë. Qirkoviqi lajmëron më 6 gusht 1914 se Isa Boletini ndodhej ende në Durrës¹⁵. Vërtet, Qeveria shqiptare në vend se të merrej me çështje më të rëndësishme kombëtare, ajo u detyrua të merrej pandërprerë me çështje që nuk ishin të nevojshme si, shfaqja e asaj lëvizjeje anakronike e fshatarëve në Shqipërinë e Mesme, kur gjysma tjetër e Shqipërisë rënkonte nga pushtuesit barbarë serbo-malazezë.

Duke parë ato ndërhyrje të ndryshme rreth kryengritjes fshatare, Isa Boletini, nuk u mundua më, të hynte në marrëveshje me kryengritësit rebelë. Ai iu përmbajt vendimit dhe idesë së tij të drejtë për mbrojtjen e qeverisë së Durrësit dhe Princ Vedit si institucione kryesore të shtetit shqiptar. Andaj, është fakt që Isa Boletini qëndroi në Durrës derisa Princ Vidi u largua nga Shqipëria¹⁶. Pas largimit të Princ Vedit nga Shqipëria më 3 shtator 1914, Isa Boletini, Bajram Curri dhe shumë shqiptarë nga Kosova, u larguan më 5 shtator nga Durrësi për në Shëngjin dhe pas disa ditësh u nisën për në krahinën e Hasit. Isa Boletini u sëmur nga ato çka pa në kryengritjen fshatare dhe u detyrua të qëndroi në Krumë deri në fund të tetorit 1914.

Në anën tjetër “gjahu i çmueshëm” Esat Pasha ra në “prehrin” e Pashiqit në fund të gushtit dhe në fillim të shtatorit 1914, meqë më 14 shtator përfaqësuesi serb, Ballugxhiq, lajmëronte se Esat Pasha është takuar me Nikolla Pashiqin, ku është biseduar që patjetër duhet të hyjë në Shqipëri dhe paraprakisht të lidhë “marrëveshje” me

¹⁵ DASSIP-AO Beograd 1914, fasc. IV, dos. I, br. 63.

¹⁶ Fatmira Musaj, *Isa Boletini*, Tiranë, 2004, 196.

Greqinë, Serbinë dhe Malin e Zi¹⁷. Sipas Gavrilloviqit, kthimi i Esat Pashës aspak nuk i pëlqente përfaqësuesit austro-hungarez në Durrës, por përfaqësuesit serb gjithsesi. Ai ishte më se i kënaqur me largimin e Princ Vedit, që kishte udhëtuar për Venedik së bashku me shumë ministra, e pas dy dite nga Durrësi janë larguar edhe shqiptarët e Kosovës me Isa Boletinin e Bajram Currin për në Shëngjin, ku ishin më se 500 burra. Me vete kanë marrë shumë armatim dhe municion. Me largimin e kosovarëve nga Durrësi kanë depërtuar disa qindra kryengritës fshatarë në këtë qytet¹⁸. Pra, pas largimit të Isa Boletinit dhe Bajram Currit me përkrahësit e tyre më 5 shtator 1914, kryengritësit fshatarë hynë në Durrës, ku e hoqën flamurin kombëtar dhe e ngritën atë osman.

Udhëheqësit komandues ushtarak të Serbisë këmbëjnë mendime me kryeshefin e rrethit të Prizrenit mbi aktivitetin e shqiptarëve të Kosovës të vendosur rreth kufijve verilindorë të Shqipërisë së 1913, ku njoftohen se Isa Boletini dhe Bajram Curri me bashkëluftëtarët e vetë kanë arritur në Krumë më 13 shtator 1914¹⁹. Ndërkaq, një ditë më vonë Ministria Ushtarake serbe e lajmëronte Ministrinë e Punëve të Jashtme që Isa Boletini është bashkë me Bajram Currin dhe janë duke u përgatitur për sulm në kufirin e imponuar shqiptaro-shqiptar, vetëm se po presin udhëzime nga Austria dhe Bullgaria. Thuhej se në mesin e kryengritësve të Isa Boletinit dhe Bajram Currit ka oficerë austriakë “të pajisur me topa dhe mitraloza” dhe se ata do ta udhëheqin sulmin. Brenda 10 ditëve mendohej që sulmi do të fillojë kah Dibra, Prizreni dhe Gjakova. Qëllimi i sulmit të Isa Boletinit dhe Bajram Currit me

¹⁷ AJ, fond: J. J. "Pizhon", kut. 11-80-11-385, br. 483.

¹⁸ DASSIP-AO Beograd 1914, fasc. IV, dos. II, br. 99; Raport i P. Gavrilloviqit dërguar nga Durrësi Ministrisë së Punëve të Jashtme në Nish më 7 shtator 1914.

¹⁹ DASSIP-AO Beograd 1914, fasc. IV, dos. V, br. 108.

bashkëluftëtarët e vetë është Kosova. Andaj, duhet koncentruar fuqi më të mëdha ushtarake përgjatë kufirit. Më 18 shtator 1914 Pashiqi urdhëron që t'i bëhet me dije për situatën kryeshefit të rrethit të Prizrenit²⁰. Kurse, Ministria e Punëve të Brendshme më 17 tetor 1914 njofton Ministrinë e Punëve të Jashtme në Nish se po punohet intensivisht për sulm në Kosovë. "Hasan Prishtina ndodhet në Kalis, në jug të Lumës, ku sërish tubon shqiptarë dhe po përgatitet për të sulmuar kufirin me drejtim: Gostivar-Dibër-Prizren"²¹.

Mirëpo, pas mospjekësive të ushtrisë austro-hungareze në ballafaqim me ushtrinë serbe, përfaqësuesi i saj në Durrës, Gavrilloviq, më 4 dhjetor 1914 i raporton Ministrisë së Punëve të Jashtme në Nish për entuziazmin e tij dhe të Esat Pashës, i cili ia uron atij dhe kërkon që t'ia përcjellë urimet mbretit serb. Gjithashtu, fitoren serbe ia uron edhe mitropoliti i Durrësit, Jakov, dhe disa krishterë të njohur. Po atë ditë, më 4 dhjetor, në "Senat" Esat Pasha flet me epitete për fitoren e serbëve ndaj austro-hungarezëve. Pashiqi urdhëron që menjëherë urimi i Esat Pashës t'i përcillet edhe trashëgimtarit të mbretit serb²². Duhet theksuar se Bertholdi, Ministër i Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë për shkak të situatës së krijuar në fund të muajve 1914, më 13 janar 1915 jep dorëheqje nga pozita e vetë. Bertholdin e zëvendëson ish-ministri i Financave, hungarezi Stjepan Burian.

Përcjellja e Isa Boletinit gjatë vitit 1915

Vazhdimi i Luftës së Parë Botërore e keqësoi edhe më tepër situatën në shtetin shqiptar. Kthimi i Esat Pashës me ndihmën e

²⁰ DASSIP-AO Beograd 1914, fasc. IV, dos. II, br. 125.

²¹ DASSIP-AO Beograd 1914, fasc. IV, dos. III, br. 181.

²² DASSIP-AO Beograd 1914, fasc. IV, dos. V, br. 212.

politikës serbe, vazhdimi i kryengritjes fshatare në Shqipërinë e Mesme dhe në Jug, si dhe pushtimi i Vlorës në muajin dhjetor 1914 nga Italia, e përkeqësoi gjendjen edhe më shumë. Në fillim të muajit shkurt 1915 Ministria e Punëve të Brendshme serbe në Nish kishte marrë një raport prej kryeshefit të rrethit të Prizrenit, i cili e informonte homologun e vetë - ministrin e Punëve të Jashtme:

“Në Has dhe Lumë pranë kufirit shqiptarët sërish po tubohen. Ekziston frika që kjo ushtri nuk do të jetë e mjaftueshme që këtë sulm të dytë ta zmbrops, pasi që ata do të jenë më të rrëmbyeshëm dhe në numër shumë më të madh se ai i mëparshmi. Ju lutem që të na dërgoni sa më shumë xhandarë nëse nuk ka ushtarë, dhe në rast sulmi a mundem për çdo eventualitet të kërkoj ndihmë nga ushtria malazeze”²³. Vërtet, pozitën e vështirë të popullit shqiptar në Kosovë u përpoqën ta ndihmonin edhe figurat e njohura shqiptare në krahinën e Lumës me rrethinë, ku në fillim të vitit 1915 ndodheshin Hasan Prishtina, Isa Boletini, Bajram Curri dhe shumë shqiptarë të larguar nga Kosova.

Kjo lëvizje kryengritëse shqiptare u përhap nga Malësia e Gjakovës, krahina e Hasit, Lumës, Dibrës e deri në Qafë Thanë, përgjatë brezit kufitar-kolonial, të imponuar nga Serbia, Mali i Zi dhe Fuqitë e Mëdha evropiane në krye me Rusinë. Mirëpo, luftimet më të rrepta u zhvilluan në krahinën e Lumës dhe rreth saj, në krye të së cilën qëndronin Hasan Prishtina, Isa Boletini, Bajram Curri e krerë të njohur të atyre anëve. Me atë rast u liruan shumë fshatra të rrethit të Gjakovës, Sharrit e të Prizrenit. Sulmet e kryengritësve ishin të furishme. Ushtria dhe xhandarmëria serbe u detyrua të tërhiqej në panik deri në Prizren, për çka u alarmua edhe Qeveria serbe e vendosur në Nish pas luftës austro-serbe në verë të vitit 1914.

²³ DASSIP-AO Beograd 1915, fasc. IV, dos. III, br. 242; Ky raport i është dërguar Ministrisë së Ushtrisë.

Kryengritësit i shkatërruan të gjitha linjat telefonike e telegrafike të ushtrisë pushtuese serbe²⁴. Përparimi i kryengritësve dhe fitoret e tyre zgjatën rreth një javë ditë, në dhjetëditëshin e dytë të muajit shkurt të vitit 1915, duke i shkaktuar dëme të konsiderueshme ushtrisë dhe xhandarmërisë serbe në njerëz dhe material luftarak. Ushtria pushtuese dhe administrata e saj iku në panik deri në Prizren, ku u ndoq nga kryengritësit shqiptarë në krye me Hasan Prishtinën e krerë të tjerë të njohur nga Kosova dhe krahinat prej nga filloi sulmi për thyerjen e kufirit.

Mirëpo, Serbia duke parë situatën e turbullt në vazhdimësi edhe të kryengritjes fshatare, e cila nga një kryengritje antividiste u shndërrua në një kryengritje të anti Esat Pashës, që ishte i lidhur me qeveritë e shteteve fqinje, e sidomos me Qeverinë serbe në krye me Pashiqin, mblodhi nga të gjitha anët ushtrinë dhe xhandarmërinë e vetë. Andaj, pas përlëshjeve dhe luftimeve të përgjakshme midis dy palëve, kryengritësit shqiptarë me përqendrim rreth Zhurit, Hasit dhe Malësisë së Gjakovës, u detyruan të tërhiqen dhe me atë përfundon kryengritja në mbarim të dhjetëditëshit të dytë të muajit shkurt të vitit 1915.

Ndërkaq, sulmuesit malazez më 27 qershor 1915 e pushtojnë Shkodrën. Trupat ushtarake malazeze kishin depërtuar dhe okupuar pjesën veriore të Drinit deri në derdhjen e tij në det dhe në Shëngjin²⁵. Isa Boletini me bashkëluftëtarët e vetë dhe burrat e Gashit e Krasniqes rezistuan për disa javë në Qafë të Morinës dhe Malësinë e Gjakovës e Shkodrës. Mirëpo, për shkak të mungesës së materialit e municionit luftarak u detyruan të tërhiqen përpara ushtrive të

²⁴ Liman Rushiti, *Rrethanat politiko - shoqërore në Kosovë 1912-1918*, Prishtinë 1986, f. 171; Xheladin Shala, *Pushtimi i Kosovës nga Serbia dhe Mali i Zi 1912 - 1915 - përgjysmimi i Shqipërisë*, Prishtinë 2012, f. 298 - 300.

²⁵ AS-MID-PO 1915, fasc. XII, dos. V, br. 12460.

rregullta serbo-malazeze nëpër Nikaj, Mertur e Shalë deri në Shkodër²⁶.

Duhet theksuar se në ato momente të vështira për popullin shqiptar dhe sidomos për udhëheqësit e tyre u munduan t'i dalin në krah njëri-tjetrit për ndihmë. Kështu, Bajram Curri dhe Hasan Prishtina që kishin qenë më parë në Shkodër, i thirrën bashkëluftëtarët e Kosovës dhe së bashku me Tafil Boletinin ishin nisur nëpër Pukë për në Malësi, për ta ndihmuar Isa Boletinin. Mirëpo, Isa Boletini kishte arritur nga anë tjera të rrugëve në Shkodër, ku ishte shtruar i sëmurë në hotel "Parruca". Thuhet se Hasan Prishtina e dërgoi Beqir Vokshin për ta bindur Isa Boletinin që të strehohej edhe ai në Malësi. Por, Isa Boletini u përgjigj se edhe po të ishte mirë me shëndet nuk mund t'i linte rrugëve bashkëluftëtarët, që tash e tri vjet nuk i qenë ndarë. Isa Boletini refuzoi që vetëm ai me katër-pesë veta ta shpëtojnë kokën. Mirëpo, kur e mori vesh këtë lajm Hasan Prishtina ishte habitur dhe trishtuar duke thënë: "Bobo! Ne nxafshin malazeztë, kanë me e ba copa-copa!"²⁷ Ishte një parashikim i saktë i ideologut të shquar.

Në një dokument të Ministrisë Ushtarake të Serbisë thuhet: "Gjatë 3 korrikut nuk ka ngjarë asgjë e rëndësishme në asnjë anë të frontit. Dje më 2 korrik është sjellë në Cetinë Isa Boletini me djemtë e vetë, i cili i është dorëzuar malazezëve"²⁸. Ndërsa, një historian

²⁶ Skënder Luarasi, *Isa Boletini*, Tiranë 1971, f. 214; Alush Lohja, një mercenar i Esat Pashës, për t'u përgatitur terrenin malazezëve, pati mbledhur mercenarët e rrethit të Shkodrës në emër të Esat Pashës, kishte zënë Tepen, Urën e Bashallëkut e rrugën e Jubanit dhe s'lejonte njeri të hynte në Shkodër e të dilte prej saj, f. 215.

²⁷ Skënder Luarasi, *Isa Boletini*, vep. e cit., f. 215; Fatkeqësisht edhe ashtu ndodhi tragjedia e Isa Boletinit me djemtë, nipat dhe bashkëluftëtarët e vet.

²⁸ AS-MID-PO 1915, fasc. XII, dos. V, br. 12499; Telegrami nr. 556 i dërgohet ministrit të Ushtrisë së Serbisë nga Cetina në ora 9:30, në Nish është pranuar telegrami në 10:12 më 21-VI, përkatësisht me kalendarin e ri Julian më 4 -VII- 1915.

malazez shkruan: “Malazezët hynë në Shkodër krejtësisht qetë. Bibë Doda, Isa Boletini dhe krerë të tjerë ranë në duar e tyre. Mirëpo, meqenëse Shkodra kishte qenë nën Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit, konsujt e huaj në Shkodër lajmëruan se nuk mund të pranohet okupimi”²⁹. Edhe konsulli italian në Cetinë e bëri me dije Qeverinë malazeze se, në Paris dhe Londër janë të pakënaqur me mënyrën siç është kryer okupimi i Shkodrës. Konsulli italian deklaroi se Fuqitë e Mëdha nuk do ta pranojnë atë akt, por nuk beson se do të bëhet ndonjë presion i madh ndaj Malit të Zi³⁰.

Pra, pushtimi i Shkodrës më 27 qershor e gjeti Isa Boletinin në Konsullatën franceze. Vëmendje të veçantë pushtuesit serbo-malazez i kushtuan shumë krerëve shqiptarë, veçanërisht Isa Boletinit. Gjeneral Veshoviqi, i njoftuar nga agjentët e tij në Shkodër për vendndodhjen e Isait, e vëzhgoi me kujdes Konsullatën franceze për të mos humbur gjurmët e tij. Në të vërtetë, kërkesa e Isait për ndihmë dhe strehim në Konsullatën franceze ishte një besim i tepruar i Isait ndaj kësaj përfaqësie konsullore, Qeveria e së cilës kishte qenë dhe ishte mbështetje e fortë e politikës serbo-malazeze në Shqipëri. Prandaj, nuk kaluan shumë ditë dhe nënkonsulli francez e tradhtoi Isa Boletinin, duke ia dorëzuar atë Malit të Zi. Pabesia u ka qëndruar kurdoherë e fshehur prapa shpinës së luftëtarëve të mëdhenj shqiptarë. Përfaqësuesi francez në Shkodër i propozoi Isa Boletinit të kalonte në Cetinë, prej nga konsulli i atjeshëm francez kinse mund ta përcillte më me lehtësi atë dhe bashkëluftëtarët e tij në një vend neutral. Isa Boletini e kuptoi pabesinë, por ishte vonë. Pas 7 ditësh, Qeveria malazeze vendosi ta dërgonte Isa Boletinin dhe të afërmit e

²⁹ Nikolla P. Shkeroviq, Crna Gora za vrijeme Prvog Svjetskog Rata, Titograd 1963, f. 61.

³⁰ AS-MID-PO 1915, fasc. XII, dos. V, br. 13286; Telegram i dërguar nga Cetina për Nish më 3-VII-1915.

tij në Nikshiq, kurse pjesën tjetër të shqiptarëve i dërgoi në Podgoricë. Në Nikshiq qëndruan deri në janar 1916, ku gjendja shëndetësore e Isa Boletinit u keqësua shumë, kështu që pjesën më të madhe të kohës e kaloi në shtrat³¹.

Megjithatë, kur është fjala për Shqipërinë dhe shqiptarët në përgjithësi, në luftërat e zhvilluara kanë ardhur në shprehje aspiratat e fuqishme të pushtimit dhe robërimit të qeverive të shteteve fqinje, si ndaj autonomisë dhe pavarësisë së Shqipërisë ashtu edhe ndaj popullit shqiptar në tërësi³². Prandaj, politika e Serbisë ndaj territoreve dhe popullsisë nën Austro-Hungarinë, vërtet ka qenë aneksioniste e jo çlirimtare, ashtu sikur ndaj maqedonasve dhe shqiptarëve që ishte robëruese³³. Kështu, në verë të vitit 1915 u bë okupimi i Shqipërisë. Në veri Mali i Zi, në mes Serbia dhe në jug Italia e Greqia³⁴. Pra, gjysmën e Shqipërisë së shkretë të njohur në Londër më 1913 e sulmuan katër shtete fqinje, që nëpërmjet Esat Pashës “donin t’i përdornin shqiptarët si mashë për të nxjerrë gështenjat nga zjarri”. Ndërkaq, në radhë të parë politika serbe gjithmonë është nisur jo për marrëdhënie të shëndosha si entitet në tërësi me popullin shqiptar. Faktet na bëjnë me dije se Serbia preferonte dhe aplikonte me disa krerë shqiptarë kontakte për interesa të veta megalomane.

Duhet theksuar se Princ Nikolla i Malit të Zi më 24 dhjetor 1915 e udhëzon përfaqësuesin e vetë në Durrës për të kërkuar nga Esat Pasha që t’ia dërgoi një nga krerët e tij të besueshëm, i cili do t’i sjellë “fjalë me shifra”. Esati menjëherë i përgjigjet dhe në Cetinë e dërgon Shahin Beun, gjë që Esati dhe Qeveria malazeze kishin besim

³¹ Fatmira Musaj, *Isa...*, f. 200-202.

³² Millovan Sekuliq, *Kosovo od 1912 do 1918 godine (doktoraturë në dorëshkrim)*, Prishtinë 1980, f. 202.

³³ Bogumil Hrabak - Dragosllav Janković, *Serbija 1918*, Beograd 1968, f. 8.

³⁴ Obzor, 13-VII-1915, Zagreb.

të plotë në Shahin Beun, i cili do të jetë në shërbim të tyre³⁵. Kështu, më herët në burgun e Shkodrës veçuan Çerçiz Topullin, Mustafa Qullin, Mehmet Shpendin e Shalës etj. Me pretekstin se do t'i çonin në Austri, natën e 17 korrikut 1915, të shoqëruar nga një tog ushtarësh, Çerçiz Topullin dhe Mustafa Qullin të lidhur me zinxhir i nisën për të mos i kthyer më kurrë. Afër Fushës së Shtojit, në një livadh të fshatit Golem, e pushkatuan heroin e Mashkullores, Çerçiz Topullin dhe kryeredaktorin e gazetës “Populli”, Mustafa Qullin. Thuhet se Çerçizi, në çastin e fundit para vdekjes i kishte thënë bashkëluftëtarit: “Kështu e kanë trimat, Muço!”³⁶.

Gjithashtu, pushtuesit serbo-malazez dhe esadistët më 24 shtator 1915 në pabesi e vrasin Dedë Gjo Lulin 75 vjeçar, njërin ndër trimat më të paepur. Atë e vrau kapiten Gjura me një kompani ushtarësh serb në bashkëpunim me bashibozukun (mercenarin) esadist, Sheh Hamdinë, në vendin e quajtur Sheshaz. Edhe shoqëruesit trima të Dedë Gjo Lulit, gjashtë mirditas, i therën me bajoneta (thika) dhe i hodhën në “Shpellën e akullit” në Mal të Shejtit. Kështu, mori fund jeta e atdhetarit ndër më të shquarit Dedë Gjo Lulit, i cili luftoi për pavarësinë e atdheut, duke mos e lëshuar nga dora pushkën për më tepër se gjysmë shekulli³⁷. Është i njohur mallkimi dhe amaneti për popullin shqiptar qysh para 100 viteve më 1915 nga Mehmet Shpendi i Shalës, i cili në prag të pushkatimit më

³⁵ AS-MID-PO 1915, fasc. VII, dos. XX, br. 12.

³⁶ Xheladin Shala, *Marrëdhëniet shqiptaro - serbe 1912-1918*, Prishtinë, 1989, f. 263; Ylber Skëndi, *Sali Nivica*, Tiranë, 1980, f. 50; Lefter Dilo, *Çerçiz Topulli me shokë*, Tiranë 1961, f. 52; Ajet Haxhiu, Hasan Prishtina dhe lëvizja patriotike e Kosovës, Tiranë 1968, f. 122; N. Ivanaj, *Historia e Shqipëniës së re - Vujejtjet e veprimet e mija*, Pjesa e parë, Tiranë 1943, f. 61; Piro Tako, Luigj Gurakuqi, Tiranë, 1980, f. 231.

³⁷ Pal Doçi, *Dedë Gjo Luli*, Tiranë, 1972, f. 175-176; Xheladin Shala, *Marrëdhëniet...*, f. 263-264; N. Ivanaj, *Historia...*, f. 62; Fazi Syla, *Poezia popullore shqiptare e kaçakëve*, Prishtinë, 1982, f. 69.

1915 deklaroi: “Tokë e qiell dorëzan ua paça lanë, besë shkjaut kurrë mos me i zanë!”³⁸. Kështu, në radhë të parë qëndrimi antishqiptar i pushtuesve serbo-malazez dhe aventura e tyre edhe gjatë viteve 1914-1915 është për t’u gjykuar rënd politika e ndjekur kundër popullit shqiptar. “Çështja e Shqipërisë së viteve 1914-1915, krahas çështjeve të tjera, tregon sheshazi qëllimin dhe politikën grabitqare të qeverisë së Pashiqit. Një politikë e tillë e qeverisë së Pashiqit u shpreh qartë ndaj popullit shqiptar, sidomos në “pacifikimin” famëkeq të shqiptarëve më 1913, si edhe gjatë luftës 1914-1915. Nën maskën e mbrojtjes nga grupet shqiptare, në të vërtetë udhëhoqi një politikë agresive”³⁹.

Dihet se Isa Boletini me bashkëluftëtarët e vetë më të ngushtë qëndroi në Nikshiq nga korriku i vitit 1915 deri në mesin e janarit 1916, kur qyteti u pushtua nga ushtria austro-hungareze. Nga Nikshiqi për disa ditë vendosen në Danillovgrad, gjithnjë të shoqëruar nga forcat malazeze. Më 20 janar 1916 arrin në Podgoricë dhe vendosen në shtëpinë e Lumoviqit⁴⁰. Gjatë atyre tri ditëve shpesh i dërgojnë në Ministrinë e Luftës te gjeneral Veshoviqi dhe dyshohet shumë, meqë pritej dorëzimi i Podgoricës në duar të ushtrisë austro-hungareze më 23 janar 1916.

Mirëpo, po atë ditë të 23 janarit rreth 80 xhandarë malazezë kishin zënë pusin në të dy anët e urës mbi lumin Ribnicë, përballë prefekturës, afër kishës katolike, për ta pritur Isa Boletinin që ia kishin caktuar kohën për t’u lajmëruar. Në atë moment arrin Isa Boletini te Ura e Ribnicës dhe i kërkojnë dorëzimin e armëve. Isa

³⁸ Pal Doçi, *Mehmet Shpendi*, Tiranë, 2004, f. 103; Xheladin Shala, *Hasan Prishtina*, Prishtinë 2014, f. 158.

³⁹ Dragosllav Jankoviq, *Srbija i jugosllovensko pitanje 1914 - 1915*, Beograd, 1973, f. 177.

⁴⁰ Tafil Boletini, *Pranë Isa Boletinit - Kujtime I* (1892-1916), Tetovë 1996, f. 194; Xheladin Shala, *Ngjarje dhe personalitete historike*, Prishtinë, 2009, f. 187.

Boletini kundërshton: “Jo, besa kurrë s’ja kam dorëzue as kralit as mbretit”. Aty zhvillohet një luftë e vërtetë dhe brenda një kohe bie heroikisht kryetrimi i Kosovës dhe Shqipërisë në përgjithësi si dhe shtatë të tjerë,: 1. Isa Boletini 52 vjeç, 2. Seid Boletini, djali, 18 vjeç, 3. Halil Boletini, djali, 24 vjeç, 4. Jonuz Boletini, nipi, 26 vjeç, 5. Halit Boletini, nipi, 24 vjeç, 6. Hajdar Radisheva, kunati i Isait dhe dhëndër, 30 vjeç, 7. Idris Radisheva, djali i vëllait të Hajdarit, 18 vjeç dhe 8. Misin Niman Bala nga Isniqu, kushëri, 26 vjeç. Të gjithë trimat në moshë të re vriten në vend gjatë rezistencës heroike. Nga ana e të pabesëve malazezë vriten 7-8 xhandarë dhe plagosen 12-13 të tjerë, megjithëse kishin zënë prita të përshtatshme⁴¹. Në procesin e likuidimit të udhëheqësve të dalluar të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, kanë bashkëpunuar ngushtë forcat reaksionare të sllavo-ortodoksëve me ato ndërkombëtare dhe mercenarët e Shqipërisë në krye me Esat Toptanin. Kështu, më 23 janar 1916, në Mal të Zi u vra Isa Boletini. Ajo ishte vepër kriminale e atyre forcave⁴².

Mendohet se organizatorët e komplotit për vrasjen e Isa Boletinit dhe bashkëluftëtarëve më të afër kanë qenë drejtpërdrejt ministri i Luftës, Veshoviqi, kunati i Princ Nikollës, komandanti i përgjithshëm Janko Vukotiq, ministri i Punëve të Brendshme, Pllamenac, prefekti i Podgoricës, Ramadanoviqi dhe prefekti i Nikshiqit, Llabud Gojniku. Zbatues i krimit Sava Llazareviciq-“Batarja”. Pastaj, mendohej se në procesin e këtij komploti është implikuar edhe Pashiqi, i cili e vizitoi Cetinën në vjeshtë-dimër të vitit 1915-1916, kur ushtria dhe qeveria e tij për disa muaj qëndroi në Shkodër e rrethinë pas ofensivës së austro-hungaro-bullgare në

⁴¹ Tafil Boletini, *Pranë...*, f. 202 - 203; Skënder Luarasi, *Isa...*, f. 223; Xheladin Shala, *Ngjarje...*, f. 187-188; Mehmet Rukiqi, *Azem Galica*, Prishtinë, 2013, f. 104.

⁴² Hajredin Hoxha, *“Politika e terrorit dhe e gjenocidit ndaj shqiptarëve”*, “Përparimi”, nr. 5, Prishtinë, 1971, f. 353-354.

vjeshtë të vitit 1915⁴³. Gjithashtu, kuptohet se të implikuar në vrasjen e Isa Boletinit me të drejtë dyshohet në konsullatat malazeze dhe franceze në Shkodër, legatat franceze, serbe dhe ruse në Cetinë⁴⁴.

Vrasja e Isë Boletinit më 23 janar 1916 ishte rezultat i intrigave, ndjekjeve dhe reprezaljeve nga qeveria e Pashiqit dhe Mbretit Nikollës, të cilët vepronin së bashku kundër popullit shqiptar, pra edhe kundër krerëve të njohur të tij, që përputheshin plotësisht ndërmjet veti, duke vrarë dallgë-dallgë, me qëllim luftimi sa më ashpër të çështjes shqiptare. Ata e shfrytëzuan edhe situatën e turbullt ndërkombëtare, ashtu siç thotë fjala e popullit “ujqit gjuajnë në mjegull”. Qeveritë serbo-malazeze ishin gjithnjë të interesuara t’i nxjerrin sa më shumë kokëçarje popullit shqiptar në përgjithësi. Na thotë mendja se në vrasjen e Isa Boletinit më tepër ka qenë e interesuar qeveria e Pashiqit, për arsye se ai ishte nga Mitrovica, një territor jashtëzakonisht i lakmuar për politikën serbomadhe. Serbia ka dëshiruar gjithmonë që ta njollosë dhe zhdukë simbolin më të fortë të Mitrovicës dhe të Sanxhakut e të Jeni Pazarit, Isa Boletinin - personalitetin madhështor të popullit shqiptar.

Edhe kënga popullore e kohës do ta theksojë në mënyrë të veçantë: “Karadaku me Serbinë - na e vranë Isa Boletinë”⁴⁵. Me këtë rast duhet theksuar se vrasjen e Isë Boletinit e ka dëshiruar edhe Carirus, i cili do të mundohet ta kamuflojë krimin “si përfundim të një zënke midis kaçakësh e xhandarësh”⁴⁶, marifet i zakonshtëm i politikës pansllaviste. Edhe historiani malazez N. Rakoqeviq do ta përshkruaj vrasjen e Isë Boletinit dhe më të afërmit e tij kinse si

⁴³ Tafil Boletini, *Pranë...*, f. 214 - 215; Skënder Luarasi, *Isa...*, f. 226 - 227; Xheladin Shala, *Ngjarje...*, f. 189-190.

⁴⁴ Tafil Boletini, *Pranë...*, f. 215; Fatmira Musaj, *Isa...*, f. 46; Xheladin Shala, *Ngjarje...*, f. 190.

⁴⁵ Skënder Luarasi, *Isa...*, f. 229.

⁴⁶ Skënder Luarasi, *Isa...*, f. 234.

refuzim i “çarmatosjes” i cili ka ardhur deri te përlëshja me xhandarët malazezë⁴⁷.

Në realitet, pushtuesit serbo-malazezë i ka penguar veprimtaria kombëtare e Isa Boletinit, e cila ka vlerë të jashtëzakonshme, meqenëse tokën shqiptare e skuqi me gjakun e vetë, të bijve, të nipave dhe të bashkëluftëtarëve më të afërt për Shqipërinë natyrale, duke mos i lëshuar kurrë armët nga dora deri në sekondat e fundit të jetës. Ai sa e sa herë kishte deklaruar, gjë që ishte moto e tij: “Niher jam le, niher du me dekë”⁴⁸. Andaj, me të drejtë do të konstatojë historiania e njohur prof. dr. Emine Arifi-Bakalli, se Isa Boletini ishte një trim, strateg, prijës, patriot, burrë, idhull dhe një ndër shtyllat kryesore të pavarësisë shqiptare⁴⁹. Kështu, atdhetarët e devotshëm shqiptarë që mbanin një peshë të rëndë kombëtare, gjithnjë kanë qenë në shënjestër për t’u likuiduar fizikisht, pasi që ne shqiptarët nuk kemi pasur asnjëherë një qendër shtetërore që do t’i merrte në mbrojtje në çdo kohë, sidomos në momentet e krizave dhe se armiqtë e popullit tonë përreth nuk kanë pasur kurrë frikë se do të pësojnë nga “hakmarrja” siç thuhet “dhëmbë për dhëmbë”. Andaj, është një varg shumë i gjatë i

⁴⁷ Novica Rakoqeviq, *Crna Gora u Prvom Svjetskom Ratu 1914 - 1918*, Cetinë 1969, f. 204: Pos tjerash thuhej: “Gjatë 23 janarit, në Podgoricë ka ardhur deri te incidenti, i cili në mesin e popullsisë ka shkaktuar rrëmujë. Kreu i shqiptarëve Isa Boletini, i cili gjatë luftës ishte i internuar në Nikshiq, së bashku me përcjellësit e vetë të armatosur ka lëvizur nëpër Podgoricë. Xhandarmëria malazeze ka tentuar që t’i çarmatosë dy nga përcjellësit e tij, por ata kanë kundërshtuar dhe ashtu ka ardhur deri te përlëshja, me ç’rast është vrarë Isa Boletini me djemtë e vetë dhe gjashtë përcjellësit e tij, kurse nga ana malazeze janë vrarë pesë vetë. Nëpër qytet është përhapur lajmi se shqiptarët do ta sulmojnë Podgoricën...” Autori thirret në raportin e Arkivit të Institutit të Historisë (që nuk është i saktë në numrin e vrasjeve), Titograd, fasc. 170, protokoll akt 33.

⁴⁸ *Këngë popullore të Rilindjes Kombëtare*, Prishtinë, 1978, f. 274.

⁴⁹ Emine Arifi - Bakalli, “*Shkrime disonante për Isë Boletinin*”, Isa Boletini dhe koha e tij, Prishtinë, 1998, f. 59.

ndjekjeve, burgosjeve, plagosjeve dhe vrasjeve të atdhetarëve e intelektualëve më të devotshëm të popullit tonë në dy shekujt e fundit.

Prof. dr. Xheladin SHALA

SUMMARY

ISA BOLETINI ACCORDING TO SERBIAN DOCUMENTS 1914-1915

Even after the occupation of Kosova in 1912-1913, Serbia was always attentive towards Isa Boletini, who resided in Albania as recognized in the Conference of London in 1913. Serbia considered Isa Boletini as a potential threat in the road of its consolidation of occupation in Kosova. This seems to have been the main reason why the Serbian politics continually followed is activity, and he was under continuous pressure. Therefore, one of the national personalities that was persecuted was Isa Boletini, who is considered the alpha and omega of the Albanian uprisings against foreign conquerors.

The storms that were brought forth by the Balkanic war and the First World War, caught up with Isa Boletini in Montenegro at the beginning of July 1915. A document extracted from the Archives of Serbia says: "On the 3rd of July 1915 Isa Boletini was brought to Cetinë with his sons, who obeyed to the Montenegrins'. Isa Boletini was not only an important participator in the events that took place in the last two to three decades of his life, but he also had a direct impact on their development both through fighting and in partaking in important historical councils.

The enemies of the Albanian nation tried very hard to deter Isa Boletini from his path in leading the war of Albanians. The deceiving, the flattery, the promises, pressure and threats did not have an impact on him. Isa Boletini became a challenge for the enemies with his role in the development of the National Albanian Movement.

Dr. Sylë UKSHINI
(Prishtinë)

ISA BOLETINI SIPAS GAZETËS VJENEZE
“FREMDENBLATT” (1916)

Isa Boletini në këndvështrimin e shtypit austro-hungarez

Isa Boletini ishte një figurë prominente në lëvizjen shqiptare antixhonturke dhe i cili e kaloi një periudhë të shkurtër duke i shërbyer me besnikëri dhe përkushtim udhëheqësit më të lartë të Perandorisë Osmane, sulltan Abdyl Hamitit, një fakt që historiografia shqiptare nuk e evidenton fare ose edhe kur e bënë, e kalon sipërfaqësisht. Ky shkrim nuk ka për qëllim të jetë një tematizim gjithëpërfshirës i jetës së Isa Boletinit, por një pikëvështrim analitik i shtypit austro-hungarez për këtë figurë historike shqiptare Isa Boletini, e cila u bë kyçe në luftërat kundër pushtetit të xhonturqve në Vilajetin e Kosovës dhe i Kryengritjes së madhe shqiptare të vitit 1912. Pikënisja e ngritjes së tij në skenën politike në fillim të shekullit XX, atëherë kur Perandoria Osmane, e cila po shkonte nga një humbje në tjetrën, u detyrua nga Fuqitë e Mëdha të pranonte

hapjen e Konsullatës ruse, më 1902¹, dhe austro-hungareze më 1903 në Mitrovicë. Pas kësaj ngjarje, Isa Boletini nisi karrierën e tij në Gardën Personale të Sulltanit në Stamboll, ndërkaq në historiografinë shqiptare thuhet se ishte i interesuar nga pushteti osman.

Figura e Isait lidhet me kontekstin e shtetit osman, fillimin e Shqipërisë evropiane dhe Luftën e Parë Botërore. Këtu synojmë të bëjmë një interpretim që shkon përtej qasjes dhe interpretimit tradicional etnokombëtar, por vetëm të pasqyrojmë portretizimin që asokohe i bëri shtypi i atëhershëm austro-hungarez. Nëse lexohet me kujdes edhe artikulli i gazetës “Fremdenblatt”², atëherë e kuptojmë se intencë permanente e Isa Boletinit në rend të parë ishte siguri i pushtetit të tij përmes gëzimit të përkrahjes së të gjitha etnive që jetonin në Vilajetin e Kosovës apo në rajonin e Mitrovicës, duke u shpërfaqur para autoriteteve të shtetit osman si figurë e rëndësishme për regionin dhe jo si udhëheqës shqiptar që kishte ndonjë vizion të qartë për bërjen e shtetit shqiptar, të paktën derisa nuk u shpërbë Perandoria Osmane. Sulltan Abdyl Hamitit, i cili duket se ishte më meritori për rritjen e influencën e Isait në Kosovë, dhe veçanërisht në rajonin e Mitrovicës dhe më gjerë. Po ashtu, nuk mund të absorbohet dhe as të riformulohet rëndësia e veprimeve të Isa Boletinit jashtë kontekstit në të cilën ai jetonte, e që ndryshonte vazhdimisht,

¹ Lidhur me hapjen e Ambasadës ruse në Mitrovicë dhe revoltën shqiptare, gazeta gjermane “Lokale Anzeiger”, më 3 prill 1903, në artikullin me titull “Puçi i shqiptarëve në Mitrovicë”, mes tjerash shkruante se: “situata në Kosovë është jashtëzakonisht e tensionuar, në radhë të parë për shkak të revoltës shqiptare. Sulmi në Mitrovicë dhe plagosja e konsullit rus Shçeribin dhe Kryengritja e Përgjithshme shqiptare kanë shkaktuar pakënaqësi të madhe të përfaqësuesit rus në Stamboll, i cili i fajësoi autoritet osmane se nuk kanë arritur të parandalojnë këtë kryengritje. Nëse edhe më tej organet osmane nuk i përmbushin detyrimet e tyre, atëherë paralajmëronte ndërhyrjen e drejtpërdrejt të Rusisë me anën e forcës. Shih: “Der albanesen Putsch”, Berliner Lokal Anzeiger, 3. 4. 1903.

² “Isa Boletini”, Fremdenblatt, 16. 1. 1916.

sidomos në cepin më të skajshëm të Perandorisë Osmane, por që përfshinte edhe një pjesë të shtetit të Serbisë, me të cilin asokohe normalisht bëheshin këmbime tregtare që nga ushqimi dhe deri te armët. Në fakt Isa Boletini u dallua për këtë shkak të aftësisë së tij për të shfrytëzuar faktin se jetonte buzë kufirit që ndante Kosovën otomane nga Serbia e sotme, e cila ishte në ekspansion permanent drejt viseve etnike shqiptare që nga vitet 1867-1877. Kjo rrethanë, dhe veçanërisht ndërhyrja e interesave të shtetit osman, austro-hungarez dhe rus në rajonin e Ballkanin, që kulmoi pastaj më 1902 dhe 1903 në formën e pranisë diplomatike përmes hapjes së konsullatave ruse dhe austro-hungareze m'u në qytetin e Mitrovicë, determinoi famën, fuqinë më pas edhe shtimin e pasurisë së Isa Boletinit.

Në përgjithësi transformimi i qëndrimit mosbesues i Isait ndaj depërtimit austro-hungarez, që përcaktohej nga lidhja e tij e fortë me sulltan Abdyl Hamitin dhe nga intrigat e politikës serbe, nga momenti i shpërthimit të luftërave ballkanike, tetor 1912, karakterizohet si shumë miqësore kundrejt Vjenës. Pikërisht, për këtë fakt edhe qarqet diplomatike llogarisnin vazhdimisht në Isanë në çështjen e Kosovës³, por kur erdhi momenti ndodhi fundi i tij i pritur. Në fakt, të gjitha këto momente historike janë gërshetuar mirë në portretizimin analitik që i bënë figurës së Isa Boletinit gazeta e njohur vjeneze “Fremdenblatt”, vetëm pak ditë pasi ai të vritej në mënyrë tragjike në Podgoricë, në një kurth të organizuar nga forcat malazeze, të cilat i pamundësuan Isait bashkimin me trupat ushtarake austro-hungareze, të cilat atëbotë po perceptoheshin si çlirimtare përballë mizorive dhe krimeve që po bënin trupat e xhandarmërisë serbo-malazeze. Dhe atëherë kur po afronte momenti i rikthimit pas

³ Më gjerësisht shih dosjen e Isa Boletinit, e cila ndodhet në Arkivin Shtetëror të Vjenës, HHStA PA XXXVIII, Karton 386.

shumë viteve i Isait në Kosovë dhe në Mitrovicë, e rrëmbeu vdekja, bile jashtë betejës luftarake, ose siç do të shkruante gazeta “Fremdenblatt”: “Mënyra e vdekjes së tij është e panjohur. Isa që kishte qëndruar mbi dyqind herë në beteja lufte, shpirtin e tij nuk e la në fushën e betejës”⁴.

Portreti i heroit

Gazeta vjeneze “Fremdenblatt”, në janar 1916, sjellë një artikull analitik të titulluar “Isa Boletini”⁵, të cilit i bëhet një portretizim i Isa Boletinit, këtij prijësi shqiptar me rastin e vrasjes së tij të papritur në Cetinë nga trupat ushtarake malazeze. Artikulli fillon me disa informacione të përgjithshme mbi vrasjen e Isa Boletinit në Cetinë, pikërisht në kohën ku ushtritë austro-hungareze po depërtonin në kryeqendrën e këtij shteti të vogël ballkanik, aty ku deri atëherë ndodhej si i internuar prijësi i njohur kosovar. Natyrisht, ky artikull shpërfaq interesimin që kishte shteti austro-hungarez dhe shtypi i atjeshëm për veprimtarinë dhe me fatin e Isa Boletini, si prijës i njohur shqiptar, me të cilin Vjena zyrtare, sipas dokumenteve të Arkivit Shtetëror të Vjenës, kishte llogaritur se do t’i duhej në rast të depërtimit në Kosovë.

“Para pak kohe nga Mali i Zi erdhi lajmi se Isa Boletini, një besnik i austro-hungarezëve në Shqipëri, pasi në pushtimin e Shkodrës ai kishte rënë në duart e malazezve, kishte vdekur në Cetinë. Me atë ka vdekur një nga prijësit dhe udhëheqësit shqiptar, një luftëtar trim dhe shembull i besnikërisë së patundshme. Një njohëse e mirë e sulltanit, M. J. Frein von Godin, solli së fundi disa

⁴“Isa Boletini”, *Fremdenblatt*, 16. 1. 1916.

⁵*Po aty*.

të dhëna karakteristike për udhëheqësin e sapo vdekur, për të cilin më poshtë do të shkruajmë”⁶, konstaton gazeta “Fremdenblatt”.

Në vazhdim artikulli nënvizon se Isa Boletini ishte i lindur në rrethin e Mitrovicës, dhe ishte “rritur në mesin e trazirave, të cilat u bënë ferr” edhe për pushtetin xhonturk në Vilajetin e Kosovës dhe përtej tij në 40 viteve e fundit. “Ishte njeri rrezikues, trim dhe me iniciativë, veçanërisht kishte një cilësi për të ndikuar dhe për të fituar në rrethin e tij. Nuk qëndronte anash, por involvohej në konflikte: kundër serbëve dhe për shqiptarët, myslimanët e fisit të tij”, konstaton më tej artikulli. Duhet shtuar se ky artikull nuk është thjeshtë një portret stilizues, por një portretim i heroit mbi bazën e dokumenteve dhe të dhënave të verifikuara, prandaj shumë të dhëna të këtij artikulli përputhen me ato të dokumenteve arkivore që ndodhen në dosjen e tij në Arkivin Shtetëror të Vjenës.

Pa dyshim, Isa Boletini ishte i njohur deri në Stamboll për aftësinë dhe influencën që kishte në rrethin e tij. Prezenca e tij me bashkëluftëtarë ishte frymëzuese dhe vendimtare në çdo ndërmarrje ushtarake. Në këtë kontekst, “Fremdenblatt” në artikullin e saj konstaton: “Ai dëshmoi diçka të pazakonshme, Isa kishte gjithashtu aftësi të rralla për të vënë rend edhe në Shqipëri në mesin e trupave ushtarake. Me shpirtin e tij ai i frymëzonte njerëzit e tij, në mënyrë që ata të ishin plotësisht unik, të bashkuar me të (...). Kur ai dhe vartësit e tij sulmonin një fshat serb për të kërkuar hakmarrje për një padrejtësi, për t’i ndihmuar një shoku, kurrë nuk bëhej fjalë për 3 000 shqiptarë që kishin pushtuar fshatin, por banorët tmerroheshin kur njerëzit bërtisnin, “Isa Boletin është këtu!”, 2 000 njerëz ishin në përcjellje të Isait dhe nipave dhe djemve të tij - konstaton “Fremdenblatt”.

⁶*Po aty.*

Raportet me Abdyl Hamitin II

“Pasi u rrëzua Abdyl Hamiti, Isa Boletini tregoi besnikërinë e tij tradicionale shqiptare ndaj tij dhe se ishte i gatshëm ta mbronte me çdo çmim. Abdyl Hamiti u rrëzua përmes elementëve të përparuara shqiptare, të cilët në Kosovën Jugore i kishin bërë gjërat e përbashkëta, me shpresën se me një qeveri kushtetuese do të fitonin autonomi dhe mundësi zhvillimi të vërtetë të shqiptarëve dhe Shqipërisë. Atëbotë Shqipëria nuk paraqiste ende asgjë, gjithçka ishte nën sulltanin dhe zotërimin e tij të plotmëshirshëm. Pastaj xhonturqit bënë gabim, ia morën pasurinë Isait, të cilën ia kishte dhënë Abdyl Hamiti”⁷ - thekson mes tjerash artikulli i gazetës së njohur vjeneze “Fremdenblatt”.

Duke u ndalur rreth raporteve në mes xhonturqve dhe Isa Boletinit, në artikull theksohet se në vend që ai të bëhej i parrezikshëm, ashtu siç pritej, me konfiskimin e pronave të Isait, ndodhi e kundërta, ai dhe vartësit e tij nisën rezistencën kundër regjimit xhonturk. “Kështu Isa Boletini së bashku me Bajram Currin dhe Riza bej Gjakovën, një feudal i madh nga rajoni i Dukagjinit, ku xhonturqit dëshironin të eliminonin të drejtat feudale, filluan një kryengritje në krejt veriun dhe verilindjen e Shqipërisë. Asokohe ai kishte marrë edhe para serbe”, shkruan gazetë e lartpërmendur. “Në ndërkohë, shkruan “Fremdenblatt”, inteligjencia shqiptare ishte thyer edhe me Turqit e Rinj, ata e kishin kuptuar se qeveria xhonturke, pavarësisht nga premtimet e saja të mëparshme, nuk ishte e prirur për përmbushjen e kërkesave kombëtare të shqiptarëve. Tani shtrohej pyetja se si të përfitoheshin Isa Boletini, Bajram Curri dhe Riza Bej Gjakova për idealet kombëtare, që përkrahësit e tyre të fitojnë një ndërgjegjësim për kryengritjen shqiptare”.

⁷*Po aty.*

Më tej gazeta sjellë një fakt interesant për periudhën e qëndrimit të Isa Boletinit në Mal të Zi, në kohën kur ai ishte në luftë me regjimin xhonturk. “Kur Isa Boletini qëndroi në Mal të Zi gjatë Kryengritjes së madhe më 1910, për të fituar mbështetjen e malazezëve, atë e vizitoi atje, në emër të Komitetit të Fshehtë Shqiptar, i urti dhe i mprehti Hasan bej Prishtina, i cili ishte i zgjuar dhe trim si Isai. Hasani ia doli që ta përfitonte atë për të mirën e çështjes kombëtare shqiptare. Pra, kështu erdhi te kryengritjet e Isait dhe të Bajram Currit, të cilat u zgjeruan gjithnjë e më shumë në vitet vijuese. Bejlerët e fuqishëm shqiptarë në Kostandinopojë, si dhe emigrantët shqiptarë nga pjesë të tjera të botës, e mbështetnin lëvizjen me sakrifica më të mëdha financiare”⁸.

Lufta Ballkanike

Në kohën kur po afrohej shpërthimi i Luftës Ballkanike, e cila ishte projektuar nga një koalicion ballkanik, prapa të cilit qëndronte Rusia, shqiptarët e kuptuan se duheshin organizuar nën armë për ta mbrojtur vendin e tyre. Mirëpo, Perandoria Osmane, e cila tani nuk ishte në gjendje të mbronte vetveten, i mashtroi shqiptarët dhe nuk përmbushi asnjërën nga kërkesat e tyre të formulara brenda “14 pikave të Hasan Prishtinës”. Prandaj, shpërthimi i Luftës së Parë Ballkanike i gjeti shqiptarët të papërgatitur në aspektin ushtarak, të paarmatosur. “Kur filloi lufta ballkanike, edhe Isa, nga Komiteti Qendror Shqiptar e kuptoi shpejt kërcënimin e një pushtimi të Shqipërisë nga serbët dhe malazezët, dhe ai telegrafoi Kostandinopojë për armë dhe municion, dhe do të ishte i gatshëm deri në ardhjen e trupave të rregullta, me 10 000 trupa të mbronte territorin kundër depërtimit të ushtrive serbe dhe malazeze. Për

⁸*Po aty.*

fatkeqësinë e saj qeveria nuk i besonte atij, dhe nuk i dërgoi armët e nevojshme. Dhe më pastaj, Isa së bashku me qindra bashkëluftëtarë të tij, pas një lufte të shkurtër u detyrua të largohej për në Shqipërinë Perëndimore”, shkruan gazeta “Fremdenblatt”.

Më tej, gazeta vazhdon: “Kjo ishte koha kur pas humbjes së turqve në Luftën Ballkanike, Ismail Qemal Vlora ngriti flamurin shqiptar dhe shpalli Pavarësinë e Shqipërisë në Vlorë. Në rrugën për në Vlorë Ismail Qemali u takua me Isa Boletini në Durrës. Isa u bashkua me të. Në Asamblenë Kombëtare ai mori një fjalë dhe deklaroi se do jetë bashkudhëheqës në luftën e pritshme për liri. Por, që nga ajo ditë në zemër ai ishte shumë i pakënaqur, për shkak se as ai dhe as vartësit e tij besnikë nuk ishin në gjendje për t’u përballur me dhembjen e një “Shqipërie pa Kosovën” dhe e ndjenin veten të syrgjynosur gjithmonë”.

Raportet me Wilhelm Wied-in

Në këtë shkrim të gazetës “Fremdenblatt” nuk mbetet pa u trajtuar edhe periudha e qëndrimit të Isait përkrah princi gjerman Wilhelm Wied (mars 1914), i cili kishte ardhur në Shqipëri me mandatin e Fuqive të Mëdha për të vënë themelet e shtetit shqiptar në një periudhë të paqëndrueshme përbrenda dhe të kërcënuar nga jashtë. “Kur princi Wilhelm Wied erdhi në Shqipëri dhe kundër tij shpërthyen trazira, Isa Boletini iu bashkua luftës kundër kryengritësve (proosman, shën. S.U.) as ditën e as natën nuk e lëshoi armën nga krahu i tij. Po ashtu, në llogore ruante dhe inkurajonte njerëzit e tij që të vazhdonin qëndresën kundër kryengritësve. Gjithmonë kishte shpresa, gjithmonë kishte besim tek ata, dhe kjo dihej. Kur atë e ruante nipi i tij Tafili, tek i cili kishte besim, atëherë ai i sigurt mund të shkonte për çlodhje”, konstaton “Fremdenblatt”.

Duke u ndalur rreth situatës së krijuar në Shqipëri pas shpërthimit të rebelimit të lëvizjes islamiste proturke në krye me Haxhi Qamilin, e cila ishte e nxituar nga rrethet xhonturke dhe shtetet ballkanike, të cilat dëshironin që situatën e paqëndrueshme në shtetin shqiptar ta shfrytëzonin për të realizuar pretendimet territoriale, të cilat nuk kishin arritur t’i maksimalizonin në Konferencën e Londrës. Gazeta “Fremdenblatt”, konstaton se princi Wilhelm Wied i thirri shërbëtorët e tij për t’u konsultuar me ta lidhur me gjendjen e vështirë. Në këtë situatë u ngrit Isa dhe tha: “Unë Sulltanit, Zotriut tim, i kam qëndruar besnik. Tani që unë e di se ai më kurrë nuk mund të kthehet, të kam dhënë ty fjalën time të nderit. Dhe unë nuk tërhiqem prapa, për sa kohë që t’i qëndron mes nesh, ne do të luftojmë për Ju dhe askush juve nuk ua dëshiron të keqen, askush nuk mund t’u afrohen juve, përveç mbi trupin tim dhe mbi farefisin tim të vdekur”, shkruan “Fremdenblatt” duke shtuar se “atëbotë asnjë zemër nuk mbet pa lëvizur nga fjalët Isës”.

Shpresa për çlirimin e Kosovës

Në vazhdim të artikullit, gazeta “Fremdenblatt” përshkruan disa nga tiparet dhe vetitë e veçanta të Isa Boletinit, duke veçuar aftësitë goditëse me armë dhe si për ironi të historinë për të treguar mospërmbyshjen e Isait për ta parë edhe një herë Kosovën dhe Mitrovicën e tij të çliruar prej serbëve. “Çfarë mund të thuhet më shumë për Isa Boletinin? Një buzë e tij nuk kaloi kurrë as një pikë e alkoolit? Se fjala e tij ishte e saktë, e fuqishme, dhe plotësisht e ngrohtë? Se ai ishte në gjendje për të goditur vezën me një armë në njëqind metra dhe armiqtë edhe më mirë i godiste me të shtënë e parë në 1 000 metra larg? Se ai mund të ulej në gjysmën e natës në tavolinë pa ngrënë pothuajse asgjë, pa fol pothuajse asgjë, dhe se

asnjë sekondë nuk mund harrohej nga miqtë e ftuar se Isa ishte i pranishëm? Se ai nuk e dinte se çfarë është një gënjeshtër dhe se ishte i matur, si asnjë tjetër? - shkruan “Fremdenblatt”. Duke u ndalur në rrethanat e krijuara pas shpërthimit të Luftës së Parë Botërore, gazeta thekson, se: “Nga ky moment Isa Boletini ishte ndryshe. Ai e kishte kuptuar se tani ose kurrë Mitrovica dhe tërë Kosova do të çlirohen nga serbët. Dhe tani ai qëndronte ulur me duart e tij të lidhura në Durrës, dhe nuk mund të thyente fjalën e dhënë princit, prandaj u desh të qëndronte aty. Atë kjo situatë e brente dhe e thyente plotësisht. Lutja e tij e vazhdueshme ishte: “Sikur Austria t’i mundte serbët, vetëm sikur ju të hyni në Mitrovicë, dhe sikur unë atëherë do të mund të ndihmojë Juve”!

“Kur Princi Wilhelm u largua nga Shqipëria, urdhëroi nga Italia që t’i sjellë sa më parë një anije në Shqipërinë e Veriut, në Shkodër, pranë grykëderdhjes së gjerë të Bujanës, për Isa Boletinin, Bajram Currin dhe njerëzit e tyre besnikë, sepse ata nuk bënë të bien në duart e kryengritësve, sepse ky do kishte me qenë një krim”. Por, gazeta konstaton se “Isa Boletini nga Shkodra shkoj në malet e Gjakovës, ku mbledhi disa qindra njerëz dhe sulmoi serbët, por u tradhtua nga një dezertor. Pasi forcat e tij të vogla u shkatërruan pothuajse në tërësi, ai u kthye në Shkodër dhe ra në duart e malazezve dhe më pas u vra”. “Por, mënyra e vdekjes së tij është e panjohur. Isa që kishte qëndruar mbi dyqind herë në beteja lufte, shpirtin e tij nuk e la në fushën e betejës”, duke shtuar plotë patetizëm, “tani Mitrovica është e jona, Fushë Kosova është e lirë, por Isa Boletini nuk e sheh më lirinë e Kosovës së tij të dashur”, përfundon artikulli i gazetës vjeneze “Fremdenblatt” për të bëmat e heroit kombëtar Isa Boletini.

⁹*Po aty.*

Dr. Sylë UKSHINI

SUMMARY

ISA BOLETINI ACCORDING TO THE VIENNESE NEWSPAPER 'FREMDENBLATT' (1916)

The paper treats the official stance of the Austro-Hungarian foreign policy, which portrays the figure and role of Isa Boletini with a high precision and an abundance of information that match the archival acts at the State Archives of Austria (HHStA Ministerium des Ausser Politisches Archiv). This shows that the author of the acts had acquired knowledge regarding Isa Boletini and his movement even after the Second World War. It needs to be stated once again that the imperial government in Vienna, considering the shift of opinion of Isa Boletini in regards to the Austro-Hungarian politics and his role during the reign of Wilhelm Wied, relied on Isa Boletini to achieve its plans throughout its expansion in the direction of Kosova, which would serve as a fortress against the Serbian installment. From the articles it becomes evident that Vienna was aware that Isa Boletini considered the former as a gateway to achieve its goals for the liberation of Kosova. However, Isa was murdered away from his home country, without having a chance to return once again in his tower in Boletin, with which occurrence Austro-Hungary lost a great ally.

Prof. dr. Isa BICAJ
(Prishtinë)

ISA BOLETINI NË DOKUMENTET DHE SHTYPIN MALAZEZ

Shteti malazez ka përcjellë me vëmendje dhe interesim zhvillimin e ngjarjeve dhe luftës çlirimtare të popullit shqiptar kundër Portës së Lartë. Në kuadër të kësaj lëvizje është i interesuar edhe për veprimtarinë dhe angazhimin e udhëheqësve të këtyre ngjarjeve. Në veçanti interesimi i saj ka qenë më i madh në ato territore që kishte për synim t'i pushtonte siç ishte Shqipëria Veriore, Plava e Gucia dhe Rrafshi i Dukagjinit. Mbretëria malazeze ishte e mirinformuar për veprimtarinë e Lëvizjes Kombëtare në këto vise për të cilat synonte t'i pushtonte. Informacionet i merrte nëpërmjet konsullatave të shumta që ishin në pjesët e ndryshme të Perandorisë Osmane siç ishte ajo e Shkodrës, Prizrenit, Shkupit etj. Po ashtu, informacione merrte nga kleri ortodoks serb, mësuesve në shkollat serbe dhe tregtarëve të ndryshme që lëviznin në këto treva.

Duke u informuar për ngjarjet shteti malazez dinte edhe për veprimtarinë dhe udhëheqësit e rëndësishëm të Lëvizjes Kombëtare. Në një informacion të dhënë nga zona kufitare në Andriovic, Ministrisë së Punëve të Jashtme malazeze thuhej:

“Në Plavë dhe Guci gjendja nuk është e mirë. Derisa familja e Rexhepagiqëve është indiferente ndaj zhvillimit të ngjarjeve në këto anë, familja e Ferrajve janë vu në krye të Lëvizjes Kombëtare dhe shprehin armiqësi të hapur ndaj nesh. Madje Hasan Ferri mban lidhje e bashkëpunon më parinë e Kosovës siç është Haxhi Zeka dhe Isa Boletini. Me këtë të fundit ka krijuar edhe krushqi dhe kontaktet e tyre janë shpeshtuar dhe sigurisht ata veprojnë bashkërisht kundër interesave të atdheut tonë”¹.

Fuqizimi i Lëvizjes Kombëtare në viset shqiptare krijonte shqetësime në qarqet sunduese malazeze. Gazeta malazeze “Glas Cernagorça” që ishte zëdhënëse e politikës zyrtare e shtetit malazez në shkrimet e saja është përpjekur që veprimet e udhëheqësve shqiptarë t’i cilësoi si “spontane”, “të paorganizuara” dhe “pa vlera kombëtare”. Edhe për Isa Boletinin Qeveria malazeze nuk kishte mendim të mirë. Në vazhdimësi veprimtarin e tij kombëtare e ka cilësuar si veprime të një “krimineli” dhe që dinte të bënte zullume mbi popullsinë serbe. Angazhimin e Isa Boletinit për pengimin e vendosjes së konsullit rus, Shqerbinit në Mitrovicë, dhe veprimet e tjera kombëtare kishin ngjallë pezëm te krerët e Cetinës. Lidhur me veprimet e shqiptarëve të udhëhequr nga Isa Boletini, gazeta “Glas Cernagorça” shkruante: “Arnautët e çmendur po tubohen në Mitrovicë. Në krye të tyre është Isa Boletini i cili ka fituar famë me vrasjen e disa oficerëve turq dhe me shpërnguljen e dhunshme të shumë familjeve serbe nga vatrat e tyre. Sot ai konsiderohet si zotërues i tërë nahijes së Mitrovicës”². Kjo fushatë e shtypin malazez kundër Isa Boletinit dhe udhëheqësve të tjerë të Lëvizjes Kombëtare nuk ishte e rastësishme. Vlerësimet e tyre për udhëheqësit kombëtarë

¹Drzvni, Arhiv Crnogore, (me tej: DAC), fondi i Ministrisë së Punëve të Jashtme, nr. 13. dok. 34.

²“Glas Crnogorça”, nr. 12, 1903.

si veprime “kriminelësh” e “banditësh” kishin si qëllim të indoktrinonin popullin malazez dhe të përgatitnin opinionin e tyre për pushtimet e reja të tokave shqiptare.

Përhapja e lajmit për mundësinë e ndërtimit të hekurudhës Uvac-Mitrovicë krijoi shqetësime te popullata e Mitrovicës për shkak të marrjeve të tokave për trasenë e hekurudhave. Në një shkresë të komandës ushtarake kufitare dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme thuhej: “Në nahijen e Mitrovicës është situatë tejet e turbullt. Popullata është ngritur dhe kundërshton ndërtimin e hekurudhës. Në krye të tyre është Isa Boletini. Kjo popullatë e as vetë udhëheqësi i këtyre turbullimeve Isa Boletini nuk dinë se ç’është civilizimi dhe rëndësinë që ka ndërtimi i kësaj hekurudhe. Gjatë turbullirave të nxitura dhe të udhëhequra nga Isa Boletini janë sulmuar dhe djegë disa shtëpi të popullatës serbe. Qëllimi i këtyre veprimeve është të frikësojnë popullsinë serbe dhe të nxisin shpërnguljen e tyre nga vatrat e tyre shekullore”³.

Më insistimin e Rusisë Isa Boletini u internua në Stamboll. Përfaqësuesi i Malit të Zi në Stamboll përcillej me vëmendje dhe interesim që mbante Porta e Lartë ndaj Isa Boletinit. Në një raport të përfaqësuesit malazez në Stamboll, Nitar Bakiqit thuhej: “Krimineli i njohur, udhëheqësi i shqiptarëve të Kosovës tani gjendet në Stamboll, ai ishte në krye të atyre 3 000 shqiptarëve që sulmuan Mitrovicën me rastin e vrasjes së të ndjerit Shqerbin. Rusia ka kërkuar që Isanë ta internojnë në Azi të Vogël. Rusia ka qenë e informuar se ai është internuar në BIT LIS, mirëpo e vërteta është se ai asnjëherë nuk është larguar nga Stambolli dhe ka jetuar i lirë. Nga informacionet që kemi shkruhet në raport se Isa jeton mirë, ndërsa

³DACG., fondi, M. P. J. nr. i fascicles 17, dok. nr. 671.

ndikim më të madh në qarqet shqiptare të Stambollit ka Sylejman Pasha”⁴.

Kryengritjet shqiptare të viteve 1909-1912 shtypi malazez, si gazetat “Glas Cernagorca” dhe “Cetinski Vjesnik” i vlerësojnë si ngjarje spontane të paorganizuara e pa qëllime të qarta politike... Sipas këtyre shkrimeve në këto gazeta, disa njerëz që janë mësuar të sillen lirshëm e papërgjegjësi. Këta individë nuk japi llogari para askujt për këto veprime... në krye të këtyre veprimeve është Isa Boletini dhe njerëzit e tij. Masat e gjeneral Xhavit Pashës ndaj këtyre veprimeve banditeske janë në përputhshmëri të plotë me ligjet osmane, sepse ky popull vetëm në këtë mënyrë mund të qetësohej”⁵. Shuarja e Kryengritjes së vitit 1910 dhe masat e egra që mori ushtria osmane detyroi shumë udhëheqës të Lëvizjes Kombëtare të largohen jashtë vendit dhe të kërkojnë strehim në vendet fqinje. Gazeta malazeze “Glas Cernogorca” njoftonte se në qershor kufirin osman e kishte kaluar edhe Isa Boletini i shoqëruar nga 13 veta, ndër të cilët ishin edhe djemtë e tij⁶.

Sipas një raporti të udhëheqësit krahinor të Nikshiqit, Jovan Pllamencit, Boletini kishte udhëtuar në Podgoricë e me pas ishte vendosur për banim në Nikshiq⁷. Gjatë kësaj periudhe në Mal të Zi janë strehuar edhe Sylejman Batusha, Zeqir Halili, Bajram Daklani, Zefi i Vogël, Hasan Ferri e më vonë De Gjo Luli. Strehimi i këtyre personaliteteve në Mal të Zi duhej shikuar si nevojë dhe domosdoshmëri e momentit për t’i shpëtuar përkohësisht represionit osman, e kurrësi si gjunjëzim e bashkëveprim me pushtetin malazez në dëm të interesave kombëtare. Edhe pas shpalljes së Pavarësisë së

⁴ Arkivi i Institutit të Historisë, Tiranë, fondi Cetinë, nr. i dok. 572, raporti i përfaqësuesit malazez nga Stambolli dërguar M. P. J., 15 mars, 1903.

⁵ “Cetinski Vjesnik”, Cetinë, nr. 23, 1903.

⁶ “Glas Cernogorca”, Cetinë, nr. 12, 1910.

⁷ DACG, fondi i M. P. B, facikla 140, nr. dok. 2760.

Shqipërisë monarkia malazeze është e interesuar për veprimtarinë e Isa Boletinit, në një raport të gjeneral Radomor Veshoviqit dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme thuhej: “jemi të informuar se Isa Boletini ka udhëtuar për Prizren e më pas për Kukës e Dibër, e më vonë ka arritur në Vlorë, ku i ka shprehë besnikëri Ismail bej Vlorës.

Ne po përcjellim me vëmendje gjithë veprimtarinë e popullatës së Deçanit e në veçanti të pjesëtarëve të tij⁸. Urrejtja e krerëve të Cetinës ndaj Isa Boletinit ishte e madhe. Këtë e vërteton fakti se dy orë pasi që ushtria austro-hungareze të futej në Podgoricë nën komandën e Sava Llazaroviqit organizohet komploti dhe Isa Boletini me dy djemtë dhe dy nipat, truprojnë dhe Bislim Radisheven vrahët në urën e Ribnicës. Si dukët për Malin e Zi më e rëndësishme ishte likuidimi i Isa Boletinit se sa pushtimi i Podgoricës nga forcat austro-hungareze.

⁸DACG, fondi i M. P. B. facikla 210, nr. 74.

Prof. dr. Isa BICAJ

SUMMARY

ISA BOLETINI ACCORDING TO MONTENEGRIN PRESS AND DOCUMENTS

The Montenegrin monarchy has closely followed the developments in the Albanian region. It was also quite well informed on the activity of the leaders of the National Albanian Movement. It acquired information regarding the activity of the leaders through the Montenegrin consulate in Shkodër, as well as from its representative in Istanbul. It also acquired information from the teachers who taught in Serbian schools, which were opened in Albanian lands at the time by the Orthodox clergy as well as through the contribution of Serbian tradesmen. The Montenegrin monarchy was well informed on the activity of Isa Boletini.

In the Montenegrin documents we encounter reports on the obstacles he created together with other Albanians in regards to the railway that was being constructed by Austro-Hungary from Uvac in Bosnia all the way to Mitrovicë. We also have information regarding the case of the Russian consul Sçerbin, in which occasion accusations were being made against Isa Boletini. In all these writings Isa Boletini was considered a criminal, bloodsucker, who through his entire activity aimed to ultimately scare off the Slavic population in Albanian territories.

The Montenegrin documents also talk about the intern activity of Isa Boletini from the Ottoman Empire and the privileges he enjoyed during his deportation. After the defeat of 1910, Isa Boletini sought refuge in Montenegro in attempts to escape from the Ottoman Empire.

Doc. dr. Sevdail DEMIRI
(Shkup)

**PASQYRIMI I FIGURËS SË ISA BOLETINIT, SIPAS
BURIMEVE DOKUMENTARE DHE SHTYPIT BULLGAR
MË 1912**

Në periudhën e fundit të Rilindjes, një nga synimet kryesore të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare (LKSH), ishte përmbyllja e procesit të pavarësisë kombëtare nga sundimi disashekullor osman. Në këtë drejtim, një ndër kërkesat kryesore ishte bashkimi i katër vilajeteve me shumicë shqiptare, gjë që binte ndesh me synimet e politikës zyrtare bullgare. Kësaj të fundit i konvenonte që pakënaqësia e shqiptarëve të merrte përmasa më të mëdha, andaj në disa momente edhe e stimulonte atë, gjë që shihet edhe në disa burime dokumentare dhe organe të shtypit bullgar të asaj periudhe.

Për më tepër, nëpërmjet këtyre burimeve, kuptojmë se derisa zhvilloheshin kryengritje në veri të viseve shqiptare, të cilat ishin jashtë territoreve që pretendonte politika bullgare, kjo e fundit i shikonte me simpati lëvizjet kryengritëse shqiptare. Por, në momentet kur cenoheshin pretendimet bullgare, lëvizja kryengritëse shqiptare vlerësohej si armiqësore dhe etiketohej në mënyrën më të vrazhdë dhe të ashpër. Kjo politikë shtetërore e Bullgarisë gjatë

viteve 1908-1912, nuk ishte stabile, dhe ajo në disa momente reflektohej edhe si konfuze, sidomos në periudhën kur filluan bisedimet për të krijuar Aleancën Ballkanike, kur interesat e saja binin ndesh me synimet e Serbisë dhe Greqisë për Ballkanin¹.

Për trimin me nam të Kosovës, i cili deri në frymën e tij të fundit, nuk e dorëzoi koburen nga brezi, janë interesuar mjaft gazeta të kohës, që botoheshin në gjuhë të ndryshme anekënd Ballkanit, Evropës e më gjerë. Ato trajtojnë segmente të shumta të veprimtarisë së Isa Boletinit, e veçanërisht në periudhën e Kryengritjes së Përgjithshme shqiptare të vitit 1912, rrugëtimit të tij nëpër disa qendra evropiane dhe në Londër, ku shkoi për të protestuar kundër vendimeve të padrejta të Konferencës së Ambasadorëve. Kësaj radhe, në fokusin e interesimit tonë, është pasqyrimi i figurës së Isa Boletinit në disa burime dokumentare, e sidomos nëpër organet e shtypit bullgar gjatë vitit 1912.

Në të vërtetë, shtypi bullgar i ndiqte me interes të madh të gjitha zhvillimet e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, sidomos në periudhën e fundit të saj, në prag të shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë. Politika zyrtare bullgare ishte e interesuar që të përcjellë ngjarjet dhe përfundimet e Kryengritjes së Përgjithshme të vitit 1912, në mënyrë që në momente të caktuara, të shfrytëzojë situatat për të jetësuar projektet e dala nga Traktati i Shën Stefanit. Pasqyrim më i ngjeshur i ngjarjeve që lidheshin me fatin e Shqipërisë dhe shqiptarëve në këtë periudhë, haset në gazetatat në gjuhën bullgare: “Makedonia”, “Pravo”, “Vesti”, “Vardar”, “Preporec”, “Bullgaria”, “Ballkanska zora”, etj. Madje, shpeshherë në këto gazeta, LKSH-ja dhe zhvillimet e saj, hasen në ballinat apo faqet e para të tyre, e që flet për vëmendjen e madhe që kishte Bullgaria dhe bullgarët për

¹ Skender Asani & Sevdail Demiri, *Vilajeti i Manastirit dhe LKSH në vitet 1911-1912 (dokumente bullgare)*, Fondacioni Dauti, Shkup, 2015, f. 7.

Shqipërinë dhe shqiptarët. Në to flitet për zhvillimet e Kryengritjes së Përgjithshme shqiptare, gjendjen e popullsisë bullgare në territoret shqiptare, veprimet e diplomacisë së huaj, etj. Kurse, me interes të veçantë janë kronikat ku paraqiten raportet në mes të udhëheqësve kryesorë të LKSH-së, përkatësisht në mes të Isa Boletinit, Bajram Currit, Hasan Prishtinës, Idriz Seferit etj.

Figura markante e lëvizjes kryengritëse shqiptare, Isa Boletini, veçohet në shtypin bullgar si një tribun popullor, i cili vlerësohet si udhëheqës i shquar ushtarak, dhe si një figurë unifikuese në momentet kyçe të kryengritjes. Pra, gjatë vitit 1912, emri i Isa Boletinit ishte i pranishëm nëpër shumë raporte diplomatike dhe nëpër shumë faqe të gazetave bullgare, përmes të cilave pasqyrohet figura dhe aktiviteti i tij ushtarak dhe politik, sikurse edhe raportet mes udhëheqësve të kryengritjes. Kështu, p. sh. në raportin konfidencial të ministrit Mbretëror bullgar të autorizuar në Romë, drejtuar ministrit të Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Fesë, më datë 10 janar 1912, Isa Boletini cilësohet si “Kryengritësi i shquar shqiptar”², i cili së bashku me kryengritësit në Lumë, Gjakovë, dhe Malësinë e Shkodrës, më në fund kanë shkuar në Shalë, që të takohen dhe të merren vesh me udhëheqësin e atjeshëm të Dukagjinit. Më tej, nga një raport i ministrit Mbretëror të autorizuar në Beograd, drejtuar ministrit të Punëve të Jashtme dhe të Fesë së Bullgarisë, më datë 25 prill 1912, theksohet forca e madhe ushtarake e kryengritësve shqiptarë. Sipas raportit, Isa Boletini nga Mitrovica, ishte një nga udhëheqësit më të sigurt ushtarak, i cili dispononte një forcë të madhe kryengritësish me rreth 5 000 pushkë³. Kryengritjen e Përgjithshme të vitit 1912, pjesa më e madhe e shtypit bullgar e kishte cilësuar si lëvizje shumë serioze, me një karakter të

²Po aty, f. 51.

³Po aty, f. 82.

fortë revolucionar dhe gjithëpopullor, edhe për faktin se në krye të saj ishin ish-deputetët e Parlamentit osman, dhe krerë të tjerë të njohur, si: Hasan Prishtina, Isa Boletini, Ismail Qemali, Bajram Curri, Idriz Seferi, Mehmet Pashë Dërralla, Dervish Hima, Nexhip Draga, etj⁴. Këta ishin personalitete të njohura dhe me ndikim të madh në masën e gjerë popullore shqiptare, andaj thirrjes së tyre për luftë të armatosur kundër sundimit shumëshekullor osman, pa hezitim do t'i bashkëngjitej i gjithë populli shqiptar i këtyre trevave që i përfaqësonin.

Gazeta bullgare që asokohe botohej në Selanik, “Pravo”, në fillim të muajit qershor të vitit 1912, shkruante se “Isa Boletini shpalli kushtrimin se do të ngritet kundër pushtetit osman, dhe se Lëvizja Kombëtare Shqiptare do një vëmendje të posaçme”⁵. Po në këtë gazetë të datës 15 qershor 1912, njoftohej opinioni bullgar dhe ai më i gjerë, se “Isa Boletini bën mobilizimin e përgjithshëm të popullit në luftë kundër pushtetit osman”. Kurse, në informatën e 23 qershorit për kryengritjen shqiptare, theksohej se “Shqiptarët i kanë larguar gratë dhe fëmijët nga fshatrat e largëta, ndërsa familja e Isa Boletinit nuk është larguar. Ushtria përfundimisht i ka sulmuar kryengritësit. Internimi i tyre është i pashmangshëm”. Përmes këtyre raporteve, njoftohej për karakterin e fortë të Isa Boletinit, i cili po e rezikonte edhe familjen e tij për idealet e larta kombëtare.

Gazeta tjetër bullgare me emrin “Bulgaria”, më 2 korrik 1912 shkruante se “Në Shqipërinë Veriore, udhëheqës i pakontestueshëm është Isa Boletini, dhe sot pushteti turk (osman, v.

⁴ Рамиз Абдули, *Бугарскиот печат за албанското востание од 1912 година*, ГЛАСНИК, Институт за национална историја, Скопје, 42, 2, 1988, f. 88.

⁵ Движението в Албания, “*Право*”, Солун, 7.6.1912; Gazetat bullgare atëherë e llogaritnin kohën në bazë të kalendarit Julian, i cili dallon për 13 ditë nga kalendar i ri Gregorian, të cilin e përdorim edhe sot.

j.) nuk mund t'i bënë për vete, jo vetëm se elementin paqësor, por edhe oficerët dhe ushtarët të cilët janë thirrur në konsultime.

Të gjithë komandantët, në mesin e të cilëve edhe Feti Pasha, e simpatizojnë Lëvizjen Kombëtare Shqiptare”⁶. Kurse, sërish gazeta “Pravo”, më datën 5 korrik 1912, duke informuar për rrjedhën e kryengritjes shqiptare, shkruan se “Kryengritësit nën udhëheqjen e Isa Boletinit, çarmatosën shumë ushtarë osmanë, ndërsa shumë të tjerë iu bashkëngjitën për shkak të autoritetit të madh të tij”⁷. Më datën 19 korrik 1912 gazeta tjetër bullgare me emrin “Preporec”, njoftonte se “Isa Boletini në krye të 5 mijë kryengritësve është nisur nga Mitrovica drejt Prishtinës, ku ishin mbledhur udhëheqësit kryesorë shqiptarë dhe shumë ushtarë të dezertuar, të cilët iu kishin bashkëngjitur aradhave të Isa Boletinit, dhe me urdhër të tij ishte parandaluar që të gjuhet nëpër qytet. Pjesa më e madhe e armatimit të garnizoneve osmane tash ishin në dispozicion të Isa Boletinit”⁸.

Edhe gazeta tjetër “Vardar” e datës 25 korrik, informonte se: “Në Pazarin e Ri të Sanxhakut, i gjithë pushteti ishte në duart e Isa Boletinit”⁹, gjë që fliste për forcën e madhe ushtarake dhe organizative të këtij trimi. Kurse, duke informuar rreth përgatitjes për hyrjen e mijëra kryengritësve shqiptarë në kryeqendrën e Vilajetit të Kosovës-Shkup, gazeta “Pravo”, e 11 gushtit, shkruan se: “Sipas dëshmimeve të gazetës “Independent” nga Shkupi, me kërkesë të Riza Beut, Bajram Currit dhe Isa Boletinit, ishte urdhëruar që kompania hekurudhore t'i vë në dispozicion 6 trena në shërbim të kryengritësve shqiptarë”¹⁰. Këto trena pastaj do të bënin bartjen e mijëra

⁶ Въстанието в Албания, “България”, София, 2.7.1912.

⁷ Движението в Албания, “Право”, Солун, 5. 7. 1912.

⁸ Хроника, “Пряпорец”, София, 19. 7. 1912.

⁹ Една характеристика на положението в Албания, “Вардаръ”, София, 25. 7. 1912.

¹⁰ Разотиването на Албанците, “Право”, Солун, 11. 8. 1912.

kryengritësve shqiptarë nga shumë anë të Kosovës, nga Ferizaj deri në Shkup, kur hynë triumfalisht në kryeqendrën e Vilajetit të Kosovës. Gazeta “Makedonija”, e 12 gushtit, duke u thirrur në burimet e gazetës tjetër bullgare “Novoe vreme”, shkruan se në kampin kryengritës shqiptarë, kishte dallime në qëndrimet e tyre: “Diçka kërkonte Isa Boletini, e diçka tjetër Ismail Qemali, dhe krejtësisht diçka tjetër Hasan Prishtina, por kur bëhej fjalë për kërkesat esenciale, të gjithë pajtoheshin, si: për të emëruar një guvernator gjeneral, që shqiptarët shërbimin ushtarak ta bënin në Shqipëri, që në shkolla të mësohet gjuha shqipe, që të dëmshpërblehen të gjithë për shtëpitë e rrënuara nga ushtria osmane, që tatimet të mbesin në Shqipëri, dhe për të drejtën e mbajtjes së armëve”¹¹.

Këtu shihet largpamësia e shumicës së udhëheqësve kryesorë të kryengritjes, të cilët edhe pse kishin divergjenca mendimesh në shumë plane rreth organizimit të luftës, por kur ishin në pyetje kërkesat kryesore, kishin mirëkuptim mes vete. Po kjo gazetë, më 26 gusht informonte opinionin se “Isa Boletini ka hyrë me mijëra kryengritës në qytetin e Mitrovicës”. Edhe në një intervistë të zhvilluar në Prishtinë pas dështimit të bisedimeve shqiptaro-osmane nga gazetari i gazetës bullgare “Vardar”, me prijësin e kryengritjes Hasan Prishtina, kuptojmë se në mesin e udhëheqësve të kryengritjes nuk ka përçarje, dhe se shqiptarët në këtë fazë kanë konsensus nacional për të bashkuar katër kalemata (katër vilajetet e Kosovës, Shkodrës, Manastirit dhe Janinës)¹². Më 4 shtator 1912, gazeta “Makedonija” njoftonte se “Nga çlirimi i Shkupit, e gjithë administrata në Mitrovicë, Prizren, Vushtrri, Tetovë, administrohet

¹¹ Македонија и Албанија, “Македонија“, Софија, 12. 8. 1912.

¹² Skender Asani, *Kryengritja e Përgjithshme Shqiptare e vitit 1912, sipas burimeve bullgare*, SHB “Shkupi”, Shkup, 2010, f. 107.

nga prijësit e Komitetit Popullor Shqiptar. Ky komitet kishte të drejta të gjëra, dhe në Mitrovicë, udhëheqës i këtij komiteti ishte Isa Boletini”¹³. Në disa pjesë të shtypit bullgar, hapësirë e duhur i jepet edhe euforisë së shqiptarëve me rastin e çlirimit të Shkupit nga ana e forcave kryengritëse shqiptare gati se pa asnjë reagim të administratës dhe ushtrisë turke, e cila po numëronte ditët e fundit të pushtetit në Ballkan. Në ndërkohë, në tetor të vitit 1912 filloi Lufta e Parë Ballkanike, nga ana e Malit të Zi, e më pas Serbisë, Bullgarisë dhe vendeve tjera. Edhe një tekst tjetër që e kemi hasur tek përmendet Isa Boletini, është ai në gazetën tjetër bullgare “Ballkanska zora”, e cila më 19 nëntor 1912, shkruante për depërtimin e ushtrisë serbe në veri të Shqipërisë, deri në afërsi të malësisë së Lumës, ndërsa thekson se “të gjitha fiset e Lumës i ishin bashkuar Isa Boletinit”¹⁴.

Siç shihet, interesimi i politikës zyrtare bullgare, sikurse edhe i opinionit të gjerë bullgar, në periudhën e vlimeve të mëdha të vitit 1912, ishte mjaft i theksuar për zhvillimet e hovshme në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare. Meqë Isa Boletini ishte njëra nga figurat kyçe të kësaj kryengritjeje, veprimtaria e tij do të regjistrohej hap pas hapi, duke dhënë kështu një tablo më të plotë të kësaj figure të dalluar historike. Meqenëse veprimtaria e trimit të Boletinit ndeshej me interesat bullgare në territoret e banuara me shqiptarë të Maqedonisë, politika dhe shtypi bullgar, në disa raste tentojnë të njollosin figurën e Isa Boletinit, (duke e vendosur atë në gjoja taborin e veprimtarëve serbofilë), por kjo tendencë asnjëherë nuk do të mund të jetë argumentuese dhe bindëse. Isa Boletini ishte dhe mbetet një figurë emblematike në historinë kombëtare shqiptare, i cili edhe sot e kësaj

¹³ Въ Албания, “Македония“, София, 4. 9. 1912.

¹⁴ Обезоржжаването на Албания, “Балканска зора“, София, 19. 11. 1912.

dite reflekton unitet, guxim dhe krenari për kombin shqiptar në të gjitha trojet e veta etnike.

Sevdail DEMIRI

SUMMARY

THE REPRESENTATION OF ISA BOLETINI ACCORDING TO BULGARIAN PRESS AND DOCUMENTS IN 1912

This paper treats some documentary sources as well as some press published articles from the Bulgarian press in 1912 that mention Isa Boletini and the National Albanian Movement at the time. Based on the researched material, we have noticed that the personality of Isa Boletini is an inseparable figures of all the reports written at the time, particularly so whenever Albanians and the developments in the National Albanian Movement were mentioned.

The General Uprising of 1912 was considered a serious movement by the Bulgarian press, according to which the uprising had a strong revolutionary character, mostly because its leaders were former chairmen of the Ottoman Parliament and other public political figures, such as Hasan Prishtina, Isa Boletini, Ismail Qemali, Bajram Curri, Idriz Seferi, Mehmet Pashë Deralla, Dervish Hima, Nexhip Draga, etc. These were renowned personalities with a great influence upon the Albanian people, which is why the Albanians responded to their call for armed resistance against the century long Ottoman occupier. As presented in this paper, it appears that the interest of the official Bulgarian policies likewise the general Bulgarian opinion during the period of 1912 was mostly focused on the rapid developments of the National Albanian Movement. Seeing that Isa

Boletini was one of the main figures of this uprising, his activity was closely followed, leaving thus a complete tableau of this renowned historical figure with who the National Albanian Movement is often identified.

Prof. assoc. dr. Teki KURTI
(Tiranë)

**VËSHTRIM I SHTYPIT SHQIPTAR MBI HEROIN
KOMBËTAR ISA BOLETINI**

Si pasojë e masave represive të xhonturqve si dhe Luftës së Parë Ballkanike në Shqipëri u mbyllën gazetatat që botoheshin në Korçë, Shkodër dhe Elbasan. Kështu, më 28 nëntor të vitit 1912, në Shqipëri nuk kishte organe të shtypit kombëtar. Në ditën e madhe të historisë sonë kombëtare, kur do të merrte udhë shteti i ri shqiptar, doli domosdoshmëri ngritja e shtypit ku qendra do të ishte Shqipëria. Në këtë fushë një kontribut të veçantë e dhanë publicistë e gazetarë që erdhën nga koloni të ndryshme, kryesisht të ardhurit nga Rumania. Me interesimin e drejtpërdrejtë të Qeverisë së Përkohshme të Ismail Qemalit, erdhi nga Italia një shtypshkronjë e madhe. Ajo filloi punë më 1 gusht 1913, ku nisi të botohej gazeta qeveritare “Perlindja e Shqipëniës”¹, e kështu me radhë. Në Durrës filloi botimi i gazetës “Ushtimi i Krujës”², në Shkodër filloi botimin gazeta

¹Luan Zelka, *Shtypi shqiptar gjatë viteve të pavarësisë (1913-1939)*, Toena, Tiranë, 2001, f. 12.

²*Po aty*, f. 13.

“Taraboshi”³ si dhe në Gjirokastrë e më gjerë. Tematika e shtypit në këtë periudhë lidhej kryesisht me dy detyrat kryesore të kohës:

1. Me bashkimin e popullit për të forcuar pavarësinë e shtetit të ri shqiptar;
2. Me rolin e gazetave në fushën e informacionit, për të qartësuar qëndrimet shoviniste e antishqiptare të Greqisë, Serbisë e Malit të Zi.

Në shtypin e kohës janë denoncuar barbarizmat e ushtrive të tyre ndaj popullsisë civile, në trojet që i ishin caktuar Shqipërisë nga Fuqitë e Mëdha si dhe në trojet shqiptare, që mbetën nën zgjedhën e tyre. Në faqet e shtypit të kohës së pavarësisë ka shkrime që i kushtohen organizatorit dhe pjesëmarrësve të drejtpërdrejtë të lëvizjeve dhe luftërave të pandërprera kundër pushtimit osman në fund të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX, Isa Boletini, i cili luftonte për bashkimin e të gjithë shqiptarëve dhe tokave shqiptare në një shtet të pavarur e sovran. Kuvendi historik i bashkimit kombëtar të shqiptarëve, të mbledhur në Vlorë më 28 nëntor 1912 gjeti pasqyrim të plotë në gazetën “Perlindja e Shqipëniës”, që doli më 6 gusht 1913, në numrin e saj të parë⁴.

Sipas artikullit “Vendimet e Kuvendit Kombëtar të Vlorës” i bëhet me dije opinionit se për gjendjen në Kosovë, Isa Boletini nuk do të ishte prezent në mbledhjen e parë të këtij Kuvendi⁵. Sipas shtypit, Isa Boletini do të ishte në mbledhjen e dytë të 30 nëntorit 1912 ku thuhej “si delegatë të ri erdhën z. Mehmed Pashë Dërrhalla, Isa Be Boletini, Ajdin Be Draga, Dervish Be Ipeku nga Kosova”⁶. Nga kjo mësohet që Isa Boletini udhëtoi në krah të atit të shqiptarëve

³*Po aty*.

⁴ Gazeta “Perlindja e Shqipëniës”, viti I, Vlonë, 6 gusht 1913, nr. 1, f. 1.

⁵ Gazeta “Perlindja e Shqipëniës”, V. II, nr. 6, dt. 31 dhjetor 1914, f. 4.

⁶*Po aty*, nr. 7, 4 dhjetor 1914, f. 5.

Ismail Qemalit në Evropë në mbrojtje të kombit shqiptar dhe të trojeve të tyre. Në shkrimin “Një fjalë e Isa Bej Boletinit”⁷ thuhej: “Luanët e Malësisë së Kosovës dhe të Malësies s’Shkodrës mendohen të ngrihen e të luftojnë burrërisht kundra tyranëvet, për t’u bashkuar me vëllezërit e tjerë të Shqipënies së lirë”. Dhe më tej i bëhej me dije Evropës “që gjer sa pa mbushur qëllimet dhe dëshirat e tyre, shqiptarët e Kosovës dhe të Hotit e të Grudës kurrë nuk do të qetësohen, por do të luftojnë gjer më në fund, sa të mos mbetet këmbë burri dhe kështu paqa në Ballkan për ditë do të jetë në rrezik”⁸. Shkrimi pasqyron përgjigjen që Isa Boletini i kish dhënë një korrespondenti:

“Neve, ju thamë qeveritarëve të Romës, të Vjenës, të Parisit dhe të Londrës, që populli ynë kurrë nuk mundet të duronjë të copëtohet. Pas trembëdhjet kryengritjeve të përgjakshme, në të cilat derdhëm kaq gjak për liriën tonë, na dha më në fund Evropa ç’varjen t’ënë. Por gjysmën më të madhe të kombit, duan t’ia bëjnë theror armiqve”. Isa Boletini vazhdon thënien e tij: “Kosova, zemra e Shqipëriës, po na humbet. Fiset e Hotit e të Grudës, të cilët luftuan kaq trimërisht për çështjen shqiptare, po i jepen Malit të Zi, 34 qytete shqiptare u dhanë në duart e armiqve t’anë”⁹.

Shtypi, në vijim të përmbushjes së misionit të tij, për të informuar publikun rreth luftërave të përgjakshme të shqiptarëve për bashkimin e trojeve të tyre, vazhdon me shkrimin “Shqiptarët hyjnë në Tuz”. Duke iu referuar agjencive të huaja, “lajmërohet prej Shkodre se çeta shqiptare, nën kryesinë e Isa Boletinit dhe Bajram Currit, u përpoqën dhe e shtyen ushtrinë serbe në Dibrë dhe afër Prizrenit. Ushtarët malësorë i zunë gjithë malet e kufirit”. “Në

⁷ Gazeta “Perlindja e Shqipërisë”, V.I, nr. 7, 3 vjeshtë e I, 1913, f. 3.

⁸ *Po aty*, f. 4.

⁹ *Po aty*.

Beligrad - vazhdon shkrimi - u hap zani se shqiptarët hynë në Tuz duke dëbuar ushtarët malazez që gjendeshin atje”¹⁰. Edhe shtypi shqiptar, që botohej jashtë Shqipërisë, kryesisht “Dielli” që botohej në Amerikë dhe “Liri e Shqipërisë” që botohej në Sofje nga Kristo Dako, e intensifikuan gamën e shkrimeve të tyre mbi portretin e Isa Boletinit. Kështu, në “Liria e Shqipërisë”¹¹ do të quhej titan dhe gjeneral i madh i Kosovës e fuqi drejtuese e ushtrisë së Shqipërisë, tmerr i Turqisë e kryengritësi i parë kundër tiranisë. Shkrimi e portretizon Isa Boletinin si të urtë, të butë e të qetë, të ëmbël, të ngadalshëm në fjalë dhe fisnik në sjellje që sa herë që fliste dorën e djathtë e vendoste në zemër.

Shkrimi na informon se Isa Boletini që ishte i gjatë nga më të gjatët e madhështor me shtat, e kalorës në sjelljet e tjera, në gjithë shëtitjet që bëri në qytetet më të mëdha të Evropës në mes të njerëzve më përfaqësues e të qytetëruar, kurrë nuk i ndërroi teshat e tij kosovare të cilat i jepnin atij një pamje madhështore e të hijshme. Theksojmë që Isa Boletini në këtë periudhë të veçantë të historisë sonë kombëtare ishte kudo: ai është në Evropë në krah të Ismail Qemalit e Luigj Gurakuqit, në Kosovë në krahë të Bajram Currit e Hasan Prishtinës dhe përsëri në Shqipërinë e lirë në mbrojtje të shtetit shqiptar dhe Princ Vidit që u rrezikua nga qamilizmi dhe fillimi i Luftës së Parë Botërore. Disa gazeta në këtë periudhë Isa Boletinin do ta quanin kryetarin e Kosovës që bashkë me shumë shokë të tjerë ka shkuar në Shqipëri të Veriut që të luftojë kundra tiranisë serbe¹². Në shkurt 1916 shtypi njoftonte se, si rezultat i Luftës së Parë Botërore malet e egra dhe të akullta të Shqipërisë janë plot me kufoma. Korrespondenti e vërteton lajmin që Isa Boletini u

¹⁰ Gazeta “Perlindja e Shqipëniës”, nr. 16, 4 vjesht’ e I, 1913, f. 5.

¹¹ Gazeta “Liri e Shqipërisë”, Kristo Luarasi Direktor, nr., dt.

¹² Gazeta “Liri e Shqipërisë”, Sofje, nr. 81, 5 gusht 1913, f. 1.

vra bashkë me djemt' e tij"¹³. Në njoftim nuk jepen hollësi mbi ngjarjen dhe vendin e saktë të saj. Në vitet e Luftës së Parë Botërore deri në përfundim, gjatë përpjekjeve për rinjohjen dhe organizimin e shtetit të pavarur shqiptar, deri në konsolidimin e tij në vitet '30, shtypi shqiptar është ndalur shumë pak mbi figurën e Isa Boletinit.

Në gazetën "Ora", në periudhën e monarkisë, në rubrikën "Kujtime historike", shkrimi "Një kujtim nga jeta e Isa Boletinit", jepte episode interesante të jetës dhe veprimit të Isa Boletinit, siç ishte përshkruar nga gazetari i vjetër Leo Aleksandër Freundlich. Sipas këtij shkrimi Isa Boletini, duke udhëtuar bashkë me Ismail Qemalin nëpër kryeqytetet e Evropës në Vjenë, jep këtë deklaratë politike: "Në radhë të parë shpall që emni jem është Boletini e jo Boljotinac sikurse më thërrasin serbët"¹⁴. E dyta "nuk kemi me e lejuë kurrë copëtimin e vilajetit të Kosovës". Isa Boletini citohet të ketë thënë që: "Do të ishte një vepër tepër antinjerëzore nëse, Europa e civilizuar do t'i lënë vëllezërit t'onë në duar t'anmikut, i cili është sjellë tepër barbar kundrejt nesh". Pra, vazhdon Boletini - "unë nuk do ta bejsojshe që Europa, me një kulturë të naltë, do të na bante një padrejtësi kaq të madhe"¹⁵.

Shkrimi evidenton aftësitë e veçanta të Isa Boletinit jo vetëm si strateg por, dhe si diplomat e njohës të mirë të historisë tonë kombëtare, ballkanike dhe evropiane. Kështu, ai nënvizon faktin që është "shumë e kjartë që Turqia nuk e kishte fuqinë e brendshme dhe kulturën, që vendeve të pushtuara t'u jepte një kulturë të mirë. Gjithë bota e di pazotësinë e Serbisë dhe të Malit të Zi me pikëpamjen njerëzore dhe të civilizacionit". Dhe ai beson që Evropa tashti do të

¹³ Gazeta "Dielli", nr. 581, february 3, 1916, f. 1.

¹⁴*Po aty*.

¹⁵*Po aty*.

jepte një fjalë fuqie, përndryshe, jemi të shtrënguar të luftojmë për vdekje me armikun tonë¹⁶.

Shteti totalitar shqiptar i pas Luftës së Dytë Botërore, në kuadër të propagandës së madhështisë së komb-shtetit ka vlerësuar figurat e Rilindjes Kombëtare, në veçanti Isa Boletinin si një ndër udhëheqësit kryesorë të pavarësisë në krah të Ismail Qemalit dhe shtetit shqiptar. Isa Boletini u shpall “Hero i Popullit”. Për të u bënë këngë, poezi, përmendore dhe deri film, ku bëmat e tij glorifikohen. Në shtypin e kontrolluar të kohës nga partia në pushtet gjejmë shkrime nga penat më të mëdha të historiografisë shqiptare. Në një shkrim të gazetës “Zëri i Popullit” të vitit 1976, profesori Stefanaq Pollo shkruante: “Figura e Isa Boletinit dhe lufta e tij janë të lidhura ngushtë me historinë e popullit të Kosovës e të gjithë Shqipërisë dhe nuk mund të kuptohet jashtë tyre”¹⁷. Po në këtë gazetë më 23 janar 1981, profesor Bujar Hoxha, me rastin e 65-vjetorit të rënies së Isa Boletinit shkruante: “Isa Boletini zë një vend me rëndësi në historinë e Shqipërisë të fundit të shekullit XIX dhe të fillimit të shek. XX. Në të mishërohet dashuria për Atdheun e lirinë e tij...”¹⁸.

Shkrimi bën një analizë të hollësishme të luftërave për liri dhe të gjithë veprimtarisë drejtuese të Isa Boletinit si strateg ushtarak e si diplomat i vendosur në mbrojtje të trojeve shqiptare. Futja e Shqipërisë në rrugën e demokracisë dhe ngritja e shqiptarëve në trojet e tyre, jashtë kufijve politikë, në luftë për liri solli dhe vërshimin e shtypit të lirë në Shqipëri. Në këtë shtyp kemi shkrime të spikatura të specialistëve të historiografisë, si: prof. Marenglen Verli, prof. Gazmend Shpuza, prof. Fatmira Musaj, por edhe të dhjetëra e

¹⁶*Po aty*.

¹⁷ Gazeta “Zëri i popullit”, Tiranë, 23 janar 1976, nr. 19 (8562), f. 3, Artikulli “Isa Boletini patriot dhe luftëtar i shquar”.

¹⁸*Po aty*, 23 janar 1981, nr. 19, f. 3.

dhjetëra të tjerëve që me shkrimet e tyre e informonin opinionin mbi rolin atdhetar e patriotik të Isa Boletinit në luftë për liri e pavarësi kombëtare.

Në shumicën e gazetave të shtypit të Shqipërisë shkrimet për Isa Boletinin shoqërohen me fotot e Ismail Qemalit dhe Isa Boletinit, si shqipja në flamur me dy koka. Si përfundim, mund të themi, se shtypi shqiptar me gjithë vështirësitë e panumërta ekonomike dhe politike ia ka arritur të evidentojë vlerat e Isa Boletinit si burrë kuvendesh dhe strateg i kryengritjeve të mëdha, si mburojë e pavarësisë kombëtare të 1912 dhe si luftëtar i pamposhtur i bashkimit të të gjitha trojeve etnike shqiptare. Kështu, shtypi ka arritur të japë një kontribut të veçantë në rritjen e ndërgjegjes gjithëkombëtare.

Prof. asoc. dr. Teki KURTI

SUMMARY

A REVIEW OF THE ALBANIAN PRESS REGARDING THE NATIONAL HERO ISA BOLETINI

The paper attempts to bring forth a representation of the Albanian press regarding one of the most renowned personalities of our history, the national hero Isa Boletini. The patriotic figure of Isa Boletini is closely related to the attempts and the battles of the Albanian people on their plight to independence and national unification. Regarding the activity of Isa Boletini, the Albanian press highlights his bravery as a warrior and a leader, as a head of uprisings such as the one at the canyon of Caraleve etc. The Albanian press values Isa Boletini for his contribution in ensuring national independence amidst the contribution of Ismail Qemali, Luigj Gurakuqi, Hasan Prishtina, Bajram Curri etc.

The Albanian press informs us regarding his ceaseless war in the path of liberating Kosova from the Serbs and Montenegrins as well as in his path of defending the newly formed state of Albania. The press pertaining to the period after the Second World War also informs us on the activity of Isa Boletini in regards to his collaboration with Ismail Qemali. The Albanian press published the picture of Ismail Qemali and Isa Boletini together in Vlorë in every major political development such as that of 1968, 1981 and so forth, as a way to show that we were united as a nation at all times.

Prof. dr. Adem ZEJNULLAHU
(Prishtinë)

**ISA BOLETINI NË EPIKËN HISTORIKE, NË POEZINË E
KULTIVUAR DHE NË KUJTIMET E POPULLIT**

Shala e Bajgorës - pararojë e kufirit

Shala e Bajgorës, me karakteristikat e saja gjeostrategjike dhe me pasuritë që ka mbitokësore dhe nëntokësore, paraqet njërën ndër trevat më të rëndësishme të atdheut tonë. Ajo, krahas Drenicës, Grykës së Kaçanikut dhe Carralevës, gjatë shekujve, ishte ndër vendet më të lavdishme të qëndresës kombëtare kundër armiqve. Përpjekjet, luftërat e pandërprera të kësaj treve dhe rezistenca për të ekzistuar e lirë, datojnë që nga kohët e mugëta, atëherë kur shumë perandorë, krajli e sulltanë u vërsulën për ta pushtuar e për ta bërë pasuri për vete. Dëshmi e këtyre synimeve ogurzeza janë shumë ngjarje të ndryshme tragjike, por edhe madhështore, që u zhvilluan në këtë krahinë.

Popullsia e Shalës së Bajgorës me rrethinë, sikurse edhe trevat e shumta shqiptare, nuk u pajtua asnjëherë me robërinë. Ajo rezistoi, luftoi dhe sakrifikoi, andaj u plaçkit, u dogj, u burgos dhe u vra, por prapëseprapë u ringjall si feniksi nga hiri i vet. Shala e

Bajgorës ishte gjithmonë pararojë e fuqishme e kësaj pjese të atdheut arbëror, duke qenë në kufi me shtetin serb, i cili nuk i ka ndalur asnjëherë krimet dhe pretendimet e tij, për ta pushtuar dhe për t'i shfrytëzuar pasuritë e kësaj krahine, por pa shqiptarë. Nga ky popull liridashës dolën figura të shquara, të cilat me fisnikërinë, trimërinë, luftërat, strategjinë dhe vizionin e tyre të qartë për të ardhmen e popullit, hynë në zemrën, në mendjen dhe në veprimet e tyre luftarake sakrifikuese.

Shala e Bajgorës me rrethinë ka simbolet e qëndresës, flakadanët, që luftuan dhe u sakrifikuan për të, për lirinë e popullit shqiptar, duke filluar nga Ahmet Boletini, Isa Boletini, Beqir Voca, Sylë Maloku, Shahin Alia, Hamdi Gavazi, Mursel Igrishta, Ahmet Selaci, Kadri Bistrice, Ukshin Kovaçica, Riza Selaci, Ymer Selaci, vëllëzërit Vocolli, Sherif Tërstenës etj. Fati i këtyre personaliteteve është i lidhur ngushtë me fatin e popullit shqiptar në tërësi, në shumë ngjarje të mëdha e të vogla, në rënie e në ngritje, në humbje e në ngadhënjime, me tragjike, me madhështi, të cilat me kohë u përjetësuan nga rapsodët popullorë, nga poetet e periudhave të ndryshme, nga kujtesa e popullit, në historinë tonë kombëtare.

Figura e Isa Boletinit në poezinë popullore dhe në atë të shkruar

Isa Boletini është njëra ndër figurat më të shquara të kombit tonë. Kulla e tij është simbol i qëndresës dhe krenarisë kombëtare. Ai në kohët më vendimtare për popullin shqiptar, thoshte: “Unë jam mirë kur asht mirë Shipnia”. Kjo fjali në shikim të parë, të duket e thjeshtë, por ngërthen në vete, kuptimësi të thellë, përcaktuese dhe vetëmohuese, që do të thotë se qenia e heroit është identifikuar tërësisht me fatin e atdheut, përballë shtrëngatave të kohëve të liga, që sillnin rreziqe në tokën dhe qiellin shqiptar.

Në ballë të këtyre furtunave u gjend Isa Boletini, simbol i qëndresës, i luftës për çlirimin, ruajtje të tërësisë tokësore dhe mëvetësinë të shtetit shqiptar. Kjo figurë kombëtare në fushën luftarake zë vendin kryesor, pas Skënderbeut, si pararojë e atdheut për tridhjetepesë vjet rresht, duke luftuar e duke mbrojtur nderin e kombit tonë. Kulla e tij u dogj gjashtë herë e u bë shkumb e hi nga forcat turke, por ajo u ngrit lart, më e fortë dhe përqafoi qiellin, në mesin e atyre kodrave, që shpesh villnin zjarr topash, tym martinash, vringëllimë shpatash e singiash të armiqve që vinin për ta vrarë Isa Boletinin dhe për ta rrafshuar atë rrafsh me tokë.

Të dhënat historike dhe folklorike dëshmojnë fuqishëm se Isa Boletini ishte inkadruar shumë herët në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare. Ai, me guximin, vendosmërinë, strategjinë luftarake dhe me vizionin e qartë që kishte për të ardhmen e atdheut, nga populli i vet ishte zgjedhur prijës në shumë krahina shqiptare. Pamja fizike e Isa Boletinit ishte në harmoni me natyrën ku kishte lindur, ku ishte rritur dhe formuar si hero. Në kullë, në odë shaljane, aty ku çmoheshin lart jeta, nderi e besa dhe ku dënoheshin frika, tradhtia e robëria, aty ku burrat e mëdhenj të kombit takoheshin, bisedonin dhe merrnin vendime të rëndësishme për fatin e shqiptarëve në vorbullat e zhvillimit të ngjarjeve historike.

Isa kishte pamje të një kreshniku, ashtu siç e përshkruan epika historike popullore dhe kujtesa e bashkëkohësve të tij. Këtë pamje madhështore, ia atribuojnë edhe të tjerët, njerëzit, miqtë e armiqtë, bashkëluftëtarët, vizitorët e huaj, që patën rastin ta shihnin, ta takonin, të shprehnin mendime për çështjet më të ndërlikuara kombëtare. Kështu, publicisti i njohur gjerman, Karl Estrajer, në librin e tij *Përshtypje udhëtimi*, të botuar më 1898, pos tjerash, për këtë hero shqiptar, shkruan: “Isa Boletini është një burrë shtatlartë, i bukur, ngjyrë gruri, është ende i ri nga mosha; ka një fytyrë të hollë,

në shprehjen e syve të tij, më kot përpiqesh të gjesh diçka të egër, përkundër në ata sheh diçka të përmallshme”¹. Këto përmasa, të tilla të pamjes se një burri të zhvilluar, të një luftëtari të paepur, të një strategu të dalluar, karshi pashallarëve, vezirëve e gjeneralëve më të mëdhenj të kohës, njohësit e mirë të tij, e quajtnë “Luan të Shqipërisë”, duke e krahasuan me Garibaldin, me Robin Hudin, Fon Berlingenin etj., Këto virtyte të shumta, ia përshkruan edhe epika historike popullore, duke e pasqyruar pamjen, qëndrimin e tij dinjitoz, burrëror, e ushtarak, me armë të ngjeshura në trup, të cilit i rri bukur, ia shtojnë vlerën edhe më tepër, që nuk mund t’i gjendet shoq në Romë as në Stamboll:

*Me ni krah ma ka dallamën,
Në krah tjetër ma ka bërshanën,
Armë të bardha prej çelikut,
Dy pishtole t’ Venedikut.
Mir’ t’ qëndisura n’flak’ t’ dukatit
Si dy gjarpnusha të Bagdatit*².

Pamje dhe virtyte të larta njerëzore e ushtarake ia përshkruajnë edhe poezitë e shumë poetëve të Rilindjes, si: Hil Mosi, Risto Siliqi, Gjergj Fishta, Asdreni, por edhe poetët e periudhave më të vonshme, si: Enver Gjergjeku, Agim Shehu, Muhamet Kërveshi, Jakup Ceraja, Qerim Ujkani, Sabri Hamiti, Adem Zejnullahu, Shahin Hasani - Shkoza, Milaim Berisha, Ali Alidema etj., duke e cilësuar si një hero të madh kombëtar që me të bëmat e tij, gjatë tërë jetës, e munda vdekjen dhe u bë i përjetshëm.

Isa Boletini e nisi veprimtarinë kombëtare qysh herët me një diapazon shumë të gjerë e të thellë. Ai në moshën 17-vjeçare hyri në flakën e luftës në Carralevë kundër forcave të Dervish Pashës. Ishte

¹ Skënder Luarasi, *Isa Boletini*, Rilindja, Prishtinë, 1972, f. 25.

² Arkivi i Institutit Albanologjik të Prishtinës, Dosja e Sabahudin Cenës.

pjesëmarrës në Kuvendin të Verrat e Llukës, në Kuvendin e Pejës, në Kuvendin e Ferizajt, në Kuvendin e Junikut etj. Veprimtarinë e tij atdhetare e intensifikoi sidomos me dëbimin dhe vrasjen e konsullit rus, Shqerbin, në Mitrovicë më 1902-1903, kryengritjet e mëdha të popullsisë shqiptare gjatë viteve 1908, 1910, 1911, 1912.

Bashkëpunonte ngushtë me ideologët dhe me patriotët më të shquar kombëtarë si me: Hasan Prishtinën, Zejnullah Begun, Ahmet Delinë, Sadik Ramën, Hasan Hysen Budakovën, Bajram Currin, Xhemail Prishtinën etj. Të dhënat folklorike dhe historike dëshmojnë fuqishëm se sa intensive ishin përpjekjet e tij kundër pushtuesve të huaj për çlirim dhe mëvetësi të shtetit shqiptar, po aq ishin edhe angazhimet e tyre për zhdukjen e tij fizike, në fushëbetejë, në tradhti, me armë e me diplomaci. Kundër tij u organizuan shumë prita, skenarë ogurzi, aksione të mëdha luftarake, por falë përkrahjes së popullit dhe luftëtarëve të tij të paepur, të gjitha dështuan. Angazhimin e tij në fushën e betejës kundër forcave të huaja ushtarake, kënga popullore historike e këndon në mënyrë të hollësishme, duke e zëruar dhe përjetësuar idealin e tij për çlirim dhe pavarësim, në realitetin historik dhe në art.

Gjatë luftërave të shumta, ai në fushëbeteja, u ndesh me forcat ushtarake më të fuqishme të pashallarëve më të shquar të Perandorisë Osmane, të cilat nuk arritën asnjëherë ta zënë, ta thyejnë, ta nënshtrojnë, ta bëjnë për vete, as ta largojnë nga rruga e idealit të tij kombëtar, por nga këto ngjarje të përgjakshme, ai doli gjithherë më i fortë dhe më i vendosur për të vazhduar deri në fund rrugën çlirimtare. Të shumta ishin betejat dhe luftërat, të cilat i zhvilloi gjatë jetës së tij ushtarake për tridhjetë vjet rresht. Po aq, janë edhe këngët historike, rrëfimet popullore, të cilat i këndojnë, i tregojnë këto ngjarje të përgjakshme gjatë rrjedhave historike. Ekziston një cikël i veçantë këngësh me shumë variante, që e përjetësojnë figurën e Isa

Boletinit në jetë, në luftë, në kuvende dhe në diplomaci. Në një numër këngësh e variantesh e këndojnë drejtpërdrejt angazhimin e tij në luftëra të ndryshme. Kurse disa të tjera e paraqesin Isa Boletinin bashkë me udhëheqës, luftarakë e strategë të tjerë shqiptarë, gjatë luftërave dhe angazhimeve të tjera për sendërtimin e idealeve kombëtare.

Në të dyja rastet, sipas epikës historike, inkuadrimi i tij në fushëbeteja ka mundësuar ngadhënjimin e forcave ushtarake shqiptare kundruall armiqve më të fortë. Hasmëria e Isa Boletinit me sulltanët dhe krajlat e ndryshëm, gjatë tërë jetës ushtarake, ishte e madhe, skajshmërisht e urrejtshme dhe kundërshtuese, që rezultoi me shumë luftëra të rrepta nëpër fushëbeteja të ndryshme. Me të u ndesh ushtria e Hafiz Pashës, e Xhavit Pashës, e Dërgut Pashës, madje edhe Shefqet Pasha, ministër i Luftës në Perandorinë Osmane, me gjeneralët e krajlit të Malit të Zi, të Serbisë u munduan ta zënë të gjallë, ta poshtërojnë e ta vrasin, por në fushën e betejës nuk arritën asnjëherë ta bëjnë këtë, sepse pësuan gjithmonë disfatë dhe u ndanë me humbje të mëdha.

Kulla e Isa Boletinit - simbol i qëndresës kombëtare shqiptare

Ligjërimi poetik gojor, dëfton se më 1895, në kuadrin e angazhimit luftarak të Hafiz Pashës për shuarjen e kryengritjeve shqiptare, të cilat kishin marrë hov nëpër shumë pika gjeografike të viseve shqiptare kundër sundimit të Qeverisë turke, Mehmet Efendiu i Mitrovicës me shumë bimbashë të zgjedhur, organizoi një ekspeditë ndëshkuese ushtarake kundër Isa Boletinit. Me të mësuar për qëllimin e armikut, popullata e Shalës së Bajgorës, djemtë e zgjedhur e më në zë, si dhe të regjioneve të tjera përreth, i erdhën në ndihmë

për ta mbrojtur e për të luftuar kundër ushtrisë turke, të cilën sulltani nga Stambolli e kishte planifikuar:

*Në Stamboll rrehi teli,
Në Prishtinë shkoi haberi,
Hafiz Pasha asht shtrengue
Isa Boletinin gjallë e due³.*

Sipas kujtesës së popullit, pjesëmarrësve në këtë luftë dhe të ligjërit të krijimeve poetike del se forcat e Hafiz Pashës, Boletinin e rrethuan nga shumë anë. Mirëpo, strategu shqiptar, ishte informuar me kohë për këtë luftë, andaj kishte bërë përgatitje të duhura mbrojtëse. Ai me luftëtarët e tij zë pikat më strategjike nga mund të luftohej dhe të mbrohej, si në: *N'maje të Vogël, N'Koritë të Gurit*, në shpate, në përrenj e në shkëmbinj të ndryshëm, ku mund të luftohej dhe të asgjësohej armiku. Filloi lufta. Nga katër anët e Boletinit shkrepin armët e llojeve të ndryshme, drejtuar kullës dhe luftëtarëve të lirisë. Por edhe kundërsulmi i forcave të Isait ishte i fuqishëm. Vriteshin dhe plagoseshin nizamët e gjorë, britmat dhe thirrjet e tyre për ndihmë i kapërdinte qielli me re e tym.

*- Top manxerrjen dredhja shpejt,
dredhja shpejt qat top mamxerrje
se na faroi Isa ushtrinë.⁴*

Epërsia në numër luftëtarësh dhe në armatim ishte në anën turke, por luftëtarët shqiptarë kishin vullnet dhe vendosmëri të palëkundur për të bërë rezistencë e për të luftuar, për të sakrifikuar dhe për të fituar atë luftë. Isa me forcat e tij luftarake i shkaktuan humbje të mëdha ushtrisë turke. U vranë shumë bimbashë e nizamë,

³*AQSh*, Tiranë.

⁴*Këngë popullore historike*, bleu II, IAP, Prishtinë, 2007, f. 279. Përgatitur nga: dr. Fazli Syla, dr. Rustem Berisha, dr. Sadri Fetiu, dr. Adem Zejnullahu dhe mr. Jahir Ahmeti.

u morë shumë armatim prej forcave turke, çka më në fund u detyruan të kthehen në Mitrovicë si humbës. Këtë përfundim të kësaj beteje epika historike e paraqet në këtë mënyrë:

*N'Korit t'Gurit qenkan hip,
kërkojnë rrugën kah me ikë⁵.*

Ose:

*Ky juzbashi po bërtet
Me buri ndihmen thrret,
Krejt fuqia m'u ka nda
Pes bylykbasha m'u kan' vra⁶.*

Rapsodi popullor duke dashur që ta lartësojë luftën, trimërinë e Isa Boletinit, me luftëtarët e tij, kundër forcave turke e bën pjesëmarrëse në zhvillimin e ngjarjes edhe natyrën me bjeshkë, shkëmbinj, përrënj:

*Çka kanë bjeshkët qi ushtojnë,
Boletini po lufton⁷.*

Fitorja e forcave shqiptare ndaj ushtrisë së Hafiz Pashës, luftëtarët shqiptarë, i mobilizoi edhe më tepër, i forcoi dhe u dha besim në vete, sepse edhe ndaj armikut më të fuqishëm, nëse ka vullnet dhe vendosmëri për të fituar, mund të fitohet.

Kjo fitore e Isait e hidhëroi dhe e hasmëroi edhe më tepër Qeverinë turke, e cila kërkonte me çdo kusht kokën e tij. Angazhimi dhe suksemi i Isa Boletinit në të mirë të çështjes kombëtare me kalimin e kohës intensifikohej gjithnjë e më tepër, bëhej më gjithëpërfshirës, më zulumëmadh, në rrafshin organizativ, ushtarak,

⁵AQSh, Tiranë.

⁶AQSh, Tiranë.

⁷Arkivi i Institutit Albanologjik të Prishtinës, Dosja e Adem Zejnullahut.

politik, diplomatik etj. Sukseset e tij në fushën e betejës shënonin ngritje të vazhdueshme.

Ishte koha e prapaskenave të mëdha në Ballkan, të cilët i hartonin dhe i realizonin shtetet e fuqishme, por edhe ato fqinje të shqiptarëve. Kombi ndodhej në rrezik të madh. Në këtë kohë, Edith Durham, njëra nga njohëset më të mira të çështjes shqiptare shkruante: “Lojë më e ndyrë e tradhtisë kurrë nuk është lozur (...) shqiptarët e Kosovës u ngritën në masë. Ata i udhëhiqte Isa Boletini(...), Kosova u mor me tradhti”⁸. Prijësit e popullit tonë e dinin se ishte koha më vendimtare për ardhmërinë e kombit, vitet më kritike, më tragjike dhe më madhështore në historinë e përpjekjeve dhe të luftërave të pareshtura të shqiptarëve për çlirim dhe mëvetësi kombëtare, andaj u mobilizuan ushtarakisht dhe diplomatikisht për ta bërë shtetin.

Kryengritjet e mëdha të shqiptarëve të viteve 1909, 1910, 1911 dhe 1912 në arenën ushtarake e diplomatike të Perandoria Osmane, të Fuqitë e Mëdha të Evropës dhe të shteteve fqinje, futën frikë të madhe për forcimin e faktorit shqiptar në Ballkan, të cilin nuk e shikonin me sy të mirë, duke e konsideruar si pengesë për synimet e tyre grabitqare, në dëm të tokave shqiptare. Qeveria turke u angazhua për reforma të shumta në shumë sfera të organizimit shtetëror, duke shpresuar në stabilizimin e gjendjes ekonomike, ushtarake, brenda Perandorisë, shteteve të robëruara, dhe skenarëve të Evropës, e cila e përcillte me kujdes shkatërrimin e saj gradual.

Në fillim, për ndryshime në Qeverinë turke, ishin edhe shqiptarët, të cilët ishin lodhur nga luftërat dhe gjendja e vështirë ekonomike e politike, andaj u përcaktuan për Hyrjet (kushtetutë) të xhonturqve, të cilët në fillim premtuan se do të jenë shumë më

⁸ Gazeta “Bujku”, më 10. III. 1996; Letër e pabotuar e Miss Edith Durhamit.

dorë lirë në të drejtat jetësore, politike, e arsimore e vetëqeverisëse të shqiptarëve sesa pararendësit e tyre.

Në saje të angazhimit të shqiptarëve dhe të fuqive të tjera brenda Perandorisë u rrëzua pushteti i Sulltan Hamitit II, por me të marrë pushtetin Turqit e Rinj, u bënë edhe më të egër ndaj shqiptarëve. Ata u vërsulën me të gjitha forcat për ta zhbërë, shkatërruar e zhdukur, çdo gjë që kishte frymën dhe pamjen shqiptare. Isa Boletini, e kishte kuptuar herët këtë dyfytirësi të tyre. Ai e dinte se për vrasjen e tij, me kohë, ishin marrë vendime nga ushtarakët më të lartë të oborrit në Stamboll, e veçanërisht pas takimit në Selanik, ku Isa u tregua se është i palëkundur në kërkesat e tij për të drejtat e shqiptarëve:

*Heh, mexhlis, paske gabue
Tanë me m'gri e me m'coptue,
S'kam myhyrën qetu me vnue⁹.*

Popullata e Shalës së Bajgorës, e udhëhequr nga Isa Boletini, kishte filluar herët të mos paguajë vergi, të mos i dërgojë djemtë nizamë etj. Porta e Lartë i dinte të gjitha këto, andaj për ta mposhtur këtë qëndresë e dërgoi Xhavit Pashën me një ushtri të madhe dhe me armatim të rëndë në Boletin, ku bëhej qëndresa kryesore. Kujtesa e popullit dhe kënga popullore njoftojnë se ishte kohë dimri, binte borë e madhe dhe bënte acar. Armiku e kishte zgjedhur këtë kohë të vështirë me qëllim për të sulmuar e për t'i befasuar Isën me luftëtarët e tij. Në mëngjesin e hershëm, të 22 nëntorit 1908, Xhavit Pasha, me forcat e tij të mëdha luftarake, rrethuan Boletinin në dy drejtime. Ai i vendosi katër topa të rëndë përballë kullës së Isa Boletinit, ndërsa gjashtë të tjerë i la në Rahovë, prej nga mund të gjuante pa vështirësi në drejtim të fshatit Boletin.

⁹Këngë Popullore Historike, IAP, bleu II, Prishtinë, 2007, f. 277.

Në atë kohë Isa Boletini nuk gjendej në Boletin, por në Podgur të Pejës. Ishte informuar me kohë se do të vinte Xhavit Pasha me ushtri, andaj arrinë shumë shpejt në vendlindje, me 200 luftëtarë, ku e prisnin edhe luftëtarë të tjerë nga Shala dhe krahinat e tjera. Sipas të dhënave folklorike dhe kujtesës së popullit, si dhe pjesëmarrësve në këtë luftë, Isa Boletini, rrethimin e tij nga Xhavit Pasha, e mori krejtësisht i qetë, si diç të rëndomtë, ngase ishte mësuar me luftëra të tilla. Kishte vendosur të luftojë, të sakrifikojë, për lirinë dhe pavarësinë e kombit. I vendos shpejt e shpejt luftëtarët nëpër vendet strategjike dhe kur nëna Ajshe e lajmëron për ardhjen e ushtrisë turke në afërsi të Boletinit, ai i thotë krejtësisht gjakftohtë:

- *Qinro, nanë, e ban gajret,*
Sa ta baj ket luftë me mret,
Ia kam dhanë besën n'zyre t'vet,
I herë jam le, 'i herë due me dekë'¹⁰

Përgatitjet për luftë nga të dyja palët kundërshtare, ishin bërë me kohë, në shkallën më të lartë, si për nga numri i madh i ushtarëve, armatimi i rëndë nga turqit, por edhe nga Isa me luftëtarët e tij, të cilët zënë pozicione strategjike me aq armatim sa kishin. Marshimin e ushtrisë turke me armatim të rëndë drejt Boletinit e kumton drejtpërdrejt edhe epika popullore historike, e cila paraqet dialogun që zhvillon Isa me nënën e vet, në ato momente dramatike, për fatin e tij dhe të luftëtarëve të vet, të cilët pritnin të ndesheshin me ushtrinë e Xhavit Pashës:

Thirrke Isa, o nanën e vet:
- Bina zhagat, oj nanë, me fyshekë!
Se ketij hallki, nanë, du m'ju shkep,
Se janë ardhë, nanë, me ne me dekë'¹¹.

¹⁰Po aty, f. 279.

¹¹Këngë të Rilindjes Kombëtare, Prishtinë, 1978, f. 276.

Atmosfera bëhej më e rëndë gjithnjë e më tepër, më tendosëse dhe më e padurueshme. Të dyja palët prisnin urdhrin për sulm. Nëna e Isait, së bashku me gratë e tjera, ishin të angazhuara për t'i ndihmuar luftëtarët shqiptarë, por edhe për të qëlluar mbi pozicionet armike. Brengë e veçantë për nënën e Isait, në këto momente kritike, ishte numri i madh i ushtarëve në anën forcave turke, sidomos topat e rëndë, të cilët ia kishin drejtuar kullës, kurse Isa i thoshte me gjakftohtësinë më të madhe:

*Po le t'i bien, moj nanë!
Ma lezet ka me luftue,
ma me shum, sesa me pak,
me provue kullën me topa¹².*

Në katër anët e kullës dëgjoreshin krismat e armëve dhe ushtrimi e topave, që gjuanin në kullë të Isait dhe në luftëtarët e tij. Lufta ishte tejet e përgjakshme. Luftohej për çdo pëllëmbë toke, kodër, përrua e çufër të Boletinit, të Kosovës dhe më gjerë. Bënte kohë shumë e vështirë, frynte pandërprerë dhe binte borë, e cila e vështirësonte edhe më tepër pozitën e luftëtarëve të Isait, sepse pengonte ardhjen e luftëtarëve të tjerë në ndihmë, nga fshatrat dhe nga regjionet e tjera. Me të dëgjuar të krismave shumë vullnetarë nisen për në Boletin, por pengohen nga moti i keq dhe nga Ushtria turke. Pa ndalur armët nga të dy anët ndërluftuese, villnin zjarr, merrnin jetë njerëzish, plagosnin dhe digjnin aty ku binin. Beteja zgjati më tepër se njëzetekatër orë. Ushtria turke plotësohej vazhdimisht me forca të reja, që vinin nga Mitrovica, madje edhe nga Selaniku. Ardhjen e këtyre forcave kundërshtare, rapsodi popullor e përshkruan në këtë mënyrë:

*Vjen pampuri tue fishkllue,
Shkojnë ushtarët tue këndue,*

¹² Skënder Luarasi, *Isa Boletini*, Rilindja, Prishtinë, 1972, f. 74.

Te çfarë krajli dona me shkue.

N' Mitrovicë ju kanë kallxue,

*Isa Begun me rrethue*¹³.

Në vazhdim kënga popullore historike e pasqyron edhe angazhimin luftarak të Isait si strateg dhe shenjëtar i mirë, të cilit gjuajtja në armik, asnjëherë nuk i shkon huq, por vret:

Isa Begi, o po del n'at' shkrep,

Me mamxerre, o sa holl, po qet,

*Sa herë qet, po asqerë po vret!*¹⁴

Me kalimin e kohës gjendja e luftëtarëve shqiptarë në fushëbetejë keqësohej gjithnjë e më tepër, hetohej mungesa në municion, kishte edhe të plagosur shumë, madje ndër ta edhe vetë Isa ishte plagosur nga një predhë gjyleje ishte goditur në krah, por edhe ashtu i plagosur, u jepte guxim shokëve që të vazhdojnë luftën deri në fund:

Isa Begi koka varrue,

Ra në kullë me u mjekue

*Po i lidhë varrët me 'i mahramë'*¹⁵.

Ose:

- Bini, shokë, ta bajmë 'i piskamë,

Se jam shqiptar nuk dalë i gjallë,

*Për pa m'ra zjarr në qafë'*¹⁶!

Lufta vazhdoi deri në orët e vona të mbrëmjes. Gjithë ditën ishte bërë luftë fytafyta, nëpër shkurre, shkëmbinj, shpate, lisa, përrenj, ku mbeten shumë nizamë të vrarë, kurse mbi pozicionet e shqiptarëve, dhe mbi kullën e Isait u hodhën 1 600 gjyle (n. v. i

¹³AQSh, Tiranë.

¹⁴Arkivi i Institutit Albanologjik të Prishtinës, Dosja e Sabahudin Cenës.

¹⁵Këngë Popullore Historike, IAP, Bleu II, Prishtinë, 2007, f. 279.

¹⁶Po aty, f. 279.

Skënder Luarasi), armiqtë i afroheshin gjithnjë e më tepër kullës, mungesa e armatimit në anën e luftëtarëve shqiptarë, hetohej shumë. Qëndresën e Isait me luftëtarët e tij e pamundësoi shumë ardhja e forcave turke nga Pazari i Ri, andaj trimat shqiptarë vendosin që me një sulm të furishëm ta çajnë rrethimin, t'i bartin të plagosurit, të kalojnë lumin Ibër dhe të vendosen në vende të sigurt. Kështu vepruan, me sukses, shpërthyen rrethimin. Kurse Xhavit Pasha humbi shumë nizamë. Nuk arriti ta asgjësonte heroin shqiptar, përpos t'ia rrënojë kullën, t'ia plaçkiste të mirat, t'ia vriste kalin dhe ta merrte përbuzjen e deputetëve në Parlamentin turk, të pashallarëve të tjerë, për mossukses, në vrasjen e Isa Boletinit.

Lufta e Isa Boletinit ishte gjithëkombëtare

Fundi i shek. XIX dhe fillimi i shek. XX, paraqet periudhën më dramatike, më komplekse dhe më vendimtare për fatin historik të shqiptarëve. Në arenën diplomatike e ushtarake dalin në skenë, plane të ndryshme për ndarjen e tokave shqiptare. Në këtë kohë u lidhë Aleanca Serbo-Bullgaro-Greke për copëtimin e tokave shqiptare, me ndihmën e Fuqive të Mëdha, sidomos të Rusisë.

Shqiptarët u zhgënjyen edhe njëherë në qeverinë xhonturke, që u tregua edhe më e egër ndaj kërkesave të tyre të ligjshme. Me të marrë të pushtetit, filluan t'i mbyllin shkollat, klubet dhe shtypshkronjat në gjuhën shqipe. Reprezaljet, ndjekjet, burgosjet, internimet dhe vrasjet e udhëheqësve popullorë morën hov, me qëllim të frikësimit të popullatës së gjerë, që ishte molisur nga luftërat e shpeshta dhe gjendja e vështirë ekonomiko-sociale. Ndaj shqiptarëve filluan ekspeditat e pandërprera ndëshkuese, të udhëhequra nga pashallarët dhe gjeneralët më të njohur të kohës, të cilët kudo që shkelnin mbillnin tmerr e vdekje. Këto reprezalje e

pezmatuan edhe më tepër popullin, andaj filluan kryengritjet e viteve 1909, 1910, 1911, 1912, në të cilat u inkuadrua pjesa më e madhe e popullatës shqiptare.

Në vllugun e këtyre ngjarjeve, Isa Boletini, në Gojbulë të Vushtrrisë takohet me Hasan Prishtinën, me Zejnullah Begun etj., për t'u marrë vesh për fillimin e Kryengritjes së Përgjithshme shqiptare kundër sundimit turk. Isa si pjesëmarrës i Kuvendit të Junikut, më 1912, ai më 15 maj thirri Kuvendin e Kurillovës në Shalë të Bajgorës, vend ndërmjet të Shalës e Llapit, me qëllim të marrjes së vendimit për fillimin e kryengritjes së përgjithshme. Thirrjes së tij i përgjigjen krerët dhe masa e gjerë popullore e fshatrave të këtyre regjioneve. Kënga popullore, sikur do ta madhërojë tubimin gjithëpërfshirës dhe figurën e Isa Boletinit karshi këtyre ngjarjeve të mëdha, që ndodhin në hapësirën shqiptare e ballkanike:

- *Të thomi: "Turkun nuk e due!"*

Ka marrë udhën e asht tfillue,

N' Kurullovë koka shkue,

Krejt n'ledinë burrat i ka tubue,

*T'krejt katuneve aty janë shkue*¹⁷.

Më 1910 të Verrat e Llukës Isa Boletinin e zgjedhin komandant të forcave shqiptare. Në këtë kuvend ishin marrë vendime të rëndësishme për çështjen e atdheut, siç ishte pajtimi i gjaqeve, organizimi dhe mobilizimi i të gjithë atyre, që ishin të aftë për luftë. Organizimin dhe mobilizimin e shqiptarëve të shtatë krajlive të Evropës, siç thotë kënga, nuk e shikonte me sy të mirë, sidomos Rusia që kishte qëllime të caktuara, t'i ndihmojë sllavët për copëtimin e tokave shqiptare, andaj bënte presion të vazhdueshëm te qeveria turke që t'i disiplinojë shqiptarët e rebeluar.

¹⁷*Po aty*, f. 286.

Shtrirjen gjeografike të mobilizimit të shqiptarëve, veçanërisht tubimet dhe marrëveshjet e tyre gjithëkombëtare, për çlirimin e vendit, epika historike e paraqet në këtë mënyrë:

*Mbledh' shqiptart-e bytevi,
N'Mitrovicë deri n'Gusi,
N'Kaçanik deri n'Malsi.
N'Verra t' Lluk's bajnë pleqni,
N'Verra t' lluk's jan mbledh' të tanë
Kanë lidhë besën për gjith'anë¹⁹.*

Sa i rëndësishëm ishte roli i Isa Boletinit në zhvillimin e këtyre ngjarjeve, në fund të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX, në fushën e betejave, në arenën diplomatike ndërkombëtare, përveç të dhënave arkivore, dëshmojnë edhe këngët historike, të cilat e pasqyrojnë në mënyrë të denjë veprimtarinë e tij.

Veprimtaria ushtarake e Isa Boletinit i pengonte, gjithnjë e më tepër Fuqitë e Mëdha, sidomos shtetet fqinje, të cilat synonin copëtimin e tokave shqiptare:

*- Heu, kral Nikolla, o, po ma rrehke telin,
he, kanxhallozit po ja çon haberin:
He, me ma nxan-o, ore, Isa Begin,
o krejt Avropa, hej, ja kanë pa sherrin²⁰!*

Me kalimin e kohës, ngjarjet në Ballkan dhe në Perandorinë Osmane të xhonturqve, vinin duke u ndërlikuar edhe më tepër në sferën ushtarake, diplomatike, por dhe ekonomike. Në këtë kohë kudo nëpër tokat shqiptare ishte ndezë flaka e luftës për çlirimin e vendit. Isa Boletini në zhvillimin e këtyre kryengritjeve ishte figura kryesore, nën udhëheqjen e të cilit çliroheshin qytetet e

¹⁹Këngë Popullore të Rilindjes Kombëtare, Prishtinë, 1978, f. 251.

²⁰Arkivi i Institutit Albanologjik të Prishtinës, Këndoi: Dervish Shaqa, Dosja e Sadri Fetiut.

njëpasnjëshme dhe më në fund bie në dorë edhe Shkupi si kryeqendër e Vilajetit. Për shuarjen e këtyre kryengritjeve Qeveria turke dërgoi pashallarët e gjeneralët më të njohur të kohës, por të gjithë përfunduan pa sukses. Shtrirja e luftës së forcave shqiptare kundër atyre turke në këtë kohë përfshinte një hapësirë të madhe. Rapsodi popullor këto pika gjeografike, i përkufizon dhe i përshkruan në këtë mënyrë:

*N'Kaçanik dej në Boletin,
Tonë Kosova u mlue m' tim;
U mlue m'tym, i ka dalë flaka,
E dogj në top Dergut Pasha²¹.*

Lufta dhe sakrifica e shqiptarëve për çlirimin e atdheut kishte marrë hov të madh. Ajo përhapej gjithnjë e më tepër, duke përfshirë shumë pika strategjike. Luftohej për çdo fshat e qytet, ngase shqiptarët e kishin kuptuar realitetin historik, dinin se ishte momenti i fundit për ardhmërinë e vendit e të kombit, andaj e bënë vdekjen pa menduar e pa u kursyer fare. Këtë vendosmëri të shqiptarëve, epika popullore historike e pasqyron me anën e këtyre vargjeve:

*- Edhe, kadalë, pasho, se s'je n' Rumeli,
E po, tash-o po sheh burr-o me sy-e,
Edhe qi djeg veten edhe t'përvlon ty-e²²!*

²¹ Demush Shala, *Këngë Popullore Historike*, Prishtinë, 1973, f. 233.

²² *Arkivi i Institutit Albanologjik të Prishtinës*, Këndoi: Dervish Shaqa, Dosja e Sadri Fetiut.

Karakteri etnopsikologjik i Isa Boletinit përballë sfidave të kohës

Heronjtë e fushëbetejave dhe të luftërave të ndryshme i bëjnë të mëdhenj luftërat e sakrificat sublime, që bëjnë ata, për t'i fituar ato, por edhe në anën tjetër, çfarë kundërshtari kanë: a janë të denjë, a janë të përmasave të njëjta, më të fortë, më të dobët, se çfarë strategjie përdorin, sa i dëgjojnë luftëtarët, sa luftëra i kanë fituar etj.

Këtë e dëshmojnë më së miri heronjtë tanë Skënderbeu, Isa Boletini, Mehmet Ali Pasha, Ali Pashë Tepelena, Shaban Polluzha, Adem Jashari e të tjerë. Isa Boletini u ballafaqua gjatë tërë jetës me kundërshtarë të fortë, me pashallarë, gjeneralë të ndryshëm, mbretër dinakë, të cilët përdorën çdo mundësi për ta bërë për vete, për ta luftuar, për ta vrarë, por kurrë nuk patën sukses. Isën e vrau vetëm tradhtia, por edhe Isa e vrau tradhtinë me zulmë, duke hyrë thellë në zemrat e të gjithë atdhedashësve të lirisë, në kujtesën e popullit, në rrëfimet dhe në epikën historike, si hero legjendar që u përjetësua.

Zulma e tij shkroi dhe madhëroi faqet më të ndritshme të historisë së kombit tonë, në të djeshmen, në të sotmen dhe në të ardhmen. Të dhënat historike dëshmojnë se të gjitha ngjarjet e mëdha, që u zhvilluan në kapërcyell të shek. XIX, në pjesën dërrmuese të trojeve shqiptare ndërlidhen me veprimtarinë luftarake e patriotike të Isa Boletinit. Ai ishte njeri me virtyte e karakter të lartë njerëzor. I mençur, dinjitoz, strateg ushtarak i pashoq, por në momente të caktuara bëhej i vendosur, i rrëmbyeshëm, pa marrë parasysh raportin e forcës kundërshtare, hynte në luftë dhe fitonte. Këto tipare i cilësojnë vetëm trimat e rrallë, siç ishte Isa Boletini. Qëndrimin e vet luftarak, Isa e shfaqte haptas, pa ngurruar para mbretërve, pashallarëve, gjeneralëve, diplomatëve të vendeve më të fuqishme, si

dhe para të gjithë kundërshtarëve të tij, qofshin të mëdhenj, qofshin të vegjël.

Si hero kombëtar kishte një besim të madh te populli, andaj e donte atë dhe e respektonte fjalën, dëshirën, mendimin dhe synimet e tij. Nga çdo luftë mësonte edhe më tepër artin luftarak. Të dhënat historike, folklorike dhe kujtesa e popullit dëshmojnë fuqishëm se ky burrë i madh, në ballafaqim me sulltan Hamitin II, ia kishte shfaqur haptas përcaktimin e tij - për lirinë e popullit shqiptar, pa marrë parasysh se kjo gjë nuk i pëlqente atij. Sulltani i ofroi grada, privilegje, pasuri që të jetonte si është më së miri, po ky i refuzoi, duke i thënë se e donte më shumë Boletinin sesa Stambollin. Nuk iu përgjigj as ftesës që të takohet me Sulltan Mehmet Rashiti V në Mazgit, te Tyrbja e sulltan Muratit, me rastin e vizitës së tij në Kosovë, më 17 qershor 1911. Pikëpamjet dhe kundërshtimet e tij ia shfaqti haptazi, vendosmërisht edhe Kral Nikollës të Malit të Zi, i cili mundohej në mënyrë perfide, që ta përvetësonte, që zulmën dhe forcën e tij t'i përdorte për të mirën e tij, t'i shtinte në luftë shqiptarët me turqit, t'i çlironin fshatra e qytete të tëra, e më në fund të hynte ushtria e tij e padëmtuar. Këtë skenar të krajlit Isa e kuptoi me kohë, andaj iu kundërvu energjikisht, duke i thënë: *nuk jam ardhë këtu për të ndërruar pushtuesin!*

Përcaktimin për mëvetësinë e shtetit shqiptar dhe të tokave të pandara etnike, ia shfaqti prerazi edhe ministrit anglez të Punëve të Jashtme, Eduard Greit, më 1913, në Konferencën e Londrës: “Nëse Evropa nuk do ta zgjidhë drejt çështjen e kufijve të Shqipërisë, Ballkani nuk do të ketë kurrë qetësi”²³. Qëndrimi dhe vizioni i Isa Boletinit për paqe e qetësi në hapësirën e Ballkanit mbetet i drejtë edhe sot e kësaj dite, paluhatshëm dhe ligjërish i arsyeshëm, se pa çlirimin dhe bashkimin e të gjitha tokave shqiptare në një shtet të

²³ Fatmire Musaj, *Isa Boletini*, Tiranë, 1978, f. 176.

vetëm - vështirë mund të ketë qetësi kjo hapësirë ballkanike dhe evropiane.

Nami i sfiduar i Isa Boletinit

Sipas kujtesës së popullit dhe të dhënave folklorike, Isa Boletini, në disa momente, për çështje të caktuara lidhur me organizimin e Kryengritjes së Përgjithshme, të vitit 1912 kundër turqve ka pasur mospajtime edhe me disa udhëheqës popullorë. Isën në Kuvendin e Kurulloves, para masës së tubuar e kundërshton rreptë Beqir Voca i Melenicës, plak i mençur i Shalës së Bajgorës, duke i thënë se i bashkohet besëlidhjes, "... por dine se jemi argat të huej"! Megjithatë, sipas ligjërimit popullor, Isa e detyron me dhunë të marrë pjesë në organizimin e përgjithshëm të kryengritjes shqiptare. Këto momente dramatike, kënga i paraqet në këtë mënyrë:

- *Çou, bre Zhivk! - fort ju ngërmue,
Shpejt ni letër me marue,
E kral Petrit me ja çue:
"Shumë selam Isa t'ka çue,
Beqir Voca â tye t'nimue"*²⁴!

Në vazhdim epika historike dhe kujtesa e popullit njofton se Beqir Voca i pezmatuar nga qëndrimi i Isait, që i drejtohet krajlit të Serbisë, se kinse edhe Beqir Voca, plaku i mençur po i ndihmon, atëherë ky i thotë Zhivkut:

- *Qysh t'tham unë, dajm ka me çkrue:
Mos kujto qi m'ke tradhtue,
Po me zor jam tye t'nimue*²⁵!

²⁴Këngë Popullore Historike, bleu II, IAP, Prishtinë, 2007, f. 290.

²⁵Po aty, f. 290.

Realiteti jetësor dëshmon fuqishëm se në kohët e liga lëmshi i thashethemeve ka mundësi të tirret më shumë, më gjatë dhe më hollë, veçanërisht për ngjarjet dhe figurat e shquara, që ndërlidhen me to. Marrëdhëniet e Isait me Pop Zhivkun e Vushtrrisë ishin reciproke, secili prej tyre është munduar ta shfrytëzojë njëri - tjetrin për interesa të veta dhe të kombit të vet. Isa ishte trim dhe besnik i madh, ndërsa popi i mençur, dinak, i pabesë. Isa me anë të popit i mbante lidhjet me Serbinë, kur kishte nevojë për të. Mirëpo, edhe Serbia kur donte të realizonte ndonjë qëllim të saj me Isën komunikonte nëpërmjet pop Zhivkut të Vushtrrisë.

Për të bëmat historike të heronjve, nganjëherë, thuhet edhe të pavërteta për ta. Zërat e ndryshëm, bien pre e propagandës së huaj, dashakeqësve, të cilët rrenën e bëjnë si të vërtetë, e lëshojnë me qëllim të caktuar, për të njollosë veprimtarinë luftarake e patriotike të tyre. Nga kjo e keqe, as Isa Boletini, nuk u kursye, bile, në disa raste, edhe u atakua drejtpërdrejt. Në vllugun më të madh të zhvillimit të ngjarjeve, të luftërave që bëheshin kundër të huajit për çlirim kombëtar, nëpër disa fshatra të Shalës së Bajgorës fillojnë të përhapen fjalë të pavërteta, të papeshuara mirë se kinse Isa Boletini, nuk është në nivel të duhur kombëtar. Po blen armë prej shkaut, prej Serbisë e po e shet Kosovën etj. Lidhur me këto thashetheme janë krijuar rrëfime të ndryshme, të cilat janë përcjellë brez pas brezi. Ja, një anekdotë e tillë. Në një rast paria e fshatit Kaçanoll të Shalës së Bajgorës, i paskan thënë:

- Pse Isa Beg e shite Kosovën?! - E shita, valla, edhe zemra vërr s'mbani! E pata më vështirë kur i dorëzova çelsat e kalasë së Koçandollit. Aq shumë u mërzita sa belivallahu shpirti desh m'lsjoj prej kjametit²⁶!

²⁶ Fazli Hajrizi, "Figura e Isa Boletinit në këngët popullore", në veprën: *Isa Boletini dhe koha e tij*, Instituti i Historisë, Prishtinë, 1998, f. 179 - 180.

Nga ajo që thuhej për Isën s'kishte asgjë të vërtetë, andaj heroi me një gjakftohtësi e urti, tërë atë trillim, e kthej në shaka e cinizëm. Isa kurrë nuk hynte në ujëra të turbullta, por të painformuarit, dashakeqësit e lignin nga pak. Mirëpo, një gjë është e sigurt, se propaganda serbe vazhdimisht punonte për t'i përçarë udhëheqësit shqiptarë. E pakontestueshme është se armiqtë e tanë, gjithmonë atë çka nuk mundën ta bëjnë në fushën e betejës, për zhdukjen fizike të figurave të shquara kombëtare, e arritën në saje të tradhtisë, kjo na përcjell me shekuj, të cilën fatkeqësisht shumë herë gjatë historisë e vunë në përdorim dhe patën sukses.

Trimat më të mëdhenj të popullit tonë, duke u mbështetur te tradhtia, armiqtë arritën t'i asgjësojnë. Një fat të tillë të keq e pati edhe Isa Boletini, të cilin më 23 janar 1916, në Urën e Ribnicës së bashku me shtatë bashkëluftëtarë të tij e vranë në pritë. Edhe vdekja e Isa Boletinit me luftëtarët e tij, në pritë, ishte fljijim madhështor, ai nuk u dorëzua, por luftoi dhe shpagoi veten dhe luftëtarët e tij për disa herë duke lënë të vdekur shumë malazezë, morti i të cilëve nuk i ka lënë të qetë për shumë kohë. Luftën e tij në këto momente dramatike, të ndeshjes ballë për ballë, Isa dëshmoi fuqishëm se nuk e njihte forcën e armikut as vdekjen. Këtë më së miri e paraqesin këto vargje të këngës popullore:

- Zo', çka asht-e, he, ky nam beteri,

O Podgoricën, he, ma mloi jezeri,

O po lifton, more, he, ai Isa Begu²⁹!

Isa Boletini me veprimtarinë e tij patriotike u bë i pavdekshëm. Ai u bë legjendë në mendjen e zemrën e shqiptarëve, u bë

²⁹Arkivi i Institutit Albanologjik të Prishtinës, Këndoi: Dervish Shaqa, Dosja e Sadri Fetiut.

frymëzim që, nxiti, mobilizoi breza të shumtë, për luftë dhe sakrificë, mësim se si duhet, nderohet, e mbrohet atdheu, por dhe si ndëshkohet tradhtia e armiku.

Prof. dr. Adem ZEJNULLAHU

SUMMARY

ISA BOLETINI ACCORDING TO THE EPICS OF HISTORY, POETRY AND PEOPLE'S MEMORIES

The paper treats in a detailed manner the patriotic activity of Isa Boletini, in facing foreign conquerors throughout history, according to the historical epics, poetry and people's memories. The figure of this national hero is closely related to some significant events, both tragic and great, not only for the region of Shala of Bajgorës, but for the fate of the nation in general. A special dimension of this study, aside from the discussion of wars between Isa and the Ottoman military forces, as well as those Serbian and Montenegrin, particularly during 1909, 1910, 1911, 1912, is paid to the description of his appearance, both in a physical and moral aspect. Of this we know through national rhapsody emitted by songs, as well as by our famed poets, who dedicated much poetry to this legendary and valiant man. A particular place in this treatise is dedicated to the relations that Isa Boletini had with the most renown Albanian figures, their agreements to wage war jointly at a given time, particularly so with Beqir Voca and Hasan Prishtina. Isa Boletini thanks to his patriotic activity became a memorial to liberty, immortal, and an inspiration to new generations on how the fatherland should be protected. It is for this reason that many songs were sung for him, just as many stories and poetry were told for him.

Mulla Asllan MURATI
(Mitrovicë)

SJELLJA E ESHTRAVE TË HEROIT KOMBËTAR ISA
BOLETINI NGA MALI I ZI NË MITROVICË

Iniciator për sjelljen e eshtrave të heroit kombëtar Isa Boletini në Kosovë ka qenë akademik Pajazit Nushi. Në fund të muajit prill 1998, në Mitrovicë ka ardhur akademik Nushi me prof. dr. Masar Rizvanollin, ku janë takuar me prof. Latif Berishën dhe më kanë ftuar mua, si kryetar i Këshillit të Bashkësisë Islame në Mitrovicë. Së bashku kemi shkuar në një shtëpi private në lagjen “Iliridë”, sepse ishte kohë lufte dhe i vinte era barut. Kemi filluar bisedën ku prof. dr. Pajazit Nushi m’u ka drejtua mua duke më thënë: “Kemi ardhur të bisedojmë me ju për sjelljen e eshtrave të heroit tonë kombëtar Isa Boletini me bashkëluftëtarë të tij”. Zoti Pajazit Nushi më tha: “Unë qysh kur kam qenë përgjegjës për arsim e kulturë në vitet 1968-1970, kam shkuar në Mal të Zi-Podgoricë për t’i marrë eshtrat e heroit tonë në mënyrë zyrtare. Por, kur jam paraqitur në organet e pushtetit të Malit të Zi ata më kanë takuar me një historian, i cili ishte akademik. Dhe kur unë ia paraqita kërkesën në emër të organeve të Kosovës, ai mu përgjigj duke më thënë se nuk mundem me ua dhënë eshtrat e Isa Boletinit, sepse dihet se si është vrarë ai. Isa Boletini ka qenë aleat i

Austro-Hungarisë, kurse Austro-Hungaria ka qenë okupator për ne “ - i kishte thënë zyrtari malazez.

Akademik Nushi, vazhdoi duke më thënë mua se tani ka ardhur koha që eshtrat e heroit tonë t’i sjellim në Kosovë, dhe tani nuk ka mundësi tjetër vetëm përmes Bashkësisë Islame. Ai mu ka drejtua mua, duke më thënë: “A mundesh me marr përsipër këtë detyrë?” Unë pa hezituar iu kam përgjigjur pozitivisht, dhe i kam thënë se do të angazhohem maksimalisht, duke e ditur rëndësinë e sjelljes së eshtrave të Isa Boletinit me bashkëluftëtarë të tij. Kam shpresuar se do t’ia dalë dhe ia kam dalur, sepse në Mal të Zi-Podgoricë e kisha një koleg të mirë dhe besnik. Ai është prof. Idriz Demiri, kryetar i Bashkësisë Islame për Malin e Zi.

Për këtë unë isha i sigurt, sepse me mulla Idriz Demirin unë njihesha shumë më herët. Për 8 vjet kemi qenë së bashku në organe të larta të Bashkësisë Islame, në nivel të ish-Jugosllavisë. Kurse, prej 1986-1990 ai ishte kryetar i Kuvendit të Bashkësisë Islame për Jugosllavi, kurse unë isha nënkryetar i Kuvendit të Bashkësisë Islame të Jugosllavisë. I thash akademik Nushit se unë shpresoja shumë që mulla Idriz Demiri do të na dalë në ndihmë për këtë çështje. Pas këtyre bisedimeve, vendosëm që unë së bashku me Muhamed Shukriun nga Prizreni, i cili e dinte se ku gjendej varri i Isa Boletinit me bashkëluftëtarët e tij dhe Remzi Murati, nip i Isa Boletinit, më saktë djali i vajzës së tij, të shkonim në Podgoricë. Më datën 6 maj 1998 jemi nisur për Podgoricë, ku Fetah Hasani, nga Kqiqi na dërgoi me makinë deri në Podgoricë. Kur kemi arritur në Rozhajë, policia e Malit të Zi na ndali dhe na kontrolloi për armë. Vazhduam për Podgoricë më pas dhe kur arritëm atje, së pari shkuam te varrezat në Pobërgjë. Muhamed Shukriu e kishte bërë një maketë që në vitin 1968, se ku gjendeshin varret e Isa Boletinit me

bashkëlufëtarë. Kur dolëm nga makina te varrezat, unë e hoqa shallin, e lashë në makinë.

Muhamed Shukriu e nxori vizatimin, e vendosi në trotuar duke thënë se prej asaj pike në distancë prej 8 metra ishte varri i Isa Boletinit. Pastaj shkuam në Bashkësinë Islame, ku u takuam me prof. Idriz Demirin. Unë i thashë: “Idriz efendi, kemi ardhur me një punë shumë të rëndësishme, kemi ardhur me i marrë eshtrat e Isa Boletinit me bashkëlufëtarët e tij”, ndërsa ai na u përgjigj: “Nuk na i japin malazezët!” - unë vazhdova - “Ne duhet t’i marrim, varrezat ishin shndërruar në lëndinë, dhe fëmijët luanin futboll, kurse në një pjesë tjetër kishin vendosur një kompleks lodrash për fëmijë”. Mulla Idrizi na pyeti: “E dini se ku është saktësisht varri i Isa Boletinit?” - ne i thamë - “Po e dimë”, sepse para se të shkonim te ai ishim te varret.

Më pyeti edhe nëse e kisha mbajtur shallin gjatë vizitës në varreza. I thashë jo. Më tha: “Mirë ke bërë, sepse po të kishin parë me shall në varreza do të të zbulonin menjëherë autoritetet malazeze”. Unë i thashë: “Ne sot duhet ta shkruajmë një kërkesë zyrtare për Kuvendin Komunal që të na lejojë transferimin e atyre varrezave prej atij vendi në një vend tjetër, me arsyetimin se mbi to po bëhej diskriminim”. Atëherë kemi bërë këtë kërkesë gjoja se Bashkësia Islame e Malit të Zi, po kërkon transferimin e varrezave në një vend tjetër dhe atë kërkesë e kemi dërguar në Kuvendin Komunal të Podgoricës më datë 7 maj 1998. Nga aty jemi kthyer për Mitrovicë.

Autoritetet e Podgoricës janë përgjigjur pas pesë muajsh, në tetor 1998 dhe kanë shpallur në fletën zyrtare të Komunës dhe në gazetën “Pobeda” se kush dëshiron të transferojë eshtrat e familjarëve të vetë, nga varrezat e Pobërgjës mund t’i bartë ato lirisht. Ditën që është publikuar ky vendim, mulla Idriz Demiri më ka ftuar me telefon dhe më ka thënë: “Vendimi i Kuvendit Komunal për

zhvarrosjen e varrezave të Pobërgjës është publikuar prandaj duhet sa më parë të vinin në Podgoricë për t'i marrë eshtrat e Isa Boletinit me bashkëluftëtarët”.

Të nesërmen e kam ftuar prof. Latif Berishën dhe e kam njoftuar për vendimin e publikuar. Latifi atë ditë ka shkuar në Prishtinë te presidenti dr. Ibrahim Rugova, tani i ndjerë, dhe e ka informuar për këtë situatë. Presidenti Rugova ia ka dhënë prof. Berishës 2 000 marka në emër të shpenzimeve që do të bëheshin për bartjen e eshtrave. Prof. Latif Berisha m'i ka dhënë mua ato 2 000 marka dhe unë e kam ftuar Muhamed Shukriun dhe Remzi Muratin dhe ua kam dhënë ato para dhe i kam përcjellë me makinën time deri në stacion të autobusëve. Unë nuk kam shkuar këtë herë me ta, me qëllim që mos t'u bija në sy organeve të atëhershme, sepse isha me uniformë të hoxhës.

Ata dy kanë shkuar dhe fillimisht janë paraqitur në Bashkësinë Islame, pastaj kanë filluar me punën për hapjen e varreve, ku për çdo ditë kanë hapur nga një varr. Eshtrat i kanë vendosur në qese të najlonit e pastaj në valixhe. Secila qese ka pasur inicialet dhe jo me emra të plotë. Pas 8 ditësh valixhet i kanë vendosur në bagazh të autobusit dhe kanë arritur në Mitrovicë në KB Islame. M'i kanë dorëzuar mua, por ishim betuar që këtë çështje do ta mbanim sekret. Pas dy ditësh Muhamed Shukriu ka ardhur me Latif Berishën dhe i kemi vendosur etiketat me emër e mbiemër në secilën qese të najlonit. Pastaj kemi biseduar se ku t'i vendosnim dhe pas një bisede të gjatë ata të dy më thanë: “Po t'i lëmë amanet, vendosi ti ku të duash”. Unë e sigurova një arkivol të metaltë, i ftova dy mjeshtër pas akshamit dhe i vendosëm qeset me eshtra në arkivol. Pastaj mjeshtrit H. Mustafë Shala dhe H. Mehmet Berani e salduan arkivolin dhe pas jacisë në ora 22:00, e kemi hapur një varr të ri dhe e kemi vendosur arkivolin në oborr të xhamisë së Haxhi Veselit. Aty

kanë qëndruar deri në vitin 2004. Në 2004 u morë vendim që të bëhet rivarrimi i eshtrave. Për atë u kujtes vetë Ibrahim Rugova, duke angazhuar ministrat Behxhet Brajshorin dhe Rexhep Osmani, duke krijuar Këshillin për Rivarrim të Eshtrave të Isa Boletinit me bashkëluftëtarët e tij. Në këtë Këshill ishte: Pajazit Nushi, Zekeria Cana, Arif Muqolli, (unë) Asllan Murati, Remzi Murati dhe personalitete tjera.

E bëmë projektin dhe u parapa që të mbahej një akademi në Teatrin Kombëtar në Prishtinë, ku do të fliste presidenti Ibrahim Rugova. Në Mitrovicë ishte caktuar të fliste kryetari i Komunës Faruk Spahiu, kurse në Boletin, të fliste kryeministri Bajram Rexhepi, Agim Çeku si gjeneral i TMK-së dhe Zekeria Cana si historian. Kur kemi kërkuar nga KFOR-i që rivarrimi të bëhej në përcjellje ushtarake dhe fjalim të mbante komandanti Agim Çeku. Atëherë KFOR-i na ishte përgjigjur: “Agim Çeku, si gjeneral i TMK-së nuk bën me dal në Boletin, sepse është komunë e Zvjeçanit”. Ne dërguam dy ministrat te presidenti Rugova për t’u konsultua, se si të vepronim tani. Presidenti iu është përgjigjur: “Prolongoni, derisa të bëhen kushtet, sepse gjenerali ynë Isa Boletini meriton të përcillet në mënyrë ushtarake” - kishte thënë presidenti. Pasi u shty rivarrimi, për shkak të sigurisë, unë i kam tërhequr prej oborrit të xhamisë eshtrat e heroit Isa Boletinit me bashkëluftëtarë dhe i kam vendosur në oborrin tim, ku kanë qëndruar deri në vitin 2011. Atë vit ia kam dorëzuar kryetarit të Mitrovicës Avni Kastratit, me një ceremoni zyrtare. Ditën kur i kam dorëzuar eshtrat, të pranishëm kanë qenë akademik Pajazit Nushi, dr. Arsim Gërxhaliu, dr. Mehmet Halimi, dr. Shefki Sejdiu, dr. Jusuf Osmani, dr. Mehmet Rukiqi, familjarë nga Boletini dhe nga Isniqu. Kemi përpiluar një shkresë ku thuhej: “Sot po i dorëzojmë eshtrat e heroit tonë kombëtar Isa Boletini me bashkëluftëtarë të tij, kryetarit të Komunës z. Avni Kastratit. I dorëzuan akademik Nushi

dhe prof. mulla Asllan Murati. I pranon kryetari i Komunës së Mitrovicës Avni Kastrati”. Pra, prej atij momenti unë nuk i kam pasur më në mbrojtje eshtrat e heroit Isa Boletini me bashkëluftëtarë të tij, por jam interesuar vazhdimisht për realizimin e rivarrimit të tyre.

Unë jam krenar që për 13 vjet rresht i kam ruajtur me kujdesin më të madh eshtrat e Isa Boletinit me bashkëluftëtarët e tij. Kam sakrifikuar edhe familjen time, sepse kanë qenë kohë të vështira. Jam shumë krenar gjithashtu që i kam shërbyer qoftë edhe në këtë formë gjeneralit Isa Boletini. Derisa po i mbaja ende në shtëpinë time të fshehur eshtrat, më 17 shkurt të vitit 2008, kur është shpallur Pavarësia e Kosovës, kam shkuar te varri dhe i kam thënë: “O Isa Bej, pusho i qetë, se ajo për të cilën sakrifikove pasurinë, familjen dhe jetën tënde, u bë realitet. Sot Kosova është e lirë dhe Ti pusho i qetë. Tani edhe Ti do të pushosh në vendlindjen tënde”.

**Akademik Beqir META - Drejtor i Institutit të Historisë-
Tiranë**

**FJALA E MBYLLJES SË KONFERENCËS SHKENCORE:
“ISA BOLETINI NË LËVIZJEN KOMBËTARE SHQIPTARE”**

***I nderuar Z. Drejtor i Institutit të Historisë së Kosovës, prof.
assoc. dr. Sabit Syla,
I nderuar Z. Drejtor i Institutit për Trashëgimi Shpirtërore e
Kulturore të Shqiptarëve-Shkup,
dr. Skënder Asani,
Të dashur kolegë,
Miq të nderuar,***

Me kënaqësi të veçantë dua të shpreh para jush disa vlerësime për Konferencën Shkencore: “Isa Boletini në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare”, punimet e së cilës po i drejtohen fundit. Dëshiroj të përgëzoj të gjithë referuesit, të cilët me përkushtim sollën kontribute të vlefshme shkencore me analiza e argumente të reja për veprimtarinë e Isa Boletinit në kuadrin e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Kjo konferencë e cila pati 24 kumtime interesante, u zhvillua nën patronazhin e Kuvendit të Kosovës dhe

të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Shumë kuptimplotë ishte mbajtja e saj në selinë e Kuvendit të Kosovës, fakt që na bën të mendojmë e të jemi krenar se ëndrra dhe ideali i Isa Boletini dhe i shqiptarëve atdhetarë të të gjitha brezave është sot një realitet i prekshëm. Kontributi i tyre, gjaku i tyre qëndron në themelet e lirisë që gëzojmë ne sot. Po kështu kjo konferencë në thelbin e saj është kontribut i përbashkët i tre instituteve tona: Institutit të Historisë në Prishtinës, Institutit të Historisë-Tiranë, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve-Shkup, si dhe i studiuesve të tjerë shqiptarë, të cilët kanë një bashkëpunim të ngushtë midis tyre në ndriçimin e historisë sonë kombëtare, çka me siguri është një motiv që e ka frymëzimin e vetë edhe në dimensionin e figurës së Boletini dhe mesazhet që rrezaton ajo.

Rikthimi i Isa Boletinit mes nesh në tempullin e shtetësisë së Kosovës është një ngjarje sa emocionuese aq edhe frymëzuese për ne dhe çdo shqiptar. Gjithashtu, kjo ishte një mundësi për të gjithë ne që të rishqyrtonim rrethanat në të cilat gjendej kombi ynë në kohën që padyshim mban vulën e bëmave të tij. Pikërisht këtë kontribut përftuam nga konferenca e sotme, e cila solli analiza dhe fakte të reja shkencore mbi një sërë çështjesh të rëndësishme historiografike, si: dimensionin ushtarak i veprimtarisë së Isa Boletinit, kontributi i tij në kryengritjet antiosmane, kontributi i tij në rezistencën kundër pushtuesve serbë, për mbrojtjen dhe jetësimin e Shqipërisë së pavarur, deri tek qëndrimi i tij human ndaj minoritetit serb, çka flet për një dimension tjetër madhor të këtij burri të madh shqiptar. Figura e Isa Boletinit u ndriçua në mënyrë interesante dhe objektive nga një sërë referatesh të ndërtuara mbi

bazën e burimeve të ndryshme publicistike e diplomatike, si në këndvështrimin e shtypit xhonturk, të burimeve diplomatike britanike, burimeve serbe, austro-hungareze, malazeze dhe bullgare.

Gjithashtu u sollën të dhëna interesante për figurën e tij në epikën historike dhe kujtesën popullore. Unë dëshiroj nga zemra të përgëzoj referuesit për kumtimet interesante dhe me nivel shkencor, si dhe organizatorët e kësaj konference të rëndësishme e produktive shkencore, veçanërisht kolegun tim të nderuar, drejtorin e Institutit të Historisë së Kosovës “*Ali Hadri*”, prof. asoc. dr. Sabit Syla, për organizimin shumë të mirë të kësaj konference. Kam bindjen se për figurën e Isa Boletinti ka ende punë për të bërë dhe arkivat na rezervojnë ende fakte kuptimplota që do ta plotësojnë edhe më tej aktivitetin dhe personalitetin e këtij Garibaldi shqiptar. Historianët shqiptarë nuk do të reshtin së hulumtuari rreth figurës dhe kohës së tij, e cila qëndron në themelet e kombit modern shqiptar. Duke ju falënderuar të gjithëve për pjesëmarrjen dhe kontributin tuaj, punimet e kësaj konference i deklaroj të mbyllura.

Ju faleminderit!

Prishtinë, më 5 qershor 2015

ISA BOLETINI NË LËVIZJEN KOMBËTARE
SHQIPTARE

Botues: Instituti i Historisë “Ali Hadri” –Prishtinë
Formati: 14.8 X 21.8 cm

Tirazhi: 500 ekzemplarë

Realizimi kompjuterik:
Dr. sc. Teuta SHALA - PELI

U shtyp në shtypshkronjën- Europrint

Prishtinë, 2015

Katalogimi në botim – **(CIP)**

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

94(=18)(063)

929(496.51)Boletini, Isa

Isa Boteltini në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare :
(materiale nga Konferenca Shkencore kushtuar 99-
vjetorit të rënies së Isa Boletinit, mbajtur në Prishtinë
me 05 qershor 2015) / Kryeredaktor Sabit Syla. –
Prishtinë : Instituti i Historisë “Ali Hadri”, 2015. –
360 f. ; 14.8 X 21.8 cm

1.Syla, Sabit

ISBN 978-9951-409-44-5